FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.11 **Datë 21 shkurt 2006**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Udhëzim i MF nr.1, datë 30.1.2006	Për sistemin e taksave kombëtare në Republikën e Shqipërisë	223
Udhëzim i MF nr.2, datë 30.1.2006	Për procedurat tatimore……	238
Udhëzim i MF nr.3, datë 30.1.2006	Për tatimin mbi vlerën e shtuar……	271
Udhëzim i MF nr.4, datë 30.1.2006	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore……	316
Udhëzim i MF nr.5, datë 30.1.2006	Për tatimin mbi te ardhurat……..	341

UDHËZIM
Nr.1, datë 30.1.2006

PËR SISTEMIN E TAKSAVE KOMBETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8977, datë 12.12.2002 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministria e Financave nxjerr këtë:

UDHËZIM:

1.Dispozita të përgjithshme

1.1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit Nr.8977, datë 12.12.2002, taksat kombëtare derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit. Taksat vjetore, me përjashtim të taksës vjetore të qarkullimit rrugor, arkëtohen nga agjentët e taksave brënda tremujorit të parë të vitit në vazhdim. Kur detyrimi lind në 6-mujorin e parë te vitit, taksat paguhen në masën 100%, ndërsa kur detyrimi lind për herë të parë në 6-mujorin e dytë, taksat paguhen në masën 50 për qind të shumës së taksës vjetore të përcaktuar në ligj.

1.2. Në zbatim të nenit 6 të ligjit agjentët e taksave janë të detyruar të bëjnë vjeljen e taksave dhe të derdhin në buxhet shumat e vjela sipas ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

1.3. Në zbatim të nenit 9, agjentët e taksave të përcaktuar në nenin 6 të ligjit, përfitojnë një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat. Punonjësit e taksave në degët e tatimeve në rrethe bëjnë aktrakordime me agjentët e taksave për taksat e vjela, si dhe përcaktojnë shumën që u takon agjentëve të taksave. Aktin e rakordimit, i cili do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave, përfaqësuesi i agjentit të taksave, si dhe nga kryetari i Degës së Tatimeve, agjentët e taksave duhet ta paraqesin në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave. Modeli i aktit të rakordimit dhe përmbajtja e tij do të jetë sipas formularit nr.1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kriteret e përdorimit të komisioneve që ju jepen agjentëve të taksave janë përcaktuar në ligj dhe përdoren:

- për shpërblimin e punonjësve që merren me vjeljen e taksave. Drejtuesi i agjentit të taksave cakton punonjësit që merren me vjeljen e taksave. Këta punonjës përgjigjen për vjeljen dhe arkëtimin e taksave sipas ligjit;
- për përballimin e shpenzimeve të vjeljes së taksave si prodhim pulla takse, shtypshkrime, komisione bankare etj.).

2.Dispozita të veçanta

Sipas llojit të taksave, kemi :

2.1. Taksat portuale.

Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjencive detare shtetërore ose private. Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë në bazë të nivelit të taksave të përcaktuara në lidhjen nr.1 të ligjit "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë". Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes dhe janë të vlefshme për të gjithë kohën që anija qëndron në port.

Në kuptimin e pikës 6 të lidhjes nr.1, nëse anija për kryerjen e veprimeve të saj do të prekë edhe një port tjetër shqiptar, paguan vetëm në portin e parë. Pra, nëse një anije mbërrin në Durrës dhe shkarkon një pjesë të mallit dhe në të njëjtin rejs shkarkon pjesën tjetër në Shëngjin atëherë kjo anije paguan vetëm në portin e parë. Në qoftë se një anije që vjen nga një port i huaj shkarkon në portin e Durrësit ku paguan taksat portuale dhe ngarkon në këtë port një mall të ri të cilin e shkarkon në një port tjetër shqiptar si p.sh. në Vlorë, atëhere kjo anije do të paguajë taksat portuale edhe në portin e Vlorës.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë pavaresisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar. Pagesat e taksave nga anijet e huaja bëhen në euro sipas lidhjes nr.1 të ligjit. Në zbatim të pikës 5 të kësaj lidhje taksat portuale mund të paguhen edhe në valuta të tjera lirisht të konvertueshme me kursin ditor të këmbimit. Për anijet e personave juridike apo fizike shqiptare shtetëror apo privat taksat llogariten dhe paguhen në lekë apo valutë, duke e konvertuar me kursin ditor të këmbimit në bankë. Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në

pronësi të vet dhe anijet e marra me qera. Të gjitha përjashtimet nga pagesat e taksave portuale të parashikuara në këtë ligj do të regjistrohen në nje regjistër të veçantë sipas formularit nr.8 bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2.2. Taksat për shërbimet konsullore

Taksat për shërbimet konsullore vilen nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme dhe institucionet e tjera në varësi të tyre sipas përcaktimeve të bëra në ligj.

Shtetasit që pajisen me pasaportë për dalje jashtë shtetit, përveç pagimit të vlerës së pasaportës do të paguajnë dhe taksën të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të lidhjes nr.2 "Taksat për shërbimet konsullore".

Për shërbimet që kryhen nga përfaqësitë tona diplomatike në vende të tjera, në bazë të lidhjes nr.2 "Për taksat për shërbimet konsullore" niveli i taksës përcaktohet në euro dhe pagimi i tyre mund të bëhet në euro, në dollarë ose në monedhën e vendit ku kryhet shërbimi, konvertuar me kursin përkatës ditor të këmbimit.

Ministria e Punëve së Jashtme çdo muaj derdh në degën e thesarit Tiranë shumën e taksave konsullore të arkëtuara nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë shtetit. Dega e thesarit pasi bën rakordimet e nevojshme me Ministrinë e Jashtme, brenda ditës së fundit të muajit, shumën e taksave konsullore e kalon në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Me termin përfaqësi kuptohet përfaqësia diplomatike apo konsullore e Republikës së Shqipërisë jashtë shtetit. Taksat për veprimet konsullore arkëtohen me fillimin e procedurës përkatëse. Institucionet shtetërore që do të presin shtetas të huaj, të cilët sipas nenit 10 të ligjit janë të përjashtuar nga pagesa e taksës së vizës ose të hyrjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, i konfirmojnë pikave të kalimit të kufirit, emrat e personave të cilët janë të përjashtuar. Konfirmimi për këtë qëllim jepet vetëm nga titullari i institucionit shtetëror.

Ministria e Jashtme i dërgon Ministrisë së Brendshme, listën e taksës së vizës dhe të hyrjes. Ministria e Brenshme dërgon në PKPK listën e taksës së vizës dhe të hyrjes.

Taksa e hyrjes ose taksa e vizës paguhet në euro, ose valutë tjetër lirisht të konvertueshme. Me vjeljen e taksës së hyrjes në territorin e Republikes së Shqipërisë ngarkohen PKPK. Me vjeljen e taksës së vizës ngarkohen edhe përfaqësitë. Në rastet kur viza jepet në kufi taksa e vizës arkëtohet nga PKPK mbi bazën e konfirmimit nga dega e vizave në Ministrinë e Brendshme. Vjelja e taksës së hyrjes ose të vizës në PKPK dokumentohet me mandatarkëtimi, i cili duhet të përmbajë veç shënimeve standarde, edhe shtetësinë e paguesit, numrin rendor të regjistrit të hyrjes të shtetasve të huaj, llojin e monedhës që derdh i huaji. Mandati i arkëtimit përpilohet nga kontrolli i shërbimit të PKPK, në dy kopje, njëra nga të cilat i jepet qytetarit të huaj dhe tjetra mbahet nga PKPK.

Përjashtimisht për pikën e kontrollit të kalimit kufitar Rinas në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit ngarkohet Tirana Airport Partnes për vjeljen e taksës së hyrjes apo të vizës për shtetasit e huaj. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme, japin zyrtarisht nivelin e taksave të hyrjes apo të vizës për çdo shtet.

Të ardhurat e realizuara nga vjelja e taksave derdhen çdo 5 ditë në llogarinë e degës së tatimeve.

Në zbatim të nenit 8, shkronja a, për vjeljen e taksave konsullore me anën e pullës, Ministria e Jashtme planifikon dhe porosit në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve pullat konsullore për nevojat e saj dhe të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

2.3. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve

Taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve i nënshtrohen të gjitha mjetet e klasifikuara sipas lidhjes nr.10 të ligjit, që janë të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Kjo taksë arkëtohet nga Qendrat e Kontrollit Teknik të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Pagesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik të mjetit. Vlera e taksës është vjetore pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet. Edhe mjetet e reja, pavarësisht nga momenti i targimit të tyre, paguajnë vlerën e plotë të taksës. Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë, me pullën e taksës, si dhe biletën me numër serial në të cilën përveç të dhënave të mjetit shënohet edhe vlera e taksës së paguar. Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit vizual nga organet e Ministrisë së Brendshme dhe Policia Tatimore. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 9

pika 3 të ligjit. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre.

Drejtoritë Rajonale të Transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me degët e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë forma dhe përmbajtja e të cilit jane sipas formularit nr.2 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në degët përkatëse të tatimeve listën e mjeteve të regjistruara, duke shënuar edhe datën e fundit të kontrollit teknik të mjetit.

Drejtoritë Rajonale, deri në datën 15 të muajit pasardhës, evidentojnë dhe dërgojnë në degët përkatëse të tatimeve dhe në organet e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk janë paraqitur për të bërë kontrollin teknik dhe që për rrjedhojë nuk kanë paguar taksën.

2.4. Taksa e qarkullimit të automjeteve të huaja.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e doganave në pikat e kalimit kufitar. Personat në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, pajisen nga degët e doganave me një vërtetim hyrje sipas formularit nr.3 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky vërtetim mbahet në dy kopje, nga të cilat njëra i jepet personit që hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjet me targë të huaj, ndërsa kopja tjetër ruhet në degët e doganave. Ky vërtetim është i detyrueshëm të paraqitet në degën e doganës në pikën e kalimit kufitar në dalje, me qëllim që degët e doganave të llogarisin dhe arkëtojnë taksën e qarkullimit të automjetit me targë të huaj dhe të arkëtojnë taksën për ditët e qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo pagesë bëhet me mandat arkëtimi, një kopje e të cilit i jepet personit, ndersa kopja tjetër i bashkëngjitet vërtetimit që personi paraqet në dalje dhe ruhet në degën e doganës.

Për rastet kur automjeti me targë të huaj, me akt noterial, kalon në pronësi të personave të tjerë dhe pajiset me targë shqiptare, pronari i paraqet degës së doganës në momentin e zhdoganimit të automjetit vërtetimin e hyrjes që i është dhënë personit në pikën e kontrollit të kalimit kufitar në hyrje, me qëllim që të llogaritet edhe taksa e qarkullimit të automjetit për ditët e qëndrimit në Shqipëri. Drejtoritë rajonale të transportit rrugor nuk bëjnë pajisjen me targa shqiptare si dhe regjistrimin e mjetit pa u paguar detyrimet e taksës së qarkullimit të automjeteve të huaja.

Shumat e taksave të arkëtuara në degët e doganave regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr.4 bashkëngjitur këtij udhëzimi, ku shënohet lloji i mjetit, ditët e qëndrimit, si dhe shuma e taksës së paguar.

Në zbatim të nenit 10 të ligjit, përfituesit e përjashtimeve nga pagimi i kësaj takse paraqesin pranë degës përkatëse të tatimeve një kërkesë ku përcaktohet automjeti me targë të huaj, tipi, numri i shasisë dhe targa përkatëse. Dega e tatimeve i lëshon kërkuesit një shkresë nëpërmjet të cilës miraton përjashtimin. Me paraqitjen e kësaj shkrese të lëshuar nga dega e tatimeve, dega e doganës në hyrje lëshon një vërtetim sipas formularit nr. 5 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ky vërtetim është në dy kopje, një prej të cilave i jepet zotëruesit të mjetit, ndërsa kopja tjetër ruhet në degën e doganës. Në dalje të mjetit me targë të huaj nga territori i Republikës së Shqipërisë, dega e doganës detyron zotëruesin e mjetit të dorëzojë kopjen e vërtetimit.

Nga zbatimi i këtij rregulli përjashtohen automjetet e rregjistruara në territorin e Kosovës të cilat, në zbatim të pikës (d) të nenit 10 të ligjit të sipërpërmendur e përfitojnë përjashtimin automatikisht (pra pa plotësuar procedurat e mësipërme).

2.5. Taksa e importimit të automjeteve të përdorura.

Agjent tatimor për vjeljen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura janë degët e doganës në pikat e kalimit të kufirit. Kjo taksë paguhet nga importuesi i automjetit në momentin e zhdoganimit të tij. Degët e doganës bëjnë llogaritjen e taksës së importimit të automjeteve të përdorura sipas llojeve të mjeteve:

2.5.1. Për autoveturat

Llogaritja e taksës bëhet sipas formulës:

Taksa fikse x Cilindrata e motorit x koeficienti i viteve të përdorimit. Taksa fikse për autoveturat me naftë është 25 mijë lekë, ndërsa për autoveturat me benzinë 20 mijë lekë. Cilindrata e motorit është volumi i dhomës së djegjes së motorrit të shprehur në centimetër kub dhe është dhënë në cetifikatën shoqëruese të mjetit.

Vite përdorimi quhet diferenca ndërmjet vitit kur mjeti hyn në doganën shqiptare dhe vitit të prodhimit.

Shembull: Llogaritja e taksës për një autoveturë tip benz 190 i prodhuar në vitin 2000 me

naftë dhe i importuar ne vitin 2005, behet si me poshte:

Koeficienti sipas ligjit është 0.0018

Cilindrata e motorit është 1930 centimetër kub

Taksa fikse 25 mije leke.

1930 x 25000 x 0.0018 = 86.9 mijë lekë

Shembull: Llogaritja e takses për një autoveturë e cila në momentin e zhdoganimit ka mbi 10 vjet prodhimi, per të njëjtin tip autoveture si ne shembullin e mesiperm, behet si me poshte :

1930 x 25000 x 0.003 = 144.8 mije leke

2.5.2. Për mjetet e tjera të transportit

Llogaritja e takses është e diferencuar sipas vitit të prodhimit :

prodhuar deri në 31 dhjetor 1995, dhe

prodhuar nga 1 janari 1996

Taksa është fikse sipas llojit të mjetit e përcaktuar në pikën 5 të nenit 5 të ligjit. Degët e doganës të gjitha arkëtimet nga taksat i evidentojnë në regjister, sipas formularit nr.6 bashkengjitur ketij udhezimi.

2.6. Taksa e pajisjes me leje drejtimi për drejtim automjeti.

Taksa për pajisjen me leje drejtimi për drejtim automjeti arkëtohet nga drejtorite rajonale të transportit rrugor. Detyrimi i pagimit të kësaj takse lind në momentin e dhënies së dëshmisë se aftësisë për drejtim automjeti. Shtetasi duhet të pajiset me dokumentin që vërteton pagimin e kësaj takse. Të gjitha pagesat e taksës do të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr.7 bashkëngjitur udhëzimit.

2.7. Taksa e përdorimit të aparateve radio-televizive.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen zyrat e pagesës së energjisë elektrike dhe vjelja e kësaj takse duhet të bëhet brenda tremujorit të parë. Kjo taksë paguhet për marrësit radiofonikë dhe televizivë individuale që janë në gjëndje teknike të marrin programe të radios ose të televizionit. Për çdo familje merret në konsiderate vetëm një marrës i çdo lloji. Kur familjet kanë vetëm marrës radio ato paguajnë vetëm taksën për radion. Për këtë ata duhet të njoftojnë në degën e tatimeve të rrethit ku banojnë, e cila verifikon nëse ka vetëm aparat televiziv dhe i jep vërtetimin me firmën e kryetarit të degës. Kur familja ka vetëm marrës televiziv do të ndiqet e njëjta procedure si në rastin e marësit radiofonik.

Personat fizikë e juridikë paguajnë taksën për përdorimin e aparaturave radiotelevizive për të gjitha aparaturat që disponojnë në ambientet e tyre.

Degët e tatimeve bashkëpunojnë me zyrat e pagesës së energjisë elektrike për njoftimin dhe pagimin nga ana e zoteruesve te taksës së aparateve radiotelevizivë. Pagesat e taksës vërtetohen për përdoruesit në librezën e pagesës së energjisë elektrike ku shënohet "taksa e paguar për vitin ____, data e pagesës si dhe firma dhe vula e punonjësit të ngarkuar me vjeljen e kësaj takse.

2.8. Taksa e përdorimit të numrit telefonik

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen operatorët përkatës të numrit telefonik dhe paguhet brenda tremujorit të parë të çdo viti. Pagesa e kryer vërtetohet në librezën e pagesës së telefonit për telefonat kabllore, ku shënohet "taksa e telefonit e paguar për vitin ____ si dhe firma e punonjësit të ngarkuar për vjeljen e kësaj takse dhe vula. Për telefoninë celulare pagesa e taksave të zotëruesve të aparateve celulare bëhet nga operatorët celulare, te cilët janë përgjegjes për vjeljen e taksave. Degët e tatimeve bëjnë çdo muaj rakordimet për numrat celulare të shitur si dhe kontrollin e derdhjes së taksave .

2.9. Taksa për veprime e shërbime nga administrata gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, prokuroria, noteritë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive te paluajtshme.

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohen Ministria e Drejtësisë, organet gjyqësore, prokuroria, zyrat e noterisë dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Këto taksa paguhen në momentin e kryerjes së veprimeve sipas lidhjes nr.5 të ligjit dhe bëhen me anën e pullës për taksat fikse ose me mandat arkëtim për ato raste kur, në bazë të ligjit, kjo taksë është shprehur në përqindje. Pullat e taksave vendosen në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që sipas ligjit duhet të pajisen me pulla takse. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla e taksës është e vulosur nga organi që kryen shërbimin. Për plotësimin e vlerës së pullës për aktet që lëshohen mund të përdoren një ose më shumë pulla, me kusht që ato të plotesojne vlerën e taksës. Në rast se personi kërkon kopje të akteve apo dokumentave të lëshuara nga organet gjyqësore apo noteriale, vlera e pullës së taksës është përcaktuar në lidhjen Nr. 5 të ligjit, me kusht që tek akti ose dokumenti të jetë shënuar fjala "kopje".

Në rast të kundërt merret vlera e plotë e taksës. Taksa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore apo noteriale.

Në zbatim të nenit 9 pika 9/a, organet e mësipërme, me përjashtim të zyrave të noterisë të cilat nuk përfitojnë komision, përfitojnë si agjentë taksash një komision 2%. Në po këtë nen pika (c), përcaktohet që personat e autorizuar nga ligji nr.8002, datë 27.9.1995 "Për përdorimin dhe administrimin e pullave të taksave", për shitjen e pullave të taksës përfitojnë komisioni 3 për qind. Në rast se organet e mësipërme kryejnë rolin e agjentit për të dy rastet, atëherë do të përfitojnë 2% komision për rastin e pare dhe 3% komision për rastin e dytë.

2.10. Taksa e regjistrimit në arsimin e lartë.

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen universitetet dhe shkollat e tjera të larta. Këto taksa arkëtohen jo më vonë se 30 ditë nga data zyrtare e fillimit të vitit të ri shkollor, për çdo vit arsimor. Pagesat e taksave regjistrohen në regjistër dhe derdhen në llogarinë e degës së tatimeve jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.11. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve.

Me vjeljen e këtyre taksave ngarkohet Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT). Llogaritjet teknike të taksave bëhen nga ERT sipas lidhjes nr.6. ERT nuk u jep licencë subjekteve fizike apo juridike për përdorimin e sistemeve të radiokomunikimit pa vjelë taksat. ERT njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për rastet kur subjektet nuk rinovojnë licencat si dhe në rastet e identifikimit të përdorimit abuziv të spektrit të frekuencave. Taksa për shërbimet e radiokomunikacioneve është takse vjetore dhe arkëtohet deri ne diten e fundit te tremujorit të pare të vitit. Brenda dates 15 Prill të çdo viti Enti Rregullator i Telekomunikacioneve bën akt-rakordimin përfundimtar me degën e tatimeve.

2.12.Taksa vjetore për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit (KKRT). Llogaritjet teknike të taksës bëhen nga KKRT sipas lidhjes nr.9 te ligjit. KKRT njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve kur subjektet nuk paguajnë taksën vjetore të sherbimeve te tramsmetimeve radiotelevizive, kur nuk rinovojnë liçensat si dhe në rastet e identifikimit të transmetimeve të paliçensuara. Të gjitha këto taksa arkëtohen çdo 5 dite në Buxhetin e Shtetit.

2.13. Taksa e kalimit me avion te kufirit shtetëror

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Tirana Aeroport Partners (TAP). Kjo taksë paguhet në momentin e blerjes së biletës nga udhëtari. TAP, në zbatim të ligjit, Marrëveshjes së Koncesionit dhe këtij udhëzimi, kryen të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj takse në sistemin e IATA-s. Pas këtij regjistrimi, çdo shoqëri ajrore në momentin e shitjes së biletave duhet t'i shtojë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të, edhe vlerën e kësaj takse. Vjelja e taksës kryhet pavarësisht vendit të shitjes apo mënyrës së shitjes së biletës nga shoqëritë ajrore. Vjelja e taksës së paguar nga udhëtarët në momentin që ata blejnë biletën e avionit dhe që derdhet nga ana e shoqërive ajrore duhet të reflektohet nëpërmjet faturimeve që TAP i lëshon shoqërive ajrore që operojnë në aeroportin Nënë Tereza. Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit të pasagjerëve dhe këto dokumente ruhen në TAP dhe shoqërinë ajrore. Shumat e arkëtuara nga TAP, nëpërmjet shoqërive ajrore, derdhen brenda 5 dite-pune në llogarinë e degës së tatimeve.

Të gjithë personat që në bazë të ligjit përjashtohen nga pagimi i taksës së kalimit të kufirit me avion, do te paguajnë këtë taksë në momentin e prerjes së biletës së udhëtimit dhe më pas vlera e taksës së paguar do të rimbursohet nga degët e tatimeve mbi bazen e dokumenteve që vërtetojnë përjashtimin nga taksa.

Çdo muaj do të bëhet rakordimi i taksës se mbledhur nga TAP-i me PKPK Rinas dhe Shoqëritë ajrore.

Kjo pike e këtij udhëzimi, hyn në fuqi më datë 1 mars 2006. Mbledhja e kësaj takse për periudhën tranzitore, deri në kete date do të vazhdoje te bëhet nga dega e doganes Rinas sipas procedurave ne fuqi.

2.14. Taksa e pajisjes se personave me pasaportë lundrimi

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohet Kapiteneria e Porteve. Pasaporta e lundrimit është dokument identifikimi i pjesëtarëve të ekuipazheve të anijes ose personave të tjerë që mund të punojnë dhe udhëtojnë me këto anije. Kjo taksë derdhet brenda 5 ditësh nga momenti i arketimit ne llogarinë e degës së tatimeve. Modeli i pasaportës dhe procedurat e dhënies së saj përcaktohen nga Ministria e

Transporteve.

2.15. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Peshkimit. Pagesat e kesaj takse behen sipas lidhjes nr.7 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit. Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit jepen mbasi të jetë paguar taksa përkatëse. Kjo taksë derdhet ne llogarinë e degës së tatimeve brenda 5 ditesh nga momentimi i arketimit.

2.16. Taksa e akteve dhe e pullës

Vjelja e këtyre taksave bëhet nga zyrat e gjëndjes civile. Shtetasit për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile janë të detyruar të paguajnë taksën sipas lidhjes nr.5 të ligjit. Dokumentet e gjendjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjëndjes civile. Shtetasit shqiptarë që pajisen me pasaportë për brënda vëndit (karten e identitetit) paguajnë përveç vlerës së pasaportës edhe taksën perkatese prej 100 leke te percaktuar në lidhjen nr.5. Vjelja e kësaj takse bëhet me mandat arkëtimi. Derdhja e taksave të vjelura në llogarinë e organit tatimor do të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.17. Taksa e rentës minerare

Me vjeljen e kësaj takse ngarkohen degët e tatimeve. Leja për shfrytëzimin e pasurisë minerare jepet nga Ministria e Industrise dhe Energjitikes. Zotëruesi i lejes regjistrohet në organet tatimore dhe brenda datës 15 të muajit pasardhës duhet të derdhë për llogari të degës së tatimeve ku ushtron aktivitetin e tij taksën e rentës së pasurisë të specifikuar në nenet 51, 74 dhe 83 të ligjit minerar, sipas vlerës së tregut të mineraleve të shitura konsumatorëve gjatë muajit. Për të përcaktuar vlerën e tregut të këtyre mineraleve me qëllim që të llogaritet renta e pasurisë minerare veprohet si vijon:

1. Vlera e tregut të mineralit të shitur tek konsumatori gjatë muajit kalendarik jepet:

a. Në rastin kur produkti i shitur është mineral i nxjerrë nga miniera, vlera e tregut të mineralit është e barabarte me çmimin e shitjes së produktit.

b. Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e tregut të mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- Shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit që janë kryer mbi mineralin.
- Shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit.
- Të gjitha shpenzimet e tjera të cilat nuk janë zbritur në pikën 1 dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a. N.q.s. produkti eksportohet çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

b. N.q.s produkti nuk eksportohet çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- Shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri
- Shpenzimet e tjera të shitjes nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes, dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji formularin tip nr.9 bashkengjitur ketij udhezimi. Ai duhet te jape gjithashtu kur eshte e nevojshme edhe të dhënat e mëposhtme:

a. Emrin dhe përshkrimin e mineralit

b. Emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit

c. Sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar

d. Një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (psh. tek konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkritoret, rafineritë ose të depozituar)

e. Sasinë e mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve.

f. Emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkritoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali.

g. Koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkritoreve, dhe rafinerive ku është shpërndarë

minerali gjatë muajit kalendarik.

h. Koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti

i. Shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik

j. Një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalenderik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumetacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes kontrollohen nga degët e tatimeve dhe taksave.

2.18. Taksa e kalimit te se drejtës së pronesise per pasurite e luajtshme (automjetet)

Per taksen e kalimit te se drejtes se pronesise te pasurive se luajtshme (automjetet) ngarkohen Drejtorite Rajonale te Transportit Rrugor. Kjo takse aplikohet per çdo ndryshim te pronesise se mjeteve. Taksa e kalimit te pronesise vilet ne momentin kur dokumenti i kalimit te pronesise (me aktin noterial te shitjes, dhurimit e te tjera te ngjashme me to) paraqitet per veprim ne Drejtorite Rajonale te Transportit Rrugor per pajisjen me lejen e re te qarkullimit te mjetit. Pronari i ri, perveç dokumentacionit që nevojitet për të legalizuar kalimin e të drejtës se pronesisë, paraqet edhe një kopje te noterizuar te kontrates se kalimit te se drejtes se pronesise. Te gjithe pronaret e mjeteve qe bejne kalim te pronesise se mjetit, paguajne taksen e kalimit te pronesise ne masën 2% te vleres se kalimit te pronesise te shprehur ne kontrate por jo më pak se çmimi dysheme i përcaktuar në Ligj, i cili merr për baze edhe vitin e prodhimit. Drejtorite Rajonale derdhin taksat e vjela për llogari të organit tatimor jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

2.19. Taksa e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin

Taksa e karbonit eshte caktuar ne masen 0.5 leke per liter per benzinen dhe benzolin dhe 1 leke per liter per gazoilin. Per benzinen, benzolin dhe gazoilin e importuar vjelja e taksës së karbonit bëhet nga deget e doganave. Kjo taksë paguhet në momentin e deklarimit në doganë te benzines, benzolit apo gazoilit të importuar.

Taksa e karbonit per benzinen, benzolin dhe per gazoilin e importuar nuk perfshihet në bazen e taksueshme per efekt te llogaritjes se takses doganore, TVSH-se dhe akcizes.

Taksat e karbonit per benzinen, benzolin dhe gazoilin e importuar, për mallrat qe vendosen ne regjimin e pezullimit tatimor ose doganor, nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto rregjime, por ne momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Per gazoilin, benzinen dhe benzolin e prodhuar ne vend, prodhuesit deklarojnë dhe paguajnë taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në momentin e levizjes se ketyre produkteve nga vendi i prodhimit.

Shumat e arketuara nga kjo takse derdhen cdo 5 dite ne llogarine e deges perkatese te tatimeve.

2.20. Taksa per ambalazhet plastike të lengjeve

Taksa e ambalazheve plastike te lengjeve te importuar apo te prodhuar ne vend llogaritet ne masen 2 leke per cope per ambalazhet e lengjeve me kapacitet mbi 1.5 litra dhe 1 lek per cope per ambalazhet me kapacitet te barabarte ose me te vogel se 1.5 litra. Per mallrat e importuara kjo takse arketohet nga Drejtoria Pergjithshme e Doganave nepermjet Degeve te saj, në momentin e çdoganimit të mallit.

Taksat e ambalazheve plastike te lengjeve nuk perfshihen ne bazen e taksueshme per efekt te llogaritjes te takses doganore, TVSH-se dhe akcizes.

Taksa për ambalazhet plastike të lengjeve per mallrat qe vendosen ne regjimin e pezullimit tatimor ose doganor nuk aplikohet në momentin e vendosjes në këto rregjime, por ne momentin kur mallrat çlirohen nga këto regjime.

Për ambalazhet plastike bosh te lengjeve, te cilat importohen, taksa nuk llogaritet ne momentin e cdoganimit te mallit, por tek prodhuesi i lengjeve.

Per mallrat me ambalazhe plastike te prodhuara ne vend, vjelja e taksës behet nga deget e tatimeve, në momentin e shitjes së mallrave. Prodhuesit e lengjeve me ambalazhe plastike bejne llogaritjen e takses te cilen me pas e derdhin ne llogarine e deges perkatese te tatimeve. Brenda dates 14 te çdo muaji subjektet dorezojne ne degen e tatimeve formularin e deklarimit sipas modelit nr. 10 bashkengjitur ketij udhezimi

2.21. Taksa per regjistrimin e lojërave te fatit, kazinote dhe per garat sportive qe zhvillohen ne hipodrom

Taksa per regjistrimin e lojrave te fatit, kazinote dhe per garat sportive qe zhvillohen ne hipodrom paguhet vetem njehere ne momentin e fillimit e veprimtarise dhe te regjistrimit te saj.

3.Perjashtime nga taksat me ligje te tjera te veçanta.

3.1. Invalidët dhe veteranët e luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidët e punës, të verbërit, invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike që e fitojne këtë status në bazë te ligjeve perkatese, përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta.

3.2. Në kuptimin e përjashtimit nga taksat e drejtpërdrejta, konsiderohen taksa të drejtpërdrejta taksat e mëposhtme:

a. Taksa për shërbimet konsullore.

b. Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive.

c. Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor.

d. Taksa për regjistrimin në arësimin e lartë.

e. Taksa për kalimin e kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion.

f. Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi.

g. Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

h. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve

3.3. Përjashtimet nga taksat e drejtpërdrejta

a. Taksa për shërbimet konsullore. Përjashtimi nga taksa për shërbimet konsullore bëhet në rastet e pajisjes së veteranit të punës apo të luftës, invalidit të punës, të verbërve, të sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjikë me pasaportë.

b. Taksa për përdorimin e aparateve radiotelevizive. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur këto pajisje janë në emrin e tyre.

c. Taksa për përdorimin e numrit telefonik kabllor. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë e tetraplegjikë, kur abonimi telefonik është në emrin e tyre.

d. Taksa për regjistrimin në arsimin e lartë. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur dëshirojnë të vazhdojnë arsimin e lartë.

e. Taksa e kalimit të kufirit të Republikës së Shqipërisë me avion. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës dhe të luftës, veteranët e luftës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, kur kalojnë kufirin e Republikës së Shqipërisë me avion.

f. Taksa për pajisjen me pasaportë lundrimi. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës apo të luftës, veteranët e luftës personat e verbër, si dhe te sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në rastet e pajisjes me pasaportë lundrimi.

g. Taksa për pajisjen me dëshmi aftësie për drejtim automjeti. Përjashtohen nga pagimi i kësaj takse invalidët e punës apo të luftës, veteranët e luftës , personat e verbër, si dhe të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në rastet e pajisjes me dëshmi aftësie për drejtim automjeti.

h. Taksa vjetore e qarkullimit rrugor të mjeteve. Përjashtohen nga pagesa e taksës së qarkullimit vjetor të mjeteve ciklomotoret, motomjetet si dhe automjetet (4+1) në pronesi të veteranëve dhe invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, të invalidëve të punës, si dhe të të verbërve dhe të sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjike, kur automjeti është në zotërimin e tyre dhe përdoret vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për aktivitet privat.

3.4. Sipas nenit 16/1 të ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", si dhe të nenit 4 të ligjit 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", kur invalidi i punës dhe personi i verbër ushtrojnë veprimtari private, nuk përjashtohen nga taksat e dretpërdrejta.

3.5. Përjashtimi nga pagimi i taksave të mësipërme bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbërit sëmurëve paraplegjike dhe tetraplegjike.

3.6. Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor, librezen përkatëse së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përjashtimin nga taksa.

3.7. Të gjitha përjashtimet do të shënohen në një regjistër të veçantë ku do të jetë shënuar

emri, mbemri, si dhe ekstremet e librezës sipas formularit Nr.8, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4.Zbatimi i udhëzimit

Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, degët e saj dhe agjentët përkatës tatimor.

5.Shfuqizime

Udhëzimi Nr.3, datë 18.01.2005 "Për sistemin e taksave ne Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar", shfuqizohet.

6.Hyrja ne fuqi

Ky udhëzim hyn në fletoren zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Formulari Nr.1

Aktrakordimi mujor i takses së _____Per muajin_____

NE MIJE LEKE

Lloji i takses	Shuma e taksave te arketuara	Shuma e taksave te derdhura ne llogarine e tatimeve	Diferenca e pageses (+ose -)	Komisioni i agjentit tatimor

Dega e Tatimeve

Agjenti Tatimor

Formulari Nr.2

REGJISTRI DITOR I TAKSES VJETORE TE QARKULLIMIT RRUGOR
PER VITIN Muaji_____

Nr.	Numri i		Data	Emri, mbiemri i pronarit	Targa	Lloji i mjetit	Tonazhi ose Nr.vend.	Vlera e takses (ne leke)	Numri i grupimit te mjetit (sipas fatures)
	Fatures	M.arket							

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

Formulari Nr.3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës

Nr. Serise data :_____

Pjesa e Pare

Emri i shtetasit_____

Adresa: Qyteti, shteti_____

Numri i dokumentit te identifikimit_____

Tipi i mjetit _____

Targa e mjetit_____

Data e hyrjes _____
(me numra dhe me fjale

Doganieri
(emer, mbiemer,firma)

Kryetari i Doganes
(emer, mbiemer, firma)

_____

Pjesa e Dyte Data_____

Data e daljes _____
(me numra dhe me fjale

Ditet e qendrimit gjithsej _____
Në shifra dhe me fjale

Shuma e takses _____
Në shifra dhe me fjale

Taksa e llogaritet në dalje te mjetit ose në momentin e çdoganimit te mjetit kur mjeti pajiset me targa shqiptare.

Doganieri
(emer,mbiemer,firma)

Kryetari i Deges se Doganes
(emer,mbiemer,firma)

Pjesa e pare plotesohet nga dogana hyrëse dhe pritet në dy kopje njëra i jepet shtetasit, tjetra mbetet në doganë.

Pjesa e dyte plotesohet vetem në kopjen e shtetasit në doganen qe del mjeti ose ku behet çdoganimi i mjetit në rastet kur mjeti pajiset me targa shqiptare dhe dorezohet në kete dege te doganes.

Formulari Nr.4

RREGJISTRI DITOR I TAKSES SE QARKULLIMIT TE AUTOMJETEVE TE HUAJA

Nr.	Lloji i mjeteve	Emri i zoteruesit te mjetit	Shteti nga vjen mjeti	Data e hyrjes se mjetit ne doganen shqiptare	Masa e takses	Shuma e taksave te paguara

Dega e doganes

Formulari Nr.5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
Dega e Doganës

Nr.serial .....

V Ë R T E T I M

Vërtetojmë se z._____banues në qytetin _____Shteti_____ me numër pasaporte____ ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë sot më datën _____ me automjetin tip _____me targë_____. Mbi bazën e shkresës Nr.___ datë____ të degës së tatimeve ky mjet përjashtohet nga pagimi i taksës se qarkullimit të automjeteve të huaja.

KRYETARI
_____

Formulari Nr.6

REGJISTRI DITOR I TAKSES SE IMPORTIMIT TE AUTOMJETEVE
TE PERDORURA

Nr.	Emri i zoteruesit te mjetit	Lloji i mjeteve	Viti i prodhimit te mjetit	Lloji i karburantit	Masa e takses	Shuma e taksave te paguara

Dega e doganes

Formulari Nr.7

REGJISTRI DITOR I TAKSES SE PAJISJES ME LEJE DREJTIMI
PER DREJTIM AUTOMJETI

Nr.	Emer mbiemer	Lloji i lejes se drejtimit	Masa e takses	Nr.mandat arketimit

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

Formulari Nr.8

REGJISTRI I PERJASHTIMEVE NGA PAGESAT E TAKSAVE

Nr rendor	Emri i taksapaguesit	Statusi ligjor i perjashtimit	Lloji i takses	Vlera e takses

Agjenti tatimor

Formulari Nr.9

Akt rakordimi i takses se rentes minerare per muajin_____

Subjekti_____

Lloji i mineralit	Sasia e prodhuar	Sasia e shitur	Subjekti bleres adresa	Taksa e paguar

Data _____

Administratori
(Emer Mbiemer)

Formulari Nr.10

DEKLARIMI I TAKSES SE AMBALAZHEVE PLASTIKE
Shoqeria_____

D E K L A R A T E

Per muajin_____

Nr	Lloji i ambalazhit sipas volumit	Sasia ne cope	Taksa per njesi	Detyrimi i pageses se takses	Derdhur ne tatime
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
etj					
Shuma					

Administratori

UDHËZIM
Nr. 2, datë 30.1.2006

PËR PROCEDURAT TATIMORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 74 të ligjit nr. 8560, date 22. 12. 1999 ‘’Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. ADMINISTRATA TATIMORE

1.1 Përbërja e administratës tatimore

Administrata tatimore është i vetmi autoritet që administron tatimet dhe taksat në Republikën e Shqipërisë. Administrata tatimore përbëhet nga :

- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Degët e tatimeve
- Zyrat tatimore të pushtetit vendor
- Komisioni i Apelimit të Tatimeve.

Asnjë autoritet tjetër nuk mund të administrojë tatime dhe taksa. Zyrat tatimore të pushtetit vendor administrojnë tatime e taksa për aq sa i lejon legjislacioni tatimor. Agjentët tatimor kryejnë veprime lidhur me mbledhjen dhe transferimin e tatimeve dhe taksave në përputhje me dispozitat e legjislacionit tatimor.

1.2 Detyrat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj kryejnë detyrat e përcaktuara në nenet 17 e 18 të ligjit. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve propozon shtrirjen territoriale dhe statusin e degëve të saj.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kryen detyrat e mëposhtme:

Organizon dhe drejton veprimtarinë e të gjithë administratës tatimore për të siguruar mbledhjen e detyrimeve tatimore me karakter kombëtar

Përgatit udhëzime dhe rregullore në zbatim të legjislacionit tatimor.

Lidh aktmarrëveshje me shoqatat e specializuara të biznesit, për të përcaktuar, kur e sheh të nevojshme, vlerën orientuese të tatueshme.

Nxjerr rregulla të përgjithshme administrative që sqarojnë pozicionin zyrtar të administratës tatimore lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor. Këto rregulla të përgjithshme janë të detyrueshme të zbatohen si për administratën tatimore, ashtu dhe për tatimpaguesit. Përjashtim bëhet vetëm në rastin kur gjykata vendos se ai bie në kundërshtim me ligjin. Rregullat e përgjithshme administrative janë të detyrueshme të zbatohen vetëm pasi ato të jenë botuar në Buletinin Tatimor. Buletini Tatimor përgatitet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sa herë është e nevojshme dhe bëhet i disponueshëm për tatimpaguesit në të gjithë degët e tatimeve. Buletini Tatimor ka efekte menjëherë pas botimit.

Siguron një zbatim uniform të ligjeve dhe të rregulloreve që kanë të bëjnë me tatimet.

Përgatit udhëzime, metodika, shpjegime dhe opinione për edukimin e tatimpaguesve për zbatimin e legjislacionit tatimor.

Përgatit projektprogramin e të ardhurave tatimore për vitin pasardhës.

Koordinon veprimtarinë e degëve të tatimeve.

Mbledh sistematikisht të dhëna, mbikqyr tatimet dhe taksat kombëtare dhe ato vendore si dhe përgatit raporte e analiza që kanë të bëjnë me mbledhjen e të ardhurave tatimore.

Siguron bashkëpunimin e institucioneve të specializuara të kontabilitetit për sa ato janë të lidhura me zbatimin e sistemit tatimor.

Menaxhon burimet njerëzore të administratës tatimore dhe organizon trajnimin e saj.

Siguron zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Degëve të saj.

Kryen të gjitha detyrat e tjera të nevojshme për administrimin e drejtë të sistemit tatimor.

Për përgatitjen e projektprogramit të të ardhurave tatimore për vitin pasardhës në shkallë vendi, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përdor metodat dhe teknikat e njohura të analizës dhe të programimit financiar në nivel makroekonomik. Projektprogrami i të ardhurave tatimore paraqitet në Ministrinë e Financave brenda muajit gusht të çdo viti për vitin pasardhës. Tregues bazë të këtij programimi janë:

- ecuria e realizimit të të ardhurave tatimore në vite për çdo lloj tatimi;
- treguesit e rritjes ekonomike për vitin planifikues;
- niveli mesatar dhe ai i parashikuar i inflacionit;
- efektet e ndryshimeve në politikat fiskale;

- efektet i ndryshimeve strukturore në ekonomi;
- efektet i përmirësimeve në kapacitetin administrues të organeve tatimore.

Për përgatitjen e projektprogramit të të ardhurave tatimore për vitin pasardhës në shkallë dege, degët e tatimeve marrin për bazë:

- numrin e tatimpaguesve;
- formën juridike të tyre;
- llojin e veprimtarisë që kryejnë;
- të dhënat mbi volumin e xhiros së realizuar në periudhat e mëparshme;
- detyrimet e pagueshme sipas dispozitave të ligjeve tatimore, etj.

Degët e tatimeve paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve projektprogramin e të ardhurave tatimore për vitin pasardhës, brenda muajit korrik të vitit korent.

1.3 Detyrat e Policisë Tatimore

Në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të Degëve të Tatimeve funksionon Policia Tatimore. Në përbërje të saj janë:

Drejtoria e Policisë Tatimore, si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe ne varësi të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Sektorët apo Zyrat e Policisë Tatimore, si pjesë e Degëve të Tatimeve dhe në varësi të Kryetarit të Degës së Tatimeve.

Punonjësit e Policisë Tatimore gjatë kohës së kryerjes së detyrës mbajnë uniformë dhe armë. Kur për qëllime të kryerjes së detyrës, është e nevojshme që punonjësit e policisë tatimore të jenë pa uniformë, aty ku do të ushtrojnë kompetencat e tyre ata janë të detyruar të paraqesin dokumentin e identifikimit të lëshuar me firmën e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve si dhe autorizimin përkatës për kryerjen e kontrollit. Pajisja me armë e punonjësve të policisë tatimore bëhet nga Ministria e Rendit Publik, sipas kërkesës me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Arma përdoret në përputhje me dispozitat ligjore për armët. Çdo mjet i policisë tatimore duhet të ketë mbishkrimin "POLICIA TATIMORE", duke pasur të instaluara edhe sinjalet e nevojshme për automjetet e policisë, sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor.

Funksionet e Policisë Tatimore lidhen me qarkullimin e mallrave dhe ato ushtrohen në treg, në vendet e magazinimit, në rrugë dhe vende të tjera ku kryhen transaksione dhe shkëmbime mallrash.

Drejtoria e Policisë Tatimore ka këto detyra:

- Kontrollon dhe ndjek veprimtarinë e sektorëve apo zyrave të policisë tatimore në Degët e Tatimeve;
- Përgatit rregulloret e funksionimit dhe manualet e punës për policinë tatimore në degët e tatimeve, të cilat miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve;
- Bashkëpunon me drejtoritë e tjera të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Bashkëpunon me organe të tjera të administratës shtetërore dhe të enteve publike, në zbatim të marrëveshjeve të lidhura ndërmjet tyre dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Propozon procedurat e operimit në terren të punonjësve të Policisë Tatimore të cilat miratohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
- Propozon mënyrat e ushtrimit të kontrolleve dhe mënyrat e evidentimit e raportimit të rezultateve të tyre të cilat miratohen me rregullore të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
- Analizon periodikisht punën e policisë tatimore në shkallë vendi.
- Ushtron kontrolle me forca të përqendruara në zona biznesi në juridiksionin e degëve të tatimeve.
- Bën vlerësimin e punës së përgjegjësit të sektorit dhe të punonjësve të tjera të policisë tatimore gjatë kontrolleve periodike.
- Organizon, kur është e nevojshme, bashkëpunimin me institucionet e tjera si Policinë e Shtetit, Policinë Pyjore, etj., sipas akteve ligjore në fuqi.
- Organizon trajnimin dhe testimin profesional të punonjësve të policisë tatimore.

Drejtori Policisë Tatimore varet nga dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve. Ai koordinon punën e sektorëve të policisë tatimore në degët e tatimeve.

Policia Tatimore në Degët e Tatimeve kryen këto detyra:

- Verifikon regjistrimin dhe pajisjen me certifikatë tatimore të çdo personi që kryen veprimtari ekonomike në juridiksionin e tyre, duke vendosur dhe sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor për këtë pikë, në raste shkeljesh;

- Zbaton veprimet e masave shtrënguese për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas Urdhrit Ekzekutiv të lëshuar nga Kryetari i Degës së Tatimeve;

- Ekzekuton sanksionet e vendosura, por të pa ekzekutuara ende, për tatime dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, sipas Urdhrit Ekzekutiv të lëshuar nga Kryetari i Degës së Tatimeve;

- Verifikon dokumentimin e lëvizjes së mallrave dhe udhëtarëve për transportin rrugor, hekurudhor, ujor e ajror, duke vendosur dhe sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor për këtë pikë, ne raste shkeljesh;

- Verifikon zbatimin e lëshimit të faturave tatimore sipas modeleve të përcaktuara për këtë në ligjin "Për TVSH-në", duke vendosur dhe sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor për këtë pikë;

Verifikon zbatimin e ligjit "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël" dhe të Kapitullit III "Tatimi i thjeshtuar mbi Fitimin" të ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" lidhur me :

a. lëshimin e kuponit tatimor të arkave regjistruese apo dëftesave tatimore;
b. lëshimin e faturës tatimore Model Nr. 4;
c. mbajtjen në njësinë e tregtimit apo shërbimit të librit të xhiros dhe librit të blerjeve;
d. afishimin e çmimeve të shitjes;
e. dokumentacionin që provon sasitë e mallit gjendje.

Për çdo shkelje lidhur me pikat më sipër, punonjësit e policisë tatimore vendosin sanksionet që parashikon legjislacioni tatimor përkatës;

Verifikon përdorimin e pullave të akcizës dhe zbatimin e kërkesave të tjera në lidhje me mallrat që i nënshtrohen akcizës dhe zbaton sanksionet e vendosura për shkelje të ligjit "Për akcizat";

Mbledh dhe raporton tek eprori informacione që kanë të bëjnë me shmangie tatimore të tatimpaguesve dhe individëve;

Ndihmon inspektorët tatimorë, kur këta të fundit e kërkojnë një gjë të tillë gjatë kryerjes së kontrolleve tatimore, duke vepruar në këto raste si forcë mbështetëse;

Bashkëpunon me policinë doganore dhe polici të tjera, sipas marrëveshjeve të bashkëpunimit që mund të lidhen midis administratës tatimore dhe pjesëve të tjera të administratës publike;

I propozon kryetarëve të degëve të tatimeve për heqjen e autorizimit të akcizës për tatimpaguesit që tregtojnë mallra akcize pa pullë fiskale.

Gjatë kryerjes së detyrës punonjësit e policisë tatimore veprojnë në grupe me jo më pak se dy punonjës.

Për rezultatet e çdo kontrolli punonjësit e policisë tatimore mbajnë, sipas rastit, proces-verbalin përkatës të gjobitjes, sekuestrimit, konfiskimit apo bllokimit, sipas modelit tip me numër serial bashkëngjitur këtij udhëzimi, i cili pasi hidhet në një libër raportimi dorëzohet brenda 24 orëve në zyrën e protokollit të Degës së Tatimeve.

Pas protokollimit, proces-verbalet administrohen nga sektorët përkatës në degën e tatimeve sipas procedurave të parashikuara në manualin përkatës të punës.

Përgjegjësit e sektorëve apo zyrave të policisë tatimore kanë detyrimin të raportojnë në Drejtorinë e Policisë Tatimore për problematikat që kanë rezultuar gjatë çdo muaji. Këto raportime duhet të përfshijnë:

rezultatet e planeve të punës dhe të planeve operative mujore;

zbatimin e detyrave të tjera.

informacione për rezultatet e kontrolleve të kryera, të rasteve të shkeljeve të konstatuara, të rasteve të kontrolleve pa shkelje si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar.

1.4 Detyrat e Degëve të Tatimeve

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka degët e saj. Kryetari i degës drejton degen e tatimeve. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas dispozitave të legjislacionit të Nëpunësit Civil dhe dispozitave përkatëse nënligjore. Degët e tatimeve kryejnë detyrat e mëposhtme:

- pajisin tatimpaguesit me certifikatë tatimore;
- hartojnë projektprogramin e të ardhurave tatimore;
- ndjekin dhe përgjigjen për realizimin e programit të të ardhurave tatimore;
- përpunojnë deklaratat tatimore;

- vlerësojnë dhe u njoftojnë tatimpaguesve, kur është rasti, detyrimin tatimor në përputhje me manualet e miratuara të punës;
- bëjnë ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit;
- kryejnë kontrollin e tatimpaguesve dhe mbledhjen e tatimeve të zbuluara;
- administrojnë borxhet tatimore;
- zbatojnë vendimet e veçanta të ekzekutive, etj.

1.5 Komisioni i Apelimit të Tatimeve

Komisioni i Apelimit të Tatimeve është pjesë e administratës tatimore, siç përcaktohet në nenin 21 të ligjit. Ai përbëhet nga 7 persona. Anëtarët e Komisionit propozohen dhe përzgjidhen në këtë mënyrë:

- Një anëtar propozohet nga Ministri i Drejtësisë,
- Një anëtar propozohet nga Ministri i Ekonomisë,
- Dy anëtarë propozohen nga Ministri i Financave, prej të cilëve një punonjës i Ministrisë së Financave dhe një punonjës i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Dy anëtarë të tjerë të Komisionit përzgjidhen me propozim të Bashkimit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë në konsultim me shoqatat e biznesit dhe,
- Anëtari tjetër propozohet nga shoqatat e ekonomistëve.

Emërimi i anëtarëve të Komisionit bëhet nga Ministri i Financave. Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave është edhe Kryetar i Komisionit të Apelimit të Tatimeve, dhe ka autoritetin e mbledhjes së këtij Komisioni sa herë është e nevojshme.

Anëtarët e Komisionit të Apelimit të Tatimeve duhet të jenë me profesionin e ekonomistit dhe juristit. Në përbërje të Komisionit do të jetë edhe një sekretar. Mandati i anëtarëve të Komisionit të Apelimit të Tatimeve është dy vjeçar, me të drejtë ripropozimi dhe riemërimi. Komisioni i Apelimit të Tatimeve i merr vendimet me shumicë të thjeshtë votash. Votimi i anetarëve të Komisionit është i hapur.

Ky komision mblidhet sa herë është e nevojshme, për shqyrtimin në afat të ankesave të tatimpaguesve. Anëtarët e Komisionit shpërblehen në bazë të rregullores së funksionimit të Komisionit të miratuar nga Ministri i Financave.

Komisioni i Apelimit të Tatimeve nuk mund të shqyrtojë një ankesë të një tatimpaguesi, nëse kjo ankesë nuk është shqyrtuar më parë në shkallën më të ulët të apelimit.

Komisioni i Apelimit të Tatimeve funksionon në bazë të rregullores së veçantë të Ministrit të Financave. Vendimet e tij janë të pavarura. Ato nuk mund të ndikohen, influencohen apo diktohen nga asnjë autoritet tjetër. Për të marrë vendimet e tij, Komisioni është i veshur me të gjithë autoritetin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesave të tatimpaguesve, përfshirë këtu të drejtën për të bërë verifikime dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore të përcaktuara.

1.6 Marrëdhëniet e administratës tatimore me organet e tjera shtetërore.

Në zbatim të nenit 23 të Ligjit, organet tatimore nuk mund të ngarkohen me detyrën për të vjelë detyrime të tjera me natyrë jotatimore që kanë tatimpaguesit ndaj organeve të tjera shtetërore apo për të kërkuar plotësimin e çfarëdo kushti tjetër të vendosur nga këto organe. Përjashtim këtu bëhet vetëm në rastet kur me ligj përcaktohet ndryshe, pra kur me ligj përcaktohet shprehimisht se tatimpaguesi nuk mund të pajiset me Certifikatë të Ushtrimit të Veprimtarisë pa plotësuar kushtin e caktuar.

1.7 Marrëveshjet me autoritetet e huaja tatimore

Në zbatim të nenit 24 të ligjit, të drejtën ligjore për zbatimin e Marrëveshjeve apo Konventave bilaterale dhe multilaterale, të cilat përmbajnë dispozita tatimore, e ka Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe jo degët e tatimeve. Në rastet kur tatimpaguesit paraqiten në degët e tatimeve dhe kërkojnë përjashtime apo lehtësira fiskale që lidhen me zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të përfunduara nga vendi ynë, ato duhet t'i kalohen për shqyrtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Ky rregull do të zbatohet për Marrëveshjet bilaterale për eliminimin e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal të përfunduara nga vendi ynë, si dhe për dispozitat tatimore që mund të përmbajnë marrëveshje të tjera si ato për transportin ndërkombëtar, marrëveshjet e ndihmave, marrëveshjet e kredive, marrëveshjet koncensionare, etj. Degët e tatimeve veprojnë sipas dispozitave të marrëveshjeve ndërkombëtare, vetëm në rastin kur marrin përgjigje zyrtare me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

2. PROCEDURAT E ADMINISTRIMIT TË TATIMEVE

2.1. REGJISTRIMI I TATIMPAGUESVE

2.1.1 Për të pasur të drejtën e pajisjes me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë, të gjithë personat janë të detyruar të fitojnë të drejtën juridike për të ushtruar veprimtari, pra të marrin vendimin përkatës të gjykatës. Menjëherë pas marrjes së këtij vendimi, personi kërkon të regjistrohet në organet tatimore, pra të pajiset me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë duke plotësuar formularin e kërkesës për regjistrim, forma e të cilit është sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Një person që nuk kërkon të pajiset me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë dhe ushtron në fakt veprimtari nuk është i përjashtuar nga përgjegjësia tatimore. Në këtë rast, personi, është objekt i sanksioneve në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera tatimore, për ushtrim veprimtarie pa leje, në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 3.1.2. të këtij udhëzimi.

Për tu pajisur me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë, veprohet si më poshtë:

a. Personat juridike e fizike me qarkullim vjetor më të madh se kufiri i regjistrimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, përveç Vendimit të Gjykatës paraqesin edhe kërkesën për regjistrim duke plotësuar formularin përkatës. Kërkesa për regjistrim, paraqitet vetëm në organin tatimor të njësisë administrative ku personi ka selinë qendrore. Tatimpaguesit e kanë Selinë Qendrore aty ku ushtrojnë tërësisht biznesin, apo pjesën më të madhe të veprimtarisë së biznesit. Nëse biznesi ushtrohet vazhdimisht në dy apo më shumë vende biznesi, atëherë, selia qendrore e tatimpaguesit është aty ku kryhet pjesa më e madhe e veprimtarisë biznesore (shërbim, tregti, etj.), pra aty ku efektivisht dhe faktikisht kryhet biznesi pavarësisht nga selia e treguar në aktin e themelimit të tatimpaguesit. Megjithatë, kur gjatë veprimtarisë biznesore fitohet një tender, merret një leje, lidhet një kontratë e ligjshme, apo fitohet e drejta për kryerjen e një veprimi të ngjashëm me to, dhe për rrjedhojë veprimtaria biznesore përkohësisht, mundet të pësojë rritje në një vend biznesi i cili nuk është deklaruar si seli qendrore, atëherë vetëm në këtë rast, tatimpaguesi nuk ka detyrim të deklarojë si seli qendrore këtë vend biznesi, në të kundërt, ky vend biznesi përbën selinë qendrore dhe duhet deklaruar si e tillë nga tatimpaguesi. Në rast se tatimpaguesi nuk deklaron, për sa më sipër brenda afatit të përcaktuar në pikën c) më poshtë, atëherë organet tatimore njoftojnë tatimpaguesin për të zhvendosur selinë vullnetarisht, në të kundërt, organeve tatimore i lind e drejta për të ndërmarrë veprime administrative për zhvendosjen e selisë.

Së bashku me kërkesën për regjistrim, këta persona duhet të paraqesin statutin, aktin e themelimit të shoqërisë dhe vërtetimin për anëtarësimin në Dhomën e Tregtisë. Ato duhet të plotësojnë gjithashtu dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në ligje të tjera. Organet tatimore nuk pajisin tatimpaguesin me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë, kur dispozitat ligjore në fuqi kërkojnë plotësimin e kushteve të tjera përpara pajisjes me këtë Certifikatë. Personat fizikë e juridikë me qarkullim vjetor më të madh se kufiri i regjistrimit për TVSH të cilët plotësojnë të gjitha kërkesat e mësipërme, regjistrohen dhe pajisen nga organi tatimor me Certifikatën përkatëse të Ushtrimit të Veprimtarisë, brenda pesë ditësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe formularit përkatës. Regjistrimi dhe Certifikata e Ushtrimit të Veprimtarisë së tatimpaguesit është e përhershme, pra ajo merret në momentin e krijimit dhe regjistrimit për herë të parë të tatimpaguesit dhe nuk përsëritet çdo vit.

b. Personat juridikë e fizikë me qarkullim vjetor më të vogël se kufiri i regjistrimit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, përveç Vendimit të Gjykatës dhe lejes së ushtrimit të veprimtarisë të lëshuar nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, paraqesin edhe kërkesën për regjistrim duke plotësuar formularin përkatës sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ato duhet të plotësojnë gjithashtu dhe çdo kërkesë tjetër të përcaktuar në Ligjin "Për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël".

Personat fizikë e juridikë me qarkullim vjetor më të vogël se kufiri i regjistrimit për TVSH, të cilët plotësojnë të gjitha kërkesat e mësipërme, regjistrohen dhe pajisen nga organi tatimor me Certifikatën përkatëse të Ushtrimit të Veprimtarisë, brenda pesë ditësh nga momenti i paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe formularit përkatës nga ana e tyre. Për vitin 2005 të gjithë këto persona janë të detyruar të riregjistrohen në organin përkatës tatimor. Riregjistrimi dhe pajisja me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë bëhen brenda afatit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin "Për Taksën Vendore mbi Biznesin e Vogël''. Duke filluar nga viti 2006, Certifikata e Ushtrimit të Veprimtarisë së tatimpaguesit është ë përhershme, dhe merret në momentin e krijimit dhe të regjistrimit për herë të parë të tatimpaguesit dhe nuk përsëritet çdo vit.

Për administrimin e kërkesave për regjistrim të tatimpaguesve hapet një regjistër i vecantë sic përcaktohet në Manualin përkatës të Regjistrimit.

c. Të gjithë tatimpaguesit, janë të detyruar t'i njoftojnë organeve tatimore ndryshimet e mëposhtme:

- ndryshimin e emrit
- ndryshimin e adresës së selisë
- ndryshimin e adresës së filialeve, degëve apo njësive
- ndryshimin në formën juridike
- krijimin ose hapjen e filialeve, degëve apo njësive të reja
- ndryshimet në llojin e veprimtarisë ekonomike.

Njoftimi bëhet brenda 30 ditëve nga data në të cilën tatimpaguesi ka bërë ndryshimet e mësipërme.

d. Regjistrimi i ortakërive

Ortakëritë janë forma të veçanta të organizimit të personave që bien dakord për të kryer së bashku veprimtari të përkohshme, me qëllime fitimi. Ortakëritë nuk krijohen si persona juridikë më vete, në format e parashikuara nga ligji "Për shoqëritë tregtare", nga "Kodi Civil" apo nga ligje të tjera të veçanta. Si të tilla, ato nuk krijohen me Vendim Gjykate dhe as nuk regjistrohen në Gjykatë. Për këtë arsye, për regjistrimin e tyre si tatimpagues në organet tatimore, ortakëritë nuk janë të detyruara të fitojnë më parë personalitet juridik (të drejtë juridike për të ushtruar veprimtari) dhe as të detyruara të paraqesin vendimin përkatës të gjykatës në këto organe, Nga ana tjetër, ato janë të detyruara të respektojnë çdo kërkesë tjetër të përcaktuar më lart lidhur me regjistrimin në organet tatimore, si dhe çdo tatimpagues tjetër.

e. Regjistrimi i organizatave jofitimprurëse

Organizatat jofitimprurëse, fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve dhe organet e tjera të ngjashme që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, shkencore, ose arsimore që nuk kanë për qëllim fitimin, janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore dhe të pajisen me certifikatë tatimore. Për t'u pajisur me certifikatë tatimore, personat e mësipërm duhet të paraqesin në organet tatimore, vendimin e gjykatës që miraton regjistrimin e tyre, aktin e themelimit, statutin, akt-marrëveshjen me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe informacione të tjera, duke plotësuar "Formulari i kërkesës për regjistrim", forma e të cilit është sipas modelit bashkangjitur këtij udhëzimi. Organet tatimore mbajnë një regjistër të veçantë për evidentimin e këtyre personave, duke i konsideruar ato për efekte fiskale si tatimpagues pasive.

Këto organizata janë të detyruara të njoftojnë organet tatimore, me anë të një deklarate, për çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, etj., siç përcaktohet në pikën "c" të pikës "2.1.1" të këtij udhëzimi.

Organizatat jofitimprurëse (OJF), fondacionet, njësitë e zbatimit të projekteve dhe organet e tjera të ngjashme që kryejnë veprimtari fetare, humanitare, bamirëse, shkencore, ose arsimore, dhe që, krahas aktivitetit të tyre me karakter fetar, humanitar, bamirës, shkencor ose edukativ kryejnë edhe aktivitete të tjera të karakterit ekonomik, janë të detyruar t'i regjistrojnë veçmas këto aktivitete në organet tatimore, njëlloj si çdo tatimpagues tjetër që ushtron veprimtari ekonomike, siç përcaktohet në shkronjën "a" dhe "b" të pikës "2.1.1" të këtij udhëzimi.

f. Evidentimi i tatimpaguesve të paregjistruar

Për tatimpaguesit e identifikuar nga punonjësit e administratës tatimore qendrore dhe vendore, që ushtrojnë veprimtari pa u regjistruar në administratën tatimore, krijohet dhe mbahet një regjistër shtesë, që shoqëron regjistrin bazë të tatimeve. Në këtë regjistër shënohen të dhënat e subjekteve të identifikuara nga Policia Tatimore, por të paregjistruar në administratën tatimore. Të dhënat e këtij regjistri janë si më poshtë:

- Emri i tatimpaguesit;
- Adresa e tatimpaguesit;
- Data e njoftimit ose konstatimit;
- Data e plotësimit të regjistrimit;
- NIPT-i.

2.1.2 Të gjithë tatimpaguesit regjistrohen vetëm njëherë, në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike. Përjashtimisht, vetëm për vitin 2005, tatimpaguesit e taksës vendore mbi

biznesin e vogël dhe/ose të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, riregjistrohen brenda datës 20 mars 2005, sipas procedurave të përcaktuara në pikën 2.1 të këtij Udhëzimi.

2.1.3 Tërheqja e Certifikatës së Ushtrimit të Veprimtarisë është një masë ndëshkuese e përkohshme që ndërmerret nga organi tatimor që ka lëshuar këtë certifikatë. Kjo masë merret në të gjitha rastet kur tatimpaguesi kryen shkelje të rënda siç është mospagimi i detyrimeve të prapambetura tatimore (përfshirë këtu gjobat dhe interesat eventuale), për të cilat ligjet specifike tatimore parashikojnë mbylljen e veprimtarisë dhe vetëm pasi ndaj tatimpaguesit të jenë marrë të gjitha masat e tjera paraprake administrative të parashikuara nga këto ligje. Tatimpaguesi, të cilit i është hequr përkohësisht Certifikata e Ushtrimit të Veprimtarisë, nuk ka të drejtë të ushtrojë me aktivitet. Ushtrimi i aktivitetit në këtë rast konsiderohet si aktivitet i paregjistruar (pa leje) dhe dënohet në bazë të nenit 49 të ligjit "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë''. Kur tatimpaguesi e ka rregulluar situatën që çoi në heqjen e Certifikatës së Ushtrimit të Veprimtarisë, organi tatimor bën rikthimin e saj. I gjithë ky proces evidentohet në një regjistër të veçantë ku veç të tjerave identifikohet arsyeja e tërheqjes së certifikatës, urdhri administrativ mbi të cilin mbështetet, personat ekzekutues të urdhrit, data dhe afati i mbylljes.

2.1.4 Tatimpaguesit që kanë vendosur të mbyllin veprimtarinë e tyre (të çregjistrohen), kanë të drejtë të kërkojnë të çregjistrohen nga gjykata ku kanë fituar cilësinë e personit fizik apo juridik, për të ushtruar veprimtari ekonomike, vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore të papaguara dhe bashkë me pagesat të kenë paraqitur në sektorët e vlerësim–mbledhjes bilancin e mbylljes. Gjykata, njofton organin tatimor të rrethit përkatës për kërkesën për çregjistrim të tatimpaguesit. Organi tatimor, kur tatimpaguesi nuk ka paguar të gjitha detyrimet tatimore (përfshirë këtu dhe dënimet administrative e interesat eventuale), brenda 45 ditësh nga data e marrjes së njoftimit nga gjykata është i detyruar të verifikojë situatën tatimore dhe kur është e nevojshme të ushtrojë kontroll në vend të aktivitetit të tatimpaguesit që ka kërkuar të çregjistrohet. Kur tatimpaguesi i kontrolluar rezulton të jetë pa detyrime të papaguara, organi tatimor bën konfirmimin e statusit brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të gjykatës. Nëse pas 45 ditësh nga data e njoftimit, organi tatimor nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim me shkrim, gjykata vendos për çregjistrimin e tatimpaguesit.

Kur organi tatimor paraqet kundërshtimin përkatës brenda 45 ditësh nga data e njoftimit, gjykata nuk mund të marrë vendim për çregjistrimin e tatimpaguesit. Këtë vendim ajo mund ta marrë vetëm pasi organi tatimor përkatës, ka tërhequr kundërshtimin dhe ka konfirmuar me shkrim se tatimpaguesi që kërkon mbylljen e veprimtarisë ka rregulluar situatën dhe nuk ka me detyrime tatimore të papaguara (përfshirë këtu gjobat dhe interesat eventuale).

Në qoftë se, për një tatimpagues të çregjistruar vërtetohet më vonë se ka pasur një detyrim tatimor të papaguar, çregjistrimi nuk e çliron atë nga përgjegjësia për të paguar këto detyrime së bashku me penalitetet përkatëse.

2.1.5 Organet tatimore kanë të drejtë të çregjistrojnë përkohësisht çdo tatimpagues, kur provohet se ai për çfarëdo arsye, në vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari. Në këtë rast, këta tatimpagues regjistrohen si pasive në një regjistër të veçantë të organeve tatimore. Mund të kalohen në të regjistruar si pasive të gjithë tatimpaguesit që gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, nuk kanë kryer xhiro. Theksojmë se, këtu bëhet fjalë për tatimpaguesit që nuk kanë realizuar të ardhura nga veprimtaria dhe nuk kanë deklaruar për më shumë se 12 muaj rresht. Pra, para ndërmarrjes së hapit për kalimin si pasive të një tatimpaguesi, organi tatimor paraprakisht provon me sa më shumë fakte dhe dokumente mungesën e aktivitetit gjatë 12 muajve të fundit. Këto veprime paraprake janë:

- Marrja e konfirmimit me shkrim nga sektori i policisë tatimore (përgjegjësi i këtij sektori dhe inspektori i zonës përkatëse), se tatimpaguesi nga verifikimi në vendin apo adresën e deklaruar të ushtrimit të veprimtarisë, nuk është gjendur.

- Verifikimi në vend, duke mbajtur një procesverbal prej jo më pak se dy personash (një inspektor i sektorit të vlerësimit dhe mbledhjes dhe një inspektor kontrolli), i cili të vërtetojë se tatimpaguesi nuk është gjendur.

- Vërtetimi nëpërmjet një procesverbali të hartuar nga inspektori përkatës, që tatimpaguesi gjatë vitit të fundit tatimor nuk ka kryer asnjë import në bazë të të dhënave të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe të dërguara në degën e tatimeve.

- Vërtetimi nëpërmjet një procesverbali të hartuar nga inspektori përkatës, që tatimpaguesi gjatë vitit të fundit tatimor nuk ka kryer asnjë lekë xhiro nëpërmjet të dhënave që disponohen nga thesari.

- Të gjitha përpjekjet e tjera të mundshme nëpërmjet verifikimit të të dhënave të tjera, si ato të PMU-ve, të Bankës Botërore, etj.

Vetëm pasi jenë ndërmarrë të gjithë hapat e mësipërm, sektori i regjistrimit, i kalon këta tatimpagues në të regjistruar si pasivë, çka do të thotë qe ata nuk janë çregjistruar përfundimisht. Në këtë moment për këto tatimpagues nuk është e detyrueshme të printohen formularët e deklarimit, pasi ata nuk do të jenë më të detyruar të deklarojnë.

Pasi tatimpaguesit kalojnë në të regjistruar si pasivë, ata janë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të organeve tatimore. Mbikëqyrja në këtë rast nënkupton verifikimin e vazhdueshëm të të dhënave të doganës, të thesarit, të të dhënave nga kontrollet e ushtruara në subjekte të tjera, të të dhënave të financuesve të tjerë të ndryshëm, etj. Në rast se nga këto të dhëna rezulton se tatimpaguesi ka kryer aktivitet, ai kalohet ne tatimpaguesit e regjistruar si aktive, dhe ndaj tij merren të gjitha masat e duhura ligjore.

Degët e tatimeve evidentojnë dhe raportojnë çdo muaj gjendjen dhe ndryshimet në numrin e tatimpaguesve të kaluar në pasive.

2.2 PËRCAKTIMI I DETYRIMIT TATIMOR

2.2.1 Detyrimet tatimore përcaktohen siç parashikohet në ligjet e veçanta tatimore**.** Për këtë përdoren mënyrat e njohura të përcaktuara në këto ligje, të cilat janë:

a. Vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor. Kjo mënyrë përdoret në përgjithësi për tatimet indirekte si TVSH dhe akciza, për tatimet direkte si tatimi mbi fitimin, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, si dhe për një kategori të ardhurash personale, si të ardhurat nga qiratë, të ardhurat nga emfiteoza, si dhe ato nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Vetëvlerësim dhe vetëdeklarim bëhet edhe për të ardhurat me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të realizuara nga një person rezident shqiptar, etj.

b. Parapagimi i detyrimit tatimor. Kjo mënyrë përdoret vetëm në rastin e parapagimit të tatimit mbi fitimin gjatë vitit ushtrimor. Llogaritja e kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin bazohet në mënyrën e parashikuar në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", ndërsa pagesa e tyre bëhet brenda datës 15 të cdo muaji të vitit. Vlerësimi përfundimtar i detyrimit tatimor, bëhet në momentin e paraqitjes së deklaratës vjetore të të ardhurave të tatueshme (të fitimit dhe humbjes).

c. Mbajtja në burim. Kjo mënyrë përdoret kryesisht për tatimin mbi të ardhurat personale si: nga pagat dhe shpërblimet e tjera, për interesat bankare apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, dividentët, huatë dhe qiratë, kalimin e pronësisë, lojërat e fatit, të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve, ato nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale etj., sipas përcaktimit në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ''Për tatimin mbi të ardhurat''.

Organet tatimore kanë për detyrë të kontrollojnë saktësinë e përcaktimit të të gjithë detyrimeve tatimore, pavarësisht nga mënyra e vlerësimit të përdorur. Nëpërmjet kontrolleve, mund të kryhet verifikimi i saktësisë së deklarimeve tatimore për tatimin mbi fitimin, për TVSH-në dhe për të gjitha llojet e tjera të detyrimeve tatimore si dhe të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nëse, nga një kontroll i ushtruar për tatimin mbi fitimin, rezulton se fitimi i deklaruar nga tatimpaguesi mbi bazën e deklaratës vjetore të të ardhurave të vitit ose viteve paraardhës nuk është i vërtetë, organet tatimore korrigjojnë jo vetëm detyrimin tatimor të vitit ose viteve paraardhëse por, mbi bazën e këtyre detyrimeve të korrigjuara, ndryshojnë edhe kështet e parapagimit të tatimit mbi fitimin për vitin korrent. Për këtë qëllim, ato respektojnë të gjithë standardet e njohura të kontrollit, duke njoftuar njëkohësisht në mënyrë zyrtare tatimpaguesin e kontrolluar.

Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet kur nga kontrollet e ushtruara nga organet tatimore rezulton se tatimpaguesi i kontrolluar nuk ka deklaruar dhe paguar te gjitha detyrimet tatimore. Edhe në këtë rast, organet tatimore njoftojnë zyrtarisht tatimpaguesin për vlerësimin e detyrimit të ri tatimor të bërë lidhur me të.

2.2.2 Organet tatimore bëjnë vlerësim të detyrimit tatimor të tatimpaguesve me metodat alternative të përcaktuara në nenin 36 të ligjit, duke improvizuar situatën reale të tyre, nëpërmjet rikarakterizimit të transaksioneve të kryera nga ana e tyre gjatë një periudhe tatimore të caktuar. Një veprim i tillë ndërmerret në rastet e mëposhtme:

a. Kur tatimpaguesi për një periudhë të caktuar tatimore nuk ka deklaruar detyrimet tatimore të tij, siç përcaktohet në ligjet specifike tatimore. Kështu, për shembull, nëse një tatimpagues nuk

paraqet deklaratën mujore të TVSH-së, organi tatimor pasi ka zbatuar të gjitha procedurat paraprake të përcaktuara në ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 dhe në udhëzimin në zbatim të tij, ka të drejtë të bëjë llogaritjen e detyrimit tatimor nëpërmjet vlerësimit nga zyra, sipas procedurave të përcaktuara në manualin përkatës të punës. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet kur tatimpaguesi nuk paraqet deklaratat e tjera tatimore, si deklaratën e të ardhurave të tatueshme (bilancin e veprimtarisë ekonomiko financiare) të një viti të caktuar, deklaratën e akcizës, deklaratat e tatimit mbi të ardhurat personale për ato kategori të ardhurash për të cilat deklarimi sipas ligjit përkatës është i detyrueshëm. Në këtë rast, vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në nenin 36 të ligjit, mund të bëhet direkt nga zyra, pa qenë e nevojshme kryerja e një kontrolli në vend pranë tatimpaguesit. Njoftimi për vlerësimin tatimor nga zyra i dërgohet zyrtarisht tatimpaguesit me firmën e kryetarit të degës së tatimeve.

b. Kur gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore nuk gjendet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor, ose kur ky dokumentacion ka mangësi që nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore. Me një situatë të tillë kemi të bëjmë, për shembull, në rastet kur gjatë kontrollit tatimpaguesi nuk paraqet asnjë dokument për transaksionet e kryera, nuk ka mbajtur regjistrime të rregullta të cilat bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor siç parashikohet në ligjin nr. 7661, datë 19.01.1993 ‘’Për Kontabilitetin’’, në ligjin nr. 7928, date 27.04.1995 “Për TVSH”, në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘’Për Tatimin mbi të Ardhurat’’ dhe në ligjin nr. 7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”. Kemi të bëjmë gjithashtu me një situatë të tillë edhe në rastet kur gjatë kontrollit provohet se tatimpaguesi nuk ka paraqitur një pjesë të dokumentacionit ose të regjistrimeve si dhe kur dokumentacioni dhe regjistrimet e paraqitura janë dukshëm me të meta, të pavërteta dhe të pabesueshme. Në këto raste, inspektori apo inspektorët tatimorë që janë të ngarkuar me kryerjen e kontrollit, i propozojnë me shkrim kryetarit të degës së tatimeve që të urdhërojë, po me shkrim, përdorimin e metodave alternative për përcaktimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Pra, vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në pikën “b”, të nenit 36 të ligjit, bëhet gjithmonë në kuadrin e një kontrolli në vend pranë tatimpaguesit. Në asnjë rast, ky vlerësim nuk mund të bëhet direkt nga zyra.

c. Kur, gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore rezulton se tatimpaguesit kanë manipuluar dukshëm dhe në mënyrë të qartë çmimet e shitjes së mallrave apo të shërbimeve. Mënyra e vlerësimit tatimor bazuar me metodat alternative bëhet sipas procedurave të përcaktuara në manualet përkatëse të punës.

d. Kur tatimpaguesit kryejnë me lekë në dorë dhe jo me kalime në llogari, transaksione shitblerjeje që kalojnë shumën prej 300 mije lekë.

2.2.3 Në kushtet e përcaktuara në pikat ‘’a’’, ‘’b’’, “c” dhe “d” të pikës “2.2.2.” më lart, organet tatimore janë të detyruara të përdorin metodat alternative të vlerësimit tatimor, të përcaktuara në nenin 36 të ligjit, duke vepruar si më poshtë:

a. Në situatën kur tatimpaguesi nuk ka paraqitur një deklaratë tatimore për një periudhë të caktuar siç përshkruhet në pikën ‘’a’’ më sipër, organet tatimore, mund të kryejnë një kontroll në vend të situatës së tatimpaguesit.

Kur kryerja e kontrollit në vend, për çfarëdo arsye, nuk është e mundur, organet tatimore bëjnë vlerësim tatimor nga zyra për periudhën përkatëse tatimore. Për të bërë këtë vlerësim, organet tatimore gjykojnë mbi bazën e të dhënave që mund të disponojnë për këtë tatimpagues siç janë për shembull të dhënat e periudhave të mëparshme tatimore, të dhënat për importet, të dhënat për transaksionet e kryera me fonde buxhetore (të marra në degët e thesarit) apo me fonde të donatorëve të ndryshëm, të dhënat e siguruara nga klientët apo furnitorët e tatimpaguesit, të dhënat për numrin e punonjësve, të dhënat për çmimet e mallrave apo shërbimeve të kryera nga tatimpagues të tjerë të ngjashëm, etj. Kjo mënyrë e vlerësimit tatimor përdoret sidomos lidhur me detyrimet tatimore për TVSH-në. Vlerësimi tatimor nga zyra mbi bazën e këtyre të dhënave bëhet vetëm pasi ndaj tatimpaguesit janë respektuar të gjitha procedurat e përcaktuara në ligjin dhe në udhëzimin ‘’Për TVSH-në’’. Vlerësimi tatimor nga zyra i kryer si më sipër i dërgohet tatimpaguesit zyrtarisht dhe ky shërben njëkohësisht si njoftim detyrimi dhe kërkesë për të paguar. Vlerësim tatimor nga zyra mund të bëhet edhe për detyrimet tatimore për tatimin mbi fitimin, në rastet kur ushtrimi i kontrollit në vend është i pamundur jo për arsye që kanë të bëjnë me punën e organeve tatimore, por me faktin se tatimpaguesi nuk gjendet apo ai refuzon të kontrollohet. Vlerësimi tatimor nga zyra për këto raste, bëhet duke u bazuar në të dhënat e

periudhave të mëparshme, kapacitetet dhe aktivet që zotëron tatimpaguesi, në numrin e të punësuarve, llojin e veprimtarisë, shpenzimet e karakterit personal-familjar, aktive që nuk janë pjesë e vetëdeklarimeve të tatimpaguesit etj. Tatimpaguesi ka të drejtë të apelojë vlerësimin tatimor sipas procedurave të parashikuara në ligj.

b. Siç përmendet në germën ‘’b’’ më lart, kur gjatë kontrollit të kryer nga organet tatimore nuk gjendet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor, ose kur ky dokumentacion është me mangësi që nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore, organet tatimore përdorin metodat alternative të përcaktimit të detyrimeve tatimore.

Në të gjitha këto raste, organet tatimore, në kuadrin e ushtrimit të një kontrolli tatimor, kanë të drejtë të rikarakterizojnë transaksionet e tatimpaguesit, duke improvizuar një situatë sa më reale të tij në mënyrë që të përcaktojnë detyrimet tatimore nëpërmjet vlerësimit tatimor i cili i jepet tatimpaguesit në përfundim të kontrollit. Një gjë e tillë mund të bëhet si ndaj tatimpaguesve me qarkullim vjetor më të madh se kufiri i regjistrimit për TVSH, ashtu edhe ndaj tatimpaguesve që janë të regjistruar si biznese të vogla dhe që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative, të përcaktuara në pikën “b”, të nenit 36 të ligjit, bëhet gjithmonë në kuadrin e një kontrolli në vend pranë tatimpaguesit dhe vetëm pasi për të, të ketë urdhëruar me shkrim kryetari i degës së tatimeve. Inspektori apo inspektorët tatimorë që janë të ngarkuar me kryerjen e kontrollit, kur konstatojnë se tatimpaguesi nuk ka mbajtur dokumentacion apo kur ky dokumentacion është me të meta serioze, i propozojnë me shkrim kryetarit të degës së tatimeve që të urdhërojë me shkrim përdorimin e metodave alternative për përcaktimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Për të bërë një gjë të tillë, organet tatimore gjykojnë mbi bazën e të dhënave që mund të disponojnë për këtë tatimpagues siç janë për shembull të dhënat e periudhave të mëparshme tatimore, të dhënat për importet, të dhënat për transaksionet e kryera me fonde buxhetore (të marra në degët e thesarit) apo me fonde të donatorëve të ndryshëm, të dhënat e siguruara nga klientët apo furnitorët e tatimpaguesit, të dhënat për numrin e punonjësve, të dhënat për çmimet e mallrave apo shërbimeve të kryera nga tatimpagues të tjerë të ngjashëm, të dhënat për kapacitet dhe aktivet që zotëron tatimpaguesi, etj. Vlerësimi tatimor i kryer si më sipër i dërgohet tatimpaguesit zyrtarisht dhe ky shërben njëkohësisht si njoftim detyrimi dhe kërkesë për të paguar këtë detyrim. Tatimpaguesi ka të drejtë të apelojë vlerësimin tatimor sipas procedurave të parashikuara në ligj.

c. Organet tatimore bëjnë vlerësim të detyrimit tatimor me metodat alternative edhe në rastin kur, gjatë një kontrolli fiskal në vend pranë tatimpaguesit, rezulton se ai ka deformuar dukshëm e në mënyrë të qartë çmimet e shitjes së mallrave apo të shërbimeve.

Kemi të bëjmë me deformim të çmimeve të shitjes, në rastin kur tatimpaguesi për periudha të gjata kohë pretendon se shet me çmime të tilla që ndryshojnë dukshëm në ulje, pa asnjë shkak të argumentuar e të provuar, nga çmimi real i tregut. Vlerësimi tatimor duke përdorur metodat alternative të përcaktuar në pikën “c” të nenit 36 të ligjit bëhet gjithmonë në kuadrin e një kontrolli në vend pranë tatimpaguesit dhe vetëm pasi për të, të ketë urdhëruar kryetari i degës së tatimeve. Inspektori apo inspektorët tatimorë që janë ngarkuar me kryerjen e kontrollit, kur konstatojnë një gjë të tillë, i propozojnë me shkrim kryetarit të degës së tatimeve që të urdhërojë po me shkrim përdorimin e metodave alternative për përcaktimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Kryetari i degës së tatimeve është i detyruar të lëshojë ose jo këtë autorizim brenda 3 ditësh punë nga data e propozimit. Të gjitha propozimet e bëra dhe autorizimet e lëshuara evidentohen në përputhje me rregullat e protokollimit dhe arshivimit të brendshëm. Për të bërë vlersimin tatimor, në këtë rast, administrata tatimore merr për bazë çmimet reale të tregut, të konstatuara për të njëjtën periudhë për mallra apo shërbime të njëjta në tatimpagues të tjerë që kryejnë veprimtari të ngjashme. Çmimet reale të tregut përllogariten në bazë të kontrolleve e sondazheve të herëpashershme të administratës tatimore pranë tatimpaguesve. Këto sondazhe apo kontrolle verifikuese në vend dhe kryehen posaçërisht për të konstatuar çmimet reale të shitjes nga ana e tatimpaguesve në momente të caktuara. Ato kryehen në mënyrë të befasishme dhe shoqërohen kurdoherë me anë të një procesverbali konstatimi. Kontrolle apo sondazhe të tilla kryhen sidomos pranë tatimpaguesve të mëdhenj dhe për një numër të kufizuar mallrash apo shërbimesh, kryesisht të konsumit masiv. Çmimet reale të tregut, mund të sigurohen gjithashtu, edhe nëpërmjet burimeve të mundshme të informacionit, nëpërmjet shpalljeve apo afishimeve publike, reklamave etj. të cilat evidentohen rregullisht nga strukturat përkatëse në deget e tatimeve.

d. Edhe në rastin kur tatimpaguesit kryejnë me lekë në dorë dhe jo me kalime në llogari, transaksione shitblerje që kalojnë shumën 300 mijë lekë, organet tatimore kanë të drejtë të bëjnë vlerësimin e detyrimit tatimor me metoda alternative.

Vlerësimi me këto metoda me këtë rast, është kurdoherë rezultat i një kontrolli tatimor dhe në asnjë rast ai nuk bëhet nga zyra. Inspektori apo inspektorët tatimorë që janë të ngarkuar me kryerjen e kontrollit, kur konstatojnë se tatimpaguesi ka kryer me lekë në dorë transaksione që kalojnë kufirin e përcaktuar me ligj, i propozojnë me shkrim kryetarit të degës së tatimeve që të urdhërojë po me shkrim përdorimin e metodave alternative për përcaktimin e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Pra, vlerësimi tatimor, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në pikën "d" të ligjit, bëhet gjithmonë në kuadrin e një kontrolli në vend pranë tatimpaguesit dhe vetëm pasi për të të ketë urdhëruar kryetari i degës së tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për zbatimin e pikave të mësipërme, mund të lidhë akt-marrëveshje me shoqatat e specializuara të biznesit, kur një gjë e tillë është e nevojshme dhe e mundur, për të përcaktuar vlerën orientuese të tatueshme mbi bazën e të cilës bëhet përcaktimi i detyrimeve tatimore. Këto akt-marrëveshje miratohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Financave dhe botohen në Buletinin tatimor.

2.2.4 Tatimpaguesit që kryejnë furnizime mallrash apo shërbimesh, janë të detyruar të afishojnë çmimet e shitjes së mallit apo të shërbimit që furnizojnë, pavarësisht nga natyra e furnizimit dhe nga statusi i blerësit. Kjo dispozitë është e detyrueshme për të gjithë tatimpaguesit, si për ata që bëjnë furnizime mallrash apo shërbimesh me pakicë ashtu dhe për ata që bëjnë furnizime mallrash apo shërbimesh me shumicë, pavarësisht nga fakti nëse janë tatimpagues që i nënshtrohen dhe janë regjistruar për taksën vendore mbi biznesin e vogël apo i nënshtrohen dhe janë të regjistruar për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Tatimpaguesit që furnizojnë mallra apo shërbime me pakicë janë të detyruar të afishojnë në mënyrë të dukshme çmimin e çdo malli apo shërbimi që ata furnizojnë. Kurse tatimpaguesit që furnizojnë mallra apo shërbime me shumicë, në bazë të kësaj dispozite janë të detyruar të kenë të gatshme në vendin e furnizimit listën e çmimeve të mallrave apo shërbimeve që furnizojnë. Kjo liste i vihet në dispozicion administratës tatimore sa herë që kjo e fundit e kërkon një gjë të tillë. Mosplotësimi i kërkesave të mësipërme penalizohet në bazë të pikës 3.1.4 dhe 3.1.10 të këtij udhëzimi.

2.3 PAGIMI I DETYRIMEVE TATIMORE

2.3.1 Detyrimet tatimore paguhen në degët e bankave, në agjencitë bankare dhe në zyrat postare, organet qendrore drejtuese të të cilave kanë marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Në këto marrëveshje përcaktohet lloji i detyrimit që do të arkëtohet për llogari të organeve tatimore, vendi i arkëtimit të këtyre detyrimeve, kushtet që duhet të plotësohen dhe mënyra e dhënies së informacioneve për pagesat e arkëtuara.

2.3.2 Detyrimet tatimore paguhen sipas afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore. Në raste të veçanta, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me kërkesën e argumentuar të tatimpaguesit, mund të lëshojë një autorizim me shkrim për miratimin e zgjatjes së afatit të pagesës për të gjithë detyrimet tatimore, me përjashtim të detyrimeve për TVSH-në. Zgjatja e afatit të pagesës nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga afati i përcaktuar në ligjet e veçanta tatimore. Autorizimi për miratimin e zgjatjes së afatit të pagesës së një detyrimi tatimor për tatimpaguesit që kërkojnë një gjë të tillë jepet në rastet e mëposhtme:

a. Kur tatimpaguesi provon se nuk mund të respektojë afatin për shkaqe shëndetësore të tij ose të stafit të tij që merret me përgatitjen e deklaratës tatimore të tatimit mbi fitimin, të tatimit mbi të ardhurat personale apo të ndonjë tatimi tjetër.

b. Kur tatimpaguesi i të ardhurave personale provon se nuk mund të bëjë deklaratën e të ardhurave personale të tij për shkaqe objektive, si në rastin e kryerjes së shërbimit ushtarak.

c. Kur tatimpaguesi provon se për arsye objektive e të argumentuara nuk mund të respektojë afatet ligjore të deklarimit tatimor.

Në çdo rast, zgjatja e afatit të pagesës nuk ndërpret llogaritjen dhe pagimin e interesave. Ato llogariten dhe paguhen duke marrë për bazë afatin në të cilin duhet të paguheshin detyrimet tatimore, siç përcaktohet në ligjet e veçanta tatimore.

Për tatimpaguesit që kërkojnë shtyrje të afatit të deklarimit dhe pagesës së një detyrimi tatimor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve mund të kërkojë garanci. Kërkesa për garanci bëhet me shkrim dhe i dërgohet tatimpaguesit. Garancia jepet nga njëra prej bankave, klient i të cilës është

tatimpaguesi që kërkon shtyrjen e afatit të pagesës. Në këtë rast banka që lëshon garancinë, bëhet garant për detyrimin e tatimpaguesit. Pasi tatimpaguesi paraqet dokumentin e kësaj garancie, Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve autorizon miratimin e zgjatjes së afatit të deklarimit dhe pagesës së detyrimit tatimor.

2.3.3 Në zbatim të nenit 41 të ligjit, për shkaqe që kanë të bëjnë me gjendjen e keqe të përkohshme financiare të tatimpaguesit, ky i fundit mund të kërkojë të paguajë me këste një detyrim tatimor të papaguar. Organet tatimore për të pranuar pagesën me këste të një detyrimi tatimor, mund të kërkojnë nga tatimpaguesi paraqitjen e një garancie. Garancia jepet nga njëra prej bankave, klient i të cilës është tatimpaguesi që kërkon pagesën me këste. Në këtë rast banka që lëshon garancinë, bëhet garant për detyrimin e tatimpaguesit. Kur plotësohen kushtet e mësipërme, organet tatimore pranojnë pagesën me këste të detyrimit tatimor duke hartuar në këtë rast një marrëveshje me shkrim me tatimpaguesit. Pagesa me këste nuk mund të pranohet për një periudhë më të gjatë se 9 muaj nga momenti i hartimit të marrëveshjes. Pagesa me këste e një detyrimi tatimor, nuk ndërpret llogaritjen e interesave për të gjithë detyrimin. Pranimi i pagesës me këste të një detyrimi tatimor të papaguar, nga organet tatimore, do të thotë se gjatë periudhës për të cilën është rënë dakord për pagimin me këste, ndaj tatimpaguesit nuk mund të merren masat e vjeljes me forcë të detyrimeve tatimore të përcaktuara në nenet 45 e 46 të ligjit (nxjerrja e vendimeve ekzekutive për bllokimin e llogarive bankare, sekuestrimin e pasurisë, mbylljen e veprimtarisë, etj.). Këto masa merren vetëm pasi ka përfunduar afati për të cilin është pranuar pagesa me këste dhe kur tatimpaguesi nuk ka respektuar derdhjen e kësteve në shumën ë duhur dhe në afatin e caktuar.

2.3.4 Kur një tatimpagues nuk mund të paguajë menjëherë të gjithë shumen e detyrimit, i cili përbëhet, përveç shumës së tatimit të papaguar edhe nga interesa dhe dënime administrative, pagesat e kryera llogariten në fillim për likuidimin e tatimit të papaguar, më pas të interesave dhe në fund të dënimeve administrative. Kështu për shembull në qoftë se për një tatimpagues që paguan 800 mijë lekë nga detyrimi i tij tatimor prej 1 milion lekë, i cili përbëhet nga 500 mijë lekë tatim i papaguar, 200 mijë lekë interesa dhe 300 mije lekë dënim administrativ (gjobë), detyrimi i tij i mbetur tatimor është 200 mijë lekë dhe ky detyrim është vetëm dënim administrativ i papaguar. Në këtë rast pra tatimi i papaguar dhe interesat janë likuiduar plotësisht, kurse nga dënimet administrative janë likuiduar vetëm 100 mijë lekë.

2.3.5 Në rastet kur një tatimpagues nuk paguan shumën e plotë të detyrimit tatimor brenda afateve të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore, ai detyrohet të paguajë interesa mbi shumën e detyrimit tatimor të papaguar duke filluar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme, deri në datën në të cilën ajo kryhet. Interesi për mospagimin e detyrimeve tatimore brenda afateve të përcaktuara, llogaritet 2 për qind për muajin e parë apo një pjesë të tij dhe 1 për qind për muajt pasardhës ose pjesë të tyre. Për mospagimin në kohë të parapagimeve të tatimit mbi fitimin, nuk zbatohen interesa për pagesë të vonuar. Për këtë tatim, interesat zbatohen për mospagimin në kohë të detyrimeve që rezultojnë në momentin e paraqitjes së deklaratës vjetorë dhe të rillogaritjes përfundimtare të tatimit mbi fitimin. Për detyrimet tatimore të papaguara, para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9333, datë 06.12.2004 "Për Procedurat Tatimore", zbatohen normat e vjetra të interesit, për çdo muaj vonesë apo pjesë të tij që i përket periudhës para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji. Për çdo muaj vonesë që i përket periudhës pas hyrjes në fuqi të ligjit zbatohen normat e reja të interesit.

Në çdo rast interesat konsiderohen pjesë e pandarë e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Interesat mblidhen duke respektuar të gjitha procedurat e mbledhjes së tatimeve të papaguara dhe derdhen në llogarinë përkatëse të të ardhurave tatimore.

Për detyrimet e papaguara në afat që lidhen me taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe ato që lidhen me tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, nuk llogariten interesa sipas paragrafit të mësipërm por zbatohen dënime administrative (gjoba për pagesë të vonuar).

2.4 KTHIMI I TATIMEVE TË PAGUARA TEPËR

2.4.1 Kthimi i tatimeve të paguara tepër dhe rimbursimi i TVSH-së

Tatimpaguesit që plotëson kriteret sipas përcaktimeve të ligjit "Për TVSH-në", i lind e drejta të kërkojë rimbursim. Rimbursimi i TVSH-së kryhet sipas procedurave dhe afateve të ligjit "Për TVSH-në". Ky rimbursim dhe kthimi i tatimeve të paguara me tepër mund të bëhet sipas një prej mënyrave të mëposhtme:

- shuma e paguar më tepër mund të kalohet për llogari të pagimit të detyrimeve të tjera tatimore të papaguara të tatimpaguesit;

- shuma e paguar më tepër mund të kalohet për llogari të pagimit të detyrimeve të mëvonshme të tatimpaguesit, por vetëm me pëlqimin e tatimpaguesit;

- shuma e paguar tepër kalohet nga Dega e Tatimeve në llogarinë bankare të tatimpaguesit.

Kur shuma që ka paguar një tatimpagues pretendohet prej tij se është më e madhe se shuma e vlerësuar si detyrim për t'u paguar, ai ka të drejtën të kërkojë kthimin e shumës së tepërt. Pretendimin e tij, tatimpaguesi duhet ta paraqesë me një kërkesë me shkrim në Degën e Tatimeve ku deklaron periodikisht. Dega e Tatimeve është e detyruar që të marrë vendim për kthimin ose jo të shumës së pretenduar si të paguar më tepër, duke e njoftuar tatimpaguesin me shkresë brenda 60 ditëve nga data që ai ka protokolluar kërkesën me shkrim. Në rast përgjigje pozitive nga Dega e Tatimeve, kthimi i shumës së paguar më tepër ekzekutohet brenda 60 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës me shkrim nga tatimpaguesi, siç përcaktohet në nenin 39 të ligjit.

Nëse Dega e Tatimeve nuk bën kthimin e shumës së paguar tepër në një nga format e kthimit si më sipër brenda 60 ditësh apo nuk bën rimbursimin brenda afateve të përcaktuara në ligjin "Për TVSH-në", ajo është e detyruar të paguajë interesat në masën 2% për muajin e parë të vonesës ose pjesë të tij dhe 1% për çdo muaj apo pjesë të tij që vijon.

2.5 MBLEDHJA ME FORCË E DETYRIMEVE TATIMORE

2.5.1 Procedurat e zakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore fillojnë vetëm pasi ndaj tatimpaguesit që ka detyrime të prapambetura të papaguara, janë marrë të gjitha masat paraprake dhe janë respektuar të gjitha procedurat e njoftimit, të përcaktuara në nenin 45 dhe 46 të ligjit "Për procedurat tatimore" dhe të përcaktuara në ligjet e veçanta tatimore.

Ekzistenca e detyrimeve të papaguara mund të ketë dy arsye. Së pari, për shkak të mospagimit në kohë të detyrimeve të deklaruara si të pagueshme nga vetë tatimpaguesi dhe, së dyti, nga mospagimi në kohë i detyrimeve të rezultuara nga një rivlerësim tatimor.

Në rastin kur kemi të bëjmë me mospagim brenda 30 ditëve nga data kur duhej të ish kryer pagesa (datë e përcaktuar në ligjet e veçanta tatimore), të një detyrimi tatimor të deklaruar si të pagueshëm nga vetë tatimpaguesi, ndaj tij fillojnë procedurat e vjeljes me forcë të detyrimeve tatimore. Në këtë rast tatimpaguesi nuk mund të apelojë, pasi detyrimi i tij tatimor është vlerësuar dhe deklaruar si i pagueshëm nga vetë ai. Për këtë, dega përkatëse e tatimeve vepron si më poshtë:

Lëshon një Urdhër Bllokimi në dy kopje, në bazë të të cilit urdhërohen të gjitha bankat ku tatimpaguesi debitor mund të ketë llogaritë e tij, të bllokojnë një shumë sa detyrimi tatimor i papaguar i tatimpaguesit ose të gjithë gjendjen e llogarisë bankare, kur ajo është më e vogël se detyrimi tatimor i papaguar. Në qoftë se tatimpaguesi ka më shumë se një llogari në të njëjtën bankë, banka, mbi bazën e urdhrit të organit tatimor, bllokon llogarinë/llogaritë që kanë shumën e mjaftueshme të detyrimit të papaguar. Me marrjen e Urdhrit të mësipërm nga dega e tatimeve, banka, brenda të njëjtës ditë pune në të cilën ka marrë Urdhrin, bllokon llogarinë apo depozitën e debitorit, në masën e detyrimit të papaguar dhe lajmëron menjëherë debitorin për bllokimin. Te gjitha këto veprime ndërmerren dhe evidentohen në përputhje me procedurat dhe dokumentacionin e përcaktuar në Manualin e Menaxhimit të Borxhit.

Pas kësaj, tatimpaguesi ka të drejtë të deklarojë në degën e tatimeve numrin e llogarisë së tij likuiduese që përmban shumën e duhur. Për këtë, përveç deklaratës, ai duhet të paraqesë edhe dokumentin përkatës bankar i cili vërteton numrin e llogarisë së tij likuiduese dhe shumen përkatëse të llogarisë që duhet të jetë jo më e vogël se detyrimi i papaguar. Brenda 3 ditëve pune bankare nga data e paraqitjes së kësaj deklarate të shoqëruar me dokumentin bankar përkatës, dega e tatimeve, lëshon një urdhër për zhbllokimin e të gjitha llogarive të tjera të tatimpaguesit në bankat e tjera. Në qoftë se për çfarëdo arsye organi tatimor nuk lëshon urdhrin e mësipërm të zhbllokimit, banka bën vetë zhbllokimin e llogarive të tatimpaguesit vetëm në qoftë se kanë kaluar 20 ditë pune bankare nga data e marrjes së Urdhër Bllokimit.

Tatimpaguesi debitor ka 10 ditë pune bankare kohë nga data e marrjes nga banka të Urdhrit të Bllokimit për të bërë vullnetarisht pagesën. Datë e marrjes nga banka të Urdhër Bllokimit quhet data kur banka konfirmon mbërritjen e tij nëpërmjet një vule bankare në të dy kopjet e lëshuara nga organi tatimor, njëra nga të cilat i jepet punonjësit të organit tatimor që e dorëzon atë. Në qoftë se tatimpaguesi debitor nuk e bën pagesën vullnetarisht, Dega e Tatimeve e Rrethit lëshon një Urdhër Ekzekutimi mbi bazën e të cilit banka menjëherë, brenda të njëjtës ditë pune vepron mbi llogarinë apo

depozitën e tatimpaguesit duke ekzekutuar Urdhrin e Ekzekutimit të organit tatimor dhe duke kaluar nga llogaria apo depozita e tij në llogarinë e organit tatimor përkatës një shumë sa detyrimi i papaguar tatimor i tatimpaguesit ose të gjithë gjendjen e llogarisë bankare, kur ajo është më e vogël se detyrimi tatimor i papaguar. Urdhër Ekzekutimi lëshohet jo më vonë se 5 ditë pune bankare nga data e përfundimit të afatit prej 10 ditësh pune bankare të lëshimit të Urdhër Bllokimit. Në rastin kur gjendja e llogarisë bankare është më e vogël nga detyrimi tatimor i papaguar, banka kalon në llogarinë e organit tatimor të gjithë shumën gjendje në llogarinë e tatimpaguesit dhe llogaria e tatimpaguesit mbetet e bllokuar deri sa të bëhet i mundur kalimi i të gjithë shumës së kërkuar në llogarinë e organit tatimor.

Kur kemi të bëjmë me mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore që rezultojnë nga një rivlerësim tatimor, i cili nuk është apeluar nga ana e tatimpaguesit, dega e tatimeve e rrethit përkatës vepron sipas pikës 2.5.1 më lart. Po në këtë mënyrë veprohet edhe në rastet kur tatimpaguesi apelon por apelimi i tij nuk është pranuar nga shkalla përkatëse e apelimit, për shkak se: (i) apelimi nuk është bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh nga data e kryerjes se rivlerësimit tatimor, (ii) se nuk është parapaguar tatimi i përcaktuar sipas rivlerësimit (pa interesat dhe dënimet eventuale), (iii) se nuk është paraqitur garancia e nevojshme bankare para apelimit. Urdhri i Bllokimit në çdo rast do të përmbajë përveç arsyes së lëshimit të tij dhe shumës së detyrimit të papaguar, edhe faktin nëse tatimpaguesi ka apeluar apo jo, si dhe në rastin e mospranimit të apelimit edhe shkakun e këtij mospranimi.

Kur kemi të bëjmë me mospagimin në kohë të detyrimeve tatimore që rezultojnë nga një rivlerësim tatimor, i cili është apeluar nga ana e tatimpaguesit, dhe apelimi është pranuar nga shkalla e parë e apelimit, dega e tatimeve nuk mund të bllokojë llogarinë bankare të tatimpaguesit. Dega e tatimeve e rrethit përkatës mund ta bëjë një gjë të tillë vetëm pasi të ketë përfunduar procesi i apelimit dhe vendimi i shkallës së fundit të apelimit të jetë i formës së prerë në favor të administratës tatimore. Në këtë rast dega e tatimeve e rrethit përkatës vepron si më poshtë:

Lëshon një Urdhër, në bazë të të cilit urdhërohen të gjitha bankat ku tatimpaguesi debitor mund të ketë llogaritë e tij, të bllokojnë një shumë sa detyrimi tatimor i papaguar i tatimpaguesit ose të gjithë gjendjen e llogarisë bankare, kur ajo është më e vogël se detyrimi tatimor i papaguar. Në qoftë se tatimpaguesi ka më shumë se një llogari në të njëjtën bankë, banka, mbi bazën e urdhrit të organit tatimor, bllokon llogarinë/llogaritë që kanë shumën e mjaftueshme të detyrimit të papaguar. Urdhër Bllokimi i mësipërm do të shoqërohet me vendimin e shkallës së fundit të apelimit i cili ka marrë formën e prerë dhe është në favor të administratës tatimore. Me marrjen e Urdhrit të mësipërm nga dega e tatimeve, banka, brenda të njëjtës ditë pune në të cilën ka marrë Urdhrin e Bllokimit, bllokon llogarinë apo depozitën e debitorit, në masën e detyrimit të papaguar dhe lajmëron menjëherë debitorin për bllokimin.

Pas kësaj, tatimpaguesi ka të drejtë të deklarojë në degën e tatimeve numrin e llogarisë së tij likuiduese që përmban shumën e duhur. Për këtë, përveç deklaratës, ai duhet të paraqesë edhe dokumentin përkatës bankar i cili vërteton numrin e llogarisë së tij likuiduese dhe shumën përkatëse të llogarisë që duhet të jetë jo më e vogël se detyrimi i papaguar. Brenda 3 ditëve pune bankare nga data e paraqitjes së kësaj deklarate të shoqëruar me dokumentin bankar përkatës, dega e tatimeve, lëshon një urdhër për zhbllokimin e të gjitha llogarive të tjera të tatimpaguesit në bankat e tjera.

Tatimpaguesi debitor ka 10 ditë pune bankare kohë nga data e marrjes së Urdhrit të Bllokimit për të bërë vullnetarisht pagesën. Në të kundërt (kur tatimpaguesi debitor pra nuk e bën një gjë të tillë), Dega e Tatimeve e Rrethit lëshon një Urdhër Ekzekutimi mbi bazën e të cilit banka menjëherë brenda të njëjtës ditë pune vepron mbi llogarinë apo depozitën e tatimpaguesit duke ekzekutuar Urdhrin e Ekzekutimit të organit tatimor dhe duke kaluar nga llogaria apo depozita e tij në llogarinë e organit tatimor përkatës një shumë sa detyrimi i papaguar tatimor i tatimpaguesit ose të gjithë gjendjen e llogarisë bankare, kur ajo është më e vogël se detyrimi tatimor i papaguar. Urdhër Ekzekutimi lëshohet jo më vonë se 5 ditë pune bankare nga data e përfundimit të afatit prej 10 ditësh pune bankare të lëshimit të Urdhër Bllokimit. Në rastin kur gjendja e llogarisë bankare është më e vogël nga detyrimi tatimor i papaguar, banka kalon në llogarinë e organit tatimor të gjithë shumën gjendje në llogarinë e tatimpaguesit dhe llogaria e tatimpaguesit mbetet e bllokuar deri sa të bëhet i mundur kalimi i të gjithë shumës së kërkuar në llogarinë e organit tatimor.

2.5.2 Procedurat e jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, fillojnë vetëm pasi më parë janë ndërmarrë të gjitha veprimet e përcaktuara në nenin 45 të ligjit ‘’Për Procedurat Tatimore” dhe në pikën 2.5.1, të këtij Udhëzimi. Pra, zbatimi i nenit 46 të ligjit

të procedurave tatimore ‘’Procedurat e jashtëzakonshme të mbledhjes me forcë të detyrimeve’’, ndërmerret për tatimpaguesit me detyrime tatimore të papaguara, ndaj të cilëve nuk është bërë e mundur mbledhja e detyrimeve nëpërmjet vendimit ekzekutiv të nxjerrë për bankat nga kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës.

Për zbatimin e nenit 46 të ligjit, organet tatimore, aplikojnë procedurat e jashtëzakonshme për mbledhjen me forcë të detyrimeve duke vepruar si më poshtë:

a. Kryetari i degës se tatimeve të rrethit përkatës, për të gjitha llojet e detyrimeve tatimore të papaguara, mund të nxjerrë një vendim ekzekutiv, në bazë të të cilit urdhërohet mbyllja e mjediseve ku tatimpaguesi me detyrime të papaguara ushtron veprimtarinë e tij ekonomike. Mbyllja e mjediseve të veprimtarisë bëhet nga punonjësit e Policisë Tatimore dhe vazhdon derisa tatimpaguesi të ketë paguar detyrimet e tij tatimore të papaguara por jo më shumë se 30 ditë. Për detyrimet e papaguara për TVSH, vendimi ekzekutiv për mbylljen e mjediseve të veprimtarisë nxirret nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve në bazë të propozimit të kryetarit të degës përkatëse të tatimeve.

b. Në qoftë se edhe pas 30 ditësh nga mbyllja e mjediseve të veprimtarisë, tatimpaguesi nuk ka paguar detyrimin e tij tatimor, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës, për të gjitha llojet e detyrimeve tatimore të papaguara, mund të nxjerrë një vendim ekzekutiv, në bazë të të cilit urdhërohet sekuestrimi i pasurive të biznesit të tatimpaguesit. Shuma e pasurive që urdhërohet të sekuestrohen sipas vendimit ekzekutiv të mësipërm nuk mund të jetë më e madhe se shuma nëpërmjet të cilës sigurohet pagimi i detyrimit tatimor të papaguar nga tatimpaguesi. Vendimi ekzekutiv zbatohet nga Policia Tatimore. Kur zbatohet masa e sekuestrimit, fillimisht sekuestrohen pasuritë e luajtshme të biznesit të tatimpaguesit me detyrime të papaguara tatimore dhe kur është e nevojshme kalohet në sekuestrimin e pasurive të paluajtshme të biznesit të tij. Pasuritë e sekuestruara, kalojnë në favor të shtetit dhe llogariten të konfiskuara brenda 30 ditësh nga nxjerrja e vendimit ekzekutiv të sekuestrimit. Ato shiten sipas akteve normative në fuqi. Të ardhurat e arkëtuara nga shitja e tyre pasi zbriten shpenzimet e ruajtjes dhe të shitjes, përdoren për likuidimin e detyrimit tatimor të papaguar. Pjesa e të ardhurave që mund të mbetet mbas likuidimit të të gjithë detyrimit tatimor të papaguar, i kthehet tatimpaguesit.

c. Në qoftë se edhe pas nxjerrjes së vendimit ekzekutiv për sekuestrimin e pasurive të tatimpaguesit, për arsye të ndryshme nuk arrihet të paguhet detyrimi tatimor i tatimpaguesit, atëherë ndaj këtij të fundit bëhet denoncim në organet e Prokurorisë, në bazë të nenit 181 të Kodit Penal.

d. Kur tatimpaguesi nuk mund të paguajë detyrimet e tij tatimore të papaguara, organi tatimor ku është i regjistruar tatimpaguesi, kërkon fillimin e procedurave të falimentimit, si kreditor i interesuar, në mbështetje të ligjit nr. 8901, date 23.05.2002 “Për falimentimin”.

3. MASAT NDËSHKUESE

3.1 DENIMET ADMINISTRATIVE

3.1.1 Në zbatim të nenit 47 të ligjit, për shkeljen e dispozitave të legjislacionit tatimor jepen dënime administrative (gjoba). Dënimet administrative jepen në përputhje me përcaktimet e bëra në ligjet e veçanta tatimore dhe në nenet 49 deri në 53 te ligjit ‘’Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’’.

Në çdo rast dënimet administrative (gjobat) konsiderohen pjesë e pandarë e detyrimit tatimor të tatimpaguesit. Ato mblidhen duke respektuar të gjitha procedurat sipas të cilave mblidhen edhe tatimet e papaguara dhe derdhen në llogarinë përkatëse të të ardhurave tatimore.

Në rastet kur tatimpaguesi kryen më shumë se një shkelje, jepen dënime administrative (gjoba) të veçanta për secilën shkelje.

Rregullat e administrimit të sanksioneve të vendosura dhe mënyra e kontabilizimit të tyre nga sektorët përkatës në degën e tatimeve përcaktohen në manualin përkatës.

Degët e tatimeve paraqesin çdo tremujor në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, evidencën e sanksioneve të vendosura, siç përcaktohet në Manualin e Kontrollit.

3.1.2 Dënimet për shkeljet lidhur me regjistrimin

Në zbatim të pikës 1.a. të nenit 49 të ligjit, tatimpaguesi konsiderohet i papajisur me Certifikatë (i paregjistruar) në këto raste:

a. Kur tatimpaguesit me qarkullim më të madh se kufiri i regjistrimit për TVSH, nuk janë të pajisur me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë dhe njëkohësisht me Certifikatën e NIPT, ndaj tyre merret fillimisht masa e mbylljes së veprimtarisë për 15 ditë kalendarike. Në qoftë se tatimpaguesi brenda afatit 15 ditor regjistrohet në organin tatimor, ndaj tij nuk vendoset masa e gjobës. Në të

kundërt, kur tatimpaguesi nuk regjistrohet edhe pas kalimit të afatit prej 15 ditësh mbylljeje, ndaj tij merret masa e gjobës prej 75 mijë lekë. Të papajisur me Certifikatë (të paregjistruar) konsiderohen edhe çdo filial, degë apo njësi e një tatimpaguesi që nuk është pajisur me Certifikatën sekondare të NIPT. Në të gjitha këto raste tatimpaguesit dënohen me gjobë 50 mijë lekë.

b. Kur tatimpaguesit me qarkullim më të vogël se kufiri i regjistrimit për TVSH-në (tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin) nuk janë pajisur me Certifikatën e Ushtrimit të Veprimtarisë për vitin përkatës ushtrimor dhe për çdo njësi në të cilën tatimpaguesit ushtron veprimtari, merret fillimisht masa e mbylljes së aktivitetit për 15 ditë kalendarike. Në qoftë së tatimpaguesi brenda 15 ditëve regjistrohet në organin tatimor, ndaj tij nuk vendoset masa e gjobës. Në të kundërt, kur tatimpaguesi nuk regjistrohet edhe pas kalimit të afatit prej 15 ditësh mbylljeje, ndaj tij merret masa e gjobës prej 35 mijë lekë. Shkeljet e tjera lidhur me regjistrimin dënohen sipas ligjit "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe ligjit "Për Tatimin mbi të Ardhurat", kapitulli "Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin".

c. Në zbatim të pikës 1.b. të nenit 49 të ligjit, tatimpaguesit kryejnë shkelje nëse nuk u njoftojnë organeve tatimore ndryshimet e mëposhtme :

- ndryshimin e emrit,
- ndryshimin e adresës së selisë dhe të filialeve, degëve apo njësive,
- ndryshimin në formën juridike,
- krijimin ose hapjen e filialeve, degëve apo njësive të reja,
- ndryshimet në llojin e veprimtarisë ekonomike.

Për mosnjoftimin e ndryshimeve të mësipërme të gjithë tatimpaguesit e regjistruar për TVSH dënohen me gjobë 35 mije lekë kurse të gjithë tatimpaguesit e tjerë dënohen sipas ligjit "Për taksën vendore mbi biznesin e vogël" dhe ligjit "Për Tatimin mbi të Ardhurat", kapitulli "Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin".

Kur edhe pas vendosjes së gjobave të mësipërme, tatimpaguesit vazhdojnë të ushtrojnë veprimtari pa u pajisur me Certifikatë, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës nxjerr një Vendim Ekzekutiv në bazë të të cilit urdhërohet vendosja e sekuestros mbi pasuritë e biznesit të tatimpaguesit dhe mbyllja e aktivitetit të tij. Ky Vendim Ekzekutiv ekzekutohet nga punonjësit e Policisë Tatimore.

3.1.3 Dënimet për agjentët tatimorë

Mosllogaritja, mosmbajtja dhe mostransferimi në buxhet në mënyrë korrekte dhe në kohën e duhur të tatimeve të mbajtura në burim si dhe mostransferimi në buxhet i taksave të arkëtuara, përbën shkelje dhe agjentët tatimore në këtë rast detyrohen të paguajnë përveç detyrimit tatimor edhe një gjobë të barabartë me këtë detyrim.

Mosmbajtja e regjistrimeve për pagesat e bëra për çdo tatimpagues të veçantë si dhe për tatimet e taksat e mbajtura për këto pagesa, të cilat janë transferuar në buxhet, përbën shkelje dhe dënohet me gjobë herën e parë me 10 mijë lekë dhe në rast përsëritjeje me 50 mijë lekë.

Në zbatim të nenit 50 të Ligjit, agjentët tatimorë të ngarkuar me mbledhjen e tatimeve dhe taksave, janë të detyruar t'u japin në çdo kohë organeve tatimore, të dhëna për tatimet dhe taksat e transferuara në buxhet. Ato janë të detyruar gjithashtu të bëjnë çdo muaj akt-rakordime për tatimet dhe taksat e mbledhura.

Mosdhënia e dokumentacionit të kërkuar nga organet tatimore për kontrollin e saktësisë së llogaritjeve, të mbajtjes në burim dhe të pagimit të tatimeve e taksave, përbën shkelje dhe dënohet me gjobë në masën 50 mijë lekë.

3.1.4 Dënimet për mosdhënie informacioni

Në zbatim të neneve 51 e 65 të ligjit, një tatimpagues i cili gjatë kontrollit të organeve tatimore nuk jep të gjitha informacionet e kërkuara, dokumentet, regjistrimet, etj., kryen shkelje e cila dënohet me gjobë 100 mijë lekë.

Në zbatim të nenit 51 të ligjit, personat të cilët në bazë të nenit 66 janë të detyruar të japin në mënyrë automatike (pa kërkesë) informacione të ndryshme për organet tatimore dhe nuk e bëjnë një gjë të tillë, dënohen me gjobë 200 mijë lekë. Të detyruar për të dhënë informacione në mënyrë automatike, pa kërkesën e organeve tatimore janë sistemi gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive si dhe të gjithë punëdhënësit.

Në zbatim të nenit 51 të ligjit, personat të cilët në bazë të nenit 67 janë të detyruar të japin informacione përkundrejt kërkesës me shkrim të organeve tatimore dhe nuk e bëjnë një gjë të tillë, dënohen me gjobë 200 mijë lekë. Të detyruar për të dhënë informacione si më lartë janë :

- shoqëritë e sigurimeve,
- shoqëritë tregtare,
- bankat dhe institucionet financiare,
- fondet e investimeve,
- agjentet e pasurive të paluajtshme,
- personat e përfshirë në transaksione shitblerjesh,
- institucionet dhe personat juridikë vendas apo të huaj, për pagesat ndaj personave jorezidentë.

3.1.5 Dënimet për mosdokumentim

Ruajtja, përdorimi dhe transportimi i mallrave justifikohet në çdo rast me dokumentin përkatës. Për çdo rast shitje të mallrave, tatimpaguesi shitës është i detyruar të lëshojë dokumentet përkatëse të shitjes që janë:

- Kupon tatimor në rastin kur tatimpaguesi është i pajisur me arkë regjistruese. Ky kupon i jepet klientit për çdo shitje të kryer.
- Dëftese tatimore në rastin kur tatimpaguesi nuk është pajisur me arkë regjistruese. Dëftesat tatimore përgatiten në dy kopje me letër vetëkopjuese nga të cilat njëra i jepet klientit.
- Fature e thjeshtë tatimore, e cila lëshohet vetëm nga tatimpaguesit e taksës vendore dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të cilët shesin mallra apo shërbime për klientë të cilët nuk janë konsumatorë finalë të mallit apo shërbimit, por i kryejnë këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje, pra janë subjekte të regjistruar për tatimet. Tatimpaguesi duhet t'i japë klientit një faturë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh. Fatura do të përbëhet nga dy kopje duke përdorur letër vetëkopjuese ose letër karbon, dhe tatimpaguesi i jep një kopje klientit dhe një kopje e mban vetë. Fatura duhet të jetë me numër serial, dhe numri i faturës duhet të shënohet në librin e shitjeve dhe blerjeve.
- Faturë tatimore me TVSH, e cila lëshohet nga tatimpaguesit e regjistruar me TVSH, siç përcaktohet në ligjin mbi TVSH-në dhe në udhëzimin e Ministrisë së Financave në zbatim të tij.

Kur tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin nuk përmbushin ndonjërën nga kërkesat e mësipërme, në bazë të pikës "d" te nenit 32/8 të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", ata dënohen me një gjobë prej 10 000 lekësh. Nëse këta tatimpagues nuk paguajnë brenda 15 ditëve detyrimin tatimor dhe gjobën përkatëse, në bazë të pikës 4 të nenit 32/8 të ligjit të mësipërm, dega e tatimeve vendos mbylljen e veprimtarisë deri në pagimin e plotë të detyrimeve dhe të gjobave.

Kur tatimpaguesit me xhiro mbi 8 milion lekë (të regjistruar në TVSH), nuk përmbushin ndonjërën nga kërkesat e mësipërme, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 "Për Procedurat Tatimore" dhe të këtij Udhëzimi, ata dënohen me një gjobë prej 50 000 lekësh.

Transportimi i mallrave justifikohet në çdo rast me dokumentin përkatës. Për çdo rast që kemi të bëjmë me shitje të mallrave, tatimpaguesi shitës është i detyruar të lëshojë faturën përkatëse të shitjes, e cila në rastin kur shitësi është tatimpagues i regjistruar në TVSH do të jetë faturë tatimore me TVSH me numër serial dhe në rastin kur shitësi është tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin faturë e thjeshtë shitjeje, siç sqarohet më lart në pikën 3.1.5.

Mungesa e një nga dokumentet e mësipërm për mallrat në transport është shkelje dhe dënohet me një gjobë prej 40 mijë lekësh, si dhe me bllokimin e lejes së qarkullimit të mjetit. Leja e qarkullimit të mjetit bllokohet nga punonjësit e Policisë Tatimore, të cilët brenda 24 orëve e dorëzojnë atë te kryetari i degës së tatimeve në rreth, së bashku me aktin e konstatimit për vendosjen e gjobës. Leja e qarkullimit të mjetit i kthehet transportuesit nga kryetari i degës së tatimeve në rreth vetëm në qoftë se:

- tatimpaguesi shkelës ka paguar gjobën e vendosur, ose,
- tatimpaguesi ka apeluar në afat në degën e tatimeve masën e bllokimit të lejes së qarkullimit dhe gjobën.

Kur nuk kemi të bëjmë me shitje të mallrave, por me lëvizje të brendshme të tyre (nga magazina në magazinë ose dyqan, nga qendra e tatimpaguesit drejt filialeve apo degëve të tij), lëvizja dokumentohet me dokumentin e shoqërimit të mallit, i cili do të ketë formën dhe përmbajtjen sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi. Në rastet kur punonjësit e Policisë Tatimore dyshojnë për

vërtetësinë e dokumentit të shoqërimit të mallit, ata marrin masa për të shoqëruar mallin deri në destinacionin e shënuar në dokument. Kur rezulton se tatimpaguesi në fakt mallin e kishte të destinuar për shitje (pra nuk kemi të bëjmë me shitje të brendshme), ai dënohet si më sipër.

Këtu nuk bëhet fjalë për shkeljet që kanë të bëjnë me moslëshimin e faturës së TVSH, e cila dënohet siç përcaktohet në ligjin ''Për TVSH'' dhe në udhëzimin për zbatimin e tij.

3.1.6 Dënimet për moslejimin e hyrjes dhe të kontrollit

Moslejimi nga tatimpaguesit i hyrjes dhe pengimi për kryerjen e kontrollit nga ana e organeve tatimore apo përpjekjet e tatimpaguesve për të ndaluar veprimin e organeve tatimore direkt apo indirekt, vetë ose nëpërmjet një personi tjetër, konsiderohen shkelje të këtij Ligji dhe dënohen :

a. Tatimpaguesit e regjistruar për TVSH dënohen me gjobë 1 milion lekë.

b. Tatimpaguesit e regjistruar për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dënohen me gjobë 10 mijë lekë.

Në çdo rast, të drejtën e dënimit me gjobë për moslejimin e hyrjes dhe të kontrollit nga tatimpaguesit, e ka Kryetari i degës së tatimeve përkatëse.

3.1.7 Shkeljet dhe dënimet penale

Fshehja e qëllimshme e të dhënave me synimin për t'u shmangur nga pagimi i detyrimeve tatimore përbën vepër penale. Në këtë rast, organet tatimore janë të detyruara të zbatojnë fillimisht të gjitha procedurat e vjeljes së detyrimeve dhe marrjen e të gjitha masave administrative. Pasi janë marrë të gjitha masat administrative për tatimpaguesin në fjalë, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës, në zbatim të nenit 180 të Kodit Penal, bën denoncimin për ndjekje penale pranë organit të Prokurorisë.

3.1.8 Shkeljet dhe dënimet për kryerjen e arkëtimeve dhe pagesave me lekë në dorë

3.1.8.1 Kryerja me lekë në dorë dhe jo nëpërmjet kalimit nga llogaria likuiduese e blerësit në llogarinë likuiduese të shitësit e transaksioneve të shitblerjes që e kalojnë vlerën 300 mijë lekë, përbën shkelje si për shitësin ashtu dhe për blerësin dhe dënohet me një gjobë sa 5 për qind e vlerës së transaksionit të kryer. Nëse këto transaksione nuk kalojnë nëpërmjet kanaleve bankare, pra nga llogaria e blerësit në llogarinë e shitësit, konsiderohet shkelje dhe dënohet me gjobë si më poshtë:

- Në rastin kur blerësi e ka paguar me lekë në dorë shitësin, megjithëse vlera e transaksionit është më shumë se 300 mijë lekë, aplikohet një gjobë e barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit si për blerësin, ashtu edhe për shitësin.

- Në rastin kur blerësi e ka likuiduar detyrimin duke paguar me mandat arkëtimi në bankë shumën e caktuar, dhe banka e ka transferuar shumën përkatëse në llogarinë likuiduese të shitësit, aplikohet një gjobë e barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit vetëm për blerësin.

3.1.8.2 Për rastet kur vlera e transaksionit (vlera e furnizimit) është më shumë se 300 mijë lekë, pavarësisht nga fakti se blerësi dhe shitësi mund të kenë rënë dakord për një plan pagesash pjesore lidhur me këtë furnizim dhe secila pjesë e saj është më e vogël se shumat e mësipërme, likuidimi i detyrimit kërkohet të bëhet nëpërmjet kalimit të mjeteve nga llogaria likuiduese e blerësit në llogarinë likuiduese të shitësit për çdo pagesë pjesore që lidhet me atë furnizim. Nëse këto transaksione pjesore nuk kalojnë nëpërmjet kanaleve bankare, pra nga llogaria e blerësit në llogarinë e shitësit, konsiderohet shkelje dhe dënohet me gjobë si më poshtë:

- Në rastin kur blerësi i ka bërë në cash pagesat pjesore për shitësin, aplikohet një gjobë e barabartë me 5 për qind të vlerës së transaksionit të kryer si për blerësin, ashtu edhe për shitësin.

- Në rastin kur blerësi i ka derdhur me mandat arkëtimi në bankë pagesat pjesore, dhe banka i ka transferuar shumat përkatëse në llogarinë likuiduese të shitësit, aplikohet një gjobë e barabartë me 5 për qind të transaksionit të kryer vetëm për blerësin.

8.1.8.3 Do të konsiderohen shkelje e nenit 36/1 dhe do të aplikohen sanksionet e parashikuara në nenin 52/1, edhe ato raste kur me qëllim shmangien e likuidimit të detyrimeve nëpërmjet kanaleve bankare, shitësi dhe blerësi fraksionojnë ose ndajnë në disa fatura një furnizim apo transaksion, i cili në kushte normale të personave jo të lidhur do të realizohej si një i vetëm duke kaluar nëpërmjet llogarive bankare.

Kur konstatohet se ndarja në shumë fatura e një transaksioni është bërë me qëllim shmangien e pagesave nëpërmjet llogarive likuiduese dhe për të përcaktuar rastet e fraksionimit apo ndarjes së një fature e cila normalisht duhet të konsiderohet si një e vetme, organet tatimore marrin në konsideratë faktorë të tillë si:

- Natyrën dhe funksionet e komponentëve dhe pjesëve përbërëse të furnizimit, të cilat janë fraksionuar në disa fatura,

- Kapacitetin e mjetit me të cilin janë transportuar furnizimet e fraksionuara (p.sh. me një mjet 25 tonësh shitësi ka bërë disa furnizime, secila me peshë 2-3 ton, duke lëshuar jo një por disa fatura me vlerë nën 1 milion lekë)

- Për rastet e pikës 3.1.8.3, punonjësit e kontrollit do të analizojnë me kujdes formën e transaksionit dhe mundësinë që ai të jetë fraksionuar me qëllim shmangien e pagesave nëpërmjet llogarive likuiduese. Për aplikimin e penaliteteve në këto raste, punonjësit e kontrollit do të marrin konfirmimin e përgjegjësit të sektorit të kontrollit (nëse ka) dhe të Kryetarit të Degës së Tatimeve.

3.1.9 Shkeljet dhe dënimet për mosafishimin e çmimeve të shitjes

Mosafishimi i çmimit të shitjes se mallrave apo shërbimeve përbën shkelje dhe dënohet me gjobë 50 mijë lekë për tatimpaguesit e regjistruar për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar dhe 10 mijë lekë për tatimpaguesit e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimpaguesit e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin.

3.1.10 Shkeljet dhe dënimet për klientët

Kushdo që blen mallra e shërbime, është i detyruar të kërkojë dhe të pajiset me dokumentin e blerjes, që mund të jetë faturë TVSH-je, faturë e thjeshtë ose kupon tatimor (i lëshuar me arkë regjistruese).

Mospasja e një prej dokumenteve të mësipërme nga ana e blerësve individë, dënohet me gjobë me vlerë 500 lekë.

Mospasja e një prej dokumenteve të mësipërme nga ana e blerësve tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, dënohet me gjobë me vlerë 20 mijë lekë.

Mospasja e një prej dokumenteve të mësipërme nga ana e blerësve tatimpagues të regjistruar në TVSH, dënohet me gjobë me vlerë 30 mijë lekë.

4. APELIMET TATIMORE

4.1 PROCEDURAT E APELIMIT TATIMOR

4.1.1 Të drejtën e apelimit e ka çdo tatimpagues në lidhje:

- Me çdo vlerësim tatimor, me anë të të cilit janë përcaktuar detyrimi tatimor, interesat dhe gjobat;

- Me çdo vendim të organit tatimor që ka të bëjë me pretendimin e tatimpaguesit për rimbursim apo përjashtim tatimor;

- Me çdo akt zyrtar të Degës së Tatimeve, që ka të bëjë me mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor dhe me bazën ligjore të përcaktimit të këtij detyrimi si dhe ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të Degës së Tatimeve;

- Me çdo vendim ekzekutiv të posaçëm, që ka të bëjë me të.

Apelimi bëhet me shkrim dhe në krye të shkresës jepet shënimi “Kërkesë për apelim”. Në kërkesën për apelim përcaktohen qartë :

- Të dhënat identifikuese të tatimpaguesit si emri, NIPT, dega e tatimeve ku është regjistruar, adresa (e tij ose e përfaqësuesit), numri i telefonit, etj.

- Objekti i apelimit, lloji i detyrimit/detyrimeve që apelohen dhe shuma e detyrimit/detyrimeve që apelohen.

- Arsyet, argumentet dhe baza ligjore mbi të cilën apeluesi mbështetet për të kundërshtuar vendimin e organeve tatimore.

Kërkesa për apelim shoqërohet gjithmonë me kopjen e vlerësimit tatimor apo të çdo akti zyrtar të organit tatimor që tatimpaguesi kundështon, dokumentin me anë të të cilit vërtetohet se është parapaguar shuma e detyrimit të vendosur, pa gjobat dhe interesat përkatëse, kur rasti është i tillë si dhe çdo dokument tjetër që tatimpaguesi gjykon se është i nevojshëm për shqyrtimin e apelimit tatimor, si kopjen e aktit të kontrollit, kopjen e bilancit të veprimtarisë, etj.

Për çdo apelim tatimor, tatimpaguesi duhet të paraqesë bashkëlidhur një kopje të përcaktimit të vlerësimit tatimor, aktin zyrtar ose vendimin e posaçëm ekzekutiv që ka të bëjë me tatimpaguesin.

Për apelimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve tatimpaguesit duhet të paraqesin njëkohësisht në degën përkatëse të tatimeve një kopje të kërkesës për apelim (pa dokumentet shoqëruese).

Apelimi paraqitet në shkallën më të ulët të sistemit të apelimit administrativ, brenda 30 ditëve nga data e marrjes se vlerësimit tatimor ose njoftimeve të tjera zyrtare, që lidhen me apelimin.

Data e marrjes së njoftimit të vlerësimit tatimor apo njoftimeve të tjera zyrtare, konsiderohet dita e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë të tij. Gjithashtu, administrata tatimore, mund të dorëzojë njoftimin e vlerësimit tatimor apo njoftimet e tjera zyrtare, dorazi. Në këtë rast, data e marrjes së njoftimit konsiderohet dita kur njoftimi i dorëzohet tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rastin e dorëzimit të njoftimeve dorazi, kur tatimpaguesi refuzon marrjen në dorëzim të tyre, date e marrjes së njoftim vlerësimit tatimor apo i njoftimeve të tjera zyrtare, konsiderohet data kur tatimpaguesi ka refuzuar marrjen në dorëzim të tyre.

Organet tatimore përkatëse e shqyrtojnë kërkesën për apelim të tatimpaguesit dhe i kthejnë përgjigje atij brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Date e paraqitjes se kërkesës konsiderohet data në të cilën kërkesa për apelim është protokolluar në protokollin e organit ku bëhet apelimi. Në rast se dita e fundit e afatit 30 ditor bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e parë të punës që vjen pas asaj të pushimit.

Para se të paraqitet për apelim, tatimpaguesi është i detyruar të paguajë detyrimin tatimor që apelohet (pa përfshirë interesat dhe gjobat e mundshme) ose të paraqesë garanci për shumën e detyrimit tatimor. Në rastin e garancisë, për periudhën e apelimit llogariten të gjitha interesat. Garancia jepet me para në dorë, depozita në llogari apo tituj të shkëmbyeshëm, bono dhe garanci bankare. Garancia mund të vendoset për një kohëzgjatje deri në përfundim të procedurës së apelimit tatimor, por mund të vendoset edhe për afate kohe të përcaktuara dhe të rinovohet sa herë është e nevojshme për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së apelimit tatimor, me kusht që të jetë e vlefshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së apelimit dhe të mos ketë ndërprerje. Shuma e garancisë kalon në favor të organeve tatimore vetëm pasi ka përfunduar procesi i apelimit dhe vendimi i shkallës së fundit i shkallës së fundit të apelimit është i formës së prerë në favor të administratës tatimore.

4.1.2 Hierarkia e organeve të apelimit tatimor në rrugë administrative, nga shkalla më e ulët, tek shkalla më e lartë, për çdo lloj tatimi e takse është si më poshtë:

Për taksat dhe tarifat vendore :

a. Kryetari i Komunës ose Bashkisë;

b. Gjykatat.

Për detyrimet kombëtare :

a. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

b. Komisioni i Apelimit të Tatimeve për të gjitha llojet e detyrimeve të administruara nga DPT;

c. Gjykatat

Një apelim nuk mund të shqyrtohet në një shkallë më të lartë të hierarkisë së apelimit, nëse nuk është shqyrtuar më parë në shkallën më të ulët, me përjashtim të rastit kur organi më i ulët i apelimit nuk ka kthyer përgjigjen në afat apo nuk ka kthyer fare përgjigje ndaj apelimit. Në rastin e moskthimit të përgjigjes në afat punonjësit përgjegjës të administratës tatimore përgjigjen siç përcaktohet në nenin 26 të ligjit.

4.1.3 Vetëm pas përfundimit të apelimit tatimor në rrugë administrative, tatimpaguesve iu lind e drejta të vazhdojnë apelimin në sistemin gjyqësor për çdo lloj tatimi dhe takse nacionale e vendore.

4.2 PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË APELIMEVE TATIMORE

Çdo organ shqyrtues i apelimit tatimor, përfshirë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si shkallë e parë e apelimit tatimor, gjatë shqyrtimit të apelimit tatimor, ka të drejtën të heqë tërësisht apo pjesërisht dënimet, pavarësisht nëse detyrimi për tatimin mbetet në fuqi ose jo.

Organi i apelimit e shqyrton çështjen në themel, gjithashtu ai, nuk kufizohet vetëm në çështjet e ngritura në apelim, por ka të drejtë të njihet me të gjitha problemet tatimore. Tatimpaguesi mund të paraqitet vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit për të shpjeguar çështjet e apelimeve tatimore. Apelimi tatimor nuk mund të tërhiqet nëse zbulohen fakte që vërtetojnë se shuma e detyrimeve të

caktuara nuk është e mjaftueshme. Në çdo rast tjetër, tatimpaguesi ka të drejtë në çdo kohë të tërheqë apelimin tatimor.

Drejtoria e Përgjithshme shqyrton kërkesën për apelim të një tatimpaguesi, si dhe merr vendime mbi bazën e kontrolleve dhe përcaktimeve të mëparshme tatimore, në bazë të informacionit të caktuar dhe mbështetur në të gjitha argumentet e tatimpaguesit. Vendimi i marrë përcakton shumën e detyrimit tatimor, sipas mënyrës që organi përkatës tatimor e quan të arsyeshme. Vendimi, duhet të shoqërohet me argumentim dhe t'i dërgohet tatimpaguesit jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së apelimit.

Për shqyrtimin e apelimeve, krijohet Drejtoria e Apelimeve Tatimore, e cila është pjesë përbërëse e strukturës organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Drejtoria e Apelimeve Tatimore është e pavarur në vendimmarrje dhe ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të shqyrtuar apelimet që kanë të bëjnë me vlerësimet tatimore, të paraqitura nga tatimpaguesit, përfshirë të drejtën për të kryer hetime, kontrolle, dhe rillogaritje të detyrimeve tatimore. Në bazë të shqyrtimit të apelimeve, ajo merr vendimin përkatës i cili duhet të jetë i argumentuar dhe duhet të merret jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është paraqitur kërkesa për apelim nga tatimpaguesi.

Jo më vonë se data 10 e çdo muaji, për muajin paraardhës dhe në mënyrë progresive, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve paraqet në Ministrinë e Financave evidencën e apelimeve, e cila duhet të përmbajë numrin e apelimeve të grupuara sipas degëve të tatimeve, numrin e rasteve të shqyrtuara, dhe rezultatet pas shqyrtimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Mosdërgimi brenda afatit, nga shkalla përkatëse e apelimit tatimor, i njoftimit për rezultatet e apelimit, vlerësohet si refuzim i apelimit të tatimpaguesit dhe i jep të drejtën tatimpaguesit për t'u ankuar në shkallën tjetër më të lartë pa paraqitur rezultatin e shqyrtimit të shkallës më të ulët. Komisioni i Apelimit vendos mbi bazën e të gjithë të dhënave që ka, pa u kufizuar në propozimet e palëve apo në detyrimin tatimor të përcaktuar më parë. Kur Komisioni i Apelimit Tatimor shqyrton një apelim dhe Dega është e mendimit se detyrimi tatimor i përcaktuar duhet të ndryshohet, të dyja palët thirren për t'u paraqitur përpara Komisionit.

Vendimet e Komisionit të Apelimit të Tatimeve merren me shumicë të thjeshtë votash. vendimi i dërgohet tatimpaguesit, jo më vonë se 30 ditë nga data në të cilën është paraqitur kërkesa për apelim. Tatimpaguesi, pasi ka ndjekur të gjitha shkallët e ankimit administrativ të parashikuar në këtë ligj, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

5. DETYRIME TË ADMINISTRATËS TATIMORE NDAJ TATIMPAGUESVE

5.1 SHPËRNDARJA PA KUSHTE E FORMULARËVE DHE DEKLARATAVE

Degët e Tatimeve duhet t'u shpërndajnë tatimpaguesve pa asnjë kusht Formularët e Deklarimit dhe Pagesave përpara kufijve kohorë të paraqitjes së tyre nga tatimpaguesit. Fakti i mosmarrjes së Formularit/rëve të Deklarimit dhe Pagesave prej tatimpaguesit apo përfaqësuesit të tij nuk do të thotë se ai përjashtohet nga detyrimi i paraqitjes së Formularit/rëve të Deklarimit dhe Pagesave të plotësuar. Çdo tatimpagues që nuk i ka marrë Formularin/ët e Deklarimit dhe Pagesave duhet t'i kërkojë ato në Degën e Tatimeve përkatëse.

5.2 KONFIRMIMI I STATUSIT TË TATIMPAGUESIT

Degët e Tatimeve, sipas kërkesës të tatimpaguesit sipas formatit tip, forma e të cilit përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, janë të detyruara të lëshojnë vërtetim për statusin tatimor të tatimpaguesit brenda 3 ditë pune nga data e kërkesës. Gjithë kërkesat ruhen në dosjen e tatimpaguesit bashkë me një kopje të vërtetimit të lëshuar.

6. KONTROLLI TATIMOR

6.1 E DREJTA PËR VERIFIKIM

Punonjësit e organeve tatimore kanë të drejtë të verifikojnë vërtetësinë e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve tatimore të tatimpaguesve. Inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve kanë të drejtë të kontrollojnë tatimpaguesit në të gjithë vendin, sipas autorizimit përkatës. Për këtë, ato kontrollojnë kontabilitetin e tatimpaguesve, duke përfshirë edhe dokumentacionin mbi të ardhurat, fitimin, kapitalin dhe marrëdhëniet financiare me të tretët. Organet tatimore mund të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta. Organet tatimore kanë gjithashtu të drejtë të kontrollojnë saktësinë e të gjithë dokumenteve që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike, saktësinë e mbajtjes së regjistrimeve, tatimet dhe kamatat përkatëse, pagesën e detyrimit tatimor, dënimet administrative dhe interesat,

deklaratat periodike si edhe dokumente të tjera që kanë të bëjnë me përcaktimin e detyrimit tatimor. Për të kontrolluar vërtetësinë e deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin, organet tatimore për efekte tatimore mund të ndryshojnë rezultatin financiar të tatimpaguesve, edhe nëse ky rezultat është i certifikuar më parë nga ekspertë kontabël. Pra, ato kanë të drejtë të nxjerrin një rezultat financiar fiskal të ndryshëm nga rezultati financiar tregtar të nxjerrë nga tatimpaguesit.

Gjatë ushtrimit të një kontrolli, organet tatimore kanë të drejtë të marrin kopje të çdo llogarie, regjistrimi apo dokumenti tjetër të tatimpaguesit. Ato kanë të drejtë gjithashtu të kontrollojnë operacionet e çdo kompjuteri, të arkave regjistruese apo të çdo pajisjeje tjetër dhe të marrin kopje të çdo llogarie, regjistrimi apo informacioni tjetër në këto pajisje.

Kur gjate një kontrolli nuk gjendet dokumentacioni i duhur për përcaktimin e detyrimit tatimor, ose kur ky dokumentacion është me të meta të tilla serioze të cilat nuk lejojnë paraqitjen e situatës reale të tatimpaguesve dhe llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore, organet tatimore përdorin metodat alternative të përcaktimit të detyrimeve tatimore. Në të gjitha këto raste, organet tatimore, kanë të drejtë të rikarakterizojnë transaksionet e tatimpaguesit, duke improvizuar një situatë sa më reale të tij në mënyrë që të përcaktojnë detyrimet tatimore nëpërmjet vlerësimit tatimor i cili i jepet tatimpaguesit në përfundim të kontrollit. Për të bërë një gjë të tillë, organet tatimore gjykojnë mbi bazën e të dhënave që mund të disponojë për këtë tatimpagues siç janë për shembull të dhënat e periudhave të mëparshme tatimore, të dhënat për importet, të dhënat për transaksionet e kryera me fonde buxhetore (të marra në degët e thesarit) apo me fonde të donatorëve të ndryshëm, të dhënat e siguruara nga klientët apo furnitorët e tatimpaguesit, të dhënat për numrin e punonjësve, të dhënat për çmimet e mallrave apo shërbimeve të kryera nga tatimpagues të tjerë të ngjashëm, të dhënat për kapacitet dhe aktivet që zotëron tatimpaguesi, etj. Vlerësimi tatimor i kryer si më sipër i dërgohet tatimpaguesit zyrtarisht dhe ky shërben njëkohësisht si njoftim detyrimi dhe kërkesë për të paguar këtë detyrim.

Pas çdo kontrolli, punonjësit e organeve tatimore duhet të paraqesin një raport me shkrim ku të përshkruhen në detaje rezultatet e kontrollit të ushtruar nga ana e tyre. Tatimpaguesi ka të drejtë të mbajë një kopje të këtij raporti, dhe te paraqesë observacionet e veta me shkrim. Në bazë të rezultateve të kontrollit, organet tatimore përgatisin njoftimin e vlerësimit tatimor. Afati brenda të cilit njoftimi i vlerësimit tatimor përgatitet dhe i njoftohet tatimpaguesit është 15 ditë nga përfundimi i kontrollit.

Kontrollet e ushtruara nga organet tatimore nuk mund të zgjasin më shumë se 30 ditë kalendarike. Në raste të veçanta, mbi bazën e kërkesës së degës së tatimeve, ku argumentohet dhe jepen arsyet e shtyrjes së afatit, Drejtori i Përgjithshëm mund të zgjasë kohëzgjatjen e kontrollit.

Kur në përfundim të një kontrolli arrihet në konkluzionin se tatimpaguesi ka fshehur me qëllim të ardhurat e tij me synimin për të mos paguar të gjitha detyrimet e tij tatimore, organet tatimore janë të detyruara të zbatojnë fillimisht të gjitha procedurat e vjeljes së detyrimeve dhe të marrin të gjitha masat ligjore administrative. Pas marrjes së këtyre masave, në zbatim të nenit 180 të Kodit Penal, për tatimpaguesin në fjalë, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përkatës, fillon procedurën e denoncimit penal siç përcaktohet në pikën 3.1.7 të këtij udhëzimi, në organet e prokurorisë.

Për të ushtruar kontrolle punonjësit organeve tatimore paraqesin autorizimin përkatës dhe kartën e identitetit të tyre. Asnjë kontroll nuk mund të ushtrohet pa u autorizuar nga kryetari i degës së tatimeve ose Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Autorizimi për kontroll duhet të përcaktojë tatimpaguesin që do të kontrollohet, objektin e kontrollit, personat e autorizuar për kontroll dhe periudha që do të kontrollohet. Tatimpaguesi ka të drejtë të mos pranojë fillimin e një kontrolli kur nuk paraqitet autorizimi përkatës apo kur ky autorizim nuk përmban elementet e mësipërm.

6.2 E DREJTA PËR ASISTENCË

Gjatë ushtrimit të kontrollit te tatimpaguesi, kur për shkak të vështirësive që paraqet ky kontroll (të cilat vijnë nga procesi teknologjik që zbaton tatimpaguesi, nga lloji specifik i veprimtarisë, etj.) është i nevojshëm mendimi i specialistit të fushës përkatëse, punonjësit e organeve tatimore kanë të drejtë të kërkojnë asistencën e eksperteve të këtyre fushave. Megjithatë, informacioni konfidencial që ka të bëjë me sekretin tregtar dhe rezultatin financiar, nuk i jepet ekspertit.

6.3 SHPËRBLIMI PËR ORGANET TATIMORE DHE PËR INFORMATORËT

Bazuar në nenin 64/1 të ligjit, pesëmbëdhjetë për qind e të ardhurave tatimore të arkëtuara dhe të pa apeluara nga tatimpaguesit, që rrjedhin nga zbulimet e kryera nga organet tatimore, përdoren nga

këto të fundit për investime të ndryshme, për shpërblimin e punonjësve, etj. Kurse 5 për qind e këtyre të ardhurave të arkëtuara dhe të pa apeluara, përdoren për shpërblimin e informatorëve të mundshëm që kanë dhënë informacionet nëpërmjet të cilave është arritur të kryhet zbulimi i të ardhurave.

7. DHËNIA E INFORMACIONIT

7.1 DHËNIA AUTOMATIKE E INFORMACIONIT

7.1.1 Për të siguruar llogaritjen e saktë të detyrimeve tatimore, organet tatimore përdorin çdo burim të mundshëm informacioni të vlefshëm për këtë qëllim. Personat fizikë dhe juridikë si edhe organizmat e ndryshme qeveritare janë të detyruar t'i japin organeve tatimore informacione të ndryshme për përcaktimin sa më të saktë të situatës ekonomiko-financiare të tatimpaguesit, të detyrimit të tij tatimor etj. Ato janë të detyruar t'i japin këto informacione në mënyrë elektronike, kur sistemi i mbajtjes së regjistrimeve nga ana e tyre është i informatizuar. Ato janë gjithashtu të detyruar të lejojnë organet tatimore të shqyrtojnë të gjitha dokumentet tatimore dhe çdo dokument tjetër që shërben për llogaritjen e saktë të detyrimeve tatimore.

7.1.2 Detyrohen të japin informacionet e duhura, në mënyrë automatike, pa kërkesën e organeve tatimore, të gjitha subjektet e mëposhtme:

a. Sistemi Gjyqësor, për të gjitha rastet kur tatimpaguesit pushojnë aktivitetin, shpërndahen, ose pësojnë ndryshime thelbësore brenda kuptimit të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare". Gjykatat njoftojnë organet tatimore për të gjitha vendimet që marrin lidhur me mbylljen e veprimtarisë, me shpërndarjen e shoqërive, si dhe me ndryshimet thelbësore që pësojnë shoqëritë (ndryshime të cilat në bazë të ligjit ''Për shoqëritë tregtare'', njihen me vendim gjykatë), brenda 5 ditëve nga dita e marrjes se vendimeve. Kur bëhet fjalë për detyrime tatimore të papaguara nga shoqëritë të cilat kërkojnë të çregjistrohen, gjykatat nuk mund të nxjerrin një vendim përfundimtar derisa organet tatimore të vërtetojnë se janë paguar të gjitha detyrimet tatimore. Gjykata dërgon në organet tatimore një kopje të vendimeve gjyqësore së bashku me kërkesën e tatimpaguesit.

b. Organet Doganore janë të detyruara të shënojnë në fletën e zhdoganimit të importeve dhe në fletën e doganimit të eksporteve numrin e identifikimit të tatimpaguesit sipas Certifikatës së TVSH-së, kodin fiskal të tij, vitin dhe vendin ku është regjistruar tatimpaguesi. Ato janë të detyruara të mos bëjnë veprime zhdoganimi e doganimi të mallrave kur tatimpaguesit nuk paraqesin certifikatën e regjistrimit si tatimpagues dhe certifikatën e TVSH. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, i dërgon zyrtarisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas përcaktimit të bërë në një Akt - Marrëveshje të lidhur midis dy Drejtorive të Përgjithshme, të dhëna analitike të tatimpaguesve që kanë kryer importe dhe eksporte gjatë muajit. Ky informacion duhet të përmbajë domosdoshmërisht të dhënat identifikuese të tatimpaguesit si emrin tregtar të tij, NIPT-in, vlerën doganore dhe detyrimet tatimore të paguara në Doganë. Të dhënat e dërguara janë të ndara për secilin tatimpagues dhe për çdo rreth.

c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive janë të detyruara të dërgojnë në organin tatimor të rrethit përkatës, brenda datës 10 të muajit pasardhës një listë të akteve të regjistrimit të pasurisë e cila përmban llojin e pasurisë që tjetërsohet, emrin e shitësit, tatimin e paguar (të mbajtur në burim) dhe vleftën përkatëse të pasurisë së shitur apo të tjetërsuar. Kjo listë përmbledh si rastet e kalimit të pronësisë nëpërmjet shitjes, ashtu edhe rastet e dhurimit e të trashëgimisë.

7.2 DHËNIA E INFORMACIONIT ME KËRKESËN E ORGANEVE TATIMORE

Gjatë një kontrolli të ushtruar te një tatimpagues, për të përcaktuar në mënyrë reale detyrimet e tij tatimore, organet tatimore mund të kenë nevojë që të disponojnë informacione të tjera shtesë për ketë tatimpagues. Në këtë rast, organet tatimore, kanë të drejtë të kërkojnë nga çdo person i tretë që ka marrëdhënie biznesi direkte apo indirekte me tatimpaguesin, që përkundrejt kërkesës me shkrim të organeve tatimore, të japin çdo informacion që u kërkohet. Të gjithë personat e tretë (përfshirë këtu edhe bankat), të përcaktuar në nenin 67 të ligjit, janë të detyruar të kthejnë përgjigje dhe të japin informacionin e kërkuar nga organet tatimore brenda 30 ditësh nga data e kërkesës me shkrim të organit tatimor. Date e kërkesës së organeve tatimore konsiderohet data në të cilën kërkesa është dorëzuar nga ana e tyre në poste apo tek personi i tretë të cilit i kërkohet informacioni (në rastin kur kërkesa dërgohet dorazi). Kur sistemi i mbajtjes së regjistrimeve është i informatizuar, të gjithë personat janë të detyruar të japin informacionet e kërkuara nga organi tatimor në mënyrë elektronike.

7.3 BUXHETI I ADMINISTRATËS TATIMORE

7.3.1 Buxheti i Shtetit siguron fondet e nevojshme për funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të saj në rrethe, nëpërmjet akordimit çdo vit në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme, të shpenzimeve sipas zërave përkatës. Shpenzimet për fondin e pagave, për

sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative përballohen në masën 100 për qind nga Buxheti i Shtetit. Nevojat për investime përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga fondet që i lihen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas nenit 19 të ligjit.

7.3.2 Në zbatim të nenit 19 të ligjit, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet 1 për qind e të ardhurave tatimore të arkëtuara. Shuma që i lihet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

a. Jo më pak se 60 për qind e të gjithë shumës për investime të ndryshme dhe për trajnimin e punonjësve të administratës tatimore qendrore dhe të degëve të tatimeve.

b. Deri në 40 për qind e të gjithë shumës për shpërblimin e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të tatimeve.

Fondi që i lihet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, krijohet në fund të çdo tremujori, mbi bazën e realizimit të të ardhurave tatimore të tremujorit. Për tremujorin e fundit të vitit, ky fond krijohet brenda muajit dhjetor në bazë të të dhënave të 11 mujorit dhe realizimit të pritshëm të muajit dhjetor. Mbas daljes së rezultateve të tremujorit përkatës dhe rakordimit të tyre me degët e thesarit e të buxhetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve llogarit shumën që i takon të përdorë për nevojat e saj, dhe i kërkon Drejtorisë së Thesarit e të Buxhetit në Ministrinë e Financave të urdhërojnë xhirimin e shumave në llogarinë përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Sistemi i stimulimit nëpërmjet shpërblimeve të punonjësve të administratës tatimore mbështetet në udhëzimin e veçantë të Ministrit të Financave.

Në zbatim të nenit 19 të ligjit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve funksionon Këshilli i Tatimeve, që përbëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve i cili është edhe Kryetar i këtij Këshilli, nga zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtori mbikëqyrës operacionale të degëve, drejtori i burimeve njerëzore dhe administratës,drejtori i financës dhe statistikës dhe drejtori i drejtorisë teknike.

Ky Këshill duhet të mblidhet sa herë administrata tatimore ka nevojë për përcaktimin e prioriteteve për investime për përmirësimin dhe modernizimin e mjediseve, për përmirësimin e kushteve të punës dhe për trajnimin e punonjësve të administratës tatimore. Mënyra e shpërndarjes sipas zërave të shpenzimeve të fondeve që i lihen Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përcaktohet nga Këshilli i Tatimeve. Ndërsa ndarja sipas degëve të tatimeve dhe mënyra e administrimit të këtyre fondeve bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Në zbatim të nenit 20 “Burimet njerëzore të administratës tatimore”, punonjësit e Administratës Tatimore, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, dhe trajtohen në përputhje me rregullat dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për Statusin e Nëpunësit Civil” dhe të gjitha dispozitave nënligjore të dala në zbatim të këtij ligji. Përjashtim këtu bëjnë vetëm punonjësit e Policisë Tatimore dhe personeli ndihmës, marrëdhëniet juridike të punës të të cilëve rregullohen me kontratë individuale sipas dispozitave të Kodit të Punës.

8. ZBATIMI I UDHËZIMIT

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe.

9. SHFUQIZIME

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, udhëzimi i Ministrit të Financave nr.1, datë 18.01.2005 “Për procedurat tatimore”, shfuqizohet.

10. HYRJA NË FUQI

Ky Udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

PROCESVERBAL GJOBE

NR= 000001

I mbajtur sot më datë __/ __/____, nga grupi i kontrollit të Policisë Tatimore të rrethit _____ ndaj tatimpaguesit _____ me adresë _____, me kod fiskal _____, dhe me Nipt._____ përfaqësuar nga _____ me letërnjoftim nr._____, me aktivitet, _____
me adresë _____ të rrethit _____, ku u konstatuan shkeljet e mëposhtëme :
_____
_____
_____
_____
_____
_____
_____

Në mbështetje të ligjit nr.____, datë __ / __ / _____, neni nr. _____, germa __, pika __, subjekti _____, për shkeljet e konstatuara më sipër, dënohet me gjobën në masën _____ lekë. Subjekti ka të drejtë të ankohet brenda ____ ditëve nga dita e marrjes së vendimit, ose e njoftimit, tek Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në përputhje me procedurat e ankimit të përcaktuar në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 "Proçedurat Tatimore", i ndryshuar. Në qoftë se subjekti nuk bie dakord me përgjigjen brenda ____ ditëve, subjekti ka të drejtë t'i drejtohet Komisionit

të Apelimit të Tatimeve. Vetëm pas kalimit të kësaj procedure, subjektit i lind e drejta t'i drejtohet Gjykatës.

Gjoba të derdhet në Degën e Bankës _____, në numrin e llogarisë _____ brenda datës __ / __ / _____ /.

Për subjektin	Për Policinë Tatimore
(_____)	**1. _____**
2. _____	
3. _____	

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Kerkese per Regjistrim

NIPT-i

(1) Emri Tregtar

(2) Administratori

(3) Adresa administratorit
Rruga dhe numri
Qyteti ose fshati
Rrethi

Zgjidh kutine e duhur

(4) Pronesia — Shqiptare ☐ E huaj ☐ E perbashket ☐

(5) Forma ligjore — Person fizik ☐ Kolektive ☐ Komandite ☐ Trup diplomatik ☐

sh.p.k. ☐ Ortakeri ☐ Anonime ☐ Ent publik ☐ OJF ☐

(6) Adresa kryesore
Rruga dhe numri
Qyteti ose fshati
Rrethi

Telefoni — E mail

(7) Aktiviteti

(8) Kodi ekonomik — *Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve* — (9) Data e krijimit

(10) Jam i regjistruar per :

- ☐ Vetem NIPT
- ☐ Tatim fitimi (*Ploteso fushen 12*)
- ☐ TVSH
- ☐ Aksiza
- ☐ Sigurimet Shoqerore
- ☐ Sigurimet Shendetesore
- ☐ Tatimi mbi te Ardhurat Personale
- ☐ Tatim fitimi i thjeshtuar
- ☐ Taksa vendore per biznesin e vogel (*Ploteso Shtojcen B*)

(11) Xhiro parashikuar — (12) Tatim fitimi parashikuar

(13)
Kategoria per efekt sigurimesh

- ☐ Punedhenes
- ☐ I vetepunesuar (I vetem)
- ☐ I vetepunesuar me punemarres
- ☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes
- ☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes

(14)
Adresat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi

(15)
Shoqeria nga varet

Nipt-i | | | | | | | | | | | Rrethi | |

(16) Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur
Shtojca A ☐ dhe/ose Shtojca B ☐ eshte i sakte

(17) Emri, nenshkrimi dhe data

Per perdorim zyrtar

(18) Perjashtime dhe lehtesi tatimore

Kodi	Tatimi	Kodi I lehtesise	Pershkrimi I lehtesise	Data fillimit	Data mbarimit

(19) Tatime te tjera per te cilat biznesi eshte pergjegjes

Kodi	Tatimi	Tipi I pergjegjesise (0=tatimpagues,1=agjent tatimor,2=perfaqesues fiskal)

Verifikuar nga ..Emri Nenshkrimi Kodi Data

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Adresa te tjera shtese (Shtojca A)

NIPT-i | | | | | | | | | | |

(14) Adresat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi	Nr. certifikates

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Te perdoret vetem per taksen vendore per biznesin e vogel

Detaje te aktivitetit per cdo adrese (Shtojca B)

NIPT-i

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

Çdo subjekti i kërkohet të regjistrohet në Degen e Tatimeve dhe të pajiset me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT). Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet përpara se veprimtaria ekonomike të fillojë. Cilido person që është i detyruar të regjistrohet dhe nuk regjistrohet ka kryer një shkelje dhe për këtë do të paguajë denimin perkates.

Plotesimi i formularit
Fusha e pare e formularit eshte fusha e NIPT-it. Kjo fushe plotesohet nga organet tatimore.

(1) **Emri tregtar :** jepni emrin e plote Duhet të jepni emrin e plotë të shoqërisë tregtare siç tregohet në dokumentin e regjistrimit në Gjykatë - ky mund të jetë emri juaj ose i shoqërisë tregtare.
(2) **Administratori :** jepni emrin e pronarit të shoqërisë. Nëse jeni një person fizik, ky do të jetë emri juaj. Në të kundërt, jepni emrin e ortakut kryesor ose drejtorit, ose emrin e personit të autorizuar për të vepruar në emër të shoqërisë.
(3) **Adresa e administratorit** : jepni adresen e plote personale te administratorit emri i te cilit eshte paraqitur me lart.
(4) **Pronesia** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(5) **Forma ligjore** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(6) **Adresa kryesore** : jepni adresen ne te cilen ushtroni veprimtarine ekonomike. Nese keni me shume se nje vendodhje te veprimtarise ekonomike duhet te caktoni njeren prej tyre si adrese kryesore. Nese jeni ambulant, zejtar apo nje subjekt qe merret me transport, pra pa vend fizik te biznesit, jepni adresen tuaj private. Jepni numrin e telefonit, dhe adresen e postes elektronike nese keni, ne menyre qe te mund t'ju njoftojme per ndryshimet e mundshme qe mund te ndikojne mbi ju.
(7) **Aktiviteti** : kepni pershkrimin me fjale te aktivitetit tuaj ekonomik.
(8) **Kodi ekonomik** : kjo fushe plotesohet nga zyra e tatimeve mbi bazen e "Nomenklatures se veprimtarive ekonomike"
(9) **Data e krijimit** : jepni daten e regjistrimit ne Gjykate.
(10) **Jam i regjistruar per** : zgjidhni te gjitha kutite per tatimet qe jeni te detyruar te paguani. Ne rast se nuk paguani asnje tatim, por regjistroheni vetem per te marre nje numer identifikimi zgjdhni kutine—-Vetem NIPT– . Ne rast veshtiresie kerkoni ndihmen e inspektoreve te regjistrimit ne zyren e tatimeve. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel duhet te plotesoni shtojcen B te formularit te Kerkeses per Regjistrim.
(11) **Xhiro parashikuar** : jepni xhiron qe parashikoni te realizoni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik.
(12) **Tatim fitimi parashikuar** : jepni tatim fitimin qe parashikoni te realioni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik. Kete fushe duhet ta plotesoni vetem nese kerkoni te regjistroheni per tatim fitimi.
(13) **Kategoria per efekt sigurimesh** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(14) **Adresat e tjera** : nese subjekti juaj operon ne me shume se nje adrese, duhet qe ne kete tabele te jepni te dhenat e seciles adrese, me perjashtim te adreses kryesore. Nese nuk keni vend te mjaftueshem ne formular duhet te plotesoni shtojcen A. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel, duhet te plotesoni shtojcen B per secilen adrese,perfshi dhe adresen kryesore.Per secilen nga adresat ju do te pajiseni me certifikaten e regjistrimit.
(15) **Shoqeria nga varet** : nese shoqeria juaj varet nga nje shoqeri tjeter, jepni NIPT-in dhe rrethin ku eshte regjistruar kjo shoqeri.
(16) **Deklarim** : zgjidhni kutite perkatese nese keni plotesuar shtojcen A dhe/ose shtojcen B te ketij formulari.
(17) **Nenshkrimi dhe data** : Deklarimi duhet te behet nga pronari ose personi i autorizuar te veproje ne emer te subjektit.Ligji parashikon denime ne rastet e deklarimit te pasakte apo dezinformues.
(18) **Perjashtime dhe lehtesi tatimore** : kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(19) **Tatime te tjera per te cilat biznesi eshte** pergjegjes : Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(20) **Detaje te aktivitetit per cdo adrese** : kjo fushe ndodhet ne shtojcen B te formularit dhe plotesohet vetem nga subjektet qe regjistrohen per taksen vendore per biznesin e vogel. Jeprni cdo adrese ku zhvilloni veprimtarine tuaj, perfshi dhe adresen kryesore, dhe per secilen adrese jepni aktivitetin apo aktivitetet ekonomike qe zhvilloni ne te sipas klasifikimit te meposhtem :

- Shites me pakice -Shites me shumice -Prodhues -Sherbime - Profesione te lira -Ambulante dhe zejtare dhe qarkullimin per cdo aktivitet.

Ne rast se ushtroni veprimtari transporti paraqisni tipin e mjetit sipas tabeles

Transport pasagjeresh	Transport mallrash	Transport detar
Deri ne 5 vende,perfshi shoferin	Deri ne 2 ton	Transport detar brenda vendit
6 deri 9 vende,perfshi shoferin	2.1 deri 5 ton	Transport ne liqen brenda vendit
10 deri 25vende,perfshi shoferin	5.1 deri 10 ton	Varka per shetitje
26 deri 42 vende,perfshi shoferin	10.1 deri 16 ton	

Detyrimet ne te ardhmen
Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni degen e tatimeve ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni degen e tatimeve. Personeli yne do t'ju pergjigjet me kenaqesi pyetjeve apo kerkesave tuaja.

FATURE SHOQERIMI (1)

Numri Serial: 000

Data: ____/_____/_____

Nr. i Fletë Daljes [2]_____

EMRI I NISESIT: [3]_____

ADRESA : _____

TELEFONI : _____

NIPT: ☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐

Numri i Çertifikatës së NIPT_____

EMRI I PRITESIT: [4]_____

ADRESA : _____

TELEFONI :_____

NIPT: ☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐

Numri i Çertifikates se NIPT-it_____

QELLIMI I LEVIZJES SE MALLIT: [5]

_____

_____

_____

Levizja e mallit nga: ☐ Magazinë, ☐ Ekspozitë, ☐ Dyqan ☐ Pikë Shitje ☐ Te tjera

Për në : ☐ Magazinë ☐ Ekspozitë ☐ Dyqan ☐ Pikë Shitje ☐ Te tjera

Data e nisjes _____ Ora _____

Transporti me mjetin ☐ E vet ☐ E të treteve [Ploteso ne fund te faqes]

Nr.	PERSHKRIMI I MALLIT	NJESIA	SASIA	VLEFTA

LLOJI I AMBALLAZHIT_____ NR. KOLIVE _____

Kur transporti bëhet me të tretë :

SHOQERIA TRANSPORTUESE :

_____

ADRESA :

_____

TELE-
FONI :_____

NIPT:

_____

Shenim: 1. Fatura e shoqerimit te mallit duhet te pritet minimumi ne dy kopje me leter vetekopjuese, ku kopjen e pare e mban pritesi i mallit dhe kopja e dyte mbetet tek nisesi i mallit.

2. Shenohet numri i flete daljes se mallit nga njesia nisese

3. Ketu shenohet emri i njesise nga niset ngarkesa (psh magazina Nr. 2, Fabrika prodhuese etj)

4. Ketu shënohet emri i njësise i mbëritjes së mallit (psh magazina Nr , dyqani nr , ekspozita, etj)

5. Shenoni qellimin e transportit te mallit (psh per shitje me pakice, per shitje me shumice, per ekspozite, per perpunim te metejshem, etj.)

UDHËZIM
Nr.3, datë 30.1.2006

PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.04.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Regjistrimi

1.1 Detyrimi për të kërkuar regjistrimin

Çdo person fizik apo juridik që zhvillon veprimtari ekonomike, qarkullimi i të cilit tejkalon apo parashikohet të tejkalojë 8 milionë lekë për një vit kalendarik detyrohet të kërkojë të regjistrohet.

Termi "person" përfshin çdo subjekt që kryen një veprimtari ekonomike pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij. Ai përfshin edhe institucionet, organet e pushtetit qëndror e vendor, organizatat shoqërore e politike që kryejnë veprimtari ekonomike të tatueshme.

Janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu edhe çdo subjekt tjetër, si individët, organet e pushtetit qendror e lokal, organizatat shoqërore, politike, ndërkombëtare, misionet diplomatike, etj. që kryejnë aktivitete import-eksporti, pavarësisht nga qarkullimi. Për çdo subjekt që kryen import-eksporte, veprimet doganore bëhen vetëm pasi ai të ketë paraqitur origjinalin ose kopjen e noterizuar të Çertificatës së Numrit të Identifikimit për Personin e Tatueshëm (NIPT).

Mund të bëjnë veprime doganore pa qenë të detyruar të regjistrohen vetëm individët për mallrat e përdorimit personal. Përcaktimi "mallra të përdorimit personal" bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 199 të Kodit Doganor dhe të pikës 2.12 të vendimit të Këshillit të Ministrave «Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor». Nuk janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu individët që kryejnë importe të rastësishme, si mjete transporti për përdorim privat, dhe te tjera të kësaj natyre, pavarësisht se për importet e mësipërme ato janë të detyruar të paguajnë Tatim mbi Vlerën e Shtuar në doganë. Në këtë rast importimi bëhet me një NIPT të përbashkët i cili akordohet nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe i behet i ditur te gjitha pikave doganore nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

1.1.1 Periudha që merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit

Periudha bazë që duhet të merret parasysh për llogaritjen e qarkullimit është viti kalendarik, që do të thotë periudha nga 1 janari deri në 31 dhjetor. Në çdo rast, në qoftë se gjatë vitit kalendarik qarkullimi i pritshëm tejkalon ose parashikohet të tejkalojë 8 milion lekë, personi fizik ose juridik detyrohet të kërkojë të regjistrohet.

1.1.2 Qarkullimi që merret parasysh

Qarkullimi që duhet të merret parasysh është qarkullimi gjithsej i realizuar nga i njëjti person, pavarësisht nga statusi i tij.

a) Qarkullimi gjithsej

Qarkullimi gjithsej përfshin të gjitha furnizimet e bëra nga një person: furnizimet e tatueshme, furnizimet e përjashtuara, furnizimet për eksport. Ai përfshin gjithashtu edhe furnizimet e tjera që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së personit, si ndihmat, subvencionet etj. Qarkullimi llogaritet në bazë të çmimit total që paguan blerësi. Çmimi përfshin edhe tatimet dhe çdo detyrim tjetër. Përjashtim bëjnë vetëm shitjet e aktiveve të qëndrueshme të personit të tatueshëm, si ndërtesat, makinat dhe pajisjet. Këto shitje nuk merren parasysh kur llogaritet qarkullimi gjithsej.

b) I njëjti person

Në qoftë se një person ka disa veprimtari në të njëjtin vend ose në vende te ndryshme, qarkullimi që merret për bazë për kriterin e kufirit të regjistrimit përfshin qarkullimin e të gjitha veprimtarive, në të gjitha vendet ku zhvillohet ajo, cilido qoftë emri i degëve apo forma e tyre juridike. Është personi dhe jo veprimtaria ekonomike që regjistrohet për TVSH dhe çdo regjistrim mbulon të gjitha veprimtaritë ekonomike të personit të regjistruar.

c) Fillimi ose mbyllja e veprimtarisë ekonomike

Nëqoftëse nje person fillon apo mbyll veprimtarinë ekonomike gjatë një viti kalendarik, kufiri i regjistrimit llogaritet në përpjestim me zgjatjen e veprimtarisë. Për shembull, një person e fillon veprimtarinë e tij më 15 tetor.Qarkullimi i tij nga 15 tetori deri në fund të vitit është 1700 000 lekë.

Kufiri minimal i regjistrimit për një tremujor është (8 000 000:365)x76=1 665 753 lekë. Në këtë rast personi është i tatueshëm dhe duhet të kërkojë të regjistrohet.

d) Rritja e qarkullimit mbi kufirin e regjistrimit

Nëqoftëse qarkullimi gjatë një viti kalendarik rritet mbi kufirin e regjistrimit, personi bëhet person i tatueshëm dhe duhet të kërkojë të regjistrohet që nga 1 janari i vitit kalendarik pasardhës.

1.2 E drejta për të kërkuar regjistrimin

Çdo person, qarkullimi i të cilit është më i ulët se kufiri i regjistrimit, mund të kërkojë të regjistrohet në çdo kohe, në qoftë se ka nevojë të bëjë kështu për arsye të veprimtarisë së tij ekonomike. Personi i regjistruar, pavarësisht nga niveli i shitjeve të tij, duhet të zbatojë të gjitha kërkesat e ligjit duke përfshirë paraqitjen e deklaratave tatimore, pagimin e tatimit, mbajtjen e regjistrimeve deri sa ai të çregjistrohet, etj.

1.3 Mënyra e regjistrimit

1.3.1 Periudha e regjistrimit

a) Fillimi i veprimtarisë ekonomike

Një person i cili fillon veprimtarinë ekonomike, detyrohet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të saj, kur qarkullimi i tij pritet të tejkalojë kufirin e regjistrimit. Në rastin e një personi i cili fillon veprimtarinë ekonomike dhe kjo veprimtari ka të bëjë me import-eksportin është i detyruar të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga data e fillimit të veprimtarisë, pavarësisht se qarkullimi i tij mund të mos arrijë kufirin minimal të regjistrimit.

b) Rritja e qarkullimit

Në qoftë se gjatë një viti kalendarik qarkullimi i realizuar e tejkalon kufirin e regjistrimit, personi detyrohet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga dita e përfundimit të vitit kalendarik në të cilin qarkullimi e tejkalon kufirin e regjistrimit. Për vitin e kaluar kalendarik, tatimpaguesi paguan detyrimet tatimore për llojin e tatimit për të cilin ai ka qenë i regjistruar.

1.3.2 Vendi i regjistrimit

Vendi i vetëm ku mund të bëhet regjistrimi është dega perkatese e tatimeve.

1.3.3 Formularët e regjistrimit

Personi i tatueshëm duhet të mbushë formularin e Kërkesës për Regjistrim me TVSH. Formulari i vetëm që përdoret për regjistrim është ai që shpërndahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Ai përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e personit të tatueshëm (emrin, adresën, veprimtarinë ekonomike dhe gjithë informacionin e kërkuar në përputhje me ligjin dhe këtë udhëzim). Forma dhe përmbajtja e këtij formulari është sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

1.4 Certifikata e regjistrimit

Organet tatimore, pas marrjes së kërkesës për regjistrim kur ajo plotëson kushtet e përcaktuara, plotësojnë certifikatën e Regjistrimit te Personit te Tatueshem dhe ia japin atë personit të tatueshëm. Certifikata përmban emrin e personit të tatueshëm, emrin tregtar (nëse ka), Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT) dhe datën kur regjistrimi hyn në fuqi. Forma dhe përmbajtja e certifikatës është sipas formularit bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm është unik. Personi i tatueshëm ka një numër të vetëm, sado që të jetë numri i degëve apo i veprimtarive ekonomike të tij. Një numër i njëjtë identifikimi nuk mund t'i lëshohet disa personave të tatueshëm, edhe në qoftë se numri i identifikimit tatimor nuk përdoret më nga një person i tatueshëm. Të gjitha deklaratat e bëra për organet tatimore (deklaratat tatimore, deklaratat doganore), të gjitha faturat e lëshuara nga personi i regjistruar dhe të gjitha dokumentet e përdorura prej tij për veprimtarinë e tij ekonomike duhet të përmbajnë numrin e identifikimit tatimor.

Certifikatat e Regjistrimit të Personit të Tatueshëm, të shpërndara nga organet tatimore, duhet të ekspozohen në të gjitha adresat ku personi i tatueshëm ushtron veprimtarinë e tij. Këto certifikata merren në momentin e fillimit te veprimtarisë dhe janë të vlefshme përgjithmonë.

1.5 Të drejtat e organeve tatimore për regjistrimin

Organet tatimore kanë të drejtë:

- të regjistrojnë një person të tatueshëm edhe në qoftë se ai nuk ka bërë kërkesë për t'u regjistruar kur ai plotëson kushtet për të qenë person i tatueshëm. Për këtë ato plotësojnë në vend te personit të tatueshëm formularin e regjistrimit duke shënuar në mënyrë të dukshme në të "Regjistruar në zyrë" dhe "Regjistrim i bërë nga _____ (emri dhe mbiemri i inspektorit që bën regjistrimin). më

datë _____”. Brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit në zyrë, organi tatimor i dorëzon personit të tatueshëm Certifikatën e Regjistrimit;

- të refuzojnë të regjistrojnë ose të çregjistrojnë çdo person që nuk ka qenë i detyruar dhe as ka të drejtë të regjistrohet, me efekt nga data në të cilën regjistrimi ka hyrë në fuqi.

Kur organet tatimore marrin vendime të tilla, ato informojnë me shkrim personin e tatueshëm.

2. Çregjistrimi

2.1 Detyrimi për të njoftuar ndryshimet

Personi i tatueshëm është i detyruar t’i njoftojë organeve tatimore ndryshimet e pësuara. Njoftimi i ndryshimeve duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga momenti kur ato ndodhin, duke plotësuar Formularin e Ndryshimeve në Regjistrim, sipas atij të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, forma dhe përmbajtja e të cilit është sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi, duke e dërguar atë në degën përkatëse te tatimeve. Procedura e njoftimit të ndryshimeve është e njëjtë me procedurën e regjistrimit. Ka ndryshime që kërkojnë çregjistrim dhe të tjera që kërkojnë modifikim të regjistrimit.

2.1.1 Ndryshime që kërkojnë çregjistrim.

Çdonjëri nga ndryshimet e mëposhtme kërkon anullimin e regjistrimit ekzistues:

a) Mbyllja e veprimtarisë ekonomike.

b) Shitja e veprimtarise ekonomike.

c) Bashkimi ose shkrirja për të kryer një veprimtari ekonomike që më parë kryhej nga një person i tatueshëm.

d) Rënia e qarkullimi nën kufirin minimal të regjistrimit në periudhën më të fundit prej 12 muajsh.

e) Heqja dore nga e drejta për t’u regjistruar, kur kjo nuk është e detyrueshme.

Nëse si rezultat i ndryshimeve b e c më sipër personi i tatueshëm i ri duhet të riregjistrohet, atij i jepet një numër i ri regjistrimi.

2.1.2 Ndryshime që kërkojnë modifikime në regjistrim

Çdonjëri nga ndryshimet e meposhtme kerkon modifikimin e regjistrimit ekzistues:

- Ndryshim në emrin ose emrin tregtar të biznesit, ose emrin dhe/ose adresën e njërit prej partnerëve.
- Ndryshim në emrat e pronarëve apo administratorëve.
- Ndryshim i emrit dhe/ose adresës në Shqipëri të përfaqësuesit fiskal për TVSH të emëruar nga një kompani jashtë vendit.
- Ndryshim në adresën e vendit kryesor, apo vendeve në të cilat kryhet biznesi.
- Ndryshim në veprimtarinë ekonomike kryesore.
- Ndryshim në numrin e llogarisë bankare.

NIPT-i ekzistues nuk ndryshon si pasojë e këtyre ndryshimeve, por çertifikata përditësohet me të dhënat e reja.

2.1.3 Kalimi në regjistrin pasiv

Organet tatimore kanë të drejtë të çregjistrojnë nga regjistri aktiv i regjistrimeve duke kaluar në pasiv çdo person të tatueshëm, kur provohet se ai për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari.

2.2 Mënyrat e çregjistrimit

2.2.1 Periudhat e çregjistrimit dhe data e hyrjes në fuqi të tij.

Kur personi i tatueshëm mbyll veprimtarinë e tij ekonomike, ai duhet të kërkojë të çregjistrohet jo më vonë se 15 ditë nga dita e fundit në të cilën ai ka bërë furnizime të tatueshme. Çregjistrimi hyn në fuqi nga dita e fundit e bërjes të furnizimeve të tatueshme.

Kur qarkullimi bie nën kufirin e regjistrimit gjatë periudhës më të fundit prej 12 muajsh, personi i tatueshëm mund të kërkojë të çregjistrohet në çdo kohë, por jo më përpara se një vit nga data në të cilin regjistrimi i tij ka hyrë në fuqi. Çregjistrimi hyn në fuqi në kohën kur personi i tatueshëm ka kërkuar të çregjistrohet.

Kur personi i tatueshëm heq dorë nga e drejta për t’u regjistruar, ai mund të kërkojë të çregjistrohet jo më përpara se 1 vit nga data e hyrjes në fuqi të regjistrimit.

Kur provohet se për çfarëdo arsye në vitin e fundit fiskal personi i tatueshem nuk ka ushtruar veprimtari, organet tatimore, pas kryerjes se procedurave administrative te verifikimit te ketyre personave, kanë të drejtë të çregjistrojnë ato nga regjistri aktiv i regjistrimeve duke kaluar në pasiv.

2.2.2 Dispozita të tjera për çregjistrimin

. Vendi i çregjistrimit është dega e tatimeve ku është bërë regjistrimi. Formulari që përdoret për çregjistrim është Formulari i Ndryshimeve të regjistrimit për TVSH" i percaktuar ne piken 2.1. të këtij udhezimi. Proçedura e çregjistrimit është e njëjtë me procedurën e regjistrimit. Në çastin e çregjistrimit, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një deklarate përfundimtare pagese sipas formularit te percaktuar ne piken 10.1. Kjo deklaratë do të ketë të llogaritur TVSH mbi gjendjen e mallrave (stoqet) dhe mbi mallrat kapitale (pajisjet) në datën e çregjistrimit.

Personat e tatueshëm që çregjistrohen nga TVSH, sipas pikave d) dhe e) të paragrafit 2.1.1, të këtij udhëzimi dhe që vazhdojnë veprimtarinë e tyre ekonomike, trajtohen si persona të tatueshëm të taksës mbi biznesin e vogël dhe të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin. Kjo kategori personash të tatueshëm nuk detyrohet të llogarisë TVSH mbi gjendjen e mallrave stok në datën e çregjistrimit nga TVSH.

Për çdo çregjistrim përfundimtar nga organet tatimore, do të ndiqen procedurat e përcaktuara në ligjin dhe udhëzimin “Për procedurat tatimore në RSH”. Edhe pas datës së çregjistrimit, personi i tatueshëm është përgjegjës për çdo detyrim të TVSH që rezulton për periudhën kur ai ishte i regjistruar, deri ne momentin kur këto detyrime parashkruhen sipas nenit 46.2 të ligjit “Për procedurat tatimore”.

3. Vetëfurnizimet

Në mbështetje të pikës 5 të nenit 10, nëse një person i tatueshëm do të përdorë për qëllime të veprimtarisë të tij ekonomike të tatueshme mallra të cilat i prodhon vetë, trajtohet sikur i furnizon (shet) këto mallra si pjesë të kësaj veprimtarie të tatueshme, dhe sikur furnizohet (blen) me këto mallra për qëllimet e ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme. Kushti i vëtëfurnizimit është qe mallrat e prodhuara nga tatimpaguesi të përdoren po nga ai për qëllime të furnizimeve të tatueshme (të ketë të drejtën e kreditimit). Në këtë rast personi i tatueshëm lëshon një faturë tatimore shitje për veten, që do të thotë që është dhe shitës dhe blerës.

Shembull: nëse një person i tatueshëm prodhues mobiljesh, 10 tavolina dhe 10 karrike nga i gjithë prodhimi i tij i përdor për pajisjen e zyrave ku zhvillon veprimtarinë e tij ekonomike, kemi të bëjmë me një vetëfurnizim.

Vlera e tatueshme e furnizimit për vete është kostoja e prodhimit. Nëse mallrat që prodhohen nga veprimtaria ekonomike që ushtrohet, përdoren nga vetë prodhuesi por në funksion të ushtrimit të një veprimtarie ekonomike të përjashtuar, ose pjesërisht të përjashtuar sipas ligjit për TVSH (neni 33), personi i tatueshëm nuk ka të drejtën e kreditimit (ose e ka pjesërisht kur është rasti) të TVSH-se së paguar ne blerjet e bëra.

Pika 5 e nenit 10 nuk zbatohet në rastin e shoqërive të ndërtimit, të cilat ndërtojnë për të shitur, pavarësisht nga fakti se sipërmarrësi i punimeve dhe investitori janë i njëjti person i tatueshëm. Në këtë rast furnizimi i procesit të ndërtimit është i tatueshëm, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 7.1.2, germa a, më poshtë.

4. Transferimi i veprimtarisë ekonomike

Nëse një person i tatueshëm i kalon të gjithë veprimtarinë ose një pjesë të saj një personi tjeter, i cili është ose bëhet i tatueshëm në lidhje me veprimtarinë e kaluar, duke e vazhduar atë, dhe ky transaksion plotëson njëkohësisht kushtin ekonomik dhe ligjor, kalimi konsiderohet transferim i veprimtarisë ekonomike dhe nuk eshte i tatueshem.

Plotësimi i kushtit ekonomik kërkon që veprimtaria qe transferohet të ketë autonomi ekonomike, pra të ketë mundësi të funksionojë si e pavarur te marrësi. Autonomia ekonomike presupozon ekzistencën e të gjitha kushteve për realizimin e prodhimit, si ambientin, lëndët e para, makineritë, etj. Shitja vetëm e njërës prej tyre (lëndës së parë, makinerive ose ambienteve, etj) nuk konsiderohet transferim i veprimtarisë ekonomike, por vetëm një furnizim i zakonshëm mallrash, për të cilin aplikohet TVSH.

Plotësimi i kushtit ligjor kërkon që të bëhet në të gjitha rastet verifikimi i bilancit te personit qe kalon veprimtarinë, të verifikohet sa dhe cilat asete të aktivit përdoreshin për prodhimin e produktit dhe sa janë transferuar dhe po kështu në pasiv, sa të ardhura janë realizuar për shkak të këtij kalimi. Të njëjtat verifikime do të bëhen në bilancin e personit tek i cili kalon veprimtaria, sa asete kanë hyrë dhe çfarë veprimesh jane bërë në pasiv. Midis dy personave duhet të jetë perpiluar gjithashtu nje kontrate transferimi e noterizuar, mbeshtetur ne Kodin Civil.

Nëse personi i tatueshëm jep mallra të cilat janë pjesë e aseteve të veprimtarisë së tij ekonomike, p.sh. i shet, i fal ose i përdor privatisht, ky është një furnizim i tatueshëm dhe mbi vlerën e tatueshme të këtyre furnizimeve llogaritet TVSH.

5. Momenti i furnizimit

Furnizimi quhet i kryer në momentin kur është e detyrueshme të lëshohet fatura. Personi që kryen një furnizim të tatueshëm, detyrohet të lëshojë faturë për atë furnizim në momentin kur lëvrohen mallrat ose kur ato bëhen të disponueshme, apo kur shërbimet janë kryer prej tij në lidhje me atë furnizim.

Në të gjitha rastet kur personi i tatueshëm, arkëton pagesën përpara se mallrat të lëvrohen apo të bëhen të disponueshme, apo shërbimet të jenë kryer ai është i detyruar të lëshojë një faturë në momentin që pagesa është arkëtuar prej tij. Kjo faturë do të regjistrohet menjëherë në librin e shitjes dhe do të pasqyrohet në FDP-në e po atij muaji në të cilin është bërë marrja e pagesës.

5.1 Transferimi i mallrave për shitje me këste

Bazuar ne nenin 13 pika 7 të ligjit, kur mallrat transferohen në bazë të një kontrate, e cila parashikon marrjen me qira ose shitjen me këste, pavarësisht nga momenti i kalimit të pronësisë, detyrimi për TVSH-ne lind mbi vlerën e plotë të mallit. Ndërsa përsa i takon deklarimit dhe pagesës për çdo periudhë tatimore, TVSH llogaritet mbi pagesat e vlerës së kësteve për mallin e vënë në dispozicion të përdoruesit. Operacione të kësaj natyre janë ato që kanë të bëjnë me transferimin e mallrave në bazë të një kontrate qeraje financiare (leasing). Per cdo rast qeradhenesi perpilon nje fature tatimore me TVSH për çdo këst të përcaktuar në kontratën përkatëse të leasing si më poshtë:

a) Kur qiradhënësi është person i tatueshëm jo bankë ose institucion financiar.

Furnizuesi qe i jep mallin qiradhënësit, lëshon për të faturë tatimore me vlerë të tatueshme aq sa është çmimi i plotë, duke zbatuar mbi këtë vlerë TVSH 20%.

Qiradhenesi e regjistron faturen e leshuar nga furnizuesi ne librin e blerjeve dhe krediton TVSH e zbatuar ne te. Kur qiradhenesi i dorëzon mallin qiramarresit, per cdo kest te qirase financiare(zakonisht muaj) ai do te leshoje per te fature tatimore me vlere te tatueshme aq sa eshte vlera e plote e kestit (perfshire interesin)mujor,duke zbatuar mbi të TVSH 20%. Keto fatura regjistrohen nga qiradhenesi ne librin e shitjes dhe deklarohen si shitje te tatueshme,sipas periudhave tatimore qe i takojne.

Qiramarresi, kur eshte person i tatueshem (i regjistruar si tatimpagues i TVSH) ka te drejten e kreditimit te ketyre faturave, brenda percaktimeve te nenit 33 te ligjit te TVSH. Pra lejohet kreditimi per ato lloje mallrash qe i sherbejne veprimtarise se tij te tatueshme dhe nuk kufizohen nga neni i mesiperm.

Ne fund te periudhes se kontrates, nese qiramarresi do te ushtroje mundesine e blerjes se mallit te percaktuar ne te, qiradhenesi leshon per te nje fature perfundimtare me vlere te tatueshme te caktuar ne kontrate, regjistrimi i se ciles behet njelloj si i faturave pjesore te leshuara gjate gjithe periudhes se zgjatjes se kontrates.

E njeta procedure si me siper kryhet ne rastin kur qiradhenesi e prodhon vete mallin,me ndryshimin qe perjashtohet nga skema roli i furnizuesit.

b) Kur qiradhenesi eshte nje banke ose institucion financiar qe kryen edhe aktivitetin e qirase financiare

Personat qe ushtrojne veprimtari ne fushen bankare, qe te mund te kryejne veprimtarine e qirase financiare,duhet te kene perfshire kete aktivitet ne licensen ose lejen perkatese. Sipas nenit 21 te ligjit te TVSH,sherbimet financiare te percaktuara ne kete nen dhe qe kryhen nga banka jane te perjashtuara nga TVSH.

Nderkohe qe aktiviteti i qirase financiare eshte i tatueshem.Pra banka kryen njekohesisht operacione te tatueshme dhe operacione te perjashtuara nga TVSH. Edhe ne kete rast krijohen marredhenie midis furnizuesit, bankes ne rolin e qiradhenesit, si dhe qiramarresit.

Furnizuesi qe i shet mallin bankes(qiradhenesja), leshon per te fature tatimore me vlere te tatueshme aq sa eshte cmimi i plote duke zbatuar mbi kete vlere TVSH prej 20%.

Banka e regjistron kete fature ne librin e blerjeve.Meqenese aktiviteti i qirase financiare eshte i tatueshem dhe furnizimi i marre i sherben vetem ketij aktiviteti, atehere banka ka te drejten e kreditimit te TVSH se zbatuar ne kete furnizim. Ne castin kur banka i dorezon mallin qiramarresit, per cdo muaj ajo do te leshoje per te fature tatimore me vlere te tatueshme aq sa eshte vlera e plote e kestit(perfshire interesi) mujor, duke zbatuar 20 % TVSH. Keto fatura regjistrohen nga banka ne librin

e shitjes dhe deklarohen si shitje te tatueshme, sipas periudhave tatimore qe i takojne.

Ne fund te periudhes se kontrates,nese qiramarresi do te ushtroje mundesine e blerjes se mallit te percaktuar ne te,banka leshon per te nje fature perfundimtare me vlere te tatueshme te caktuar ne kontrate, regjistrimi i se ciles behet njelloj si i faturave pjesore te leshuara gjate gjithe periudhes se zgjatjes se kontrates.

Ne te njejten kohe, banka kryen blerje te tjera, te ngarkuara me TVSH, te cilat i sherbejne edhe aktivitetit te perjashtuar (sherbime finaciare) edhe aktivitetit te tatueshem, perfshire qerane financiare. Per kete kategori shpenzimesh, bazuar ne nenin 33 te ligjit te TVSH, zbatohet kreditimi i pjesshem i TVSH. Pra banka krediton TVSH e lidhur me keto shpenzime deri ne masen qe ato i sherbejne aktivitetit te saj te tatueshem.

6. Furnizimi kundrejt pagesës

6.1 Përdorimi privat i mallrave

Kur mallrat qe i përkasin veprimtarisë ekonomike të një personi të tatueshem përdoren privatisht jashtë kësaj veprimtarie, furnizimi është i tatueshëm sipas nenit 18.2 te ligjit mbi TVSH-ne. Ky furnizim perfshin mallrat të cilat janë prodhuar vetë dhe mallrat nga inventari ose nga aktivet e veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm. Përdorimi privat përfshin përdorimin personal nga personi i tatueshëm të aktiveve të veprimtarisë së tij ekonomike. Ai gjithashtu përfshin edhe përdorimin nga persona të tjerë të tillë si një i punësuar, i afërt, një mik, etj. te personit te tatueshem.

Vlera e tatueshme në këto raste përcaktohet sipas Nenit 27 të ligjit mbi TVSH-ne, paragrafi i dytë. Konsiderohet si përdorim privat në çastin e çregjistrimit, inventari gjendje i aseteve për të cilat është paguar TVSH në blerje. Në këtë çast, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një Formular Deklarimi dhe Pagesë përfundimtare sipas formularit te percaktuar ne piken 10.1 te ketij udhezimi. Kjo deklaratë do të ketë të llogaritur TVSH mbi gjendjen e mallrave (stoqet) në datën e çregjistrimit të vlerësuara sipas vlerës së tregut dhe mallrat kapitale gjendje të vlerësuara sipas paragrafit 15.1.4 të këtij Udhëzimi.

6.2 Furnizimet kundrejt pagesës së reduktuar

Trajtohen si furnizime kundrejt pagesës (të tatueshme), të gjitha rastet kur mallrat që i janë furnizuar një personi të tatueshëm për qëllimet e veprimtarisë së tij ekonomike, furnizohen prej tij ose ju jepen për përdorim personave të tjerë kundrejt pagesës së reduktuar, përveç rasteve kur mallrat janë furnizuar apo përdorur vetëm si mostra, artikuj publicitare apo promocionale furnizuar pa pagesë. Në kuptim të këtij ligji, mostër konsiderohet ai furnizim malli pa pagesë në atë formë që nuk është e përshtatshme për rishitje.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar quhen rastet kur, furnizuesi nuk arkëton pagesën, p.sh., dhuratat, mallra e shërbime të furnizuara si nxitës (ofrohet një dhuratë me kusht që blerësi të blejë dicka ose të bëjë veprime të tjera në dobi të shitësit) ose pagesa është dukshëm më e vogël se ç`duhej të ishte nëse qëllimi i furnizuesit ka qënë fitimi për këtë dhe furnizime të ngjashme. Mallrat dhe shërbimet e furnizuara në rrethanat e mësipërme janë të tatueshme dhe vlera e tatueshme e tyre është pagesa totale që duhet të ishte e pagueshme ne baze te cmimit te te shitjes në lidhje me atë furnizim.

6.3 Dhënia në përdorim pa pagesë e aktiveve te veprimtarise

Në rastet kur një furnizues mallrash i jep klientit të tij në përdorim, pa pagesë, aktive të qëndrueshme të trupëzuara, pjesë e veprimtarisë së tij, me qëllim shpërndarjen e mallrave që ai furnizon (frigoriferë, banakë frigoriferikë dhe te tjera të kësaj natyre) trajtimi i TVSH-së do të jetë si më poshtë:

- Në rast se klienti, të cilit i është dhënë në përdorim aktivi nga furnizuesi i tij, paguan të njëjtin cmim si edhe një klient i cili thjesht blen mallra pa marrë në përdorim aktive të kësaj natyre, atëhere nuk llogaritet TVSH mbi dhënien në përdorim të aktiveve.

- Në rast se klienti të cilit i është dhënë aktivi nga furnizuesi i tij, paguan një vlerë më të madhe për mallrat e furnizuara nga ky i fundit se një klient i cili thjesht blen mallra, atëhere llogaritet TVSH, me shkallë tatimore 20%, mbi diferencën e cmimit. Kjo diferencë konsiderohet si vlerë e dhënies në përdorim. Ky parim zbatohet vetëm aty ku nuk ka detyrim për blerësin për të bërë një pagesë në para ose në natyrë, për përdorimin e aktivit. Si kusht per kete trajtim nevojitet :

- Midis furnizuesit (pronar i aktivit) dhe klientit, te ekzistoje nje kontrate e lidhur sipas se ciles furnizuesi kryen furnizime te vazhdueshme te atij malli, i cili ruhet ne keto aktive. Ne te njejten kontrate sqarohet qe dhenia ne perdorim e ketyre aktiveve behet pa pagese.

- Zbatimi në praktikë i kësaj kontrate, pra furnizimet e vazhdueshme te furnizuesit (pronar i aktivit) për klientin të jenë konkretizuar me dokumenta justifikuese.

- Furnizuesi i paraqet keto aktive ne dokumentat e tij te kontabilitetit kundrejt te gjitha rregullave, si prone te tij.

Trajtimi i mësipërm është i vlefshëm vetëm në rastet kur nuk ka detyrim për klientin (blerësin) për të bërë një pagesë në vlerë ose natyrë për llogari të furnizuesit, për marrjen në përdorim të aktivit.

Nëse dhënia në përdorim e aktiveve bëhet kundrejt pagesës, atëhere kemi të bëjmë me furnizim të tatueshëm dhe mbi transaksionin zbatohet TVSH me shkallë tatimore 20%.

7. Furnizimet e tatueshme dhe ato të përjashtuara

Ligji "'Për tatimin mbi vlerën e shtuar" zbatohet mbi çdo furnizim mallrash e shërbimesh që kryhet nga çdo person i tatueshëm, pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij dhe pavarësisht nga lloji i veprimtarisë ekonomike që ai kryen. Në të njëjtën kohë, nenet 19 deri ne 25.7 dhe neni 26.1 të ligjit parashikojne edhe përjashtimet nga ky tatim.

7.1 Toka dhe ndertesat

Furnizimi i tokës dhe truallit dhe dhënia me qera e tyre është furnizim i përjashtuar, përveç rasteve kur toka përdoret për parkimin e mjeteve të transportit dhe mjeteve të tjera lëvizëse. Parkimi i mjeteve të transportit dhe pajisjeve të tjera lëvizëse, është i tatueshëm me TVSH.

Furnizimi i shërbimeve të ndërtimit, pra kryerja e procesit të ndërtimit si dhe të mirëmbajtjes jane furnizime te tatueshme.

Dhënia me qera e ndërtesave, me përjashtim të ndërtesave pronë publike nga organet e pushtetit qendror apo vendor, është furnizim i tatueshëm.

Tokë për qëllime të këtij ligji do të thote çdo zonë e papunuar, papërpunuar, pazhvilluar e tokës, që nuk përmban ndonjë ndërtim, përveç mureve të thjeshta ndarëse ose gardhe që përcaktojnë kufijtë ndarës të tokës.

Ndërtesë do të thotë çdo ndërtim i nje ndërtese te fiksuar në tokë, ose pjesë e asaj ndërtesë (e tillë si dhomë ose apartament), dhe që përfshin tokën mbi të cilën ajo qëndron plus tokën rrethuese që bën pjesë në shitje, por nuk përfshin artikuj të tillë si rulotat dhe trajlerat.

Ndërtimi përcaktohet si çdo operacion që ka për rezultat përfundimin tërësor ose pjesor të një ndërtese të re ose substancialisht të ndryshuar, muri, rruga ose themeli. Ndërtime konsiderohen:

a) Punët për konstruksionin e ndërtesave dhe të objekteve të tjera, ku futen :

- punët e ndërtimit (muraturë, armaturë, suvatime, etj.);
- punët publike (ndërtim e mirëmbajtje rrugësh, etj.);
- punët për rregullimin e parqeve që lidhen me operacione të tilla që zgjasin afatin e shfrytëzimit);
- punët për rregullimin e teritoreve që kërkojnë modifikime të relievit;
- punët e rrjetit ngrohës dhe të konstruksioneve metalike;
- punët për shkatërrimin e pasurive të patundshme.

b) Punët për pajisjen e ndërtesave dhe të objekteve të tjera, ku futen:

- punët për pajisjen e ndërtesave, pajisje të cilat inkorporohen mënyrë definitive në ndërtesë, duke u transformuar kështu për shkak të destinacionit të tyre në pasuri të patundshme (instalimet elektrike, ato sanitare, të ngrohjes, etj.).
- Instalimet e objekteve ose të aparateve të lëvizshme, të cilat me vendosjen e tyre ruajnë karakter te lëvizshëm, nuk konsiderohen punë ndërtimi por shitje materialesh pasojë e kryerjes së një shërbimi.

c) Punët për riparimin e pasurive të patundshme dhe të instalimeve me karakter të patundshëm. Këtu bëhet fjalë për punë që bëhen të nevojshme për shkak të degradimit ose prishjes së ndërtesave (pasuri të patundshme) si lyerja e fasadave, ribërja e një instalimi elektrik apo sanitar, etj.

Mirëmbajtja përcaktohet si çdo operacion i kryer mbi tokë ose ndërtesa për të parandaluar degradimin ose dëmtimin dhe për t`i mbajtur tokën dhe ndertësat me pamje të mirë dhe rregull funksionimi, duke përfshirë pastrimin.

7.1.1. Vlera minimale e tatueshme e ndërtimit të banesave.

Ne baze te nenit 27/1 te ligjit, vlera minimale e tatueshme në procesin e ndërtimit të banesave, bazohet në çmimin minimal fiskal dhe sipërfaqen e ndërtimit.

Çmimi orientues minimal fiskal, për procesin e ndërtimit të banesave, përcaktohet me vendim të Keshillit te Ministrave, pas këshillimit me Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë.

7.1.2. Mënyra e zbatimit te TVSH ne ndertim

TVSH në ndërtim aplikohet:

a) Kur shoqëritë e ndërtimit ndërtojnë për të shitur apo për të dhënë me qera, TVSH llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve. Bashkëngjitur me çdo situacion mujor do të jetë detyrimisht fatura tatimore me numër serial. Vlera e situacionit mujor do të jetë vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-ne çdo muaj. Vlera totale e këtij situacioni mujor regjistrohet në librin e shitjeve.

b) Kur shoqëritë e ndërtimit të licencuara profesionalisht, do të ndërtojnë objekte për qellim përdorimi në funksion të aktivitetit të tyre të tatueshëm (jo per t'u shitur), kemi të bëjmë me vetëfurnizim të ndërtesave. Per cdo muaj, shoqeria ndertuese perpilon situacionin e punimeve te kryera. Bashkëngjitur me çdo situacion mujor, do të jetë detyrimisht fatura tatimore. Personi i tatueshëm është i detyruar të llogarisë TVSH-ne çdo muaj kalendarik. Fatura tatimore e përpiluar si më sipër, regjistrohet njëkohësisht në librin e blerjeve dhe të shitjeve të shoqërisë.

Lejohet kreditimi i TVSH-se së paguar në blerjet e bëra për këtë qëllim. Kreditimi lejohet i plotë për rastet kur personi i tatueshëm kryen aktivitet ekonomik plotësisht të tatueshëm, si dhe i pjesshsëm kur kryen aktivitet pjesërisht të tatueshëm. Eshtë kusht që ndërtesat e kësaj natyre duhet të jenë të destinuara për kryerjen e aktiviteteve të tatueshme nga vetë shoqeria. Gjithashtu ndërtesat duhet të jenë të një tipi të tillë, qe natyra dhe qëllimi i përdorimit të tyre te shpallen dhe aprovohen në lejen e ndërtimit të dhene nga organet e qeverisjes vendore.

c) Kur një shoqëri ndërtimi e licencuar si e tillë ndërton shtëpi banimi për vete, llogarit dhe paguan TVSH-ne, sipas nenit 18.2 te ligjit mbi TVSH-ne.

Nëse merret paradhënie për punimet që do të kryhen, atëherë personi i tatueshëm që merr paradhënien detyrohet të lëshojë faturë në momentin e marrjes së saj dhe këtë faturë ta regjistrojë në librin e shitjes së periudhës tatimore në të cilën është marrë paradhënia.

7.2 Shërbimet financiare

Shërbimet financiare të përcaktuara në nenin 21 të ligjit "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", janë furnizime të përjashtuara nga TVSH. Por në qoftë se personi i tatueshëm kryen shërbime për mbikëqyrje, transaksione që lidhen me artikujt e përdorur për koleksione apo veprime që lidhen me mbledhjen e borxhit, ai kryen furnizime të tatueshme.

Furnizime të tatueshme janë gjithashtu edhe sigurimi i jojetës, me përjashtim të sigurimit të jetës. Furnizime të jojetës janë të gjitha llojet e sigurimit të pasurisë, sigurimi i përgjegjësisë civile, të gjitha llojet e sigurimit të mjeteve motorike si dhe të gjitha llojet e tjera të sigurimeve të jojetës.

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar për të gjitha rastet e mësipërme do të llogaritet në masën 20 për qind të primit të sigurimit dhe së bashku me primin do të jetë i pagueshëm nga blerësi.

Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palëve të treta për mjetet motorrike jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (kartoni jeshil) si dhe sigurimi i shëndetit për shtetasit në udhëtim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, do të trajtohen me TVSH në masën 0 %.Furnizime të tatueshme janë gjithashtu edhe sigurimet e pronës. Në këtë rast, në vlerën totale të primit të sigurimit do të përfshihet edhe TVSH.

7.3 Banka e Shqipërisë

Në bazë të nenit 22 të ligjit, furnizimi i arit, banknotave dhe i monedhave për Bankën e Shqipërisë përjashtohen nga TVSH. Por, në rastet kur Banka e Shqipërisë kryen veprimtari të tjera ekonomike të tilla si bërja e shtypshkrimeve të ndryshme, furnizimi i monedhave për qëllime numizmatike, etj, ajo bën furnizime të tatueshme dhe duhet të regjistrohet e të paguajë TVSH. Furnizimi i shtypshkrimeve të pullave fiskale nga Shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë, për Ministrinë e Financave, konsiderohet furnizim i përjashtuar nga TVSH.

7.4 Shërbimet postare

Furnizimi i pullave të postës për përdorim për shërbime postare, furnizimi i pullave fiskale dhe i të gjithë pullave të tjera të ngjashme përjashtohen nga TVSH. Por në qoftë se posta bën importe apo kryen edhe shërbime të tjera postare, dhe qarkullimi vjetor kalendarik i saj është më i madh se 8 milionë leke, ajo duhet të regjistrohet dhe të paguajë TVSH.

7.5 Organizatat jofitimprurese

Për qëllimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, organizatë jofitimprurëse është çdo shoqëri, institucion, shoqate apo organizate, që themelohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me

Ligjin Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” dhe që nuk është krijuar për përfitime ose të ardhura të antarëve të saj dhe rregullat e së cilës nuk lejojnë shpërndarje fitimesh apo pronash për antarët e saj.

Në organizata jofitimprurëse futen edhe të gjitha institucionet buxhetore që subvencionohen nga shteti.

Në bazë të nenit 24 të Ligjit furnizimet e bëra nga organizatat jofitimprurëse kundrejt pagesës së reduktuar, që do të thotë se këto organizata duhet t`i kryejnë vetë këto furnizime dhe këto furnizime të jenë bërë kundrejt pagesës së reduktuar sipas kushteve që përcakton neni 18 i ligjit, janë furnizime të përjashtuara nëse janë :

- furnizim mallrash e shërbimesh për trajtim mjekësor ose dentar;
- furnizim shërbimesh për mbrojtjen e kujdesin ndaj fëmijëve ose të moshuarve;
- furnizim shërbimesh arsimore, kulturore a sportive;
- furnizim shërbimesh nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqënien shpirterore.

Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar kemi ne ato raste kur këto organizata nuk arketojnë pagesë ose pagesa që ato arkëtojnë është dukshëm më e vogël se ç'duhet të ishte nëse qëllimi i tyre do të ishte fitimi, sipas Nenit 18, paragrafi 4 te ligjit mbi TVSH-ne. Përkundrazi, kur këto organizata i bëjnë furnizimet e mësipërme kundrejt pagesës së plotë, ato bëjnë furnizime të tatueshme. Nëse një organizatë jofitimprurese kryen veprimtari të tjera, të ndryshme nga ato të përmendura më sipër, ajo kryen veprimtari të tatueshme, pavarësisht nëse pagesa është e reduktuar apo e plotë. Në këtë rast, nëqoftëse volumi i qarkullimit është më i madh se 8 milionë lekë, ajo është e detyruar të regjistrohet dhe të paguajë TVSH.

Në bazë të paragrafit të dytë të nenit 4 të dekretit të Presidentit, nr.1510, datë 28.06.1996 "Për disa ndryshime në ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar", mallrat e importuara kundrejt pagesës së reduktuar si ndihmë humanitare nga organizatat bamirëse humanitare, institucionet e kultit, entet publike, si dhe institucionet shtetërore buxhetore me qëllim kryerjen e sherbimeve të percaktuara ne nenin 24 të Ligjit, nuk ngarkohen me TVSH.

Furnizimi i shërbimeve arsimore dhe i mallrave e shërbimeve të lidhura ngushtë me to, nga institucione arsimore, publike dhe private, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjet “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” është furnizim i përjashtuar nga TVSH. Me “mallra dhe shërbime të lidhura ngushtë me sistemin arsimor” do të kuptohet furnizimi nga institucionet arsimore i librave dhe pajisjeve shkollore, shërbimeve të internetit, fotokopjimeve, printimeve, etj. të kësaj natyre, të përfshira në çmimin që paguajnë nxënësit. Shërbimet e tranportit dhe ato të ushqimit do të konsiderohen të lidhura ngushtë me shërbimet arsimore, vetëm në rastet kur ato furnizohen nga vetë institucioni arsimor, pra me mjetet dhe personelin e institucionit arsimor. Në rastet kur këto shërbime furnizohen nga subjekte jashtë institucionit arsimor, ato nuk konsiderohen si furnizime të lidhura ngushtë me shërbimet arsimore dhe nuk përfitojnë përjashtim nga TVSH.

7.6 Diplomatët dhe organizatat ndërkombëtare

Në bazë të nenit 25, përjashtohen nga TVSH furnizimet që bëhen për misionet diplomatike e personelin e tyre, mbi bazën e reciprocitetit dhe për organizatat ndërkombëtare e personelin e tyre mbi bazën e marëveshjeve ndërkombëtare dhe NATO-n.

Në mbështetje të këtij neni, importimi i mallrave për misionet diplomatike dhe personelin e tyre është i përjashtuar nga TVSH. I përjashtuar nga TVSH është gjithashtu edhe importimi i mallrave për organizatat ndërkombëtare të njohura si të tilla nga shteti shqiptar dhe NATO. Përjashtimi për organizatat ndërkombëtare jepet sipas kushteve të vendosura prej konventave ndërkombëtare që themelojnë këto organizata.

Megjithatë, edhe pse janë të përjashtuara, si misionet diplomatike ashtu dhe organizatat ndërkombëtare dhe NATO, meqënëse bëjnë importe janë të detyruara të regjistrohen për TVSH dhe të pajisen me certifikatën e Numurit të Identifikimit.

Për blerjet brenda vendit, misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare dhe personeli i tyre, do të paguajnë TVSH në momentin e blerjes. Por, për TVSH e paguar në blerje ato do të rimbursohen me kusht që, çdo faturë blerjeje të jetë me e madhe se 10 000 lekë. E drejta e rimbursimit për ambasadat do të jepet në bazë të parimit të reciprocitetit. Kjo do të thotë që, do t’u rimbursohet TVSH e paguar në blerje vetëm misioneve diplomatike dhe personelit të tyre, shtetet e të cilave rimbursojnë TVSH për Ambasadën Shqiptare dhe personelin e saj. Me procedurat e rimbursimit të

TVSH së paguar, do të merret Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e cila është përgjegjëse edhe për zbatimin e parimit të reciprocitetit. Kjo drejtori do ti pajisë misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, e personelin e tyre me formularin "Kërkesë për Rimbursim" e cila eshte ne formularin bashkengjitur ketij udhezimi. Çdo mision diplomatik, organizatë ndërkombëtare për blerjet e bëra nga vetë ato ose nga personeli i tyre do të dërgojë në drejtorine e mësipërme dy kopje të formularit "kërkesë për rimbursim" (të firmosur e të vulosur nga titullari i ambasadës apo i organizatës ndërkombëtare) të cilave u bashkëngjisin edhe faturat origjinale të blerjes. Drejtoria e Protokollit në Ministrine e Jashtme, kopjen origjinale të formularit "kërkesë për rimbursim" dhe faturat origjinale të blerjes e dërgon në degen e tatimeve. Dega e tatimeve është e detyruar qe brenda 1 muaji nga data e paraqitjes së dokumentacionit të mësipërm nga ana e Drejtorisë së Protokollit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, të bëjë rimbursimin e TVSH së paguar në faturat përkatëse. Brenda këtij afati, dega e tatimeve verifikon direkt në vend tek shitësi, faturën e lëshuar nga ai për misionin diplomatic apo organizatën ndërkombëtare, regjistrimin e saj në librin e shitjeve, pasqyrimin e të dhënave në deklaratën e pagesës së TVSH për muajin përkatës dhe derdhjen në fakt të TVSH së mbledhur nga subjektet e mësipërme. Pas verifikimit dhe miratimit të Kërkesave për rimbursim, dega e tatimeve lëshon një Urdhër Rimbursimi per degen perkatese te bankes. Urdhër Rimbursimi lëshohet për të gjithë shumën e TVSH që do të rimbursohet në bazë të kërkesave të paraqitura nga Drejtoria e Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme. Dega perkatese e bankes në bazë të Urdhërit të Rimbursimit, paguan Drejtorinë e Financës dhe të Kontrollit në Ministrine e Punëve të Jashtme për të gjithë shumën e rimbursimeve, dhe kjo e fundit shpërndan rimbursimet sipas çdo kërkesë.

Përsa i përket blerjeve që personeli i NATO dhe bazat e saj brenda territorit të Shqipërisë, bëjnë brenda vendit, ato nuk do të paguajnë TVSH në pikën e blerjes. Për këtë në pikën e blerjes përfaqesuesi i NATO-s, është i detyruar t'i dorëzojë shitësit një Çertifikatë Lëvrimi, sipas modelit bashkangjitur, mbi bazën e të cilës shitësi harton faturën tatimore me TVSH 0%. Në fund të faturës, shitësi bën shënimin "ky përjashtim nga TVSH bazohet në Çertifikatën e Lëvrimit Nr……datë……." Zyra e autorizuar për lëshimin e Çertifikatës së Lëvrimit, pranë Komandës së NATO-s në Shqipëri, çdo muaj, brenda datës 10 dërgon në degët e tatimeve ku janë bërë blerjet pa TVSH, një listë përmbledhëse së bashku me kopjet e Çertifikatave të Lëvrimit të lëshuara për blerjet e realizuara në muajin paraardhës, që do të shërbejë për kryqëzimin dhe verifikimin e faturave tatimore të lëshuara me TVSH 0%.

7.7 Operacionet hidrokarbure

Janë të përjashtuara nga TVSH:

- Furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët dhe nënkontraktorët e tyre, të vërtetuar si të tillë nga Agjensia Kombëtare e Hidrokarbureve, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure.

- Furnizimi i mallrave që bëjnë kontraktorët për njëri-tjetrin ose nënkontraktorët për kontraktorët e tyre, të importuara sipas nenit 26/1 të këtij ligji.

"Operacionet hidrokarbure", për efekt të këtij paragrafi, ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr.7746, datë 28.07.1993 "Për hidrokarburet".

Kontraktorët dhe nënkontraktorët që përfitojnë nga përjashtimet e mësipërme janë ato tatimpagues të TVSH,që kryejnë në emër të tyre vetëm furnizimet specifike të shërbimeve të përmendura në përcaktimet "Kërkim" dhe "Zhvillim", të Ligjit nr 7746 dt 28.07.1993"Për Hidrokarburet".

"Kërkim" do të thotë kërkimi për hidrokarbure me mjete gjeologjike, gjeofizike e të tjera, dhe përfshin shpimin e puseve të kërkimit dhe vlerësimit.

"Zhvillim" do të thotë ndërtimi dhe instalimi i pajisjeve për prodhimin e hidrokarbureve dhe shpimi i puseve të shfrytëzimit.

Në kuptim të këtij paragrafi, do të trajtohen si furnizime të përjashtuara nga TVSH, furnizimet e shërbimeve të ndërtimit që kryhen nga kontraktore e nënkontraktorë të panjohur nga AKH kur këto punime të ndërtimit konsiderohen nga AKH si të domosdoshme për realizimin e fazave të kërkim zhvillimit. Nuk e përfitojnë këtë përjashtim nënkontraktorët që furnizojnë shërbime që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me fazat e kërkimit dhe të zhvillimit, si shërbime interneti, telefonike, akomodimi, etj.

7.8 Barnat dhe pajisjet mjekësore

Furnizimi i barnave, i pajisjeve mjekësore dhe i ambalazheve e materialeve që përdoren për

prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara.

7.9 Furnizimet e përjashtuara në import

Janë furnizime të përjashtuara nga TVSH, mbështetur në nenin 26/1 të ligjit:

- Importimi përfundimtar i të gjitha mallrave prej një personi të tatueshëm, kur furnizimi i tyre në të gjitha rrethanat brenda vendit është furnizim i përjashtuar nga tatimi mbi vlerën e shtuar.
- Importimi i mallrave të vendosura në regjimin tranzit.
- Importimi i mallrave të deklaruara për të qënë nën regjimin e lejimit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv.
- Importimi i kafshëve të gjalla të racës, të dhuruara nga donatorë të ndryshëm.
- Importimi i mallrave nga NATO dhe organizmat e saj në kuadër të operacioneve ne bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.
- Importimi i materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura të dhuruara nga vendet e Aleancës së Nato-s dhe ato partnere.

7.9.2 Operacione nën regjimin e përpunimit aktiv

Nënkontraktorët të cilët bëjnë furnizime shërbimesh për shoqëritë e përpunimit aktiv, janë të përjashtuar nga TVSH, vetëm për furnizimin e shërbimit të kryer prej tyre për llogari të shoqërive të përpunimit aktiv. Pra, vetëm për përpunimin e mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u rieksportuar.

Aktivitetet e klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv, konsiderohen terësisht të destinuara për eksport. Kushtet e ekzistencës së kësaj natyre operacionesh janë :

a) Përpunuesi (nënkontraktori) asnjëherë nuk duhet te behet pronar i materialeve te sjella nga porositesi.

b) Materialet e sjella nga porositësi tek përpunuesi, duhet te trupëzohen tërësisht në produktin e fabrikuar.

Materialet e sjella nga porositesi ne formen e lëndës së parë duhet t'i kthehen atij fizikisht nga përpunuesi në formën e gjysëmproduktit ose produktit të gatshëm, me perjashtim te mbetjeve teknologjike gjate procesit te prodhimit dhe në përputhje me kartat teknologjike të prodhimit. Kjo kerkon si domosdoshmeri, qe keto materiale te jene te identifikuara me dokumentacion, tek perpunuesi per gjate gjithe kohes se perpunimit. Nëse rezulton që sasia e gjysëmproduktit ose produktit të gatshëm është më e vogël nga sa duhej të ishte kundrejt materialeve të përdorura në përpunim, diferenca konsiderohet si shitje e kryer nga përpunuesi.

c) Detyrime te vecanta

Midis porositësit (kontraktori kryesor i vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv) dhe përpunuesit (nënkontraktori) të jetë lidhur një kontratë në përputhje me Kodin Civil.

Përpunuesit duhet te mbajnë një regjistër te vecantë, ku përshkruhet realizimi i punimeve për llogari të porositësit. Në këtë regjistër duhet të shënohet identiteti i porositësit, pra emri tregtar, NIPT, emri mbiemri i administratorit, statusi juridik i tij, adresa e selise dhe dega e tatimeve në të cilën është regjistruar.

Per çdo porosites dhe per cdo operacion hyrje dhe dalje, shënohet :

- Lloji dhe sasia e materialeve objekt i perpunimit dhe data e hyrjes.
- Lloji dhe sasia e gjysëm produktit ose produktit te fabrikuar si dhe data e daljes.
- Ne regjister duhet te evidentohet edhe malli gjendje tek perpunuesi. Për këtë hartohet inventari mujor.
- Lëvizja e çdo sasie gjysëmprodukti ose produkti të gatshëm nga perpunuesi (nenkontraktori) tek porositesi (kontraktori), shoqerohet me fature tatimore pa TVSH, per vleren e sherbimit te kryer.

Per te perfituar nga skema e mesiperme cdo tatimpagues nenkontraktor duhet te paraqese nje kerkese ne degen perkatese te tatimeve e cila pasi ben verifikimet e duhura leshon autorizimin e perfshirjes ne kete skeme. Te gjitha autorizimet e leshuara evidentohen nga dega e tatimeve ne nje regjister te vecante ku shenohet emri i tatimpaguesit (nenkontraktorit), NIPT, adresa, lloji i veprimtarise, kontraktori per te cilin punon, data e leshimit te autorizimit dhe afati i vlefshmerise.

7.9.3 Skema e shtyrjes se pageses se TVSH

Mbështetur në ligjin nr.8714 datë 15.12.2000, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.49 datë 28.04.2001 dhe vendimit i Këshillit të Ministrave Nr.122 dt.03.03.2005, ndaj personave të tatueshëm që importojnë pajisje apo makineri për t`u investuar në prodhim, ndërtim, transport, telekomunikacion, KESH, si dhe energjisë elektrike të importuar nga kjo e fundit zbatohet skema e shtyrjes së pagesës së

TVSH-së në importet e makinerive dhe pajisjeve.

Importimi dhe investimi duhet të kryhet nga i njëjti subjekt si dhe të jetë i lidhur drejtpërdrejtë me procesin teknologjik përkatës. Kuptimi i termave sipas dispozitave të akteve të lartpërmendura është si më poshtë :

- Me fjalën "makinë" do të kuptohet cdo konstruksion, i krijuar prej njeriut që, duke marrë energji në një formë të përshtatshme, si dhe instruksionet e duhura, është në gjendje të kryejë punë.

- Me shprehjen "linjë teknologjike" do të kuptohet tërësia e metodave që duhet të ndiqen, hap pas hapi, për të bërë të mundur kryerjen e qëllimit, për të cilin bëhet investimi përkatës.

- Me shprehjen "proces teknologjik" do të kuptohet tërësia e metodave që duhet të ndiqen, hap pas hapi, për të bërë të mundur kryerjen e qëllimit, për të cilin bëhet investimi përkatës.

- Me fjalën "pajisje" do të kuptohen paisjet dhe aparaturat, që shërbejnë si plotësuese të makinerive dhe që ndihmojnë për funksionimin e rregullt të tyre, si dhe për matjen dhe kontrollin e parametrave të punës.

Investimet që përfitojnë nga skema e shtyrjes së pagesës së TVSH, duhet të kryhen të paktën në njërën nga fushat e mëposhtme:

a) Në prodhim, me të cilin kuptohet instalimi i makinerive dhe i linjave teknologjike, për të realizuar shfrytëzimin e pasurive natyrore(përfshirë ato ujore), rritjen e bimëve dhe të kafshëve dhe përpunimin industrial të lëndëve të para e të gjysmëprodukteve.

b) Në ndërtim, me të cilin kuptohet ngritja e parkut të makinerive dhe paisjeve të nevojshme për të realizuar sipërmarrjet ndërtimore.

c) Në telekomunikacion, me të cilin kuptohet instalimi i centraleve dhe i sistemit të antenave, linjave dhe aparaturave të nevojshme për të realizuar telekomunikimin masiv.

ç) Në transport me impiante fikse, me të cilin do të kuptohet realizimi i instalimeve të përhershme, të linjave, makinerive e paisjeve, që i shërbejnë transportit të udhëtarëve e të mallrave.

Makineritë dhe paisjet që përfitojnë nga kjo skemë, duhet të regjistrohen në llogaritë e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të investitorit.

Kur personat e tatueshëm për TVSH, importojnë makineri dhe pajisje sipas klasifikimit të bërë në VKM nr.49, dt.26.01.2001 dhe VKM NR 122,DT.03.03.2005, atyre i lejohet shtyrja e pagesës së TVSH mbi importet deri në momentin e dorëzimit të deklaratës përkatëse të TVSH. Kjo do të thotë që, kjo kategori mallrash nuk i nënshtrohet pagimit të TVSH-së në doganë.

Në këto raste, importuesit bëjnë menjëherë një faturë tatimore shitje me TVSH (brenda vendit) për të njëjtën vlerë të makinerive dhe pajisjeve të importuara nën skemën e shtyrjes se pageses, ku edhe shitesi dhe blerësi është i njëjti person. Kjo faturë regjistrohet në librin e shitjeve dhe të blerjeve.Në librin e blerjeve do të regjistrohen të dhënat e faturës tatimore të blerjes dhe referencat e Deklaratës Doganore të importit.

Nëse importuesi gëzon të drejtën e 100% të kreditimit tatimor për blerjet (d.m.th. makineritë dhe pajisjet e importuara do t`i shërbëjnë krejtësisht veprimtarisë së tij te tatueshme), TVSH-ja e aplikueshme ne import, do të zbritet totalisht nga po e njëjta shumë TVSH-je e llogaritur mbi shitje sipas paragrafit 2, në të kundërt do të zbatohet paragrafi "Kreditimi i pjesshëm" i këtij Udhëzimi të Ministrit të Financave, "Për TVSH".

Në deklaratën përkatëse të TVSH, vlera e tatueshme në import e makinerive e pajisjeve dhe TVSH e llogaritur mbi këto mallra, raportohen në kutitë përkatëse të importit (14,15 te FDP) dhe në të njëjtën deklaratë raportohen si shitje brenda vendit dhe TVSH e llogaritur mbi këto shitje (11 e 12 te FDP).

Tatimpaguesit që përfitojnë nga kjo skemë, detyrohen që të dorëzojnë në Degën e Tatimeve, ku personi i tatueshëm është i regjistruar, brenda datës 14 të muajit pasardhës, përveç FDP edhe dokumentet e mëposhtëme në dy kopje:

- Kopje të Faturës së Shitjes së hartuar si më lart shpjeguar.
- Kopje të librit të shitjes dhe blerjes të periudhës përkatëse tatimore.
- Kopje të Deklaratës Doganore të Importit.

Në Degën e Doganës përkatëse, me qëllim për të mbyllur llogaritë kontabel të importimeve, tatimpaguesit dorëzojnë brenda dates 25 të muajit pasardhës një kopje të çdo dokumenti të mëposhtëm:

- Kopje të Faturës së Shitjes së hartuar si më lart shpjeguar.
- Kopje të librit të shitjes dhe blerjes të periudhës përkatëse tatimore.
- Kopje të FDP, të gjitha këto të vulosura nga zyra e TVSH.

Mos dërgimi i të gjithë dokumentacionit në zyrat e doganës, i jep të drejtë organeve doganore të pezullojnë aplikimin e kësaj skeme.

Inspektorët e vlerësimit një kopje të librave përkatës i vendosin në dosjen e tatimpaguesit me qëllim që të përdoret gjatë kontrollit. Kjo do të sigurojë përputhshmërinë me realitetin gjatë kontrollit të ardhshëm.

7.10 Kartat telefonike te parapaguara

Operatorët kryesorë të telekomunikacioneve llogarisin dhe paguajnë TVSH për vlerën e plotë të kartave telefonike të parapaguara që ata i furnizojnë distributorëve të tyre. Me vlerë të plotë do të kuptohet çmimi i shpallur ose çmimi përfundimtar i përcaktuar nga operatori kryesor që emeton kartat.

Furnizimi i këtyre kartave në vazhdim nga distributorët do të konsiderohet jashtë objektit të TVSH-së dhe distributorët nuk kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e faturuar nga operatorët kryesorë në lidhje me këto karta. Ndërkohë, distributorët e kartave telefonike të parapaguara i faturojnë operatorit kryesor vlerën e komisionit që ato përfitojnë për shërbimin që kryejnë. TVSH e llogaritur në këtë rast, është e kreditueshme për operatorin kryesor.

Shembull:

Supozojmë që operatori kryesor i telekomunikacionit X hedh në treg karta telefonike me çmim të shpallur 1 000 lekë (përfshirë TVSH).

Kjo shoqëri do të lëshojë një faturë ku TVSH e llogaritur do të jetë:

833.4+166.6(TVSH)=1.000 lekë.

Shoqëria distributore Y që blen kartën me faturën e mësipërme, nuk llogarit më TVSH në rishitjen e kësaj karte dhe nuk ka të drejtë të kreditojë 166.6 lekë TVSH të faturës së lëshuar nga operatori kryesor.

Në rast se për shërbimin që I kryen operatorit X, distribtori Y përfiton një komision në masën 15 % të çmimit të shpallur të kartës = 150 lekë, atëherë ai I lëshon një faturë tatimore me TVSH, ku TVSH e llogaritur do të jetë: 150:6=25 lekë pra, 125+25(TVSH) = 150 lekë.

Operatori kryesor X ka të drejtë të kreditojë TVSH në blerje për shumën 25 lekë.

7.11 Shitja e librave, e gazetave, e revistave dhe shërbimet e reklamave në to

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetat. Në këtë rast vlera e tatueshme në faturat tatimore që shtypshkronjat lëshojnë për gazetat, nuk ngarkohet me TVSH.

Shitja e gazetave, e revistave dhe e librave të çdo lloji është furnizim i përjashtuar.

Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar dhe nga media elektronike është i furnizim i përjashtuar.

Vlera e tatueshme në faturat tatimore që mediat e shkruara dhe elektronike lëshojnë për porositësit e reklamave, nuk ngarkohet me TVSH.

Furnizim i perjashtuar eshte edhe shitja e Fletores Zyrtare te Republikes se Shqiperise, botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.

7.12 Importuesit e vegjël

Personat e tatueshëm që realizojnë një qarkullim më të vogël se 8 milionë lekë për çdo vit kalendarik, nuk janë të detyruar të regjistrohen për TVSH-në. Ne kete rast ata mbeten tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel dhe tatimit te thjeshtuar mbi fitimin.

7.13 Lojrat e fatit, kazinotë dhe hipodromet.

Furnizimet e shërbimeve të lojërave të fatit, të kazinove dhe të hipodromeve, janë furnizime të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

7.14 Eksportet

Në bazë të pikës "a" të nenit 31 të Ligjit, mallrat që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të tatueshme. Shkalla tatimore e aplikueshme është zero përqind. Si provë për të vërtetuar eksportet, do të shërbejë fatura dhe DAV (Dokumenti i Vetëm Administrativ) dhe deklarata doganore e eksportit. Forma dhe permbajtja e deklarates doganore te eksportit eshte sipas formatit tip

te miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

Vlera e eksportit është e barabartë me vlerën e paraqitur në faturën tatimore të lëshuar nga personi i tatueshëm.

Moment i furnizimit, pra i regjistrimit të eksportit në librin e shitjeve të personit të tatueshëm eksportues (kur eksporti quhet i kryer) është "Data e Çlirimit", datë kur mallrat clirohen nga dogana. Ajo paraqitet në "Urdhërin e Lëshimit", dokument i lëshuar nga organi doganor dhe i bashkëngjitet si provë deklaratës doganore të eksportit.

8. Faturat

8.1 Të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore

Faturat janë dokumenti bazë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Ato përcaktojnë detyrimin tatimor të furnizuesit dhe shumën e tatimit të zbritshëm që do ti lejohet të kërkojë blerësi i regjistruar për TVSH.

Një person i tatueshëm i cili bën një furnizim (edhe nëqoftëse furnizimi është i përjashtuar apo me 0 përqind) detyrohet t'i lëshojë personit që merr furnizimin (edhe nëqoftëse ai, pra blerësi, nuk është person i tatueshëm) një faturë tatimore (neni 36 paragrafi 1).

Fatura, e cila prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sipas formularit tip bashkengjitur ketij udhezimi, duhet të përmbajë :

- numrin rendor;
- numrin serial te parashtypur;
- datën e lëshimit;
- emrin, adresën, numrin e identifikimit të shitësit;
- emrin, adresën, numrin e identifikimit të blerësit;
- emrin dhe adresen e bleresit, ne rastin e individeve (per shitje me pakice me vlere mbi 10 mije leke);
- emrin, adresën dhe NIPT-in e transportuesit, targën e mjetit dhe orën e furnizimit;
- përshkrimin e hollësishëm të mallrave të shitura ose të shërbimeve te kryera;
- sasinë e mallrave të shitura ose vëllimin e shërbimeve të kryera;
- çmimin për njësi pa TVSH;
- vlerën totale të transaksionit pa TVSH;
- shumën e TVSH-se (nëqoftëse zbatohet TVSH);
- vlerën totale me TVSH;
- cilësimin furnizim i përjashtuar apo me 0 përqind (nëqoftëse ai është përkatësisht i përjashtuar apo i tatueshëm me 0 përqind).

Fatura lëshohet në jo më pak se tre kopje dhe shpërndahet si më poshtë:

- faqja 1 për blerësin;
- faqja 2, 3, etj. për shitësin dhe transportuesin.

Në fund të faturës shënohet shitesi me emër, mbiemër, nënshkrim dhe vulë, blerësi me emër, mbiemër, nënshkrim transportuesi me emër, mbiemër, nënshkrim (kur është dhe transportuesi).

Për shitje të bëra tek një individ konsumator jotregtar, në faturën e lëshuar nga shitësi paraqitet emri, mbiemri e adresa e blerësit.

Shitjet e një natyre të tillë i takojnë mallrave të konsumit përfundimtar dhe sasia e tyre është brenda kufijve normalë të konsumit individual ose familjar (jo për t'u rishitur ose për t'u përpunuar).

Vetëm origjinali i faturës i jep të drejtë blerësit për të kredituar (zbritur) TVSH-ne e paguar në blerje. Për qëllime të kreditimit tatimor, ne rastet kur kopja e pare origjinale humbet, do të konsiderohet e vlefshme per bleresin kopja e noterizuar e faturës së blerjes, me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë. Nëqoftëse fatura nuk përmban të gjitha të dhënat e përcaktuara më lart, blerësi nuk ka të drejtë të kreditojë (zbresë) TVSH-ne e paguar në blerje, kurse shitësi nga ana e tij do të paguajë TVSH-ne e detyrueshme për t`u paguar.

Në rastet kur një tatimpagues shet një sasi të konsiderueshme artikujsh në të njëjtën kohë e për të njëjtin klient, ai mund të lëshojë faturë kompjuterike. Por në këtë rast, faturën kompjuterike me të njëjtin numër duhet t`ia bashkëngjisë faturës tatimore të shperndare nga organet tatimore. Në këtë mënyrë, për çdo klient lëshohet detyrimisht fatura tatimore e emetuar nga organet tatimore, e cila do të plotësohet normalisht me të dhënat e shitësit dhe blerësit, ndërsa vlera e transaksionit të kryer me

klientin do te paraqitet ne total. Menyra e shperndarjes dhe administrimit te faturave tatimore te TVSH-se percaktohet ne nje rregullore te vecante te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, ka të drejtë të lejojë mospërdorimin e faturave me numër serial të parashtypur. Per kete, personat e tatueshëm duhet te paraqesin nje kerkese tek Dega e Tatimeve ku eshte regjistruar, duke treguar se sistemi i tyre i regjistrimeve është i kompjuterizuar, i aftë të prodhojë besueshmërisht fatura tatimore me nr. serial per çdo transaksion të tatueshëm dhe që kanë një numër të konsiderueshëm klientësh konsumatorë final. Ne kete rast tatimpaguesi paraqet edhe modelin e fatures qe do te perdore. Dega e tatimeve, pas verifikimit nese fatura kompjuterike qe tatimpaguesi do te leshoje permban te gjithe te dhenat e nevojshme per cdo artikull, kete kerkese se bashku me nje opinion te shkurter te saj, e dergon ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve. Kjo e fundit brenda 30 ditesh nga data e mberritjes se kerkeses jep ose jo miratimin per perdorimin e kesaj fature duke njoftuar me shkrim personin e tatueshem dhe degen e tatimeve.

Në rastin e miratimit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degës së Tatimeve në të cilën personi është regjistruar, i dorëzon atij zyrtarisht diapazonin e numrave seriale për faturat tatimore që do të lëshojë ky person.

Në bazë të pikës 2 të nenit 28 të Ligjit, personi që kryen furnizime të tatueshme, detyrohet të njoftojë në mënyrë të dukshme nëpërmjet shpalljes, kontratës apo reklamës nëse çmimi i mallrave apo i shërbimeve të furnizuara ose çmimi që duhet të paguhet për furnizimin përfshin ose jo TVSH. Në rast se furnizimi i tatueshëm kryhet pa një shumë të ndarë e të identifikuar si pagesë e TVSH, vlera e tatueshme e tij është shuma që së bashku me TVSH e pagueshme mbi këtë vlerë është e barabartë me pagesën totale që bëhet për furnizimin.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka të drejtë të autorizojë personat e tatueshëm që ushtrojnë veprimtari në fushën e përpunimit të qumeshtit, ullirit, rrushit dhe grurit, të lëshojnë fatura tatimore me TVSH për veten e tyre kur i blejnë këto mallra nga persona të tjerë, individë ose persona të paregjistruar për TVSH-në. Autorizimi jepet jo me vone 30 dite nga data e paraqitjes se kerkeses nga ana e tatimpaguesit. Autorizimi jepet pa afat dhe ai mund te revokohet sa here qe rrethanat e personit te taueshem ndryshojne apo sa here qe nga kontrollet e ushtruara rezulton se personi i tatueshem kryen shkelje ligjore. Për të përfituar këtë autorizim, personi i tatueshëm duhet ti drejtohet me kërkesë me shkrim deges perkatese te tatimeve, duke i bashkengjiten kartat teknologjike të prodhimit të artikujve të gatshëm nga përpunimi i lëndës së parë të grumbulluar.

Fatura e lëshuar nga blerësi duhet të përmbajë informacionin si më poshtë:

- Në një vend të dukshëm të shkruhet "Faturë e lëshuar nga blerësi, autorizuar nga DPT me autorizim nr …… dt ……."
- Blerësi dhe shitësi kanë rënë dakord që për një furnizim vetëm blerësi duhet të lëshojë faturë tatimore.
- Edhe blerësi dhe shitësi mbajnë nga një kopje të faturës.
- Të gjithë informacionin e detyrueshëm që duhet të mbajë një faturë tatimore në përputhje me Ligjin dhe Udhëzimin "Për TVSH-në".

Dega e tatimeve, pas verifikimeve te kryera, kerkesen e paraqitur nga personi i tatueshem, se bashku me nje opinion te shkurter te saj, e dergon ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve. Kjo e fundit brenda 30 ditesh nga data e mbrritjes se kerkeses leshon ose jo autorizimin duke ia derguar ate personit te tatueshem dhe deges se tatimeve.

Në rast se personi i tatueshëm blerës nuk plotëson kërkesat si më lart, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka të drejtë të mos leshoje autorizimin perkates. Ne kete rast tatimpaguesi ka te drejte te apeloje si per cdo vendim tjeter te administrates tatimore. Autorizimet e leshuara evidentohen ne nje regjister te vecante te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve.

8.2 Saktësimet

Nëqoftëse bëhet saktësim për një pagesë të bërë për një furnizim pasi është lëshuar fatura, shitësi duhet të lëshojë një faturë shtesë.

Një saktësim kryhet kur:

- furnizimi nuk është i njëjtë me atë që ka kërkuar blerësi;
- mallrat janë dëmtuar apo shërbimi nuk është kryer mirë;
- çmimet ndryshojnë për çfarëdo arsye (zbritje për pagesë të menjëherëshme, etj).

Në qoftë se çmimi rritet apo ulet shitësi duhet të lëshojë një faturë shtesë. Fatura shtesë lëshohet në të njëjtën formë si fatura dhe duhet të tregojë:

- shumë qartë, në një vend të dukshëm fjalët "faturë shtesë";
- numrin rendor dhe numrin serial të faturës së parë të cilën saktëson;
- shumën në para të rritjes apo uljes të çmimit;
- arsyen e saktësimit sipas rasteve të përcaktuara më sipër.

8.3 Borxhi i keq

Kur furnizuesi nuk ka marrë një pagesë plotësisht apo pjesërisht për një furnizim të kryer, kemi të bëjmë me një borxh të keq. Në këto raste e drejta për të lëshuar një faturë të borxhit të keq, lind :

- Pasi borxhi bëhet një borxh i keq. Kjo fillon 6 muaj pas periudhës tatimore në të cilen TVSH është zbatuar.
- Pasi shitësi të ketë paraqitur të gjitha provat që kërkon organi tatimor për të vërtetuar se ai ka ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura për të arkëtuar borxhin e keq.

Prova kryesore që detyrohet të paraqesë shitësi, është Vendimi i Gjykatës në të cilin vërtetohet se blerësi i tij është debitor dhe ka falimentuar, prandaj për këto arsye nuk mund t`i paguajë shitësit vlerën e furnizimit të marrë. Pa këtë vendim, organet tatimore nuk munden në asnjë rast të pranojnë borxhin e keq si të tillë.

Në rastin e një borxhi të keq, shitësi duhet të lëshojë një faturë të borxhit të keq. Kjo faturë lëshohet në të njëjtën formë si një faturë normale. Ajo duhet të te tregojë fjalët "borxh i keq", numrin rendor të faturës të parë me të cilën lidhet ky borxh dhe të tregojë që kreditimi i tatimit të blerësit duhet të zvogëlohet. Kjo faturë përdoret nga shitësi për të zvogëluar detyrimin për TVSH, ndërsa nga blerësi për të zvogëluar kreditimin e TVSH.

Kur vetëm një pjesë e vlerës së transaksionit nuk është arkëtuar, atëherë fatura duhet të tregojë shumën e pa arkëtuar të transaksionit dhe TVSH që i përket kësaj shume.

Për shembull:

Në faturën e parë:	
Shuma për t’u arkëtuar, përfshirë TVSH është	90 lek:
- TVSH për t’u arkëtuar	10 lek
- Shuma e arkëtuar	54 lek
- TVSH e arkëtuar	6 lek
Në faturën e borxhit të keq:	
Shuma e paarkëtuar	36 lek
- TVSH për t’u kredituar (saktësuar)10-6	4 lek

Saktësimet mbi bazën e faturës të borxhit të keq regjistrohen nga shitësi në librin e shitjeve si pakësim detyrimi për TVSH ndërsa nga blerësi në librin e blerjeve si pakësim kreditimi për TVSH.

Kur kreditimi për një borxh të keq lejohet dhe i gjithë ose një pjesë e këtij borxhi paguhet më vonë, shitësi duhet të lëshojë një faturë të re. Për lëshimin e kësaj fature zbatohen të njejtat rregulla dhe fatura e re duhet të tregojë fjalët "borxh i keq i paguar" dhe numrin e "faturës të borxhit të keq" me të cilën ka lidhje.

8.4 TVSH e zbatuar nga një person i cili nuk është i regjistruar

Paragrafi 5 dhe 6 i nenit 36 të ligjit parashikon që, personi i cili nuk është i regjistruar dhe lëshon faturë me TVSH apo le të kuptohet se ka zbatuar TVSH, paguan TVSH e treguar në faturën që ka lëshuar. Veç kësaj, bazuar ne nenin 57 te ligjit dhe ne piken 19.1. te ketij udhezimi, masa e dënimit është e barabartë me shumën e TVSH të zbatuar.

9. Mbajtja e regjistrimeve

9.1 Libri i blerjeve

Libri i blerjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe permbajtja e tij eshte sipas formularit bashkengjitur ketij udhezimi. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë. Në të regjistrohen për çdo transaksion furnizuesi dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin.

Në këtë libër regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial i shtypur nga shtypshkronja ose nga tatimpaguesi kur i lejohet, të dhënat e deklaratës së importit,emri i shitësit dhe numri i identifikimit tatimor të tij.

Blerjet regjistrohen në vlerë totale e cila përfshin edhe TVSH (nëqoftëse ka) si dhe të ndara në blerje me TVSH dhe në blerje pa TVSH. Blerjet me TVSH regjistrohen të ndara në importe dhe blerje

brenda vendit. Për çdo blerje me TVSH personi regjistron vlerën e tatueshme dhe TVSH që i korespondon kësaj blerje.

Në fund të librit të blerjeve janë fletët e inventarit të cilat përdoren për të pasqyruar inventarin e mallrave në fund të vitit.

Një kopje e regjistrimeve mujore në librin e blerjeve do të paraqitet degen e tatimeve brenda dates 14 te cdo muaji.

9.2 Libri i shitjeve

Libri i shitjeve është i detyrueshëm të mbahet nga të gjithë personat e tatueshëm. Forma dhe permbajtja e tij eshte sipas formularit bashkengjitur ketij udhezimi. Ai duhet të tregojë në faqen e parë numrin e identifikimit dhe emrin e personit të tatueshëm. Të gjitha faqet duhet të kenë numër rendor. Libri plotësohet çdo ditë. Në të regjistrohen për çdo transaksion klienti dhe të dhënat e faturës që paraqet transaksionin. Në librin e shitjeve regjistrohen data e lëshimit të faturës, numri rendor i faturës, numri serial I shtypur nga shtypshkronja ose nga tatimpaguesi kur i lejohet dhe data e numri i deklaratës doganore kur mallrat eksportohen, emri i klientit dhe numri i identifikimit të tij (në qoftë se ka). Në të regjistrohet vlera totale e transaksionit përfshire TVSH (nëqoftëse ka).

Shitjet regjistrohen të ndara në të përjashtuara, me zero përqind dhe të tatueshme. Për çdo shitje të tatueshme regjistrohen vlera e tatueshme dhe TVSH.

Një kopje e regjistrimeve mujore në librin e shitjes paraqitet ne degen e tatimeve brenda dates 14 te cdo muaji.

9.3 Regjistrimet elektronike

Regjistrimet (librat e shitjes dhe të blerjes) mund të mbahen edhe në kompjuter. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të lejojë hyrjen e organeve tatimore në çdo kompjuter ku janë mbajtur regjistrimet, për të kryer inspektime të ndryshme mbi regjistrimet e mbajtura.

10. Deklarimi

10.1 Deklarata dhe pagesa e TVSH-se

Formulari i deklarimit dhe pageses se TVSH plotësohet në dy kopje dhe paraqitet nga personi i tatueshëm në degën përkatëse të bankes, me të cilat DPT ka lidhur marëveshje per pranimin e pagesave të TVSH, brenda 14 ditëve pas përfundimit të periudhes tatimore.

Punonjësi i bankës bën shënime në pjesën e tretë të dokumentit "pagesa" pastaj i kthen personit të tatueshëm kopjen e dytë. Në fund të cdo dite origjinalët e deklaratës dhe pagesës të TVSH mblidhen nga banka dhe ju dorëzohen organeve tatimore perkatese për përpunim sic parashikohet ne marëveshjet e lidhura midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe bankave përkatëse.

Personi i tatueshëm paraqet deklaratën e TVSH në bankë edhe nëqoftëse ai nuk ka për të paguar detyrim tatimor. Plotësimi i saktë i deklaratës, paraqitja dhe pagesa brenda afateve kohore të përcaktuara është detyrim ligjor për të gjithe personat e tatueshëm. Moszbatimi i këtij detyrimi ngarkon me përgjegjësi ligjore personin e tatueshëm dhe dënohet në bazë të ligjit për TVSH dhe të udhëzimit në zbatim të tij.

Deklarata përbëhet nga tre pjesë:

a) Pjesa e parë kërkon të dhëna për identifikimin e personit të tatueshëm.

b) Pjesa e dytë kërkon të dhëna për llogaritjen e detyrimit tatimor.

c) Pjesa e tretë është pagesa e TVSH e cila plotësohet nga banka.

Formulari i deklarimit dhe pageses eshte sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi.

11. Shitja me pakicë

Konsiderohen shitje me pakicë të gjitha ato furnizime që bëhen:

(i) për konsum përfundimtar;

(ii) në ato sasi që nuk tejkalojnë nevojat private normale të konsumatorit; dhe

(iii) që nuk rishiten.

Te gjithe tatimpaguesit, te cilet ne aktivitetin e tyre kryejne njekohesisht tregti me shumice per tatimpagues te tjere dhe tregti me pakice per publikun e gjere, jane te detyruar te bejne nje gje te tille ne vende te vecanta, te ndara nga njeri tjetri. Ne nje mjedis te deklaruar si vend per shitje me shumice per tatimpagues te tjere nuk mund te behen shitje me pakice per publikun dhe e kunderta, ne nje mjedis te deklaruar si vend per shitje me pakice per publikun nuk mund te behen shitje me shumice per tatimpagues te tjere. Kur pretendohet se ne ambientet e shitjes me pakice jane kryer edhe shitje me shumice, keto te fundit vleresohen sikur te jene shitur me cmimet e shitjes me pakice. Cdo vend veprimtarie te shitjes me shumice dhe te shitjes me pakice duhet të pajiset me Çertifikatë Regjistrimi

me numra të ndryshëm seriale.

Shitësit me pakicë detyrohen të lëshojnë fatura tatimore në rastet kur shitja, perfshire TVSH, është më e madhe se 10.000 lekë apo kur blerësi është person i regjistruar si tatimagues. Faturat regjistrohen kronologjikisht një per nje në librin e shitjeve.

Hipermarketet detyrohen te leshojnë fatura tatimore në rastet kur vlera e tatueshme në shitje, përfshirë TVSH, është më e madhe se 40.000 lekë.

Në çdo rast tjetër shitësit me pakicë lëshojnë kupona tatimore të arkave regjistruese ose dëftesa tatimore, kur nuk kanë arka regjistruese, siç përcaktohet në Ligjin Nr.7758 datë 12.10.1993 "Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet". Kuponi tatimor dhe dëftesa tatimore nuk është e detyrueshme të përmbajë përveç shumës totale të tij edhe TVSH-në e llogaritur. Për të gjetur shumën e TVSH-së të përfshirë në vlerën totale të kuponit apo defteses tatimore, kjo vlerë shumëzohet me 16,666 përqind ose pjestohet me 6. Në këto raste, regjistrimi në librin e shitjeve nga shitësit me pakicë do të bëhet në mënyrën e mëposhtme:

Totali i të ardhurave ditore duhet të regjistrohet çdo ditë. Në kollonën TVSH të librit të shitjeve do të shënohet shuma e TVSH së mbledhur e cila është rezultat i produktit të totalit të shitjeve me TVSH shumëzuar me 16.666 përqind ose i pjestimit të totalit të shitjeve me TVSH me 6. Të ardhurat ditore duhet të mbështeten nga dokumenta justifikuese që dëshmojnë për saktësinë e tyre, të tilla si kuponat e arkave regjistruese dhe dokumenta të tjera në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

12. Lidhjet midis administratës tatimore dhe asaj doganore

Organet tatimore dhe ato doganore janë të detyruara të shkëmbejnë informacion për transaksionet që lidhen me importin apo eksportin e mallrave të kryer nga personat e tatueshëm mbi bazën e specifikimeve të përcaktuara në Akt-Marrveshjet e nënshkruara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave për zbatimin e këtij ligji. DPD i dergon DPT periodikisht, sipas afateve të përcaktuara në Akt-Marrëveshje, të dhënat për importet dhe eksportet. DPT i dergon DPD, brenda dates 10 te muajit pasardhes, listen e NIPT-ve te azhornuar.

13. Ambalazhet

Ambalazhet mund te jene qarkulluese dhe te pakthyeshme. Ne funksion te ketij dallimi ndryshon edhe menyra e aplikimit te TVSH.

13.1 Ambalazhet qarkulluese

Ambalazhet qarkulluese jane ambalazhe te tipit konteniere, qelqe, arka, bombola apo depozita gazi te lengshem dhe te tjera te kesaj natyre. Ambalazhet qarkulluese si rregull furnizohen se bashku dhe ne te njejten kohe me mallrat qe ato permbajne. Keto lloj ambalazhesh jepen nga shitesi (furnitori), se bashku me mallin ne to ne drejtim te bleresit (klientit); ato ruhen provizorisht nga bleresi dhe me pas kthehen nga ky i fundit perseri ne drejtim te shitesit. Blerja e ambalazheve nga shitesi i jep atij te drejten e kreditimit te TVSH-se sipas rregullave te parashikuara ne nenin 33 te ligjit per TVSH. Vlera e ambalazheve qe i jepen bleresit nga shitesi nuk perfshihen ne vleren e tatueshme te mallrave qe ato shoqerojne gjate furnizimit. Ambalazhet qe i jane dhene bleresit, duhet te kthehen tek shitesi brenda nje afati normal sipas fushes se aktivitetit te cilit ato i takojne. Ky afat varion edhe sipas natyres se produktit qe ambalazhet permbajne dhe duhet te paraqitet ne kontraten e lidhur mes paleve.

Per mosllogaritjen e TVSH mbi vleren e ambalazheve qarkulluese duhen plotesuar dy kushtet e meposhteme:

- Vlera e tyre te mos jete perfshire ne vleren e fatures nga shitesi.
- Te ekzistoje nje kontrate e lidhur midis paleve per dhenien dhe kthimin e ambalazheve. Ne kontrate paraqitet edhe afati i kthimit te ambalazheve nga bleresi tek shitesi. Ambalazhet qe bleresi nuk i kthen tek shitesi konsiderohen sikur te ishin shitur dhe i nenshtrohen TVSH-se mbi vleren e tyre.

13.2 Ambalazhet e pakthyeshme

Jane ambalazhe te natyres si kartona, shishe plastike, qese plastike, etj. Vlera e ketyre ambalazheve eshte element i vleres se tatueshme te mallrave qe ato permbajne. Blerja e ambalazheve nga shitesi, i jep atij te drejten e kreditimit te TVSH-se sipas rregullave te parashikuara ne nenin 33 te ligjit per TVSH. Mbi vleren e tatueshme te mallrave qe perfshin edhe vleren e ambalazheve, zbatohet TVSH ne shitje.

14. Kreditimi i tatimit

14.1 Permbajtja

TVSH e kreditueshme (i zbritshëm) është shuma e TVSH-se që personi i tatueshëm paguan në momentin që ai blen mallra apo shërbime brenda vendit, si dhe shuma e TVSH-se që ai ka paguar për

importet e bëra, me kushtin që, këto furnizime t`i shërbejnë vetëm furnizimeve të tatueshme që do të bëjë ky person i tatueshëm.

Nëse furnizimet e marra ose importet e bëra i shërbejnë furnizimeve të përjashtuara që mund të bëjë personi i tatueshëm, nuk lejohet kreditimi i TVSH së paguar në lidhje me furnizimet e marra për këto qëllime. Kur furnizimet që merr një person i tatueshëm, qoftë duke blerë brenda vendit qoftë duke importuar, nuk janë të destinuara për ushtrimin e një veprimtarie ekonomike ,sipas nenit 17 ”Veprimtaria ekonomike”, ai nuk ka të drejtë të kreditojë (zbresë) TVSH e paguar për këto blerje ose importe.

Nëse personi i tatueshëm i përdor furnizimet e marra ose importet e bëra edhe për qëllime të furnizimeve të tatueshme edhe për qëllime të furnizimeve të përjashtuara njëkohësisht, kreditimi i tatimit të paguar bëhet përpjestimisht sipas paragrafit 18 të këtij udhëzimi.

14.2 Forma

Kreditimi i TVSH-së paguar në blerje do të kërkohet mbi bazën e faturës tatimore origjinale të lëshuar sipas nenit 36 te ligjit mbi TVSH-ne. Për qëllime të kreditimit tatimor, konsiderohet e vlefshme edhe kopja e noterizuar e faturës së blerjes (ne rast se fatura origjinale humbet), me kusht që shitësi të zotërojë origjinalin dhe ta ketë deklaruar atë. Pa këtë faturë nuk mund të zbritet TVSH e paguar në blerje.

Për të kredituar TVSH e paguar në import tatimpaguesit duhet të zotërojnë deklaratën doganore origjinale të importit.

14.3 Momenti i kreditimit

Kreditimi i tatimit për një periudhë tatimore është totali i TVSH i zbatuar në lidhje me:

- Të gjitha furnizimet e tatueshme të bëra për personin e tatueshëm gjate kësaj periudhë tatimore nga persona të tjerë të tatueshëm.

- Të gjitha importet e mallrave të bëra nga personi i tatueshëm gjatë kësaj periudhe tatimore.

Periudha tatimore, sipas nenit 38 te ligjit, është muaji kalendarik. TVSH e hyrjeve nuk mund të zbritet përpara periudhës të cilës i përket. TVSH e hyrjeve mund të paraqitet si e kredituesshme vetëm brenda 12 periudhave tatimore. Pas kësaj periudhe tatimpaguesi nuk ka të drejtë të kreditojë më TVSH e faturuar (fatura regjistrohet si blerje me TVSH jo të zbritëshme). TVSH e hyrjeve regjistrohet në periudhën tatimore në të cilën po kërkohet kreditimi. Kreditimi i TVSH së hyrjeve jo në periudhën përkatëse dënohet sipas shkronjës b të pikës 19.6 të këtij udhëzimi.

14.4 Kreditimi në rastet e eksporteve

Në rastet kur eksportuesit zotërojnë Deklaratën Doganore të Eksportit (DAV- Dokumenti Administrativ i Vetëm), origjinale ose në mungesë të saj fotokopje të legalizuar nga organet doganore, bazuar në ligjin mbi TVSH-ne, neni 33, kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e paguar në blerjet që i shërbejnë eksporteve. Në këto raste, organet tatimore njohin si të zbritshme TVSH-ne e paguar në blerjet e bëra në funksion të eksporteve të kryera ose për t’u kryer (fatura tatimore origjinale të kontrolluara nga organet tatimore).

14.5 Kreditimi në rastet e importeve

Moment i regjistrimit të importit në librin e blerjeve të personit të tatueshëm importues (kur importi quhet i kryer) është “Data e Çlirimit“, datë kur mallrat clirohen nga dogana. Ajo paraqitet në “Urdhërin e Lëshimit“, dokument i lëshuar nga organi doganor dhe i bashkëngjitet deklaratës doganore të importit.

Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përcaktohet mbi bazën e dispozitave të legjislacionit doganor pavaresisht nese mallrat e importuara janë apo jo të taksueshme me taksa doganore.

Vlera e tatueshme e mallrave të importuara përfshin, gjithashtu:

- shpenzimet e transportit e te sigurimit dhe shpenzimet e tjera, te perfshira ne importimin e mallrave dhe lëvrimin e tyre, deri ne momentin e çastin e hyrjes ne territorin e Republikes se Shqiperise;

- tarifat, taksat dhe detyrime të pagueshme, si pasojë e eksportimit të këtyre mallrave nga shtete prej të cilave ato eksportohen apo të pagueshme si rezultat i importimit të tyre, përveç TVSH të pagueshëm që nuk përfshihet në bazë të këtij ligji.

Pas zhdoganimit, organet doganore mund të bëjnë rivlerësime të vlerës doganore të mallrave

të importuara. Dallohen rastet :

a) Rivleresim ne rritje i vlerës doganore te importit: personi i tatueshëm eshte debitor ndaj doganes. Vetem pasi ai shlyen detyrimin ndaj doganes i njihet vlera e rritur e TVSH së zbritshme nga importi ne FDP e muajit në të cilin është bërë pagesa. Rivleresimet ne rritje të vlerës doganore raportohen per DPT nga organet doganore, vetem ne rastin kur ato jane paguar.

Shembull:

Ne 12 Janar 2006 tatimpaguesi ka bërë një import me vlerë të tatueshme prej 100 000 lekë. Ne FDP e periudhes tatimore 200601 tatimpaguesi raporton vlerën 100 000 leke ne kutine 14 dhe TVSH përkatëse prej 20 000 lekë në kutinë 15. Në 25 Shkurt 2006 dogana e rivlereson në rritje vlerën e tatueshme në shumën 200 000 leke. Tatimpaguesi do te pasqyroje ne librin e blerjeve diferencën ndermjet vleres se fundit dhe vlerës së mëparshme të deklaratës pra, 200 000 – 100 000=100 000 lekë. TVSH që paguan tatimpaguesi për diferencë është 20 000 lekë. Pagesa bëhet në 5 mars 2006, që është edhe data e regjistrimit ne librin e blerjeve Njëkohësisht në FDP e periudhës tatimore 200603, do të rriten respektivisht kutia (14) Importet me 100 000 lekë dhe kutia (15) e TVSH së zbritshme me 20 000 lekë.

b) Import rivleresim ne ulje i vlerës doganore: personi i tatueshëm ka paguar TVSH ne dogane më shumë nga sa i takonte dhe nga ana tjetër në organin tatimor ka deklaruar TVSH te zbritshme me shume nga sa i takonte. Në këtë rast organi doganor nuk e rimburson personin e tatueshëm, dhe ai nuk e ndryshon deklarimin e TVSH te zbritshme nga importi ne FDP e muajit në të cilin ishte bërë deklarimi.

15. Kreditimi i pjesshëm i tatimit

Në mbeshtetje të nenit 33 pika 4, nëqoftëse një furnizim malli apo shërbimi përdoret pjesërisht për qëllime të furnizimeve të tatueshme të bëra ose për t'u bërë dhe pjesërisht për furnizime të përjashtuara, lejohet vetëm një pjesë e kreditimit të tatimit. Llogaritja e kreditimit të pjesshëm bëhet në bazë të përqindjes të kreditimit sic percaktohet ne piken 15.1.1. me poshte.

15.1.1 Përqindja e kreditimit te tatimit mbi vlerën e shtuar

Perqindja e kreditimit do të llogaritet si raport i shumës pa përfshirë TVSH të furnizimeve të tatueshme dhe eksporteve në numërues me qarkullimin gjithsej pa përfshirë TVSH në emërues

Përqindja e kreditimit eshte raporti: qarkullimi i tatueshem + eksporte/qarkullimi i tatueshem + eksporte + furnizime të përjashtuara

Llogariten dy përqindje kreditimi:

- përqindja fillestare dhe,
- përqindja përfundimtare.

15.1.2 Periudha që merret për llogaritjen e përqindjes të kreditimit

Periudha qe merret parasysh për llogaritjen e përqindjes fillestare të kreditimit të tatimit është viti i mëparshëm kalendarik. Nëqoftëse personi është në vitin e parë të regjistrimit, ai duhet të bejë një vlerësim të përqindjes me gjykimin e tij. Periudha që merret për bazë në llogaritjen e përqindjes përfundimtare të kreditimit është viti kalendarik në të cilin është bërë blerja (furnizimi i mallit apo shërbimit). Veprimet për llogaritjen e përqindjes të kreditimit dhe saktësimi i TVSH për t'u krediturar duhet të pasqyrohen në librin e blerjeve në periudhën kur bëhen llogaritjet.

15.1.3 Rregullimi përfundimtar

Jo me vone se data 31 janar e vitit pasardhes kalendarik, personi i tatueshëm duhet të rillogarisë përqindjen përfundimtare të kreditimit të TVSH që i takon furnizimeve të tatueshme, sipas qarkullimit të realizuar në fakt. Rregullimi përfundimtar bëhet kur përqindja përfundimtare e kreditimit ndryshon nga përqindja fillestare e kreditimit të zbatuar gjatë vitit me më shumë se 20%. Nëqoftëse ndryshimi nuk kalon 20%, kreditimi fillestar nuk ndryshon.

P.sh. në vitin 2003 qarkullimi gjithsej pa TVSH është 5 milionë lekë, nga i cili:

- furnizime të tatueshme 2,5 milionë lekë dhe,
- furnizime të përjashtuara 2,5 milionë lekë.

Përqindja e kreditimit të tatimit është:

2,5 milionë/5 milionë=50%

Në vitin 2004, qarkullimi gjithsej pa TVSH është 7.000.000 lekë nga te cilat:

- furnizime të tatueshme 2 milionë lekë;
- furnizime të përjashtuara 5 milionë lekë.

Përqindja e kreditimit të tatimit është:

2 milionë/7 milione=28.5%

Në mars te vitit 2004 blihet një banak me një vlerë 10 mije leke. TVSH i paguar është 1250 lekë. Në këtë kohe personi i tatueshëm mund të llogaritë vetëm përqindjen fillestare të kreditimit atë të vitit 2003. Prandaj kreditimi i pjesshëm i tatimit do të llogaritet me përqindjen fillestare të kreditimit:

1250 x 50%=625 leke

Në janar 2005 do të bëhet rregullimi përfundimtar i kreditimit të pjesshëm të kërkuar sepse përqindja fillestare me të cilën është llogaritur kreditimi i pjesshëm i tatimit ndryshon nga përqindja përfundimtare e vitit 2004, me më shumë se 20%.

- Kreditimi përfundimtar i TVSH 1250x28.5%=356 lekë;
- Kreditimi fillestar i TVSH 625 lekë;
- Rregullimi në minus 625 - 356 = 269 lekë.

Veprimet për rregullimin përfundimtar të kreditimit pasqyrohen në librin e blerjeve në janar të vitit pasardhes kalendarik dhe raportohen në deklaratën e këtij muaji. Në deklaratën e muajit janar 2005 kreditimi i TVSH pakësohet me 269 lekë.

Aktivet e qendrueshme

Për aktivet e qëndrueshme rregullimi i kreditimit të pjesshëm do të bëhet me 2 mënyrat e meposhtme :

Mënyra e parë është ajo e përshkruar në paragrafin e mësipërm për furnizimet e zakonshme të mallrave dhe shërbimeve.

Mënyra e dytë do të përdoret vetëm në rastet kur cmimi i aktivit të qendrueshëm është më i madh se 1.000.000 lekë (pa TVSH) dhe ndryshimi i përqindjes fillestare të kreditimit me përqindjen përfundimtare është me i madh se 20 %. Kjo mënyre mban parasysh afatin e amortizimit të aktiveve te qëndrueshme. Në këto raste, vetëm për qëllime të TVSH-se periudha e amortizimit të aktivit te qëndrueshëm do të merret 5 vjet.

P.sh., përqindja e kreditimit të tatimit për vitin 1999 është 60%. Në mars të vitit 2000 blihet një aktiv qëndrueshëm me një vlerë pa TVSH prej 2 milionë lekë. TVSH e paguar për aktivin e qendrueshëm eshte 250 mijë lekë, me nje kreditim te pjesshëm prej 150.000 leke, i llogaritur me përqindjen fillestare 60%:

250.000x60%=150.000 lekë.

Përqindja e kreditimit të TVSH për vitin 2000 është 30%.

Kreditimi përfundimtar i TVSH është 250.000x30%=75.000 lekë.

Kreditimi fillestar i TVSH është150 mije lekë.

Rregullimi i kreditimit në minus eshte 150.000-75.000=75.000 leke.

Ky rregullim do të behet në deklaratën e janarit 2001.

Përqindja kreditimit për vitin 2001 është 55%.

Ndryshimi i përqindjes të kreditimit të vitit 2001 me përqindjen e kreditimit të vitit 2000 është më i madh se 20%.

Ndryshimi është:

55% - 30%=25%

Rregullimi i kreditimit në plus llogaritet: (kreditimi përfundimtar x koeficientin e amortizimit vjetor) x ndryshimi i përqindjes të kreditimit të vitit 2001 nga përqindja e kreditimit të vitit 2000:

(75.000x1/5)x25%=3.750 lekë

Ky rregullim do të behet në deklaratën e janarit 2002.

Përqindja e kreditimit për vitin 2002,është 40%.Ndryshimi i saj me përqindjen e vitit 2001, nuk i kalon 20% (40%-25%)=15%.

Rregullimi i kreditimit eshte 0

Përqindja e kreditimit për vitin 2003 është 42%.

Rregullimi i kreditimit eshte 0.

Përqindja e kreditimit për vitin 2004 është 60%.

Rregullimi i kreditimit eshte 0.

Pra, rregullimi i fundit i kreditimit është 3.750 lekë.

15.1.4 Ndryshimet e përdorimit të aktiveve qëndrueshme.

Në qoftë se aktivet e qëndrueshme të përdorura për veprimtari të tatueshme ose për eksporte:

- përdoren më vonë për veprimtari private,
- i transferohen një veprimtarie të përjashtuar

- shiten dhe shitja nuk është e tatueshme,

- dalin jashtë përdorimit perpara afatit te amortizimit, atëhere rregullimi i kreditimit fillestar do të bëhet vetëm nëqoftëse aktivi kapital ndryshon përdorimin brenda 5 vjetëve nga data e blerjes ose e përfitimit dhe nëqoftëse çmimi i aktivit i tejkalon 1 milion lekë pa TVSH. Rregullimi bëhet duke përdorur koefiçientin e amortizimit vjetor që merret 1/5. Viti kalendarik i papërfunduar do të merret si vit i plotë. Veprimet e saktësimit të kreditimit fillestar duhet të pasqyrohen në librin e blerjeve.

Shembull. Një shoqëri blen brenda vendit në muajin gusht te vitit 2000 një aktiv të qëndrueshëm me një vlerë 2 milionë lekë. Kreditimi fillestar, pra TVSH e zbritshme, është 400 mijë lekë (2 milionë x 20% shkalla tatimore) dhe paraqitet në librin e blerjeve të muajit gusht 2000 nga shoqëria. Njëkohësisht kjo shumë paraqitet në kutinë 17 në FDP e muajit gusht 2000.

Në muajin maj të vitit 2002, kjo shoqëri e ndalon veprimtarinë e saj ekonomike dhe e mban aktivin e qëndrueshëm për përdorim privat. Meqenëse më parë shoqëria kishte deklaruar të plotë TVSH e zbritshme të aktivit asaj i lind detyrimi të bëjë rregullimin e kreditimit.

Rregullimi i kreditimit do të bëhet duke mbajtur parasysh nga të pesë vitet e amortizimit total të tij, 2 vjetët e mbetur në të cilat ky aktiv i qëndrueshëm nuk do të përdoret për veprimtari ekonomike:

Shuma e TVSH së zbritshme që duhet të kthejë shoqëria është 400.000x2/5=160 mijë leke.

Rregullimi bëhet në librin e blerjeve të shoqërisë në periudhën tatimore në të cilën ka ndodhur ngjarja që bën të detyrueshëm rregullimin e kreditimit.

Në rastin konkret, në librin e blerjeve të muajit maj 2002, në rreshtin e fundit do të paraqitet me storno shuma e TVSH së zbritshme prej 160 mijë lekë që do të kthehet nga shoqëria duke pakësuar totalin e TVSH së zbritshme të atij muaji.

Ne rastet kur shpenzimet e rinovimit apo rikonstruksionit te aktiveve te qendrueshme jane objekt i amortizimit sipas rregullave te percaktuara ne ligjin ”Per Tatimin mbi te ardhurat”, rregullimi i kreditimit te TVSH qe i perket ketyre shpenzimeve behet ne perputhje me afatin 5 vjecar qe fillon nga data kur keto shpenzime jane kryer.

15.1.6 Furnizimet te cilat perdoren edhe ne veprimtarine ekonomike edhe ne veprimtari jo ekonomike (per qellime private).

Në keto raste do të lejohet kreditimi i një pjese të tatimit të paguar në blerje, nese personi ka dokumenta ku pasqyrohet saktë pjesa e shpenzimeve që është e lidhur me veprimtarinë ekonomike.

15.2 Llojet e furnizimeve të tatueshme dhe importimeve për të cilat nuk lejohet kreditimi

Në mbështetje të nenit 33 pika 5 kreditimi i tatimit nuk lejohet për:

a) Shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur :

- qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e karburantit me qëllim për ta shitur atë.

- gazoilit që përdoret për kryerjen e veprimtarisë ekonomike të tatueshme.

b) Shpenzimet për udhetime e dieta, strehimin në hotele dhe veprimtari çlodhëse gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike.

c) Shpenzimet për autovetura, përveç rasteve kur:

- Qëllimi i veprimtarisë ekonomike është blerja e autoveturave vetëm me qëllim për ti shitur ato.

- Përdorimi i veturave është i vetmi qëllim i veprimtarisë ekonomike (psh dhënia me qira, shërbimi i taksive, ambulancave).

ç) Shpenzimet e karburantit të çdo lloji, i perdorur per autoveturat.

d) Shpenzimet për artikuj publicitare,promocionale.

e) Të gjitha shërbimet në lidhje me shpenzimet e përmendura në paragrafët nga (a) në (d).

16. Rimbursimet

Në zbatim të nenit 50 të ligjit, personi i tatueshëm ka të drejtë të kërkojë rimbursimin e tepricës kreditorë të TVSH, kur ka mbartur një shumë kreditimi tatimor gjatë 3 muajve radhazi dhe kur kjo tepricë është më e madhe se 400,000 lekë.

Kur tatimpaguesi plotëson kushtet e mësipërme, ai plotëson formularin "Kërkesë për Rimbursim" sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi dhe e dërgon atë në degen perkatese te tatimeve. Dega e Tatimeve, është e detyruar të verifikojë në vend saktësinë e shumës së rimbursimit të kërkuar dhe e miraton atë brenda 30 ditësh nga data e paraqitjes së Kërkesës për Rimbursim. Dega e tatimeve harton në dy kopje listën e rimbursimeve të cilën ia dërgon degës përkatëse të bankës. Kësaj

liste të nënshkruar nga kryetari i deges se tatimeve i bashkëngjiten urdhër xhirimet përkatëse për çdo rast rimbursimi të miratuar dhe të përfshirë në listë. Urdhër xhirimet nënshkruhen nga kryetari i degës së tatimeve.

Pasi të jetë bërë rimbursimi, njëra kopje e listës së rimbursimeve do ti kthehet degës së tatimeve nga dega perkatese e bankes. Çdo rimbursim përmban datën e kryerjes dhe nënshkruhet nga nëpunësi i degës së bankës.

Çdo kerkese per rimbursim evidentohet ne nje regjister te vecante qe mbahet nga dega e tatimeve. Kerkesat ne kete regjister evidentohen ne menyre kronollogjike. Kontrolli i kerkesave per rimbursim behet duke respektuar radhen e vendosur ne kete regjister. Nuk mund te kontrollohet kerkesa per rimbursim e nje personi te tatueshem i cili e ka paraqitur kete kerkese pas nje personi tjeter te tatueshem situata e te cilit nuk eshte kontrolluar ende. Dhenja e rimbursimeve gjithashtu do te ndjeke rendin kronollogjik te regjistrit te kerkesave per rimbursim, me perjashtim te rastit kur nje kerkese per rimbursim eshte refuzuar zyrtarisht nga organi tatimor per arsye qe kane te bejne me rezultatet e kontrollit ose me shkelje te tjera ligjore. Ndaj cdo refuzimi per rimbursim, personi i tatueshem mund te apeloje si per cdo akt tjeter te organeve tatimore.

16.1 Rimbursimi i eksportuesve

Për qëllime të përfitimit të rimbursimit sipas nenit 50, paragrafi 4, do të quhen eksportues ajo kategori tatimpaguesish që:

- Eksporton sipas kuptimit të nenit 181 dhe 182 të Kodit Doganor.
- Vlera e eksporteve të bëra në një muaj përbën më shumë se 50% e vlerës totale të shitjeve duke përfshirë eksportet.

Teprica kreditore, që kërkohet si e rimbursueshme, duhet të plotësojë dy kushte në të njëjtën kohë:

- Të llogaritet si produkt i koeficientit N me totalin e TVSH të paguar në blerje, ku N të jetë më i madh se 50 %. N=Vlera totale e eksporteve të një muaji.
- Vlera totale e shitjeve të një muaji (përfshirë eksportet, por jo vlerën e faturave të bëra në skemën e pagesës së shtyrë) të jetë më shumë se 400 000 lekë.

Rimbursimi i eksportuesve bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tyre.

Në rastet e eksporteve, personi i tatueshëm që do të kërkojë rimbursimin duhet tí paraqesë organeve tatimore Deklaratën Doganore origjinale të importit në vendin pritës të mallit. Në mungesë të saj mund të paraqesin kopjen e deklaratës të konfirmuar nga autoritetet doganore të vendit importues ose të noteruara atje.

Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm për eksportuesit që klasifikohen me risk zero. Në këtë grup bëjnë pjesë ato eksportues që:

- prodhojne 100 % per eksport,
- kane nje aktivitet eksportues mbi tre vjet.
- kanë paraqitur të paktën një herë pranë organeve tatimore deklaratat origjinale të importit, kopje të tyre të konfirmuara nga autoritetet doganore të vendit pritës ose të noteruara atje.
- nuk kane asnje vleresim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore sipas metodave alternative, që përcakton neni 36 i ligjit të procedurave tatimore.
- mbajne sakte dokumentat e kontabilitetit në përputhje me ligjin «Për Kontabilitetin» dhe ligjin «Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet».
- kane pagesa te sakta dhe ne kohe te detyrimeve tatimore, doganore, dhe atyre te sigurimeve shoqerore dhe shëndetësore.

Këta persona të tatueshëm paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit Deklaratën Doganore te Eksportit,leshuar nga organet doganore shqiptare.

Klasifikimi i personave të tatueshëm eksportues me risk zero, bëhet nga Dega e Tatimeve në të cilën ato janë regjistruar, sipas procedurave te percaktuara ne aktet nenligjore per zbatim.

16.2 Rimbursimi per marreveshjet financiare

Në zbatim të Dekretit të Presidentit Nr.1582, datë 15.08.1996, për rastet e marrëveshjeve financiare të ratifikuara në Kuvend ose të miratuara nga Qeveria në formën e granteve, parashikohet mospërdorim i burimeve financiare të huaja për të paguar taksa e tatime, duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar. Tatimi i paguar do t'u rimbursohet financuesve të huaj nga administrata tatimore brenda 45 ditëve.

Proçedurat e rimbursimit të TVSH së paguar si më lart do të jenë si më poshtë:

a) Kur TVSH paguhet direkt nga donatori

Kur TVSH paguhet direkt nga njësia zbatuese e donatorit apo e projektit në Shqipëri si për blerjet brenda vendit ashtu dhe për importet, njësia paraqet në degen e tatimeve (ku ka qendrën njësia zbatuese e projektit) dokumentacionin e meposhtem:

- Kërkesën për rimbursim ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim, etj.

- Kopjen ne shqip te noterizuar te Marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose te Marrëveshjes së miratuar nga Qeveria. Marrëveshja duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e Marrëveshjes shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtar të çdo projekti.

- Deklaratën mujore të TVSH-se, teprica kreditore e të cilës (kutia 22) duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH-se që kërkohet të rimbursohet.

- Faturat origjinale të blerjes (në rastin e blerjeve brenda vendit) dhe deklaratat origjinale doganore (për rastet e importeve). Si faturat ashtu dhe deklaratat doganore të importit duhet të përmbajnë në mënyrë shumë të dukshme shënimin: "Blerja/importi bëhet në kuadrin e marrëveshjes së ratifikuar në Kuvend ose të miratuar nga Keshilli i Ministrave me Nr. __, datë __/ __/ 200 _ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë se zbatimit të projektit i njohur nga dega e tatimeve (në bazë të listës së mësipërme) i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

b) Kur TVSH paguhet nga sipërmarrësit e punimeve për zbatimin e projekteve

Kryerja e punimeve për zbatimin e projekteve do të ngarkohet kurdoherë me TVSH, e cila në çdo rast do të paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit. Por kjo TVSH do ti jepet atij (përkundrejt paraqitjes së situacionit me TVSH) ose nga donatori i huaj (kur ky pranon një gjë të tillë) ose nga burime të brendshme te financuara nga kosto lokale sipas vendimit te Keshillit te Ministrave nr.509, date 12.08.1996 (kur donatori nuk pranon).

c) Kur donatori pranon të financojë edhe TVSH-ne.

Në këtë rast shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit është e detyruar të aplikojë TVSH-ne mbi vlerën e situacionit të punimeve. Nga kjo TVSH të zbresë TVSH-ne e paguar në blerjet që bën shoqeria dhe diferenca përfaqëson TVSH-ne e pagueshëm nga kjo shoqëri.

- Kopjen origjinale të situacionit të punimeve shoqëria sipërmarrëse e punimeve është e detyruar t'ia paraqesë njësisë zbatuese të projektit. Kjo e fundit (njësia zbatuese e projektit) paraqet në degen perkatese te tatimeve (ku ka qendrën njësia zbatuese e projektit) këtë dokumentacion:

- Kërkesën për rimbursim ku theksohet shuma e rimbursimit që kërkohet, veprimtaria e kryer, arsyet për rimbursim, etj.

- Kopjen e noterizuar e në gjuhën shqipe te marrëveshjes së ratifikuar në parlament ose te marrëveshjes se miratuar nga qeveria. Marrëveshja duhet të përmbajë emërtimin e projektit apo të projekteve, shumën totale për secilin prej tyre, afatin kohor të fillimit e të përfundimit të projektit. Kopja e marëveshjes shoqërohet edhe me listën (emrin dhe mbiemrin) e përfaqësuesve zyrtar të çdo projekti.

- Deklaratën mujore të TVSH, teprica kreditore e së cilës (kutia 22) duhet të jetë e barabartë me shumën e TVSH që kërkohet të rimbursohet.

- Kopjen origjinale të situacionit të punimeve e cila duhet të përmbajë në mënyrë shumë të dukshme shënimin: "Situacioni është hartuar në kuadrin e Marrëveshjes se ratifikuar në Parlament ose të miratuar nga Keshilli i Ministrave me Nr. __, datë __/__/200 _ dhe për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje". Ky shënim do të bëhet nga përfaqësuesi zyrtar i njësisë së zbatimit të projektit i njohur nga dega e tatimeve (në bazë të listës së mësipërme) i cili veç kësaj duhet të shënojë në faturë edhe emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij.

Ne te gjitha keto raste rimbursimi behet sic percaktohet ne piken 16 me lart te ketij udhezimi.

d) Kur donatori nuk pranon financimin e TVSH-se.

Në rastet kur donatori nuk pranon të financojë pagimin e TVSH, do të veprohet në përputhje me VKM Nr. 509, datë 12.08.1996. Në bazë të këtij Vendimi, TVSH financohet nga përfituesi apo investitori vendas i projektit dhe paguhet nga shoqëria sipërmarrëse e punimeve për zbatimin e projektit.

17. Interesat

Kur një person i tatueshëm nuk paguan shumën e plotë të TVSH-se se detyrueshme brenda

datës të përcaktuar në ligj, detyrohet të paguaje interesa mbi shumën e TVSH-se se papaguar nga data në të cilën pagesa ka qenë e detyrueshme deri në datën në të cilën ajo kryhet. Interesi për mospagimin e TVSH brenda datës të detyrueshme llogaritet 2% për muajin e parë apo një pjesë të tij dhe 1 % për muajt pasardhës ose pjesë të tyre bazuar në tatimin e papaguar në datën që interesi llogaritet. Interesat zbatohen automatikisht dhe hiqen vetem me ligj.

Interesat për mos rimbursimin ne kohe janë të zbatueshme, kur :

- Organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në bazë të nenit 50, brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, ne nje nga format e percaktuara ne germat "a","b" dhe "c" te pikes 3 te nenit 39 te ligjit "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise". Në këtë rast ato detyrohen te paguajne interesa sic percaktohet ne nenin 44 te ligjit "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise".

- Organet tatimore nuk bejne rimbursimin e TVSH-se per kategorine se eksportuesve te percaktuar ne VKM nr. 49 dt. 26.01.2001, brenda 30 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses. Ne kete rast ato paguajne interesa per shumen e rimbursimit, sipas perqindjeve te percaktuara ne nenin 44 te Ligjit «Per Procedurat Tatimore».

18. Përfaqësuesit tatimore

Në zbatim të nenit 55 të ligjit, kur personi i tatueshëm për qëllime të këtij ligji, nuk ka vend të veprimtarisë ekonomike në Shqipëri, ai duhet të emërojë një person tjetër si përfaqësuesin e tij tatimor për përmbushjen e detyrimeve per TVSH. Marrësi i furnizimit detyrohet të njoftojë me shkrim organet tatimore menjëherë me lidhjen e kontratës. Personi i emëruar si përfaqësues tatimor i TVSH-së ka të drejtë të veprojë në emër të kryesorit të tij (personit te tatueshem te cilin ai perfaqeson) për të gjitha qëllimet që lidhen me TVSH dhe njëkohësisht është përgjegjës për të përmbushur të gjitha detyrimet, përfshirë çdo gjobë a dënim, për të cilat kryesori detyrohet.

Përfaqësuesi tatimor duhet të kërkojë të regjistrohet brenda 15 ditëve nga dita e emërimit të tij. Kërkesës për regjistrim í bashkangjitet prokura e përpiluar në formën e përcaktuar në ligjin "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë". Në rast se përfaqësuesi tatimor vepron për disa kryesore në të njëjtën kohë (per disa persona te tatueshem te cilet ai i perfaqeson), ai duhet të regjistrohet vecant për secilin prej tyre. Këto regjistrime janë krejtësisht të ndara nga regjistrimi që mund të ketë bërë ose mund të bëjë përfaqësuesi tatimor për aktivitetin e tij. Përfaqësuesi tatimor është i detyruar të njoftojë me shkrim degën e tatimeve, ku është i regjistruar si i tillë, për çdo ndryshim të mundshëm që prek informacionin fillestar të dhënë brenda 15 ditëve nga momenti kur këto ndryshime ndodhin. Përfaqësuesi tatimor per TVSH duhet të mbajë regjistrime të veçanta për çdo kryesor që përfaqëson si dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që provon saktësinë e mbajtjes së këtyre regjistrimeve. Regjistrimet mbahen ashtu siç është përcaktuar në pikën 9 të këtij Udhëzimi.

19. Dënimet

Per cdo shkelje qe ka te beje me TVSH, pasi mbahet akti i kontrollit apo proces verbali perkates, percaktohet masa e denimit dhe plotesohet formulari tip i denimeve, forma dhe permbajtja e te cilit eshte sipas modelit bashkengjitur ketij udhezimi. Ky formular eshte i kodifikuar dhe hidhet ne sistemin e integruar kompjuterik per deget e informatizuara dhe ne regjistrin perkates per deget e painformatizuara. Per cdo denim, bazuar ne nenet 42 dhe 43 te ligjit, personi i tatueshem mund te apeloje ne shkallet perkatese te apelimit.

19.1 Denimet per mosregjistrim

Kur një person i tatueshëm nuk është regjistruar dhe nuk kërkon të regjistrohet brenda 10 të ditëve, sipas dispozitave te ligjit mbi TVSH-ne, detyrohet të paguaje një gjobë prej 75.000 leke.

Organet tatimore regjistrojne nga zyra kete kategori personash te tatueshem. Kryetari i Deges se Tatimeve ka të drejtë që, nëqoftëse personi i tatueshëm nuk reagon ndaj regjistrimit, duke deklaruar dhe paguar:

a. të vendose sekuestro mbi mallra, materiale dhe aktive të tjera të përdorura për veprimtarinë ekonomike;

b. të urdheroje mbylljen e njesise, dyqanit, magazines;

c. të publikojë emrin e personit të tatueshëm dhe shkeljen qe ka kryer.

Kryetari i Deges se Tatimeve mund të urdheroje forcat e policisë tatimore të detyrojnë zbatimin e masave të parashikuara në germat a dhe b me siper.

Kur një person i tatueshëm jep te dhena te gabuara gjate regjistrimit, nuk njofton ndryshimet apo nuk kërkon të çregjistrohet ne baze te parashikimeve te Ligjit, detyrohet të paguaje një gjobë prej

50,000 lekë.

19.2 Denimet në lidhje me faturën tatimore

a) Kur nje person i tatueshem konstatohet se nuk ka leshuar fature tatimore, ai eshte i detyruar te leshoje menjehere fature te rregullt tatimore si dhe te paguaje pervec shumes se TVSH qe lidhet me ate furnizim edhe nje denim te barabarte me shumen e kesaj TVSH-je.

b) Një person, i cili lëshon një faturë pa informacionin e plote te parashikuar në ligjin për TVSH, qe nuk vendos NIPT-in e vertete te bleresit dhe identitetet e sakta te tij, që zbaton TVSH në një furnizim në një kohe që ky person nuk është i regjistruar për TVSH, detyrohet të paguajë një dënim të barabartë me shumën e TVSH-se të zbatuar në atë furnizim, përvec TVSH-se së zbatuar në atë furnizim.

c) Kryetari i deges se tatimeve, nëqoftëse personi i tatueshëm, per me shume se nje here, nuk leshon faturë tatimore lëshon me shume se nje here faturë tatimore pa qenë i regjistruar ka te drejte:

- të vendosë sekuestro mbi mallra, materiale apo ndonje aktiv tjetër që përdoret në veprimtarinë ekonomike te tatimpaguesit;
- të urdherojë mbylljen e dyqaneve apo magazinave;
- të publikojë emrin e personit të tatueshëm dhe shkeljen e tij.

Kryetari i deges se tatimeve ka të drejtë të urdhërojë forcat e policise tatimore qe të detyrojnë zbatimin e dispozitave të parashikuara në paragrafin c me lart.

d) Kur një person i tatueshëm nuk lëshon një faturë në formën e parashikuar në ligjin për TVSH dhe ne udhëzimin ne zbatim te tij, ai detyrohet te leshoje menjehere faturen e rregullt si dhe te paguaje pervec TVSH-se qe duhej zbatuar per ate furnizim edhe nje denim te barabarte me shumen e kesaj TVSH-je.

19.3 Denimet per mosdeklarim

a) Kur një person i tatueshëm nuk bën deklarimin brenda 15 diteve nga data ligjore apo deklaron jo ne formën e parashikuar ne ligjin per TVSH-ne, detyrohet të paguaje një dënim prej 20% të tatimit për t'u paguar por jo më pak se 10000 leke.

b) Kur një person i tatueshëm nuk bën deklarimin brenda 30 diteve nga data ligjore, detyrohet të paguajë një dënim në masen 50% të tatimit të detyrueshëm, por jo më pak se 25000 leke.

19.4 Denimet për pagesë të vonuar

a) Kur një person i tatueshëm nuk paguan TVSH-ne e detyrueshëm brenda 15 diteve nga data ligjore, detyrohet të paguajë një gjobe në masen 20% të tatimit të detyrueshëm të papaguar, përvec interesit.

b) Kur një person i tatueshem nuk paguan brenda 30 ditëve nga data ligjore, detyrohet të paguaje një gjobë në masën 50% të tatimit të papaguar, pervec interesit. Nëqoftëse personi i tatueshëm bën dy shkelje njëkohësisht, edhe mosparaqitje të deklaratës edhe mospagesë të tatimit zbatohet vetëm dënimi i vendosur për deklarimin.

19.5 Denimet per deklarimet fallco

Kur TVSH e paraqitur si e pagueshme në një deklaratë është më pak se sa TVSH që duhet të ishte treguar si i tillë dhe kjo konsiderohet fshehje me qellim, zbatohet një dënim në masën 50% të diferences të padeklaruar.

19.6 Dënime të tjera

a) Kur një person i tatueshëm nuk mban regjistrimet në formën dhe mënyren e parashikuar në ligj dhe udhëzimin ne zbatim te tij apo nuk jep informacionin e detyrueshëm, detyrohet të paguajë 50.000 leke gjobe.

b) Kur një person i tatueshëm nuk deklaron si të kredituesshme në periudhën përkatëse TVSH në hyrje, dënohet në masën 10% të kësaj TVSH, nëse personi e deklaron TVSH e zbritshme ne periudhat tatimore qe vijne, pas muajit pasardhes te muajit ne te cilin transaksioni eshte kryer.

Shembull. Në muajin janar 2005 shoqëria ka blerë mallra me TVSH të zbritshme prej 100 000 lekë. Nëqoftëse kjo shumë nuk deklarohet si e zbritshme në FDP e muajit janar (që është edhe momenti i kreditimit dhe me afat deklarimi deri ne 14 shkurt 2005), por në FDP e muajit shkurt (me afat deklarimi deri ne 14 mars 2005), ndaj shoqërisë nuk vendoset asnjë dënim. Nëse ajo deklarohet në muajin FDP e muajit mars apo më pas, ndaj shoqërisë vendoset një dënim prej 100 000x10 % = 10 000 lekë.

c) Kur një person i tatueshëm nuk lejon hyrjen dhe inspektimin nga ana e organeve tatimore, apo kur një person direkt apo indirekt, vetë ose nëpërmjet një personi tjetër, pengon ose përpiqet të pengojë veprimet e organeve tatimore sic parashikohet në Ligj dhe udhëzimin e tij, denohet me 1.000.000 leke gjobe të vendosur nga kryetari i degës përkatëse të tatimeve.

20. Veprimet për mbledhjen e tatimit

TVSH e pagueshme duhet paguar brenda 30 diteve nga data e Njoftim Vleresimit Tatimor.

Interesat dhe denimet jane te detyrueshme per t`u paguar dhe mblidhen si TVSH-ja. Nëse detyrimet nuk janë paguar deri në datën, në të cilën janë të detyrueshme, organet tatimore kanë të drejtë të ndërmarrin veprime për të nxjerrë me forcë TVSH-në e detyruar, së bashku me interesat e dënimet e vëna, sipas neneve 45 e 46 të ligjit "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

21. Ankimimi

Çdo person ka te drejte te ankoje rezultatet e Vleresimit Tatimor te bere nga organet tatimore.

- Shkalla e pare e apelimit (administrativ) është Drejtoria e Apelimit në Drejtorinë e Pergjithshme te Tatimeve.
- Shkalla e dyte e apelimit eshte Komisioni i Apelimit te Tatimeve pranë Ministrisë së Financave.
- Shkalla e trete e apelimit eshte gjykata.

Personi qe apelon, duhet te plotesoje njekohesisht 2 kushte:

a) Të ankohet brenda 30 diteve nga data e marrjes se njoftimit-vlerësimit tatimor. Datë e marrjes së njoftimit të vlerësimit vlerësohet data e dhjetë pas dorëzimit të njoftimit në shërbimin postar. Përgjegjësia për mosmarrjen në kohë të njoftimit të dorëzuar në shërbimin postar është e tatimpaguesit, i cili është i detyruar të deklarojë adresën e saktë, që të sigurojë marrjen në kohë të njoftimeve nga shërbimi postar. Në rastet kur administrata tatimore dërgon njoftim – vlerësimin tatimor dorazi,si datë e marrjes së njoftim-vlerësimit vlerësohet data, kur njoftimi i jepet në dorë tatimpaguesit dhe konfirmohet nga ky i fundit. Në rast refuzimi nga tatimpaguesi, njoftimi vlerësohet i marrë datën e refuzimit.".

b) Të parapaguajë detyrimin e TVSH-se (pa interesa dhe gjoba) ose te paraqese garancite e nevojshme bankare brenda 30 diteve nga data e marrjes se Njoftim-vleresimit, sic percaktohet ne ligjin dhe ne udhezimin "Per Procedurat Tatimore".

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve ka te drejte te heqe teresisht ose pjeserisht denimet, pervec interesave, ose te urdheroje nje rishqyrtim nese personi i tatueshem ka:

- paguar ose garantuar në një bankë TVSH-ne e detyrueshme, sipas nenit 41 dhe 42 te ligjit "Per Tatimin mbi Vleren e Shtuar";
- rregulluar gjendjen per te cilen i eshte dhene denimi dhe;
- ka plotesuar kerkesat e ligjit "Per tatimin mbi vleren e shtuar" dhe te udhezimit ne zbatim te tij.

22. Zbatimi i Udhëzimit

Ngarkohen me zbatimin e ketij Udhezimi Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe deget e saj si dhe Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe deget e saj.

23. Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi, Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.7, datë 19.01.2005 "Për TVSH-në", shfuqizohet.

24. Hyrja ne fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Kerkese per Regjistrim

NIPT-i

(1) Emri Tregtar

(2) Administratori

(3) Adresa administratorit
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi
See Note 5

Zgjidh kutine e duhur

(4) Pronesia — Shqiptare ☐ E huaj ☐ E perbashket ☐

(5) Forma ligjore — Person fizik ☐ Kolektive ☐ Komandite ☐ Trup diplomatik ☐

sh.p.k. ☐ Ortakeri ☐ Anonime ☐ Ent publik ☐ OJF ☐

(6) Adresa kryesore
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni — E mail

(7) Aktiviteti

(8) Kodi ekonomik — ***Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve*** — (9) Data e krijimit

(10) Jam i regjistruar per :

- ☐ Vetem NIPT
- ☐ Tatim fitimi (***Ploteso fushen 12)***
- ☐ TVSH
- ☐ Aksiza
- ☐ Sigurimet Shoqerore
- ☐ Sigurimet Shendetesore
- ☐ Tatimi mbi te Ardhurat Personale
- ☐ Tatim fitimi i thjeshtuar
- ☐ Taksa vendore per biznesin e vogel ***(Ploteso Shtojcen B)***

(11) Xhiro parashikuar — (12) Tatim fitimi parashikuar

(13) Kategoria per efekt sigurimesh

- ☐ Punedhenes
- ☐ I vetepunesuar (I vetem)
- ☐ I vetepunesuar me punemarres
- ☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes
- ☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes

(14) Adresat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi

(15) Shoqeria nga varet

Nipt-i ☐☐☐☐☐☐☐☐☐☐ Rrethi ☐

(16) Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur
Shtojca A ☐ dhe/ose Shtojca B ☐ eshte i sakte

(17) Emri, nenshkrimi dhe data

☐ ☐☐ ☐☐☐☐

Per perdorim zyrtar

(18) Perjashtime dhe lehtesi tatimore

Kodi	Tatimi	Kodi I lehtesise	Pershkrimi I lehtesise	Data fillimit	Data mbarimit

(19) Tatime te tjera per te cilat biznesi eshte pergjegjes

Kodi	Tatimi	Tipi I pergjegjesise (0–=tatimpagues,1=agjent tatimor,2=perfaqesues fiskal)

Verifikuar nga ..Emri Nenshkrimi Kodi Data

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Adresa te tjera shtese (Shtojca A)

NIPT-i | | | | | | | | | | |

(14) Adresat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi	Nr. certifikates

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Te perdoret vetem per taksen vendore per biznesin e vogel

Detaje te aktivitetit per cdo adrese (Shtojca B)

NIPT-i

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

Çdo subjekti i kërkohet të regjistrohet në Degen e Tatimeve dhe të pajiset me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT). Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet përpara se veprimtaria ekonomike të fillojë. Cilido person që është i detyruar të regjistrohet dhe nuk regjistrohet ka kryer një shkelje dhe për këtë do të paguajë denimin perkates.

Plotesimi i formularit
Fusha e pare e formularit eshte fusha e NIPT-it. Kjo fushe plotesohet nga organet tatimore.

(1) **Emri tregtar :** jepni emrin e plote Duhet të jepni emrin e plotë të shoqërisë tregtare siç tregohet në dokumentin e regjistrimit në Gjykatë - ky mund të jetë emri juaj ose i shoqërisë tregtare.
(2) **Administratori :** jepni emrin e pronarit të shoqërisë. Nëse jeni një person fizik, ky do të jetë emri juaj. Në të kundërt, jepni emrin e ortakut kryesor ose drejtorit, ose emrin e personit të autorizuar për të vepruar në emër të shoqërisë.
(3) **Adresa e administratorit** : jepni adresen e plote personale te administratorit emri i te cilit eshte paraqitur me lart.
(4) **Pronesia** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(5) **Forma ligjore** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(6) **Adresa kryesore** : jepni adresen ne te cilen ushtroni veprimtarine ekonomike. Nese keni me shume se nje vendodhje te veprimtarise ekonomike duhet te caktoni njeren prej tyre si adrese kryesore. Nese jeni ambulant, zejtar apo nje subjekt qe merret me transport, pra pa vend fizik te biznesit, jepni adresen tuaj private. Jepni numrin e telefonit, dhe adresen e postes elektronike nese keni, ne menyre qe te mund t'ju njoftojme per ndryshimet e mundshme qe mund te ndikojne mbi ju.
(7) **Aktiviteti** : kepni pershkrimin me fjale te aktivitetit tuaj ekonomik.
(8) **Kodi ekonomik** : kjo fushe plotesohet nga zyra e tatimeve mbi bazen e "Nomenklatures se veprimtarive ekonomike"
(9) **Data e krijimit** : jepni daten e regjistrimit ne Gjykate.
(10) **Jam i regjistruar per** : zgjidhni te gjitha kutite per tatimet qe jeni te detyruar te paguani. Ne rast se nuk paguani asnje tatim, por regjistroheni vetem per te marre nje numer identifikimi zgjdhni kutine—Vetem NIPT– . Ne rast veshtiresie kerkoni ndihmen e inspektoreve te regjistrimit ne zyren e tatimeve. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel duhet te plotesoni shtojcen B te formularit te Kerkeses per Regjistrim.
(11) **Xhiro parashikuar** : jepni xhiron qe parashikoni te realizoni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik.
(12) **Tatim fitimi parashikuar** : jepni tatim fitimin qe parashikoni te realioni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik. Kete fushe duhet ta plotesoni vetem nese kerkoni te regjistroheni per tatim fitimi.
(13) **Kategoria per efekt sigurimesh** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(14) **Adresat e tjera** : nese subjekti juaj operon ne me shume se nje adrese, duhet qe ne kete tabele te jepni te dhenat e seciles adrese, me perjashtim te adreses kryesore. Nese nuk keni vend te mjaftueshem ne formular duhet te plotesoni shtojcen A. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel, duhet te plotesoni shtojcen B per secilen adrese,perfshi dhe adresen kryesore.Per secilen nga adresat ju do te pajiseni me certifikaten e regjistrimit.
(15) **Shoqeria nga varet** : nese shoqeria juaj varet nga nje shoqeri tjeter, jepni NIPT-in dhe rrethin ku eshte regjistruar kjo shoqeri.
(16) **Deklarim** : zgjidhni kutite perkatese nese keni plotesuar shtojcen A dhe/ose shtojcen B te ketij formulari.
(17) **Nenshkrimi dhe data** : Deklarimi duhet te behet nga pronari ose personi i autorizuar te veproje ne emer te subjektit.Ligji parashikon denime ne rastet e deklarimit te pasakte apo dezinformues.
(18) **Perjashtime dhe lehtesi tatimore** : kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(19) **Tatime te tjera per te cilat biznesi eshte** pergjegjes : Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(20) **Detaje te aktivitetit per cdo adrese** : kjo fushe ndodhet ne shtojcen B te formularit dhe plotesohet vetem nga subjektet qe regjistrohen per taksen vendore per biznesin e vogel. Jeprni cdo adrese ku zhvilloni veprimtarine tuaj, perfshi dhe adresen kryesore, dhe per secilen adrese jepni aktivitetin apo aktivitetet ekonomike qe zhvilloni ne te sipas klasifikimit te meposhtem :

- Shites me pakice -Shites me shumice -Prodhues -Sherbime - Profesione te lira -Ambulante dhe zejtare dhe qarkullimin per cdo aktivitet.

Ne rast se ushtroni veprimtari transporti paraqisni tipin e mjetit sipas tabeles

Transport pasagjeresh	**Transport mallrash**	**Transport detar**
Deri ne 5 vende,perfshi shoferin	Deri ne 2 ton	Transport detar brenda vendit
6 deri 9 vende,perfshi shoferin	2.1 deri 5 ton	Transport ne liqen brenda vendit
10 deri 25vende,perfshi shoferin	5.1 deri 10 ton	Varka per shetitje
26 deri 42 vende,perfshi shoferin	10.1 deri 16 ton	

Detyrimet ne te ardhmen
Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni degen e tatimeve ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni degen e tatimeve. Personeli yne do t'ju pergjigjet me kenaqesi pyetjeve apo kerkesave tuaja.

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Ju lutem lexoni shenimet ne faqen 4 para se te plotesoni formularin.
Perdorni germa KAPITALE.

NIPT-i
Shih Shenimi 1

Emri tregtar i regjistruar

Detaje te ndryshimit

C'fare ndryshimesh po njoftoni?

Zgjidhni kutine e duhur dhe vazhdoni sipas udhezimit

Kujdes, duhet te plotesoni vetem ndryshimet.

Ndryshim ne detajet e regjistruarimit	☐	***Shko ne Seksionin 1 me poshte.***
Ndryshim i pergjegjesise per tatimet	☐	***Shko ne Seksionin 2, ne faqe 2.***
Ndryshim ne statusin juridik	☐	***Shko ne Seksionin 3, ne faqe 2***
Mbyllje e aktivitetit	☐	***Shko ne Seksionin 4, ne faqe 3***
Ndryshim i kategorizimit per sigurimet shoqerore	☐	***Shko ne Seksionin 5, ne faqe 3***

Seksioni 1

[2] Emri i ri tregtar
Shih shenimi 2

[3] Emri i drejtuesit te ri
Shih shenimi 3

[4] Adresa re drejtuesit
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Zgjidh kutine e duhur

[5] Pronesia dhe forma ligjore

Shih shenimi 4

				Shqiptare	☐	E huaj	☐	E perbashket	☐
		Person fizik	☐	Kolektive	☐	Komandite	☐	Trup diplomatik	☐
Sh.p.k	☐	Ortakeri	☐	Anonime	☐	Ent publik	☐	OJF	☐

[6] Adresa kryesore
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

E mail

[7] Aktiviteti
Shih Shenimi 5

[8] Nese biznesi juaj vepron nga me shume se nje adrese dhe detajet kane ndryshuar, jepni informacion me poshte. **Ju duhet te ktheni certifikaten e NIPT-it per adresen qe eshte mbyllur.Per adresen ekzistuese mund te shenoni vetem numrin e ri te telefonit ose Llojin e ri te veprimtarise.** *Shih shenimi 6.*

Ndryshime ne Adrese ekzistuese
Shenim 6

Numri i certificates

Telefoni

Lloji i veprimtarise

Adrese e mbyllur
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Certifikata bashkengjitur, *zgjidh kutine.* ☐ Numri i certifikates

Adrese e re

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

Nese ka me shume se nje adrese, vazhdoni me Formularin 3

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese

Seksioni 2

Zgjidh kutine e duhur

[9] Per cilin tatim jeni pergjegjes **tani**?
Shih shenimi 7

- ☐ Vetem NIPT
- ☐ Tatim fitimi
- ☐ TVSH
- ☐ Aksiza
- ☐ Sigurimet Shoqerore
- ☐ Sigurimet Shendetesore
- ☐ Tatimi mbi te Ardhurat Personale
- ☐ Tatim fitimi i thjeshtuar
- ☐ Taksa vendore per biznesin e vogel

Jepni fitimin dhe qarkullimin e parashikuar me poshte

Qarkullimi i parashikuar

Fitimi i parashikuar

Seksioni 3

[10] Nese jeni kthyer ne person Juridik
Shih shenimi 8

- **Plotesoni seksionin 4**
- **Plotesoni nje formular te ri regjistrimi**

Seksioni 4

[11] Data e mbylljes
Shih shenimi 9

Arsyeja e mbylljes

Zgjidh kutine e duhur

Shitur ☐ Mbyllur ☐ Transferuar ☐ Kalim ne pasiv ☐

Kur veprimtaria shitet ose transferohet, emri i pronarit te ri dhe adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Vertetim i transferimit

Une vertetoj qe kjo veprimtari me eshte transferuar mua . Une e pranoj transferimin dhe e kuptoj qe jam pergjegjes per te gjitha detyrimet e TVSH qe lidhen me kete biznes.

Nenshkruar ..... (Pronari i ri) Data.....

Seksioni 5

[12]
Kategoria per efekt sigurimesh
Shenim 10

☐ Punedhenes

☐ I vetepunesuar (I vetem)

☐ I vetepunesuar me punemarres

☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes

☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes

Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur eshte i plote dhe i sakte.

(Emri, nenshkrimi dhe data

Nese veproni si perfaqsues fiskal ,

Per perdorim zyrtar

[13]
Perjashtime dhe lehtesi tatimore

Kodi	Tatimi	Kodi i lehtesise	Pershkrimi i lehtesise	Data fillimit	Data mbarimit

Kodi Fiskal

Kodi Ekonomik

Verifikuar nga ..(Emri) (Nenshkrimi) Kodi Data

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Këtë formular duhet t'a përdorni për të njoftuar organin tatimor për ndonjë ndryshim që ndikon në regjistrimin tuaj. Duhet të njoftoni vetëm ndryshimet në të dhënat që keni raportuar në kërkesën për regjistrim. Për të bërë këto njoftime ekzistojnë disa kufinj kohorë. Nëse kryeni blerje ose shitje të tërë shoqërisë tregtare apo pjese të saj duhet të njoftoni menjëherë organin tatimor. Për ndryshi-met e tjera, njoftimi duhet bërë brenda 15 ditësh nga momenti i kryerjes së ndryshimit.

Plotesimi i formularit

Shenim 1 : Shkruani NIPT-i dhe dhe emrin e subjektit.

Shenimi 2 : jepni emrin e ri të subjektit.

Shenimi 3 : Nëse kemi një ndryshim në ortakun kryesor apo drejtorin, apo një tjetër person është tashmë i autorizuar të veprojë në emër të subjektit, shënoni të dhënat e personit të ri, duke përfshirë emrin dhe adresën e plotë postare të banesës private.

Shenimi 4 : Tregoni statusin e ri ose tipin e shoqërisë tregtare.

Shenimi 5 : Nëse veprimtaria ekonomike kryesore e subjektit ndryshon, shënoni këtu hollësitë.

Shenimi 6 : Për çdo degë të subjektit lëshohet një çertifikatë NIPT-i. e re. Numri i Identifikimit të Personi të Tatueshëm (NIPTi) me të cilin jeni i pajisur nuk ndryshon, por çertifikatat do të kenë të gjitha nga një numër unik. Nëse numri i telefonit të njërës nga degët e firmës tuaj ndryshon, ju duhet të shënoni numrin e ri duke shënuar **numrin e çertifikatës** të NIPT-it (jo vetëm NIPT-in).

Nëse një degë ekzistuese e shoqërisë tregtare mbyllet **ju duhet të ktheni çertifikatën e NIPT-it ne degen e tatimeve.** Anasjelltas, kur hapet një degë e re, organi tatimor do të lëshojë një çertifikatë NIPT-i në lidhje me atë degë.

Pasi të keni hapur degën e re, jepni të dhënat e veprimtarisë së biznesit që ushtrohet aty. Nëse nuk keni hapsirë të mjaftueshme për të gjithë informacionin, përdorni Shtojcen A.

Shenimi 7 : Nëse tashmë i nënshtroheni apo nuk i nënshtroheni më asaj kategorie tatimi për të cilën jeni regjistruar, spontoni kutinë përkatëse për të treguar tatimin apo tatimet të cilin detyroheni të paguani tashmë, dhe shënoni të dhënat lidhur me tatimin e parashikuar dhe qarkullimit. Nëse nuk kryeni veprimtari tregtare por që gjithësesi dëshironi të mbani një NIPT, duhet të kontaktoni degën tatimore për t'u këshilluar.

Nëse qarkullimi për vitin e fundit kalendarik e tejkalon vlerën prej 8 milion lekë, ju duhet të bëni kërkesë për t'u regjistruar për Tatimin mbi Fitimin dhe TVSH-në përpara datës 15 Janar të vitit pasardhës. Mos vononi, në të kundërt do të penalizoheni me gjobë. Nëse qarkullimi juaj për vitin e fundit kalendarik bie nën 8 milion lek, ju mund të bëni kërkesë që të paguani Tatim-Fitimin e Thjeshtuar dhe Tatimin Vendor mbi Biznesin e Vogël. Sidoqoftë, ju mund të vazhdoni të jeni i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin dhe TVSH-në nëse kjo ju sjell më shumë dobi.

Shenimi 8 : Nëse keni ndryshuar statusin tuaj juridik, tregoni datën e ndryshimit dhe emrin e ri të shoqërisë suaj. Mos harroni që një ndryshim i tillë përbën një pezullim të një veprimtarie ekonomike dhe fillim të një veprimtarie tjetër, dhe se për veprimtarinë e re duhet të plotësoni Formularin 1, Kërkesë për Regjistrim. Ktheni bashkë me formularin edhe çertifikatat. Kjo mund të përbëjë transferimin e pronësisë së veprimtarisë ekonomike

Shenimi 9 : Nëse veprimtaria ekonomike është ndërpreë, shënoni datën e ndërprerjes dhe spontoni kutinë përkatëse për të dhënë arsyen e mbylljes së veprimtarisë.

Nëse e keni transferuar veprimtarinë ekonomike si ndryshim në pronësi, qoftë me anë të shitjes apo dhurimit, shënoni datën e ndërprerjes dhe jepni hollësitë e pasardhësit tuaj. Pasardhësi juaj duhet të firmos çertifikatën, duke pranuar përgjegjësinë për detyrimet e TVSH në lidhje me veprimtarinë e transferuar.

Shenimi 10 : nese kategorizimi juaj per efekt te sigurimeve shoqerore ka ndryshuar, zgjidhni vetem njeren nga kutite perkatese , per kategorine qe ju keni tashme.

Detyrimet ne te ardhmen

Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni degen e tatimeve ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni degen e tatimeve. Personeli yne do t'ju pergjigjet me kenaqesi pyetjeve apo kerkesave tuaja.

Lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rruga 'Mustafa Lleshi', Nr 5, Tiranë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

KERKESE PER RIMBURSIM

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): .....
Emri tregtar i Personit te Tatueshem: .....
Emri Mbiemri i Personit Fizik .....
Adresa: .....
Qyteti/Komuna/Rrethi: .....
Numri i telefonit: .....

Kerkoj rimbursimin e kredise per

Tatimin : Kodi i tatimit **periudhen :** Periudha Tatimore **Nr vleresimit (Per perdorim zyrtar)**

Kredia duhet te transferohet dhe/ose rimbursohet ne perputhje me kerkesen qe une kam paraqitur ne vijim. Ne te njejten kohe une e di dhe pranoj qe nje pjese e kredise apo e gjithe kredia mund te perdoret per te shlyer detyrimet qe une mund te kem ndaj zyres se tatimeve.

....
Nenshkrimi i tatimpaguesit **Data**

Kontrolluar & Autorizuar nga:
(Per perdorim zyrtar)

....
Emri i inspektorit Kodi Data e autorizimit

	Tatimpaguesi	Zyra e Tatimeve
[19] KREDIA E RIMBURSUESHME :	[19]	
Shperndarja e rimbursimit:		
[30] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter : Taksa / Periudha tatimore / Numri i vleresimit	[30]	
[31] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter : Taksa / Periudha tatimore / Numri i vleresimit	[31]	
[32] Transferim ne nje detyrim tatimor tjeter: Taksa / Periudha tatimore / Numeric i vleresimit	[32]	
(Kodi i takses: 0-TVSH, 1-Tat.Fitimi, 4-TAP, 5-Sig. shoq, 6-Sig. shend)		
[33] Totali Transferimeve {[30] + [31] + [32]}:	[33]	
[34] Rimbursim :	[34]	
[35] MBETET PA U SHPERNDARE {[19] - [33] - [34]}:	[35]	

Nr. i Serise 0000000

FATURE TATIMORE SHITJE

Data: ____/____/_____

Nr. i Fatures: _____

EMRI I SHITESIT:_____

ADRESA:_____
TELEFONI:_____

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT) | | | | | | | | | | |

EMRI I BLERESIT: _____

ADRESA: _____
TELEFONI: _____

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT) | | | | | | | | | | |

EMRI I TRANSPORTUESIT: _____
ADRESA:_____
TARGA E MJETIT :_____
ORA E FURNIZIMIT: _____
NUMRI I IDENTIFIKIMIT TE PERSONIT TE TATUESHEM (NIPT) | | | | | | | | | | |

Nr	Pershkrimi i Mallit ose Sherbimit	Njesia e Matjes	Sasia	Çmimi per njesi pa TVSH	Vlefta pa TVSH	Vlefta e TVSH	Vlefta me TVSH
1	2	3	4	5	6=4+5	7=6x20%	8=6+7
				TOTALI			

Nga te cilat: Furnizime te tatueshme

Furnizime te patatueshme

a) faqe 1: Origjinali - Blerësi
b) faqe 2: Transportuesi
c) faqe 3: Shitesi

BLERESI	**TRANSPORTUESI**	**SHITESI**
(emer, mbiemer, nenshkrimi)	(emer, mbiemer, nenshkrimi)	(emer, mbiemer, nenshkrimi, vule)
_____	_____	_____

E-TVS 055/a

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE I PAGESES SE TVSH

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

(2) Periudha Tatimore	(1) Numri Serial:

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT)	(3)
Emri Tregetar i Personit te Tatueshem:	(4)
Emri, Mbiemri Personit Fizik:	(5)
Adresa:	(6)
Qyteti/Komuna/Rrethi:	
Numri Telefonit:	(7)

Lartmenoni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

☐ (8) Shenoni 'X' nqs. gjate muajit nuk eshte bere asnje transaksion. Vendosni Daten, Firmosni dhe dorezoni deklaraten.

TVSH e llogaritur per Muajin:	Vlera e tatueshme	TVSH i llogaritur
(9) Shitje te perjashtuara	(9)	
(10) Eksporte	(10)	
(11) Shitjet e Tatueshme	(11)	(12)

TVSH e Paguar per Muajin:	Vlera e tatueshme	TVSH i zbritshem
(13) Blerje te perjashtuara e me TVSH jo te zbritshme	(13)	
(14) Importe	(14)	(15)
(15) Blerje nga furnitore vendas	(15)	

Saktesime		
(18) TVSH i zbritshem, mbartur nga muaji i kaluar	(18)	
(19) Kerkese rimbursimi i teprices se TVSH se zbritshme nga muaji i kaluar	(19)	TVSH i zbritshem
(20) Gjendja e TVSH se zbritshme nga muaji i kaluar {(18)-(19)}		(20)
(21) *Totali i TVSH se zbritshme per muajin* {(15)+(17)+(20)}		(21)
(22) Teprica e TVSH te zbritshem {(21)-(12) nqs (21)>(12)} (Te mbartet ne muajin pasardhes)	(22)	
(23) TVSH I DETYRUESHEM PER TU PAGUAR {(12)-(21) nqs (12)>(21)}		(23)
(24) Gjoba per vonesa ne Pagese/Dorezim deklarate		(24)
(25) TOTALI PER TU PAGUAR		(25)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem – Deklaroj me pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte

Vetem per Perdorim Zyrtar

PAGESA

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Çek

☐ Te tjera

(26)Shuma e paguar (26)

Data, Vula e Bankes dhe Nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Zyra e Tatimit
Kopja - Personi i Tatueshem

LIBRI I SHITJEVE

SHITËSI

Emërtimi .....

NIPTI .....

Shitjet për periudhën (muaji)..... **(viti)** .....

Nr. Serial

FATURA						Totali Shitjeve me TVSH	Shitjet e përjashtuara	Eksportet (0 %)	Shitjet e tatueshme	
Nr. i faturës	Data	Nr.Serial	Blerësi	Rrethi	NIPT i blerësit				Vlera e tatueshme	
a	b	c	d	e	f	g=(h+i+j+k)	h	i	j	
TOTALI										
Kutia në deklaratën e pagesës së TVSH							**kutia 9**	**kutia 10**	**kutia 11**	**kuti**

1 - (a) dhe (b) Nëqoftëse shitjet bëhen brenda vendit Nr i faturës dhe Data.
Nëqoftëse eksportohen data dhe Nr. i deklaratës doganore
2 - (f) Nëqoftëse blerësi është person i tatueshëm
3 - Plotësohet në dy kopje. Kopja e bardhë (e para) dorëzohet në Degën e Tatim Taksave çdo muaj.

U PRANUA
INSPEKTORI
EMËR MBIEMËR (firmë)

EMËR MBIEM

LIBRI I BLERJEVE

Nr. Serial

BLERËSI

Emërtimi .....

NIPTI .....

Blerjet per periudhën (muaji)..... (viti) .....

FATURA						Totali i blerjeve me TVSH	Blerje me TVSH jo te zbritshme	Blerje me TVSH te zbritshme			
								Importe		Brenda vendit	
Nr. i faturës	Data	Nr.Serial	Shitësi	Rrethi	NIPT i shitesit			Vlera tatueshme	TVSH	Vlera e tatueshme	TVSH
a	b	c	d	e	f	g=(h+i+j+k+l)	h	i	j	k	l
TOTALI											
Kutia në deklaratën e pagesës së TVSH							kutia 13	kutia 14	kutia 15	kutia 16	kutia 17

1 - (a) dhe (b) Nëqoftëse blerjet behen brenda vendit Nr. faturës dhe Data
Nëqoftëse importohen data dhe Nr. deklaratës doganore
2 - (f) Nëqoftëse shitesi eshte person tatueshëm
3 - Plotesohet ne 3 kopje. Kopja e bardhe le bashkëngjitet me Degën e Tatim Taksave çdo muaj

DREJTORIA
INSPEKTORI
EMËR MBIEMËR (firma)

EMËR MBIEMËR

CERTIFIKATE LEVRIMI
DELIVERY CERTIFICATE

Numri I serise/Serial No. [ ] 000000

Per mallrat/sherbimet qe perjashtohen nga taksat sipas Statusit te Marreveshjes se Forcave (SOFA), firmosur me 24 Qershor 1999, ndermjet Organizates se Atlantikut Verior (NATO) dhe Qeverise se Republikes se Shqiperise

For supplies/services under tax-relief according to the Status of Forces Agreement (SOFA), signed on 24 June 1999, between the North Atlantic Treaty Organization (NATO) and the Government of the Republic of Albania.

Emri dhe adresa e kompanise:
Name and address of supplier: _____

No. i pasaportes/
NIPT No: [ ]

Data dhe No. i kontrates/urdhrit te pageses:
Date and No. of the contract/order: _____

Emri dhe adresa e agjencise zyrtare te prokurimit:
Name and address of official procurement agency: _____

Emri dhe adresa e agjencise se pritjes:
Name and address of receiving agency: _____

Data e levrimit/ sherbimit Date of delivery/ service	Pershkrimi ekzakt I mallrave dhe sherbimeve Exact description of goods and services	Njesia Unit	Sasia Quantity	Cmimi Price	Shuma/Amount Ne leke/ in leke	Monedhe e huaj / in foreign currency
1	2	3	4	5	6	
Shuma	totale ne leke / monedhe e huaj	Total amount	in leke /	foreign currency		

Data/Date

Vula dhe firma/Stamp and valid signature

Certifikate pranimi dhe pagese – Certificate of receipt and payment

Mallrat/sherbimet e permendura ne faqen e pare jane terhequr .Mallrat/sherbimet e perjashtuara nga taksat sipas Marreveshjes SOFA, jane vertetuar qe jane per perdorim ekskluziv nga personeli NATO dhe bazat e saj brenda territorit te Shqiperise.

The supplies/services described on the front page have been received. For supplies/services under tax –relief according to SOFA it is certified that they are intended to be used or consumed exclusively by the NATO personnel or by the NATO headquarters in the territory of Albania.

Shuma totale
The total amount of_____ eshte ne rregull
is correct

Pagesa behet ne
Payment is being made in _____
(Perkthimi monedhes/indicate currency symbol)

kesh, cek / data e kalimit
by cash, check / remittance date_____
(Data e urdhrit te ky/ra bank of the paying service)

nga no. I llogarise ne/ from acc. No at_____
(Banka e comparave qe ofri mallin/bank of supplier)

Data/Date Vula zyrtare /official stamp

emri, grada, dhe agjencia e oficerit qe vertetoi / name, rank, agency of certifying officer

Firma / signature

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

NUMRI SERIAL:

ÇERTIFIKATE REGJISTRIMI

Personit të Tatueshëm:

Me adresë kryesore:

I jepet ky numër identifikimi (NIPT):

DATA E LËSHIMIT:

DEGA E TATIMEVE

(Emri Mbiemri)

Kjo çerfitikatë mbetet pronë e Ministrisë së Financave dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qenë person i tatueshëm.

UDHËZIM
Nr.4, datë 30.01.2006

PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TE SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Në mbeshtetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 "Për Mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave,

UDHËZON :

1. REGJISTRIMI NË ORGANIN TATIMOR

Proçedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin do të jenë ato të përcaktuara në Ligjin "Per Procedurat Tatimore" dhe ne Udhëzimin ne zbatim te tij.

Personat përgjegjës për pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqerore dhe shendetesore duhet të regjistrohen në Organin Tatimor brenda 15 ditëve nga çasti kur lind detyrimi për të paguar kontributet. Për këtë:

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisen nga Organi Tatimor me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT-i);

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisin personat për të cilët paguajnë kontribute me Numrin e Sigurimit Shoqëror (NSSh), të cilin e terheqin nga organet e sigurimeve shoqërore. Ky numer përfaqeson personin, eshte unik dhe i paperseritshem per cdo person tjeter. Pra i njejti person, pavaresisht se gjate jetes mund te ndryshoje subjektet ku punesohet, mban te njejtin numer te sigurimit shoqeror. Numri i Sigurimit Shoqeror, per personat e punesuar gjate atij muaji, vendoset ne Formularin numer E-SIG 025/a "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punësimi", ne kolonen e pare te tij, krahas emrit te personit te punesuar.

Punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar me punemarres ose me punonjës të papaguar të familjes duhet të azhornojnë listën e personave për të cilët detyrohen të paguajnë kontributet sa herë që lista e paraqitur dorëzohet në organin tatimor, pavarësisht nga koha e bërjes së deklaratës, duke pasqyruar të dhënat e personave të rinj që fillojnë punë apo lënë vendin e punës, sipas formularit numer E-SIG 027/a; "Pasqyra e të Punësuarve Rishtazi dhe e të Larguarve", (kur rasti është i tillë – pra ka të punësuar të rinj ose të larguar).

Personi juridik në momentin e regjistrimit në organin tatimor, duhet të dorëzojë listen e të punësuarve me pagën përkatëse. Pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratorë apo çdo funksion tjeter trajtohen si çdo punemarres tjeter i personit juridik.

Personi fizik ne momentin e regjistrimit duhet të deklarojë statusin dhe të dorëzojë listen e të punësuarve me pagën përkatëse, si dhe listen e punonjësve të papaguar të familjes me te cilet punon e bashkejeton. Statuset e mundshme janë:

- I vetëpunësuar i vetem.
- I vetëpunësuar me punëmarrës.
- I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjes të papaguar të familjes.
- I vetëpunësuar pa punëmarrës, me punonjes të papaguar të familjes.

Kur një person fizik ndryshon statusin (p.sh. nga i vetëpunësuar i vetem ne i vetepunesuar me punemarres ose anasjelltas etj.), ai është i detyruar të njoftojë me shkrim Organin Tatimor menjehere nga momenti i ndryshimit te statusit.

Personat juridike, te regjistruar ne TVSH ose ne Biznesin e Vogel, kane gjithmone vetem statusin e punedhenesit (pra me punemarres).

Neqoftese personi juridik ose fizik kryen ndryshime ne regjistrin tregtar te gjykates dhe kalon ne person fizik ose anasjelltas, ai eshte i detyruar te njoftoje me shkrim degen e tatimeve brenda 15 diteve nga ndryshimi ne regjister.

Personat juridike dhe personat fizike jane te detyruar te deklarojne me shkrim ne organin

tatimor perkates punemarresit e punesuar rishtazi, nje dite para fillimit te punes. Te larguarit nga puna duhet t'i deklarojne me shkrim brenda 10 diteve nga largimi.

Personat juridike e fizike, persa i perket afatit te pagimit te kontributeve per sigurimet shoqerore e shendetesore, sipas statusit te regjistrimit ne degen e tatimeve grupohen ne:

- persona juridike te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se, ku grupohen dhe OJF-te, si dhe subjektet buxhetore.
- persona fizike te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se
- persona juridike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel
- persona fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel.

2. LLOGARITJA E KONTRIBUTEVE NGA PERSONAT JURIDIKE E FIZIKE

a. Llogaritja e kontributeve nga personat juridike e fizike, te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se ose te takses vendore mbi biznesin e vogel, per punëmarresit qe punojne me kohe te plotë.

Paga bruto minimale dhe maksimale, për qëllimet e llogaritjes së kontributeve për t'u paguar, përcaktohet në Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 11.6.2001, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar" dhe nr. 771, date 13.11.2003 "Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve, shoqerore dhe shendetesore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar".

Kontributet (qoftë të punëmarrësit apo punëdhënësit) llogariten për çdo punëmarrës individual. Llogaritja mbështetet në shumën e pagës bruto mbi kufirin e pagës minimale mujore deri në kufirin e pages maksimale mujore si më poshtë:

Të ardhurat mujore bruto të punonjësit:	Kontributi i llogaritur:
Deri në minimumin e pages mujore	Paga mujore minimale (sipas VKM përkatës) x tarifa e aplikueshme
Me shume se paga minimale mujore por më pak se paga maksimale	Paga mujore bruto x tarifa e aplikueshme
Më shumë se paga mujore maksimale sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave	Paga mujore maksimale (sipas VKM përkatës) x tarifa e aplikueshme

Neqoftese nje nga punemarresit punon ne dy pune atehere per kete punemarres, secili prej punedhenesve te tij (personi juridik ose personi fizik) llogarit dhe paguan kontributet per sigurimet shoqerore e shendetesore njesoj sikur personi te mos ishte i punesuar ne punedhenes tjeter. Pra, secili prej punedhenesve, ne menyre te pavarur, llogarit dhe paguan kontributet, mbi bazen e pages reale te punemarresit, brenda kufirit maksimal te miratuar.

Kur rezulton qe kontributi total i paguar per te njejtin person nga te dy punedhenesit eshte me i madh se kontributi i llogaritur mbi pagen maksimale te miratuar, punemarresit i rimbursohet diferenca ne menyre proporcionale nga te dy punedhenesit, brenda 30 diteve nga zbulimi i mbipagesës apo njoftimi për këtë të fundit. Në këtë rast organi tatimor do të njoftojë Institutet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.

b. Llogaritja e kontributeve nga personat fizike dhe juridike, te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se ose te takses vendore mbi biznesin e vogel, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes.

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për personat e vetëpunësuar (përfshirë personat e vetëpunësuar që punësojnë persona të tjerë) dhe punonjesit e papaguar të familjes me te cilet punojne e bashkejetojne, llogariten si një përqindje e pagës mujore minimale. Përqindjet përkatëse dhe niveli i pages minimale percaktohen në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 402, datë 11.6.2001 "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar".

Në rastet kur kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar fizike dhe punonjësit e papaguar të familjes llogariten si përqindje e pagës mujore minimale dhe veprimtaria ekonomike fillon, përfundon apo ndërpritet për një periudhë prej së paku një muaj të plotë kalendarik gjatë një periudhe deklarimi, dhe fillimi, mbyllja apo ndërprerja e veprimtarisë ekonomike i është njoftuar degës së tatimeve me shkrim, shuma e kontributeve për t'u

paguar do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

shuma për t'u paguar për periudhën e deklarimit x (A / B)

ku: A = numri i muajve të plotë apo të pjesshëm brenda periudhës së deklarimit gjatë së cilës është kryer veprimtaria ekonomike;

dhe, B = numri i muajve të plotë gjatë periudhës së deklarimit.

Neqoftese i vetepunesuari eshte njekohesisht edhe punemarres ne nje punedhenes, atehere ai duhet te regjistrohet ne degen e tatimeve, si i vetepunesuar, sipas gjithe regullave, njesoj sikur te mos ishte edhe punemarres. Ne kete rast ai duhet gjithashtu te paguaje kontributet edhe si punemarres te nje punedhenes tjeter. Punedhenesi ku i vetepunesuari eshte punemarres ben gjithe veprimet njesoj si per gjithe punemarresit, sikur personi te mos ishte edhe i vetepunesuar. Kontributi total i paguar nga i njejti person (si i vetepunesuar dhe edhe si punemarres) nuk mund te jete me i madh se kontributi i llogaritur mbi pagen maksimale te miratuar. Ne te njejten menyre veprohet edhe per punonjesin e papaguar te familjes kur eshte edhe punemarres ne nje punedhenes.

Per personin e vetepunesuar, i cili njekohesisht eshte edhe punemarres te nje punedhenes tjeter ku dhe paguan kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore, per pagesen e kontributeve per vete si i vetepunesuar veprohet si vijon:

- Kur paga mujore e te vetepunesuarit si punemarres eshte mbi kufirin maksimal te pages mbi te cilen llogariten kontributet, i vetepunesuari, si i tille, per vete, nuk do te paguaje kontribute, por do te beje deklarimet sipas procedurave perkatese dhe kur ai eshte i vetem deklaron me pagese „zero".

- Kur paga mujore e te vetepunesuarit si punemarres eshte nen kufirin maksimal dhe mbi kufirin minimal te pages mbi te cilen llogariten kontributet, i vetepunesuari, si i tille, per vete, do te paguaje kontribute deri ne kufirin minimal te pages, ne ate mase qe shuma e pages si punemarres dhe paga deri ne kufirin minimal si i vetepunesuar te mos kaloje kufirin maksimal te pages mbi te cilen llogariten kontributet.

Te gjithe keto raste, nga punonjesit perkates te deges se tatimeve duhet te vertetohen me kryqezimin e te dhenave te vertetimit zyrtar te punedhenesit, te cilin i vetepunesuari e dorezon ne degen e tatimeve, me ato te listepagesave te kontributeve te paguara per personin si punemarres, per çdo periudhe tatimore perkatese.

Gjithashtu ne rastet kur i njejti person eshte i regjistruar si person juridik dhe paguan kontribute si i punesuar te shoqeria, por eshte i regjistruar edhe si person fizik, per vete, do te paguaje kontribute vetem si person juridik deri ne nivelin e pages maksimale mbi te cilen llogariten kontributet. Dega e Tatimeve duhet te beje vleresimin e vendeve te punes ne sejcilin vend biznesi.

c. Llogaritja e kontributeve nga personat juridike e fizike, te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se ose te takses vendore mbi biznesin e vogel, per punëmarresit qe punojne me kohe te pjesshme.

Per qellimet e llogaritjes se kontributeve shoqerore dhe shendetesore, masa e kontributit per t'u paguar per punemarresit me kohe te pjesshme përcaktohet nga Vendimi i Keshillit te Ministrave nr.402, date 11.06.2001, i ndryshuar.

Në mbështetje të Kreut V të Kodit të Punës, personi juridik dhe personi fizik punëdhënës janë të detyruar te nenshkruajne kontrate pune me punemarresit e tyre. Gjithashtu në mbështetje të vendimit të Këshilllit të Ministrave nr.594, date 22.12.1997 "Për regjistrin që mban punëdhënësi për punëmarrësit e tij, i ndryshuar", ata janë të detyruar te mbajne regjistrime për periudhën e marredhënieve të punës dhe shumat e paguara (në të holla ose si përfitime në natyrë) për çdo punëmarrës. Ky regjister, kur kerkohet, vihet ne dispozicion te punonjesve te administrates tatimore qe ushtrojne kontroll tek subjekti.

3. FORMA DHE PROCEDURAT E DORËZIMIT TE DEKLARATAVE

a. Deklarimi i dokumenteve në letër

Deklarimet e kërkuara duhet të bëhen në formularë dhe pasqyra deklarimi standarte që paraqiten në formularet tip bashkelidhur këtij Udhëzimi. Këta formularë janë :

- "Formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shendetesore" Nr. E-SIG 011-012/a

- "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punësimi" Nr. E-SIG 025/a

- “Pasqyra e të Punësuarve Rishtazi dhe e të Larguarve” Nr. E-SIG 027/a. (sa here qe rasti është i tillë – pra ka të punësuar të rinj ose të larguar)

- “Pasqyrë deklarimi me të dhënat per pagesen e kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te ardhurat nga punësimi” Nr. E-SIG 046/a. (Dorezohet vetem nga subjektet qe do te bejne dorezimin e deklarimeve ne format elektronik).

Formulari i deklarimit E-SIG011-012/a, si rregull, duhet të dorëzohet në të njëjtën kohë me Formularin e Deklarimit dhe Pageses se Tatimit mbi te Ardhurat nga Punësimi, me numer E-TAP 010/a.

Dorezimi i ketyre formulareve nga personat juridike e fizike te regjistruar si tatimpagues te TVSH behet ne banke, ndersa nga personat juridike e fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel behet ne posten shqiptare ose ne banke sipas percaktimit te organeve tatimore. Dorezimi ne banke dhe ose ne posten shqiptare i formulareve te deklarimit E-SIG 011-012/a, E-TAP 010/a, si dhe dorezimi ne degen e tatimeve e listepageses E-SIG 025/a eshte i detyrueshem edhe kur tatimpaguesi nuk eshte ne gjendje te paguaje detyrimin teresisht apo pjeserisht. Kur tatimpaguesi nuk eshte ne gjendje te paguaje detyrimin, atehere brenda dates se caktuar duhet te dorezoje ne banke formularet e deklarimit te plotesuar me pjesen e detyrimit te plote por me pagese “zero”, ndersa ne degen e tatimeve dorezon listepagesen e plotesuar me te gjitha te dhenat e plota. Nëse për periudhën e deklarimit nuk ekzistojnë kontribute për t’u paguar, nga personat pergjegjes për pagimin e kontributeve duhet te dorezohet Formulari numer E-SIG 011-012/a, dhe Formulari numer E-SIG 025/a me shumat “zero”.

Per rastet kur gruaja si person ”i vetepunesuar i vetem” eshte me raport barrelindje, paguhet si e tille dhe subjekti nuk ushtron veprimtari, ajo deklaron ndryshimin te vertetuar me dokument nga organet e sigurimeve shoqerore, si dhe duhet te dorezoje Formularin numer E-SIG 011-012/a dhe Formularin numer E-SIG 025/a me shumat “zero”.

Kur gruaja si person ”i vetepunesuar i vetem” eshte me raport barrelindje, paguhet si e tille, por subjekti ushtron veprimtarine nga nje person tjeter, pjestar ose jo i familjes, ajo deklaron ndryshimin dhe duhet te dorezoje Formularin numer E-SIG 011-012/a dhe Formularin numer E-SIG 025/a, me te dhena per dy punonjes, ndersa pagesa do te jete vetem per nje person.

Ne te dy rastet, kur gruaja si person ”i vetepunesuar i vetem” perfundon lejen e barrelindjes dhe do te rifilloje punen, apo kur ajo do te rifilloje punen pa perfunduar lejen e barrelindjes, nje dite perpara rifillimit te punes duhet te deklaroje ndryshimin ne degen e tatimeve.

Formulari i deklarimit dhe pageses se kontributeve, si dhe listepagesa e pasqyrat e tjera duhet të plotësohen në përputhje me shënimet përkatese qe ndodhen ne faqen mbrapa çdo dokumenti. Këto shënime dhe formularet e pasqyrat bashkangjitur jane pjesë e këtij Udhëzimi dhe kanë fuqi ligjore. Kopja e formularit te deklarimit E-SIG011-012/a, tërhiqet nga subjekti ne degen e tatimeve për çdo periudhe tatimore perpara dates së deklarimit. Modelet e listëpagesës E-SIG 025/a dhe e pasqyres E-SIG 027/a merren nga subjektet ne degen e tatimeve dhe nevojat në vazhdimesi subjektet i plotësojnë duke i fotokopjuar apo printuar vetë ato.

Subjektet qe te dhenat e listepageses E-SIG 025/a i plotesojne me kompjuter formularin do ta dorezojne ne degen e tatimeve te plotesuar sipas modelit te formularit bashkelidhur ”Permasat e fletes se listepageses” duke zbatuar me rigorozitet formatin dhe permasat e çdo reshti dhe kolone. Modeli i ketij formulari edhe mund te shkarkohet nga web-site i Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve ose Institutit te Sigurimeve Shoqerore. Shkrimi qe do te perdoret per plotesimin e listepageses duhet te jete ”arial 10”, kurse shkrimi i emrave dhe mbiemrave te kontribuesve do te jete me germe te pare te madhe dhe germat e tjera te vogla.

Subjektet qe te dhenat e listepageses i plotesojne me dore do te respektojne modelin e formularit E-SIG 025/a.

b) Deklarimi elektronik

Një person që është i detyruar të paguajë kontributet mund të zgjedhë për të dorëzuar në format elektronik të dhënat e deklarimit që lidhen me kontributet për t’u paguar, liste pagesen e kontributeve për t’u paguar E-SIG 025/a dhe pasqyrën e të punësuarve rishtazi dhe të larguarve E-SIG 027/a. Kërkesa për të dorëzuar te dhenat ne format elektronik behet sipas formularit E-SIG 086/a, bashkengjitur ketij udhezimi, ku jane percaktuar gjithashtu dhe kushtet qe duhen plotesuar për dorëzimin ketij formulari. Kerkesa paraqitet Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve e cila brenda 30 diteve nga data e kerkeses eshte e detyruar te njoftoje zyrtarisht tatipaguesin per miratimin ose jo te

kerkeses.

Personat që deklarojnë në mënyrë elektronike duhet të dorëzojnë në organin tatimor "Pasqyrën e Deklarimit me të dhënat për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetsore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi" sipas modelit E-SIG 046/a bashkëlidhur këtij Udhëzimi, e cila duhet të shoqërojë dorëzimin e çdo të dhëne elektronike.

Edhe në rastet kur miratohet dorëzimi i të dhënave te liste pageses se kontributeve për t'u paguar E-SIG 025/a dhe te pasqyrës se të punësuarve rishtazi dhe të larguarve E-SIG 027/a, formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shendetesore E-SIG 011-012/a duhet të dorëzohet në bankë ose në postë brenda afateve të përcaktuara në Ligj. Të dhënat e dorëzuara në format elektronik që lidhen me punëmarrësit duhet të përfshijnë gjithashtu informacionin për pagesat e tatimit mbi të ardhurat të mbajtur në burim që kërkohet sipas pasqyrave në letër.

Nëse për periudhën e deklarimit nuk ekzistojnë kontribute për t'u paguar, duhet të depozitohet një deklaratë "zero".

4. AFATET E DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË KONTRIBUTEVE

Afatet e deklarimit dhe pagesës se kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit. Deklaratat paraqiten dhe kontributet paguhen në afatet e mëposhtme:

Personi qe detyrohet te paguaje kontributet	*Kontributet qe paguhen*	*Shpeshtesia e deklarimit dhe pageses*	*Afati per deklarimin dhe pagesen*
Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i TVSH	*a) Kontributet qe mbahen nga paga e punemarresve* *b) Kontributet e punëdhënësit per punemarresit*	*Mujore*	*Jo me vone se data 20 e muajit pasardhës*
Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i TVSH	*a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete* *b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes* *c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve* *d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit*	*Mujore*	*Jo me vone se data 20 e muajit pasardhës*
Personi juridik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi biznesin e vogel.	*a) Kontributet qe mbahen nga pagat e punemaresve* *b) Kontributet e punëdhënësit per punemarresit*	*Per çdo tremujor brenda dates 10 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik*	*Jo me vone se datat: 20 Prill;* *20 Korrik;* *20 Tetor;* *20 Janar.*
Personi fizik i regjistruar si tatimpagues i takses vendore mbi biznesin e vogel.	*a) Kontributet e të vetëpunësuarit për vete* *b) Kontributet për punonjësit e papaguar të familjes* *c) Kontributet që mbahen nga paga e punëmarrësve* *d) Kontributet e të vetëpunësuarit për punëmarrësit*	*Per çdo tremujor brenda dates 10 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik*	*Jo me vone se datat: 20 Prill;* *20 Korrik;* *20 Tetor;* *20 Janar.*

Personat e detyruar te paguajne kontribute dorëzojnë në afatet e mësipërme dokumentat që vijojnë:

a) Ne banke dhe ne posten shqiptare sh.a. sipas percaktimit te subjekteve:

- "Formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shendetesore" E-SIG 011-012/a,

b) Në Degën e Tatimeve

- "Listëpagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punësimi" E-SIG 025/a;

- "Pasqyra e të Punësuarve Rishtazi dhe e të Larguarve" E-SIG 027/a (nëse ka të punësuar të rinj ose të larguar); (Çdo person juridik e fizik eshte i detyruar te dorezoje ne degen e tatimeve kete pasqyre nje dite para fillimit te punes se punemarresve te punesuar rishtazi, si dhe brenda 10 diteve per te larguarit nga puna).

- “Pasqyre deklarimi me te dhenat per pagesen e kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te ardhurat Personale” E-SIG 046/a. (Dorezohet vetem nga subjektet qe do te bejne dorezimin e deklarimeve ne format elektronik)

Data e dorëzimit është data kur dokumentet mbërrijnë përkatësisht në bankë; ne posten shqiptare sh.a. dhe në degën e tatimeve. Kur data 20 e muajit, për personat juridike e fizike të regjistruar si tatimpagues të TVSH, si dhe data 20 e muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik, per personat juridike e fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel, qëllon te jete ditë pushimi ose feste zyrtare, kur bankat; posta shqiptare sh.a. dhe degët e tatimeve janë të mbylluara, data e pagesës ose e dorëzimit do të jetë dita e fundit e punës përpara datës së pushimit ose festës zyrtare.

Personat juridike dhe fizike te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se, brenda datës 20 te muajit pasardhes, duhet te kryejne deklarimin e pagesen ne banke ose poste, si dhe të dorezojnë listepagesen në degen e tatimeve.

Personat juridike dhe fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel duhet të deklarojnë dhe të paguajnë në Postë ose Bankë kontributet për sigurimet shoqerore e shendetesore dhe tatimin mbi te ardhurat nga punesimi, në baza tremujore, brenda datës 20 te muajit te parë pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik. Listepagesat, sipas modelit E-SIG 025/a që i bashkangjitet këtij Udhëzimi, përpilohen në baza mujore dhe dorëzohen në degën e tatimeve brenda dates 20 te muajit te parë pas perfundimit te çdo tremujori te vitit kalendarik.

Pagesat paradhenie brenda periudhes tatimore, kryhen me urdher pagese, ndersa pagesa e diferences, apo ”zero”, per periudhen tatimore kryhet me formular deklarimi, i cili permban gjithe detyrimin e periudhes tatimore dhe dorezohet ne banke, pas perfundimit te periudhes tatimore, brenda afatit te caktuar.

Afatet e dorëzimit të të dhënave në formë elektronike janë të njëjta si dhe ato për deklarimet në letër.

5. KONTROLLI, INTERESAT DHE GJOBAT

a. Kontrolli i organeve tatimore

Organet tatimore kane të drejtë dhe duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratat dhe pagesat e kontributeve të detyrueshme janë të plota dhe të sakta. Për ushtrimin e kontrollit organet tatimore kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime si ato të kontrollit tatimor, në mbeshtetje të ligjit nr. 8560 date 22.12.1999 “Për proçedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar. Kur organet tatimore zbulojne se kontributet nuk janë paguar, lëshojnë një njoftim vlerësimi, ku paraqitet shuma e kontributeve shtesë për t’u paguar, së bashku me vlerën e interesave dhe te gjobave që duhen paguar. Pagesa e shumave të vlerësuara bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit të vlerësimit. Organet tatimore kane te drejte te bejne vlerësime si me siper brenda 5 vjetëve nga data kur duhej të ishte depozituar deklarata për periudhën e vlerësuar. Nëse deklarata dorëzohet pas kësaj date, atëherë afati kohor prej 5 vjetësh fillon nga data e dorëzimit. Në rastet e një ndryshimi në vlerësim si rezultat i apelimit ky afat kohor shtyhet sa kohëzgjatja e apelimit.

Per rastet e vleresimeve per kontribute shtese (per diferenca ne numerin e punemaresve ose pagave) subjekti duhet te dorezoje ne degen e tatimeve nje listepagese shtese, me shumen e kontributit te shtuar per çdo punemarres, per periudhen tatimore qe eshte kryer vleresimi. Keto listepagesa regjistrohen dhe administrohen njelloj si dhe listepagesat e dorezuara nga subjekti perpara se te kryhej vleresimi.

Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, organi tatimor ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr. 8560 date 22.12.1999 “Për proçedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 22 të Ligjit 9136, date 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, çdo i punesuar mund të apelojë me shkrim prane Institutit te Sigurimeve Shoqerore dhe/ose Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetsor për llogaritjen e shumes së kontributeve te mbajtura nga punedhenesi. Subjekti punëdhenes dhe personi i vetëpunësuar mund të apelojne me shkrim në organet tatimore, ne perputhje me dispozitat e ligjit nr.8560 date 22.12.1999 “Për proçedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar.

b) Interesat per pagese të vonuar

Nëse kontributet per sigurimet shoqerore e shendetesore nuk paguhen në kohë, mbahen interesa për pagesë të vonuar. Masa e interesit per pagese te vonuar eshte ajo e percaktuar në ligjin nr. 8560 date 22.12.1999 "Për proçedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar. Keshtu, nese kontributet nuk paguhen brenda afateve te percaktuara, personat juridike dhe personat fizike, jane te detyruar te paguajne interesa per pagese te vonuar, qe llogariten mbi shumen e kontributeve te papaguara nga data ne te cilen pagesa ka qene e detyrueshme deri ne daten ne te cilen pagesa kryhet. Në bazë të nenit 19 të Ligjit 9136, date 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë", masa e interesit per pagese te vonuar te kontributeve per sigurimet shoqerore e shendetesore eshte 2 perqind per muajin e pare te voneses ose pjese te tij dhe 1 perqind per çdo muaj apo pjese te tij qe vijon.

Interesat per pagese te vonuar te kontributeve jane te pagueshme automatikisht dhe nuk mund te falen ose zvogelohen, pervecse me ligj. Interesat per pagese te vonuar të kontributeve vleresohen dhe mblidhen ne te njejten menyre, si dhe detyrimet e tjera tatimore.

c) Gjobat

Në bazë të nenit 20 të Ligjit 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë", shkeljet e meposhtme perbejne kundervajtje administrative dhe denohen me gjobe, si me poshte:

1. kur punëdhënësi nuk regjistrohet në organet tatimore gjobitet me 60 000 (gjashtedhjete mije) leke;

2. kur personi që detyrohet të paguajë kontributet, nuk regjistrohet në organet tatimore, gjobitet me 20 000 (njezete mije) leke;

3. kur punëdhënësi dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar sipas këtij ligji dhe paguan me vonese shumen e kontributit, gjobitet me 10 per qind të shumës së kontributit të deklaruar me vonesë, por jo me pak se 10 000 (dhjete mije) leke;

4. kur personi, i detyruar të paguajë kontributet, dorëzon me vonesë deklaratën e kërkuar sipas këtij ligji dhe paguan me vonese shumen e kontributit, gjobitet me 10 000 (dhjete mije) leke;

5. kur punëdhënësi deklaron kontribute më të ulëta, gjobitet me 50 përqind të shumës së kontributit të padeklaruar;

6. kur punëdhënësi mban kontributet e punonjësve, por nuk i paguan ato në organet tatimore, gjobitet me 50 perqind të shumës së kontributit të papaguar. Kur këto kontribute nuk paguhen në organet tatimore edhe pas tre muajve nga data e përcaktuar me ligj, punëdhënësi kallezohet per ndjekje penale. Punedhenesi qe nuk kthen kontributet e mbajtura me teper ndaj punemarresit, sipas percaktimit ne nenin 13 pika 2 të ligjit, gjobitet me 50 përqind te shumës se kontributit të parimbursuar;

7. kur punëdhënësi nuk mban regjistrime, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji, gjobitet me 30 000 (tridhjete mije) leke;

8. kur punëdhënësi nuk jep të dhëna ose pengon punonjësit e organeve tatimore gjatë ushtrimit të kontrollit, gjobitet sipas nenit 53 të ligjit nr. 8560 datë 22.12.1999 "Për proçedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar.

Gjobat i njoftohen tatimpaguesit me njoftim vleresimi ne perputhje me nenin 18 te ketij ligji.

6. VENDI I PAGESËS

Kontributet paguhen në filialet e bankave dhe te postës shqiptare sh.a. drejtoritë e pergjithshme të të cilave kanë kontrata agjentësh me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve Shëndetësore. Këto kontrata përcaktojnë mekanizmin e pranimit dhe transferimit të pagesës, kushtet që duhet të përmbushen dhe proçedurat për raportimin, si dhe të dhënat për pagesat e kryera. Në bazë të VKM nr.771, date 13.11.2003, "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, procedurat teknike per transferimin e shumave te arketuara nga nje llogari bankare ne tjetren percaktohen me marreveshje ndermjet Drejtorise se Pergjitheshme te Tatimeve, instituteve perkatese dhe bankave te nivelit te dyte e drejtorise se postes shqiptare sh.a. Pagesa në valutë do të konvertohet në leke sipas kursit të këmbimit të botuar nga Banka e Shqipërisë për atë ditë që është bërë pagesa.

7. RIMBURSIMI I KONTRIBUTEVE TË PAGUARA TEPËR

Në bazë të nenit 13 të Ligjit 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore në Republikën e Shqipërisë", nëse si rezultat i

një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e kontributeve të paguara tejkalon shumen e llogaritur te detyrimit per kontributin apo per interesin, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, sipas rastit, rimburson diferencën brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës ose nga njoftimi për këtë të fundit. Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi eshte përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

8. TE TJERA

a) Personat juridike e personat fizike jane te detyruar te deklarojne me shkrim ne organin tatimor perkates punemarresit e punesuar rishtazi, nje dite para fillimit te punes. Te larguarit nga puna duhet t'i deklarojne me shkrim brenda 10 diteve.

b) Personat juridike dhe personat fizike, per çdo periudhe tatimore, deklarojne dhe paguajne ne llogarite e deges se tatimeve vetem kontributet bruto. Per punemarresit, qe gjate periudhes tatimore, per nje pjese, apo per gjithe periudhen, nuk kane punuar per aresye se u ka lindur e drejta per te marre perfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqerore, nga subjekti nuk do te paguhen perfitimet ne deklarate dhe listepagese, mbasi perfitimet do te kerkohen dhe meren ne organet e sigurimeve shoqerore. Ne deklarimin dhe listepagesen qe subjekti dorezon perkatesisht ne banke ose poste dhe ne degen e tatimeve nuk perfshihen perfitimet.

c) Ne mbeshtetje te ligjit nr.7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar, kur punemarresi eshte i semure, ose per kujdesjen ndaj femijes qe ka ne ngarkim te semure, te vertetuara me raporte mjekesore, kontributet per sigurimet shoqerore e shendetesore deri ne diten e 14 me raport mjekesor deklarohen njelloj sikur punemarresi te mos jete i semure dhe paguhen sipas percaktimit ne Kodin e Punes, ndersa nga dita e 15 e raportit mjekesor punemaresi i siguruar ka te drejte te mare perfitime per paaftesi te perkoheshme nga fondet e sigurimeve shoqerore mbi bazen e regullave perkatese te ketyre organeve.

d) Ne mbeshtetje te ligjit nr.7703, date 11.05.1993, te ndryshuar, kontributet ndahen, ne perqindje mbi pagen, brenda kufirit minimal e maksimal te miratur me vendim te Keshillit te Ministrave, sipas degeve te sigurimit shoqeror si me poshte:

Nr.	*Dega e Sigurimit shoqeror te:*	*Kontributet ne Perqindje*			
		Per Punemarresit			*Personi fizik (i vetepunesuar) per veten e vet dhe per punonjesit e papaguar te familjes*
		Gjithsej	*Pjesa e Pune dhenesit*	*Nga paga e Pune marrresit*	
1	*Semundjeve (paaftesi perkosh)*	*0.80*			*0.00*
2	*Barrelindjeve*	*2.30*			*2.30*
3	*Pensioneve*	*29.90*			*29.90*
4	*Aksidenteve dhe semundjeve profesionale*	*0.50*	*0.50*	*0.00*	*0.00*
5	*Papunesise*	*5.00*	*5.00*	*0.00*	*0.00*
	Shuma Sigurim Shoqeror	*38.50*	*29.00*	*9.50*	*32.20*
6	*Shuma Sigurim Shendetsor*	*3.40*	*1.70*	*1.70*	*7.00*
	T O T A L I	*41.90*	*30.70*	*11.20*	*39.20*

e) Ne zbatim, te vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 402, datë 11.6.2001, "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i

ndryshuar, punemarresit jane te detyruar te paguajne kontributet dhe sigurohen ne deget e sigurimit shoqeror si me poshte:

- Punemarresit qe punojne me kohe te plote ose te pjeseshme pune per me shume se 24 ore ne javе sigurohen ne menyre te detyrueshme dhe paguajne kontributet perkatese per deget: Semundjeve (paaftesi e perkoheshme per pune), Barrelindjeve, Pensioneve, Aksidenteve dhe semundjeve profesionale, Papunesise, Sigurimit Shendetsor.

- Punemarresit qe punojne me kohe te pjeseshme pune qe zgjat me pak se 24 ore ne jave sigurohen ne menyre te detyrueshme dhe paguajne kontributet perkatese, ne nivelin e pages minimale, per deget: Semundjeve (paaftesi e perkoheshme per pune), Barrelindjeve, Pensioneve, Aksidenteve dhe semundjeve profesionale, Sigurimit Shendetsor.

- Punemarresit me afat me pak se nje jave gjate gjithe vitit me kohe te plote ose te pjeseshme sigurohen ne menyre te detyrueshme dhe paguajne kontributet perkatese per deget: Aksidenteve dhe semundjeve profesionale, Sigurimit Shendetsor.

- Personi fizik per veten e vet dhe per punonjsit e papaguar te familjes, sigurohet ne menyre te detyrueshme dhe paguan kontributet perkatese per deget: Barrelindjeve, Pensioneve, Sigurimit Shendetsor.

- Kursantet dhe studentet, per kohen e praktikes mesimore, sigurohen nga punedhenesi vetem per aksidentet ne pune.

f) Gjithashtu, per kohen qe listepagesa e sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi (E-SIG 025/a), per personin juridik e fizik perkates, eshte likujduar plotesisht, por nga dega e tatimeve nuk eshte derguar akoma në organet e sigurimeve shoqerore, vertetimet per kontributet e paguara, qe kerkojne tatimpaguesit dhe individet kontribues, leshohen zyrtarisht nga organi tatimor perkates. Keto vertetime jane si me poshte:

- Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per pjesemarrje ne tendera.
- Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per tatimpaguesin.
- Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per individet.

Modeli i vertetimeve te mesiperme eshte sipas formateve bashkengjitur ketij udhezimi.

g) Listepagesat origjinale te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi (E-SIG 025/a), nga dega e tatimeve dergohen zyrtarisht, ne organet e sigurimeve shoqerore.

9. BASHKENGJITUR KETIJ UDHEZIMI DHE PJESE E PANDARE E TIJ JANË:

- “Formular i deklarimit dhe pagesës së kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe sigurimeve shendetesore”, (E-SIG 011-012/a)
- “Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punësimi”, (E-SIG 025/a);
- “Pasqyra e të Punësuarve Rishtazi dhe e të Larguarve” (E-SIG 027/a);
- “Kerkese per dorezimin ne format elektronik te te dhenave per kontributet e Sigurimeve Shoqerore, Sigurimeve Shendetesore dhe Tatimit mbi te ardhurat nga punesimi (E- SIG 086/a).
- “Pasqyre deklarimi me te dhenat per pagesen e kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te ardhurat nga punesimi”; (E- SIG 046/a);
- Vertetim “Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per pjesemarrje ne tendera”
- Vertetim “Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per tatimpaguesin”
- Vertetim “Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per individet”.
- Formulari ”Permasat e fletes se listepageses”

10. Ngarkohet Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe deget e saj ne rrethe per zbatimin e ketij Udhezimi.

11. Udhezimi nr.4 date 18.01.2005 dhe nr.4/1, datë 21.01.2005 “Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore”, shfuqizohen.

Ky udhezim hyn ne fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE KONTRIBUTEVE TE SIGURIMEVE SHOQERORE DHE SHENDETESORE

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): **(3)**_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: **(4)**_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: **(5)**_____
Adresa: **(6)**_____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: **(7)**_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

[8] ☐ Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

(9) Totali i pagave mbi te cilat paguhen kontributet (9)

(10) Kontributet per sigurimet shoqerore nga punedhenesi (10)

(11) Kontributet per sigurimet shoqerore nga punemarresi *(pa kontributet shtese)* (11)

(12) Kontributet shtese (sig.shoq. suplementar) (12)

(13) Kontribute per sigurimet SHOQERORE gjithsej *(10+11+12)* (13)

(14) Kontribute per sigurimet SHENDETESORE (14)

(15) TOTALI PER TU PAGUAR *(13+14)* (15)

(16) Numri gjithsej i personave qe duhet te paguajne kontributet sipas listepageses (16)

(17) Numri i personave qe paguajne kontribute ne nivelin e pages minimale sipas listepageses (17)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke
☐ Xhirim
☐ Cek
☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes (Postes) dhe nenshkrimi i nepunesit te Bankes (Postes)

Origjinali - Zyra e Tatimeve
Kopja -Personi i Tatueshem

Numri i Formularit E-SIG 011 - 012/a

Shenimet e Formularit E-SIG 011-012/a

Shenim1: *Periudha Tatimore.* Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVVMM p.sh. 200608.

Shenim2: *Numri Serial.* Kjo rubrike perdoret nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve. Ne deget e painformatizuara, subjektet e TVSH-se shenojne muajin e periudhes tatimore p.sh. shkurt, ndersa subjektet e biznesit te vogel per çdo periudhe tatimore shenojne tremujorin perkates p.sh.: Trem.i pare, i dyte, i trete, i katert.

Shenim 3–7: *Kutiza 3 - 7 Gjeneralitete.* Shenoni te dhenat e subjektit siç kerkohen ne formular dhe tregoni nese te dhenat e paraqitura nuk jane te plota ose kane ndryshuar. Emri i personit fizik kerkohet vetem nese subjekti i regjistruar nuk eshte shoqeri tregetare.

Shenim 8: Nese per periudhen e deklarimit, **bazuar ne regullat ne fuqi**, nuk egziston detyrimi per te paguar kontribute spontoni kutizen nr.8. Shenoni "0" ne kutizat nga 9 deri 17. **Dorezojeni formularin, brenda datave te caktuara**, ne banke ose poste (sipas percaktimit nga organet tatimore).

Shenim 9:
Per te gjithe Personat Juridike dhe Personat Fizike te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se (kudo, perfshire subjektet buxhetore, jobuxhetore dhe OJF-te), si dhe ata te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi Biznesin e Vogel:

a) Ne kutizen nr. 9. Shenoni totalin e pagave mbi te cilat paguhen kontributet qe meret nga listepagesa perkatese.

b) Ne kutizen nr. 10.

- *Person Fizik* si *i vetepunesuar i vetem dhe i vetepunesuar me punonjes te papaguar te familjes (me ose pa punemares)*

Vetem per veten tuaj si person fizik dhe per punonjesit e papaguar te familjes me te cilet punoni e bashkejetoni shenoni te gjithe shumen e kontributeve qe duhet te paguani te llogaritura mbi bazen e pages mujore minimale mbi te cilen llogariten kontributet dhe ne perqindjen e caktuar me VKM.(Kujdes:Perqindja ndryshon nga ajo e punemaresve tuaj). Per shumen e kontributeve per vete dhe per punonjesit e papaguar te familjes mos plotesoni kutizen 11.

- *Person Juridik, si dhe Person Fizik i vetepunesuar me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes).*

Vetem per punemarresit tuaj (perfshire, pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese etj. ne shoqeri), shenoni shumen e gjithe **kontributeve qe perballohen nga punedhenesi** , te llogaritura mbi bazen e pages mujore te punemarresve mbi te cilen llogariten kontributet, brenda kufirit minimal e maksimal dhe ne perqindjen e caktuar.

c) Ne kutizen nr. 11

Person Juridik, si dhe Person Fizik i vetepunesuar me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes).

Vetem per punemarresit tuaj, perfshire, pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese etj. ne shoqeri , shenoni shumen e gjithe kontributeve qe zbriten nga paga e punemarresve, pa perfshire kontributet shtese.

Te Gjitha subjektet:

d) Ne kutizen nr. 12

Plotesohet vetem per kontributet e **sigurimit shoqeror suplementar** qe **sipas ligjit** paguajne nepunesit e shtetit.

e) Ne kutizen nr. 13

Shenoni shumen e kontributeve per **sigurimet shoqerore** per tu paguar qe eshte e barabarte me kutizat 10+11+12.

f) Ne kutizen nr. 14

Shenoni shumen e kontributeve per **sigurimet shendetsore** per tu paguar.

g) Ne kutizen nr. 15

Shenoni shumen e kontributeve nga mbledhja e te dhenave te kutizave 13 dhe 14.

h) Ne kutizen nr. 16.

- *Nga personat juridike e fizike te regjistruar si tatimpagues te TVSH-se*, shenohet numri gjithsej i punonjesve te cilet kane detyrimin per te paguar kontribute ne periudhen e deklarimit, perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter, numer i cili nxirret dhe eshte i barabarte me te dhenat e listepageses mujore per zerin perkates.
- *Nga personat juridike e fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel,* ne kutizen nr.16 do te shenohet shuma gjithsej e numrit te punonjesve, perfshire Personin Fizik per vete, punemarresit e personit juridik dhe fizik, si dhe punonjesit e papaguar te familjes te personit fizik, te cilet kane detyrimin per te paguar kontribute ne periudhen e deklarimit, numer i cili nxirret dhe **eshte i barabarte me shumen e te tre listepagesve mujore te tremujorit** korenspondues per zerin perkates.

i) Ne kutizen nr. 17.

Nga personat juridike e fizike, ne TVSH shenohet shuma e numrit te punonjesve, te cilet paguajne kontribute ne nivelin e pages minimale, numur i cili nxirret nga listepagesa. *Nga personat juridike e fizike ne Biznes te Vogel,* numri eshte **i barabarte me shumen e te tre listepagesve mujore te tremujorit korenspondues** per zerin perkates.

j) KUJDES nga GJITHE SUBJEKTET:

Te gjitha te dhenat per plotesimin e kutizave 9, 10; 11; 12; 13; 14; 15, 16 dhe 17 nxirren dhe jane te barabarta me te dhenat perkatese te pasqyruara ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi

Shenim 10:
Personat Juridike dhe Personat Fizike te regjistruar: si tatimpagues te TVSH.

Duke mbajtur parasysh sa siper; pasi plotesohet, ky formular dorezohet ne banke ose ne poste (sipas percaktimit nga organet tatimore), me pagesen per t'u kryer, **brenda dates 20 te muajit pasardhes, me te dhenat mbi baze mujore**, per pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese etj. ne shoqeri, Personin Fizik per vete, punemarresit e personit juridik dhe fizik, si dhe punonjesit e papaguar te familjes te personit fizik, sipas statusit te tatimpaguesit.

Shenim 11:
Personat Juridike dhe Personat Fizike te regjistruar si tatimpagues te Takses vendore mbi Biznesin e Vogel:

Gjithashtu pasi plotesohet, ky formular dorezohet ne banke ose ne poste (sipas percaktimit nga organet tatimore), me pagesen per t'u kryer, **brenda dates 20 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori** te vitit kalendarik, **me te dhena mbi baze tremujori. (perkatesisht brenda datave: 20 prill; 20 korrik; 20 tetor; 20 janar)**, perfshire, pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese etj. ne shoqeri, personin fizik per vete, punemarresit e personit juridik dhe fizik, si dhe punonjesit e papaguar te familjes te personit fizik, **sipas statusit te tatimpaguesit.**

Shenim 12: **Per dorezimin e formularit mbas kalimit te afateve perkatese, si me siper, zbatohen Interesa e Gjoba sipas ligjit.**

Formulari numer E-SIG 025/a **Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi** **1)Faqja ___nga ___**

2)NIPT-i _____ ; 2) Emri i Tatimpaguesit _____;3) Periudha tatimore Viti .... Muaji .. ; 4) Rrethi _____

2)Statusi i Tatimpaguesit _____ (VVVV MM)

NR	5) Numeri i sigurimit shoqeror	6) Emri Mbiemri	7) Numeri i Kategorise te punemarresit per sigurimet shoqerore	8) Dite kalendarike pa punuar gjate muajit (e drejta per perfitime nga sigurimet shoqerore)	9) Dite kalendarike te punuara te subjekti gjate muajit	Paga bruto ne leke		Kontribute per sigurimet shoqerore ne leke				16) Kontribute per sigurimet shendetesore gjithsej ne leke	17) Paga bruto mbi te cilen llogaritet Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi	18) Tatimi mbi te ardhurat nga punesimi ne leke
						10) Gjithsej	11) Mbi te cilen llogariten kontributet	12) Gjithsej = (13+14+15)	Nga keto: 13) Punedhenesi	14) Punemaresi	15) Kontribut shtese			
	Shuma e faqes													
	Shuma e mbartur													
	Shuma e transferuar ne faqen nr ___ ose													
	Totali i Listepageses (fshije njeren sipas rastit)													

DEKLAROJ qe:

19) Listepagesa ka gjithsej _____punonjes qe paguajne kontribute; nga keta _____ punonjes qe paguajne kontribut ne nivelin e pages minimale dhe _____ punonjes qe paguajne tatim ardh. punesimi

PERFAQESUESI i Personit Juridik/Fizik

( ) emer mbiemer, firme; juridiku edhe vule; ne çdo faqe

VERTETOJ qe:

Listepagesa gjithsej mbyllet me nr. rend. _____ dhe ka gjithsej _____ faqe

Listepagesa u muar dorezim ne Degen e Tatimeve ne daten _____

Inspektori i Deges Tatimeve marres ne dorezim

( ) firme ne çdo faqe

Shenime per plotesimin e Formularit E-SIG 025/a

Listepagesa e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi

1) Nese ju plotesoni me shume se nje faqe shenoni numrin e faqes dhe numrin gjithsej te faqeve

2) Shenoni numrin tuaj te NIPT-it; emrin e regjistruar ne degen e tatimeve; statusin e subjektit, p.sh. regjistruar ne TVSH apo regjistruar ne biznes te vogel si person Juridik, apo si Fizik (I vetepunesuar) dhe si i vetepunesuar je: i vetem, me punemarres, me punonjes te papaguar te familjes, me punemarres dhe me punonjes te papaguar te familjes.

3) Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09 ku shifra MM eshte muaji i listepageses. Per cdo muaj kalendarik duhet te dorezohet nje listepagese.

4) Shenoni emrin e rrethit ku subjekti ushtron veprimtarine ekonomike. Nese veprimtaria ekonomike e juaj kryhet ne me teper se nje rreth, dorezoni nje pasqyre me vete per secilin rreth ku ushtroni veprimtari ekonomike. Pasqyrat dorezohen ne degen e tatimeve ku subjekti ka te regjistruar qendren e ushtrimit te aktivitetit.

5) Shenoni ne kete kolone numrin e sigurimeve shoqerore (NSSH) çdo punemarresi.

Shenim 1: ***Personi Fizik:*** I vetepunesuar i vetem dhe me punonjes te papaguar te familjes (me ose pa punemarres), per veten e vet dhe per punonjesit e papaguar te familjes do te lere bosh kollonat 10, 13, 14 dhe 15. Per punonjesit e papaguar te familjes ne reshtin e kolonave 13, 14 dhe 15 do te shenoje lidhjen e te vetepunesuarit me punonjesit te papaguar te familjes me te cilet personi fizik punon e bashkejeton, p.sh. gruaja, i biri, e bija, etj. **Formularin do ta dorezoni edhe kur punoni si i vetepunesuar i vetem**.

6) Shenoni emrin e mbiemrin e cdo punemarresi kundrejt NSSH te cdo personi me te dhenat e mjaftueshme per te identifikuar personin.

7) Shenoni numrin e kategorise se punemarresve, kur nuk punojne me kohe te plote, si vijon: 1 - nuk kerkohet plotesimi (numer i paracaktuar per punemarresit me kohe te plote); 2—punuar me kohe te pjeseshme (me pak se 24 ore/jave); 3- punuar si i perkohshem (me pak se 1 jave gjate vitit); 4—punemarresit e tjere; 5-nuk perdoret; 6-punonjes i papaguar i familjes; 7-nuk perdoret; 8-persona ne kurse dhe studente ne praktika mesimore.

8) Shenoni ditet kalendarike te pa punuara gjate muajit nga punemarresi, per ato raste qe ai duhet te marre perfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqerore, p.sh. dite raport paaftesie te perkoheshme (duke filluar nga dita e 15 e raportit), dite me leje barrelindje; etj. perfitime sipas ligjit. Neqoftese nje punemarres per te gjithe muajin ka qene me raport, apo leje barrelindje etj. perfitime nga skema e sigurimeve shoqerore, emri i tij do te pasqyrohet ne listepagese, do te shenohet numeri i te gjitha diteve te muajit, ndersa kolonat e tjera nuk plotesohen.

9) Shenoni ditet kalendarike te muajit ne te cilat punemarresi ka punuar tek subjekti juaj. Keto dite te punuara duhet te jene te rakorduara me deklarimet e dorezuara gjate muajit ne degen e tatimeve me formularet "Pasqyra e te punesuarve rishtazi dhe e te larguarve nga puna". Ketu do te shenoni dhe ditet me raport deri ne diten e 14 me raport per te cilat punemaresi paguhet sipas Kodit te Punes dhe i llogariten kontribute.

10) Shenoni pagen bruto gjithsej qe i keni dhene punemarresit gjate muajit. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër, per efekt te pageses se kontributeve dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi trajtohen njelloj si gjithe punëmaresit e tjere te subjektit. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes kete kolone e le bosh.**

11) Shenoni pagen gjithsej mbi te cilen llogariten kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne perputhje me kerkesat e VKM nr. 402, date 11.06.2001 (i ndryshuar) dhe VKM nr. 771, date 13.11.2003 (i ndryshuar). Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose çdo funksion tjetër trajtohen njelloj si çdo punëmarrës tjetër i subjektit. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes shenon pagen minimale sipas VKM**. Per me shume sqarime, referojuni udhezuesit per punedhenesit dhe te vetepunesuarit.

12) Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore per tu paguar nga punedhenesi, punemarresi dhe kontributin shtese. Mblidhni shumen e kolones 12 dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne pasqyre duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e periudhes korensponduese.

13) Shenoni kontributin e sigurimeve shoqerore per tu paguar nga punedhenesi gjate muajit sipas pages mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes kete kolone e le bosh**. Shuma e pasqyres duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e periudhes korensponduese.

14) Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore te mbajtur ne burim nga punedhenesi per punemarresin sipas pages mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes kete kolone e le bosh**. Shuma e listepageses duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten periudhes korensponduese.

15) Shenoni kontributet **per sigurimin shoqeror suplementar** gjithsej te mbajtura ne burim gjate muajit. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten per muajin korrespondues. (Kjo kollone plotesohet vetem **per nepunesit shteterore te percaktuar me ligjin** perkates)

16) Shenoni shumen gjithsej te kontributeve per sigurimet shendetesore per çdo punemarres gjate muajit, duke u bazuar ne pagen mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e periudhes korensponduese.

17) Shenoni pagen bruto qe i keni paguar punemarresit gjate muajit dhe qe eshte baza per llogaritjen e tatimit mbi te ardhurat nga punesimi sipas kerkesave te Ligjit per Tatimin mbi te Ardhurat nr.8438, date 28.12.1998, i ndryshuar. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes kete kolone e le bosh**. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me shumen perkatese te pasyruar ne deklaraten e periudhes korensponduese.

18) Shenoni tatimin mbi te ardhurat nga punesimi te mbajtur ne burim nga paga e çdo punemarresi gjate muajit. **Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes kete kolone e le bosh**. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listpagese duhet te jete e barabarte me tatimin mbi te ardhurat nga punesimi te pasqyruar ne deklaraten e periudhes korensponduese.

19) Shenoni numrin e punonjesve qe paguajne kontribute; nga keta sa paguajne kontribute ne nivelin e pages minimale sipas VKM; si dhe numrin e punonjesve qe paguajne tatim mbi te ardhurat nga punesimi. Ky numer do te dale nga numerimi ne listepagese i punonjesve qe paguajne kontribute dhe i atyre qe paguajne tatim mbi te ardhurat nga punesimi per periudhen tatimore perkatese. Keto numra nuk mund te jene te barabarte me numrin gjithsej te punonjesve qe permban listepagesa, sepse ne listepagese jane te regjistruar edhe punonjesit qe per gjithe muajin kane qene me raport paaftesie te perkoheshme, leje barrelindje etj. perfitime nga skema e sigurimeve shoqerore; etj. raste. Numri i punonjesve ne kete rubrike duhet te jete i rakorduar me numrat qe permban deklarata E-SIG011-012/a dhe pasqyrat e te punesuarve rishtazi dhe te larguarve te dorezuara ne degen e tatimeve gjate muajit korrespondues.

Shenim 2: Ky formular perdoret per te pasqyruar parate qe ju duhet t'u mbani ne burim punemarresve tuaj per kontributet e sigurimeve shoqerore ; kontributet e sigurimeve shendetesore; si dhe tatimin mbi te ardhurat nga punesimi. Origjinali i ketij formulari, mbasi perpunohet nga organet tatimore *dergohet zyrtarisht ne organet e sigurimeve shoqerore ku arkivohet dhe perdoret per te vertetuar perfitimet* qe i *takojne te mare nga skema e sigurimeve shoqerore çdo punonjesi qe ka paguar kontribute*. **Neqoftese nuk dorezohet ky formular nuk mund te evidentohen kontributet e paguara per çdo person.**

Shenim 3: Formulari i listepageses duhet te perdoret se bashku me formularet perkates te deklarimit dhe pageses per: - kontributet e sigurimeve shoqerore dhe sigurimeve shendetesore dhe ate per TAP.

Shenim 4: - **a)** *Pesona Juridike e Fizike, te regjistruar si tatimpagues te TVSH:* **Per çdo muaj, brenda dates 20 te muajit ne vijim te muajit te deklarimit**, perfshire dhe personin fizik te vetepunesuar per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes, ju duhet te dorezoni Listepagesat e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi drejteperdrejt ne degen e tatimeve.

- b) *Persona Juridike dhe fizike te regjistruar si tatimpagues te takses vendore mbi biznesin e vogel*: **Per çdo tremujor, brenda datës 20 te muajit të parë pas perfundimit** të çdo tremujori të vitit kalendarik, perfshire dhe personin fizik te vetepunesuar per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes, **ju duhet te dorezoni drejteperdrejt ne degen e tatimeve nga nje listepagese (te hartuar mbi baza mujore), per çdo muaj te tremujorit**, dorezimi duhet te behet perkatesisht sipas tremujoreve **brenda datave: 20 prill, 20 korrik, 20 tetor, 20 janar.** Per dorezimin e Listepageses mbas kalimit te afateve, si me siper, **zbatohen Interesa e Gjoba sipas ligjit.**

Shenim 4: **Mblidhni shumat e kolonave** dhe kaloni shumat ne faqen tjeter ose shenoni shumat totale per çdo kolone te pasqyres.

Shenimi 5: **Vleresimet e organeve tatimore**, per **kontribute shtese**, jane rjedhoje e diferencave nga deklarimet: **a)** per numerin e punonjesve **b)** per pagat e tyre. Ne keto raste çdo Person Juridik e Fizik, duhet te dorezoje ne degen e tatimeve **nje listepagese shtese**, me shumen e kontributeve te shtuara, per ate periudhe tatimore qe eshte kryer vleresimi.

Formulari numer E-SIG 027/a 1) **Pasqyra e te punesuarve rishtazi dhe e te larguarve nga puna** Nr.____, date _____ 2) Faqja ___

3)NIPT-i _____;3) Emri i Tatimpaguesit _____;4)Periudha tatimore Viti .... Muaji .. ; 5)Rrethi _____

3) Statusi i Tatimpaguesit _____ (V V V V MM)

Te punesuarit rishtazi (te mare) ne pune gjate muajit				Te larguarit nga puna gjate muajit			
Nr	Numeri i Sigurimit Shoqeror	Emri e Mbiemri	Data e Fillimit te punes	Nr	Numeri i Sigurimit Shoqeror	Emri e Mbiemri	Data e largimit nga puna

6) Lidhur me sa me siper D E K L A R O J që:
duke filluar nga data _____ numeri total i punonjesve qe punojne ne kete subjekt dhe paguajne kontribute eshte _____ vete.
PERFAQESUESI i Personit Juridik/Fizik
( )
(emer mbiemer, firme, personi juridik edhe vule)

VERTETOJ që:

Pasqyra ka _____ te punesuar gjate muajit dhe _____ te larguar nga puna gjate muajit
Pasqyra u muar dorezim ne Degen e Tatimeve me date _____

Inspektori i Deges Tatimeve marres ne dorezim
( )

Shenime per plotesimin e Formularit E-SIG 027/a
"Pasqyra e te Punesuarve Rishtazi dhe e te Larguarve nga puna"

1) Kjo pasqyre plotesohet nga subjektet juridike e fizike, te regjistruar ne TVSH apo ne biznesin e vogel.
Nga Personat Fizike, me kete pasqyre, raportohen edhe punonjesit e papaguar te familjes, ne te gjitha rastet e punesimit rishtazi apo largimit nga puna te tyre.
Pasqyra plotesohet e dorezohet qofte dhe per nje te punesuar rishtazi apo te larguar te vetem pavaresisht nga numeri i diteve kalendarike. Pasqyra dorezohet ne degen e tatimeve sa here qe te subjekti ndodhin ndryshime ne numerin e te punesuarve.

- Per punonjesit e punesuar rishtazi kjo pasqyre dorezohet ne degen e tatimeve nje dite para fillimit te punes nga ana e tyre. I punesuar rishtazi do te kosiderohet dhe nje punonjes qe mund te kete punuar te subjekti ne periudhat e kaluara apo edhe brenda muajit, eshte larguar dhe sërish rikthehet te punoje.
- Per punonjesit qe largohen nga puna kjo pasqyre dorezohet ne degen e tatimeve brenda 10 (dhjete) diteve mbas largimit te tyre nga puna. Me kete pasqyre do te deklarohet dhe nje i punesuar qe mund te kete punuar te subjekti periudhat e kaluara apo dhe ne muajin ne vazhdim dhe eshte larguar, eshte rikthyer dhe perseri largohet gjate muajit, pa arsye ose me arsye (si, raport mjekesor mbas dites se katermbedhjete; leje barrelindje. etj).

Për sejcilën pasqyrë që subjekti dorëzon në degën e tatimeve i vendos numrin rendor dhe datën. Duhet te ruhet numeri rendor rites nga pasqyra paraardhese ne ate pasardhese.
2) Nese ju plotesoni me shume se nje faqe shenoni numrin e faqes dhe numrin gjithsej te faqeve
3) Shenoni numrin tuaj te NIPT-it; emrin e regjistruar ne degen e tatimeve; statusin e subjektit, p.sh. regjistruar ne TVSH, apo regjistruar ne biznesin e vogel si person Juridik, apo si Fizik (I vetepunesuar) dhe si i vetepunesuar je: i vetem, me punemarres, me punonjes te papaguar te familjes, me punemarres dhe me punonjes te papaguar te familjes.
4) Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09 ku shifra MM eshte muaji i listepageses.
5) Shenoni emrin e rrethit ku subjekti ushtron veprimtarine ekonomike. Nese veprimtaria ekonomike e juaj kryhet ne me teper se nje rreth, dorezoni nje pasqyre me vete per secilin rreth ku ushtroni veprimtari ekonomike.
6) Deklarohet numeri gjithsej i punonjesve qe punojne te subjekti duke filluar nga data qe permban pasqyra.
Ky numer rakordohet duke u nisur nga numeri i punonjesve sipas raportimit te meparshem mbi te cilin behen shtesat e paksimet sipas kesaj pasqyre.
Numeri total i punonjesve i deklaruar gjate periudhes tatimore me pasqyren e fundit te te punesuarve rishtazi dhe te larguarve nga puna, duhet te jete i rakorduar me numerin e punonjesve qe paguajne kontribute dhe tatim mbi te ardhurat nga punesimi ne formularin e deklarimit dhe pageses se kontributeve dhe ne listepagesen e kontributeve te sigurimeve shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi te periudhes korensponduese.
Ne numerin total te punonjesve perfshihen, sipas perkatesise, edhe personi fizik (i vetepunesuari) e punonjesit e papaguar te familjes, si dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese te subjekti si administratore ose çdo funksion tjeter.
Shenim : - Ne kete pasqyre nga te gjithe subjekte juridike e fizike deklarohen punonjesit qe punesohen rishtazi apo qe largohen nga puna gjate periudhes se deklarimit perfshire dhe punonjesit e papaguar te familjes te personit fizik.
- Ky formular mbahet ne Degen e Tatimeve dhe shfrytezohet per efekte vleresimesh dhe kontrolli nga organet tatimore.
- Subjekti duhet te marre nje kopje te ketij formulari, te firmosur nga inspektori marres ne dorezim i deges se tatimeve, per te vertetuar daten e dorezimit te tij.

Formulari E-SIG086/a

KËRKESË PËR DORËZIMIN NË FORMAT ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE PËR KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE, SIGURIMEVE SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA PUNESIMI

NIPT-i:	1.	
Emri i subjektit:	2.	
Adresa e subjektit: *Rruga* *Qyteti* *Rrethi*	3.	
Telefoni i zyrës:	4.	Email: 5.
Emri i kontaktit dhe numri i telefonit: *Shih shënimin 1*	6.	

Shënim 1: Personi i kontaktit i dhënë duhet të jetë një person që është në gjendje të përgjigjet për çdo pyetje që lidhet nga të dhënat e dorëzuara

7.
Deklaratë
Unë deklaroj:
Kam lexuar "Kushtet për dorëzimin në format elektronik të të dhënave për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punesimi";
Unë pajtohem me këto kushte;
E kuptoj që dorëzimi i të dhënave në format elektronik është një deklarim i përcaktuar në Ligjin nr. 9136 datë 11.9.03, i ndryshuar, Neni 10 dhe se për nga pikëpamja e gjobave dhe interesave, këto të dhëna do të trajtohen njëlloj si dhe ato të dorëzuara në letër.

Nënshkrimi dhe data:	*Nënshkrimi*	*Datë*
Emri i plotë me gërma SHTYPI dhe pozicioni ose statusi:	*Emri*	*Statusi*

Për përdorim zyrtar	Marrë	Datë
Data e mberritjes		
Verifikimi i NIPT-it		
Testimi i mostrës së përdorur për transferimSample media tested	I Kënaqshëm / Jo i kënaqshëm*	
Dhënia/Refuzimi i Autorizimit*		
Numri i autorizimit		

*Fshini sipas rastit

KUSHTET PËR DORËZIMIN ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE PËR KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE, SIGURIMEVE SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA PUNESIMI

Kushtet e përgjithshme

1. Formulari i deklarimit dhe pagesës duhet të dorëzohet në bankë sipas proçedurës së zakonshme.

2. Dorëzimi i elektronik i të dhënave duhet të bëhet sipas formatit të përcaktuar në Aneksin 1 ose 2. Nëse nuk e bëni një gjë të tillë, deklarata do të konsiderohet si jo e kryer dhe ju do të paguani gjobat që parashikohen për mosdorëzim të dhënash. Të dhënat duhet të shoqërohen nga një deklaratë e vetme (duke përdorur Formularin E-SIG046/a) që informacioni i përmbajtur në skedarin përkatës nuk është i plotë dhe i pasaktë.

3. Të dhënat elektronike duhet të dorëzohen në degën e tatimeve ku jeni te regjistruar jo më vonë se data e përcaktuar për dorëzimin e deklaratës në letër. Ashtu sikurse të dhënat e punëmarrësit përbëjnë një kërkesë ligjore te deklaratës, mosdorëzimi i të dhënave në kohë do të thotë që deklarata është e vonuar.

Mjeti i shkëmbimit

4. Të dhënat duhet të dorëzohen në një disketë 1.4MB të formatuar në Microsoft Windows®- ose një CD-ROM që mund të lexohet duke përdorur Microsoft Windows®.

5. Mjeti i shkëmbimit duhet të etiketohet me emrin dhe NIPT-in e punëdhënësit dhe për periudhën të deklarimit për të cilën janë paraqitur këto të dhëna.

Formati

6. Të dhënat duhet të dorëzohen si skedar tekst që përmban një regjistrim Titull ku përcaktohen informacioni i kontributeve për çdo punonjës dhe rreshtat e të dhënave ku jepet informacioni për kontributet e kërkuara për secilin punëmarrës. Skedari duhet të jetë i formatuar në përputhje me përcaktimin e shkëmbimit të të dhënave në Aneksin A ose me skemanë XML në Aneksin B.

7. Përpara se të japim miratimin për dorëzimin elektronik të të dhënave, për qëllimet e testimit dhe vlerësimi duhet të dorëzohet një mostër të dhënash në DPT.

Për përdorim nga zyra	Emri	Datë	Nënshkruar
Testi i të dhënave i përfunduar me sukses:			
Përdorimet e miratuara nga:			

Aneksi A: Përcaktimi i Shkëmbimit të të Dhënave

TITULLI I DEKLARATËS (Për çdo punëmarrës)

Elementi të Dhëna	Pozicioni			
	Gjatësia	Nga	Për	D / Z
Treguesi i Elementit = TITULLI	6	1	6	D
NSSH (NI Kombëtar)	10	7	16	D
Emri i Punëmarrësit	20	17	36	D
Paga për Kontributet	15	37	51	D
Kontributet Gjithsej të Punëdhënësit	15	52	66	D
Kontributet Gjithsej të Punëmarrësit	15	67	81	D
Kontributet Bruto	15	82	96	D
Kontributet Shtese	15	198	212	Z
Data e Fillimit (DD/MM/VVVV)	10	127	136	Z
Data e Largimit (DD/MM/VVVV)	10	137	146	Z
Kontributet Shëndetësore	15	147	161	D
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punesimi	15	162	176	D
Periudha Tatimore (VVVV/MM)	11	177	187	D
NIPT-i i Punëdhënësit	10	188	197	D
Paga e Tatueshme	15	213	227	D
Kodi NACE (Sipas NIPT-it)	5	228	232	Z
Kodi i Kategorise (1-8)	1	233	234	D
Rrethi	2	235	236	C

Legjenda

D=e Detyrueshme, Z= me Zgjedhje

Aneksi B: Skema XML

```
<?xml version ="1.0">
<!ELEMENT DECLARATION (#PCDATA)>
<!ELEMENT HEADER(NI_Kombetar, Emri, Paga_per_Kontribute, Kontributi_i_Punedhenesit,
Kontributi_i_Punemarresit, Kontributi_Bruto, Perfitimet, Kontributi_Neto, Data_e_Fillimit,
Data_e_Largimit, Sigurimet_Shendetesore, Tatimi_mbi_te_Ardhurat, Periudha_Tatimore,
NIPT_i_Punedhenesit, Kontribut_Shtese, Paga_e_Tatueshme, NACE, Kategoria, Rrethi)>
<!ELEMENT NI_Kombetar (#PCDATA)>
<!ELEMENT Emri (#PCDATA)>
<!ELEMENT Paga_per_Kontribute (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_i_Punedhenesit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_i_Punemarresit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_Bruto (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontribut_Shtese(#PCDATA)>
<!ELEMENT Data_e_Fillimit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Data_e_Largimit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Sigurimet_Shendetesore (#PCDATA)>
<!ELEMENT Tatimi_mbi_te_Ardhurat (#PCDATA)>
<!ELEMENT Periudha_Tatimore (#PCDATA)>
<!ELEMENT NIPT_i_Punedhenesit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Paga_e_Tatueshme (#PCDATA)>
<!ELEMENT NACE (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kategoria (#PCDATA)>
<!ELEMENT Rrethi (#PCDATA)>
<!ELEMENT DETAIL (NI_Kombetar, Kodi, Shuma, Dita, Periudha_Tatimore)>
<!ELEMENT NI_Kombetar (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kodi (#PCDATA)>
<!ELEMENT Shuma (#PCDATA)>
<!ELEMENT Dita (#PCDATA)>
<!ELEMENT Periudha_Tatimore(#PCDATA)>
```

Formulari E-SIG046/a

PASQYRE DEKLARIMI ME TË DHËNAT PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT NGA PUNESIMI

NIPT-i:		1.
Emri i subjektit:		2.
Adresa e subjektit:	*Rruga* *Qyteti* *Rrethi*	3.
Telefoni i zyrës:	4.	Email: 5.
Emri i kontaktit dhe numri i telefonit: *Shih shënimin 1*		6.

Shënim 1: Personi i kontaktit i dhënë duhet të jetë një person që është në gjendje të përgjigjet për çdo pyetje që lidhet nga të dhënat e dorëzuara

Numri i autorizimit:	7.

8. Deklaratë

Unë deklaroj:

Pasqyrat me të dhëna të dërguara sëbashku me këtë formular janë të dhënat e kërkuara sipas Ligjit nr. 9136 datë 11.9.2003, i ndryshuar, Nenet 10 dhe 11 dhe përbëjnë pjesë të deklarimit për Sigurimet Shoqërore, Sigurimet Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi të dorëzuara për periudhën tatimore deri në datën 20 të muajit [muaji_____] [Viti_____];

Në rastet e dorëzimit në format elektronik, të dhënat përputhen me "Kushtet për dorëzimin elektronik të të dhënave për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punesimi.

E kuptoj që dorëzimi i të dhënave në format elektronik është një deklarim i përcaktuar në Ligjin nr. 9136 datë 11.9.2003, i ndryshuar; Neni 10 dhe se për nga pikëpamja e gjobave dhe interesave, këto të dhëna do të trajtohen njëlloj si dhe ato të dorëzuara në letër.

Kjo pasqyrë është një pasqyrë [origjinale/e ndryshuar]* *fshij sipas rastit

Nënshkrimi dhe data:	*Nënshkrimi*	*Datë*
Emri i plotë me gërma SHTYPI dhe pozicioni ose statusi:	*Emri*	*Statusi*

Për përdorim zyrtar [E zbatueshme vetëm për të dhënat në format elektronik]**		
Marrë	Datë	Nënshkrimi
Kontrolli për viruset**		
Kontrolli i formatit**		
Marrja e të dhënave		

Numeri i Formularit. E-SIG 01/a

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Dega e Tatimeve _____
Nr. _____ Prot.

Nr. serial _ _ _ _ _ _ _

Ne_____ me _____

VERTETIM

(Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore **per pjesmarje ne TENDER**)

Ne pergjigje te kerkeses te Z. ....., perfaqesues i Personit Juridik / Fizik .... me numer NIPT-i ....., i cili pergatitet te mare pjese ne tenderin qe zhvillohet ne daten ....., sipas fteses te bere nga enti prokurues(institucioni)..... ....., me objekt prokurimi ....., me vlere ..... leke, me vendndodhje ne ....., vertetojme se:

Per, deri, kater muajt e fundit nga muaji i plotesimit te ketij vertetimi, ne mbeshtetje te formulareve "Listepagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi" E-SIG 025/a, te cilat jane te likuiduara plotesisht, por qe ne daten _____ ndodhen akoma degen e tatimeve, Tatimpaguesi ka paguar kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore si me poshte:

Nr	Muaji	Viti	Numeri i Kontribuesve (me shifra)	Numeri i Kontribuesve (me shkrim)

Tatimpaguesi ka paguar rregullisht detyrimet e kontributeve per sigurimet shoqerore e shendetesore deri ne muajin ..... Viti.....

(OSE) Tatimpaguesi nga muaji ..... Viti..... eshte debitor per shumen e kontributeve prej ..... (.....) leke.

V.O! *KY VERTETIM ESHTE I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.*
Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arkivohet sipas rregullave.

Kryetari i Deges Tatimeve
(.....)

Vula

Numeri i Formularit E-SIG 02/a

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Dega e Tatimeve _____
Nr. _____ Prot.

Ne_____,me_____

VERTETIM

(Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore **per Tatimpaguesin**)

Vertetojme se Personi Juridik / Fizik _____, i perfaqesuar nga Z. _____, ne mbeshtetje te formulareve "Listepagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi" E-SIG 025/a, te cilat jane te likujduara plotesisht, por qe ne daten _____ ndodhen akoma degen e tatimeve, ka paguar kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore si me poshte:

Nr	Muaji	Viti	Numeri i Kontribuesve (me shifra)	Numeri i Kontribuesve (me shkrim)

Vertetimi leshohet me kerkesen e Personit. Kopja e vertetimit administrohet ne Degen e Tatimeve.

V.O! *KY VERTETIM ESHTE I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.*
Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arkivohet sipas rregullave

Kryetari i Deges Tatimeve

(.....)
vula

Numeri i Formularit E-SIG 03/a

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Dega e Tatimeve _____
Nr. _____ Prot.

Ne_____,me_____

VERTETIM

(Per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore **per Individin**)

Vertetojme se nga Personi Juridik / Fizik _____, i perfaqesuar nga Z. _____, ne mbeshtetje te formulareve "Listepagesa e kontributeve per sigurimet shoqerore, shendetesore dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi" E-SIG 025/a, te cilat jane te likujduara plotesisht, por qe ne daten _____ ndodhen akoma degen e tatimeve, ne emrin e Z. _____ , i identifikuar me numer sigurimi shoqeror _____ jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore si me poshte:

Nr	Muaji	Viti	Leke (me shifra)	Leke (me shkrim)

Vertetimi leshohet me kerkesen e Tatimpaguesit ose te personit ne emrin e te cilit jane paguar kontributet. Kopja e vertetimit administrohet ne Degen e Tatimeve.

V.O! *KY VERTETIM ESHTE I VLEFSHEM KUR NUK KA ASNJE KORIGJIM.*
Nje kopje e ketij Vertetimi me siglen e Inspektorit pergjegjes ruhet ne protokoll dhe arkivohet sipas rregullave

Kryetari i Deges Tatimeve

(.....)
vula

Permasat e fletes se listepageses



UDHËZIM
Nr.5, datë 30.1.2006

PËR TATIMIN MBI TE ARDHURAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqiperise, si dhe në zbatim të nenit 40 të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat'', i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Objekti i ligjit

Objekt i tatimit mbi të ardhurat janë të ardhurat personale të individeve, fitimi i personave fizikë e juridikë subjekte të këtij Ligji, si dhe të ardhurat për të cilat tatimi mbahet në burim.

1.2 PËRKUFIZIM

1.2.1 Termat: "tatimpagues", "person", "individ", "person fizik", "person juridik", "ortakëri", "persona të lidhur" dhe "seli e përhershme", etj, kuptimi i të cilave jepet në ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat", do të kenë të njëjtin kuptim si edhe në ligjet e tjera specifike tatimore dhe në terminologjinë e përdorur në Marrëveshjet dypalëshe për eliminimin e tatimeve të dyfishta që Shqipëria ka lidhur me shtete të tjera. Për interpretimin e dispozitave të këtij ligji, veç këtij Udhëzimi, do të merren në konsiderate, sipas rastit, edhe dizpozitat e ligjeve të tjera tatimore dhe të Marrëveshjeve për eleminimin e tatimeve të dyfishta, si dhe të Udhëzimeve të Ministrit të Financave të dala në zbatim të tyre.

1.2.2. Paragrafi "2" i nenit "2" të Ligjit, sqaron kuptimin e "selisë së përhershme", e cila nënkupton një vend fiks biznesi, nëpërmjet së cilit një person (juridik apo fizik) i huaj ushtron biznes në Republikën e Shqipërisë pa qenë i regjistruar si person juridik apo fizik sipas legjislacionit Shqiptar. Përkufizimi i "selisë së përhershme" është i ngjashëm me përkufizimin e këtij koncepti nga "Modeli i Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin" botim i OECD-së, Prill 2000, si edhe me përkufizimin e këtij termi në Marrëveshjet Bilaterale Tatimore për Eleminimin e Tatimeve të Dyfishta të hyra ne fuqi ne Shqiperi. Për pasojë në interpretimin e dispozitave që lidhen me selinë e përhershme do të merren në konsideratë edhe sqarimet e bëra në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.6 datë 10.2.2004 "Për Marrëveshjet Bilaterale për Shmangien e Taksimimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal".

Në rastet kur një biznes plotëson kushtet për t'u konsideruar si seli e përhershme (vend fiks biznesi) në Republikën e Shqipërisë, atëhere të ardhurat që i atribuohen kësaj selie të përhershme tatohen në Republikën e Shqipërisë, sipas dispozitave te akteve ligjore mbi tatim fitimin.

1.3 REZIDENCA

1.3.1 Në nenin 3 të ligjit jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës tatimore për individët (paragrafët 1 dhe 2), për personat juridikë (paragrafi 3) dhe për personat fizikë (paragrafi 4).

Në paragrafin e parë të pikës 1 jepet kriteri i vëndbanimit të përhershëm, sipas përcaktimit në nenin 12 të Kodit Civil. Individi konsiderohet rezident shqiptar për qëllime tatimore, kur ka një banesë të përhershme, ka familjen, pra ka interesa jetësore dhe ekonomike në Shqiperi (vendi i interesave jetike), pavarësisht se mund të punojë në periudha të ndryshme jashtë vendit apo mund të ketë nënshtetësi të huaj.

Paragrafi i dytë i pikës 1 ka të bëjë me diplomatët dhe punonjësit e tjerë shqiptarë të caktuar me punë nga shteti në ambasada, konsullata apo në organizma ndërkombëtare jashtë vendit, të cilët konsiderohen rezidentë tatimorë shqiptarë edhe pse jetojnë me vite jashtë Shqipërisë.

Në pikën 2, jepet kriteri i kohëgjatësisë së qëndrimit në Shqipëri. Pra konsiderohet rezident shqiptar për qëllime tatimore, individi që qëndron në Shqipëri gjatë një viti tatimor, në vazhdim ose me ndërprerje, në total, më tepër se 183 ditë, pavarësisht nga nënshtetësia apo vendi ku ka interesat jetike. Në llogaritjen e kohëgjatësisë së qëndrimit në Shqipëri përfshihen ditët e presencës fizike, pra jo vetëm ditët e punës por edhe ditët e mbërritjes, largimit, pushimet.

Konsiderohet rezident tatimor Shqiptar çdo individ që plotëson njerin ose të dy kriteret e sipër-përmendura (kriterin e vend-banimit dhe kriterin e kohëgjatësisë së qëndrimit).

1.3.2 Në pikën 3 jepen kriteret e përcaktimit të rezidencës tatimore për personat juridikë. Një person juridik konsiderohet rezident tatimor Shqiptar nëse: (i) ka selinë qëndrore (zyrën qëndrore) në Republikën e Shqipërisë; dhe/ose (ii) ka vendin e menaxhimit (drejtimit) efektiv të biznesit në Republikën e Shqipërisë.

1.3.3 Në pikën 4 jepet kriteri i përcaktimit të rezidencës tatimore për personat fizikë tregtarë. Një person fizik konsiderohet rezident tatimor Shqiptar kur ushtron biznesin dhe regjistrohet si person fizik tregtar në Gjykatën Shqiptare dhe në organet tatimore Shqiptare.

1.3.4 Përcaktimi i rezidencës tatimore ka rëndësi pasi në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7 dhe paragrafit 1 të Nenit 17 të këtij Ligji, personat rezidentë tatimorë Shqiptarë tatohen në Shqipëri për të gjitha të ardhurat e realizuara në shkallë botërore (të ardhurat me burim në Shqipëri dhe jashtë saj). Ndërsa personat jo rezidentë, në bazë të paragrafit 2 të Nenit 7 dhe paragrafit 2 të Nenit 17, tatohen në Shqipëri vetëm për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë.

1.3.5 Duhet patur parasysh që për personat që janë rezidentë në vendet me të cilat Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshje për Eleminimin e Tatimeve të Dyfishta dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal dhe këto marrëveshje kanë hyrë në fuqi, do të zbatohen dispozitat e këtyre Marrëveshjeve.

1.4 BURIMI I TË ARDHURAVE

1.4.1 Përcaktimi i ‘’burimit të të ardhurave’’ është i rëndësishëm për të kuptuar mënyrën e përcaktimit të detyrimit tatimor të personave rezidentë dhe sidomos për personat jorezidente, të cilët tatohen në Shqipëri për të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë. Në Nenin 4 të Ligjit Nr.8438 datë 28/12/1998, i ndryshuar, “Për tatimin mbi të ardhurat” listohen të gjitha të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, por duke mos u kufizuar vetëm në atë listë. Për të përcaktuar të ardhurat me burim në Shqipëri të personave jo rezidentë, mënyra më e lehtë është identifikimi i pagesave që bëhen nga persona rezidentë tatimorë shqiptarë apo nga çdo ent, organ të qeverisjes qendrore dhe vendore, etj. Organi tatimor mund të shfrytëzojë, reklamat, njoftimet në gazeta apo media, informacionet nga bankat apo nga burime të tjera për të identifikuar të ardhurat e realizuara me burim në Shqipëri. Kur këto të ardhura realizohen nga persona jo-rezidentë, apo nga individë apo persona rezidentë shqiptarë që, në bazë të legjislacionit tatimor ekzistues, nuk janë të detyruar të regjistrohen në organet tatimore shqiptare, detyrimi tatimor do të mbahet në burim nga paguesi i të ardhurave. Në pamundësi për këtë, përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë detyrimin tatimor në organin tatimor përkatës.

1.4.2 Të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë konsiderohen edhe të ardhurat e paguara nga një person (shoqëri, ent, individ, fondacion etj.) jashtë Shqipërisë (jo rezident) por të realizuara për një aktivitet të kryer në Republikën e Shqipërisë (p.sh. një koncert i një artisti në Shqipëri i paguar nga një fondacion i huaj). Pra, në këtë rast, është i rëndësishëm vendi ky kryhet aktiviteti dhe jo vendi ku kryhet pagesa.

1.5 PERIUDHA TATIMORE

Periudha tatimore përputhet me vitin kalendarik, pra fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

2. TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

2.1 FUSHA E VEPRIMIT TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE.

Tatimi mbi të ardhurat personale, përfshin te gjitha llojet e të ardhurave të individëve, të parashikuara nga ligji.

2.2 SHTRIRJA E DETYRIMIT

Në Nenin 7 “Shtrirja e detyrimit” jepet parimi i përgjithshëm sipas të cilit individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave (brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), ndërsa individët jorezidente i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të ardhurat me burim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2.3 TË ARDHURAT E TATUESHME

Në zbatim të nenit 8, të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, janë kategoritë e të ardhurave të mëposhtme:

2.3.1 Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi). Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë që lidhen me punësimin aktual të individit. Në të ardhura nga pagat përfshihet paga bazë si dhe të gjitha shtesat mbi pagën bazë që kanë karakter të përhershëm si shtesat për vjetërsi, vështirësi, largësi

vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të bëra me akte të tjera ligjore e nënligjore.

Termi "shpërblime të tjera" përfshin të gjitha të ardhurat apo shpërblimet që përfitohen nga rezultatet e punës në vendin e punësimit aktual të individit. Në këtë kategori bëjnë pjesë të ardhurat që merr individi në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore të shoqërive, si pagë e 13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre.

Në grupin "shpërblime të tjera" përfshihen gjithashtu të ardhura që realizohen nga pjesëmarrja e individit në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse, etj. Në këto raste mënyra e llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale do të jetë si më poshtë:

a) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet jashtë qendrës efektive të punës së individit, këto të ardhura tatohen në masën 10 përqind;

b) Kur shpërblimi i përfituar për pjesëmarrje në komisione, komitete, këshilla, borde drejtuese, këshilla mbikqyrëse etj., paguhet në qendrën efektive të punës së individit, këto të ardhura do të tatohen duke u bashkuar me pagën e muajit përkatës, sipas tabelës nr. 1 bashkengjitur Ligjit.

Shembull: Supozojmë se individi "X", i cili është i punësuar në subjektin "Y", gjatë muajit Dhjetor 2003 ka përfituar këto të ardhura:

- Pagën bazë mujore (përfshirë pjesën e kontributit për sigurime shoqërore dhe shëndetsore që është përballuar nga punëmarrësi) 45.000 lekë;
- Shpërblim nga fondi i veçantë 20.000 lekë;
- Shpërblim prej 15.000 lekë, si anetar i Bordit Drejtues të subjektit "Y";
- Shpërblim prej 5.000 lekë nga pjesëmarrja në një komision testimi të subjektit "Y", i cili mblidhet dy herë në vit;
- Individi X është shpërblyer gjithashtu me 10.000 lekë, nga pjesëmarrja në një Komision Testimi të subjektit "Z";
- Individi X është shpërblyer gjithashtu me 8.000 lekë për një artikull që ka shkruar në një revistë të huaj.

Detyrimi tatimor për të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e tjera për muajin Dhjetor 2003 për individin "X" do të jetë:

- 45.000 (paga bazë +shtesat) + 20.000 (shpërblimi nga fondi i veçantë) + 15.000 (shpërblimi si anëtar i bordit drejtues) + 5.000 (shpërblim nga pjesmarrja në Komisionin e testimit) = 85.000 lekë. Kjo shumë do të tatohet me tatim në burim sipas tarifave progresive të Tabelës nr.1 bashkangjitur Ligjit.
- Për shpërblimin e marrë nga individi X nga pjesëmarrja në Komisionin e Testimit të subjektit "Z", detyrimi tatimor është 10 përqind, ose 1000 lekë (10.000 x10 %), tatim që mbahet në burim nga subjekti "Z";
- Për të ardhurat e perfituara nga revista e huaj prej 8.000 lekë individi X duhet të deklarojë në organin përkatës tatimor dhe të derdhë një tatim në masën 10%, pra 800 lekë.

2.3.2 Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale, të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdheniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatëve, ose funksionarëve të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuara nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk do të përfitojnë të drejtën e këtij përjashtimi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët mund të jenë të punësuar në këto organizata apo organizma, por nuk kanë statusin e diplomatit.

2.3.3 Të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionerit në shoqërinë tregtare (Pika b e paragrafit 1).

Në kuptim të kësaj pike, bëhet fjalë për të ardhurat që përfitojnë individët, në formën e ndarjes së fitimit nga ortakëritë, apo të dividentit nga shoqëritë tregtare dhe subjekte të tjera të parashikuara nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

2.3.4 Të ardhurat nga interesat bankare, apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose nga letra të tjera me vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Të ardhura nga interesat bankare konsiderohen të gjitha interesat nga llogaritë personale apo të përbashkëta të individëve, në banka ose në institucione të tjera financiare, si dhe të gjitha interesat nga

depozitat personale ose të përbashkëta me afat, në formën e llogarisë me afat, çertifikatës së depozitës me afat, kontratës për depozitë me afat, si dhe çdo e ardhur tjetër në formë interesi.

Tatimit mbi të ardhurat i nënshtrohen të gjitha interesat e lindura dhe të paguara pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, për llogaritë dhe depozitat në lekë dhe në valutë. Këtij rregulli i nënshtrohen edhe depozitat me afat maturimi më të gjatë se një vit. Tatimi mbi të ardhurat nga interesat në valutë konvertohet në lekë, me kursin mesatar të këmbimit të aplikuar nga vetë banka për blerjen e valutave respektive, në ditën e kryerjes së veprimit.

Moment i pagimit të interesave konsiderohet dita e pagimit të interesave në "cash'' ose dita e maturimit apo rikapitalizimit të tyre. Bankat apo institucionet e tjera financiare do të llogarisin dhe derdhin në organin tatimor përkatës tatimin mbi interesat brenda datës 15 të muajit pasardhës të muajit të pagimit, maturimit apo kapitalizimit. Në të njëtën mënyrë veprohet edhe për tatimin mbi interesat për llogaritë e mbyllura.

Për të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit apo letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria në tregun primar dhe të përfituara nga çdo person, tatimi llogaritet dhe derdhet nga Banka e Shqipërisë brenda datës 15 të muajit pasardhës.

Tatimi në burim nuk mbahet kur përfitues i interesave është një person juridik apo person fizik tregtar i rregjistruar në organet tatimore dhe subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar dhe i tatimit mbi fitimin dhe të ardhurat nga interesat përfshihen në të ardhurat e tatueshme të përfituesit. Në këto raste depozita apo bonot e thesarit apo letrat me vlerë në lidhje me të cilat paguhen interesat duhet të jetë në emër të personit juridik.

Banka mban evidencë për interesat e paguara dhe njofton organin tatimor përkatës brenda datës 15 të çdo muaji për interesat e paguara dhe tatimin e mbajtur në burim për muajin paraardhës.

2.3.5 Të ardhurat e përfituara nga pagesat për të drejtën e autorit dhe pronësinë intelektuale.

Këto janë të ardhura që lindin nga përdorimi apo e drejta për të përdorur të drejtat e autorit në letërsi, art, muzikë apo shkencë, që përfshijnë përdorimin apo të drejtën për të përdorur filmat kinematografikë, filmat dhe regjistrime të ndryshme për radio apo TV, çdo patentë, markë tregtare, skicë apo model, projekt, formulë sekrete, informacion apo proçes teknollogjik, lidhur me aktivitete industriale, tregtare apo shkencore.

2.3.6 Të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qeratë (pika d).

Me termin "enfiteozë" do të kuptohet kontrata me të cilën një personi i jepet e drejta të përdorë dhe të përmirësojë një pasuri të paluajtshme, sipas përkufizimit të nenit 784 e vijues të Kodit Civil. E ardhur nga enfiteoza do të konsiderohet shpërblimi periodik në të holla ose në natyrë që i paguhet pronarit të pasurisë së paluajtshme nga personi që e merr pronën në përdorim. Në rastet kur marrësi në përdorim, sipas kontratës midis palëve, kryen shpenzime për përmirësimin dhe përshtatjen e kësaj pasurie për nevojat e tij, atëherë këto shpenzime do të konsiderohen si të ardhura për individin pronar të objektit dhe do të tatohen sikur të ishin e ardhur nga enfiteoza.

E ardhur nga huaja do të konsiderohet çdo e ardhur e përfituar nga dhënia në formën e huasë e mjeteve monetare apo të mjeteve të tjera të ngjashme me to.

Të ardhura nga qeraja do të konsiderohen të gjitha të ardhurat e përfituara nga dhënia me qera e tokës, ndërtesave e objekteve të tjera që shërbejnë për banim, aktivitet industrial, tregtar, shërbimi etj., por pa u kufizuar vetëm në to.

Llogaritja e detyrimit tatimor për këtë kategori të ardhurash do të bëhet duke u bazuar në kontratën përkatëse.

2.3.7 Të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajshme (pika dh).

Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme ose vlera e tregut e pasurive të paluajtshme të dhuruara. Këto të ardhura tatohen sipas tabelës nr.2 të ligjit, me përjashtim të transferimit të së drejtës së pronësisë së tokës bujqësore që tatohet me 0,5% të vlerës së transaksionit.

2.3.8 Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave të pjesëmarrjes në kapital apo të aksioneve.Në këtë grup përfshihen të ardhurat e realizuara nga shitja e kuotës që një ortak zotëron në një biznes apo ortakëri, apo të ardhurat e realizuara nga shitja e aksioneve. Ndryshe nga grupet e tjera, baza tatimore në këtë rast është diferenca midis:

1. Të ardhurave nga shitja apo likuidimi i biznesit me vlerën e kontributit në para ose natyrë të ortakëve;

a) të ardhurave nga shitja e kuotës së pjesemarrjes në kapital me vlerën nominale ose të blerjes së kuotes;

b) të ardhurave nga shitja e aksioneve me vlerën nominale ose të blerjes aksioneve;

c) totali i kuotës së pjesëmarrjes ose pjesës së kapitalit të tërhequr nga një ortak ose pronar me kapitalin fillestar të kontribuar prej tij në kapitalin themeltar.

2.3.9 Të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen (pika g).

Në këtë grup përfshihet çdo lloj e ardhure me burim në Republikën e Shqipërisë e realizuar nga individë rezidentë ose jo rezidentë, por që nuk identifikohet në format e paraqitura më lart. Në këtë grup përfshihen të ardhurat nga sponsorizimet (p.sh. individë të ndryshëm që nuk janë të regjistruar në organet tatimore marrin sponsorizime nga burime të ndryshme dhe i përdorin për aktivitete artistike apo sportive), të ardhura nga aktiviteti profesional si mësimdhënie, trajnime, shkrime në gazeta, etj., kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore (dhe aktivitete të tilla i ka të përkohshme apo dytësore). Siç shihet, në të gjitha rastet personi përfitues nuk është i regjistruar në organet tatimore, pra nuk i deklaron ato të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit.

Edhe në rastet kur paguesi i të ardhurës është person juridik apo fizik i regjistruar në organet tatimore shqiptare ose çdo ent, organizatë joqeveritare, apo organ i qeverisjes qendrore apo vendore në Shqipëri, apo përfaqësi e organizmave ndërkombëtare apo ambasadë e huaj në Shqipëri, tatimi mbahet në burim në masën 10% të pagesës dhe derdhet në organin tatimor përkatës brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Në rastet kur përfituesi është individ rezident Shqiptar dhe paguesi është person jo-rezident (i pa regjistruar në organet tatimore Shqiptare), përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë tatimin në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa. Deklarimi i të ardhurës dhe i shumës së tatimit bëhet sipas modelit të formularit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

2.4 TE ARDHURA TE PERJASHTUARA

Në zbatim të nenit 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, përjashtohen nga detyrimi për pagimin e tatimit mbi të ardhurat personale:

a) Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe ndihmat ekonimike për familjet dhe individët pa të ardhura apo me të ardhura të ulta sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës;

b) Bursat e nxënësve dhe studentëve, pavarësisht nga burimi i financimit, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale, deri në masën e përcaktuar në dispozitat e legjislacionit dhe dispozitave nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë që sanksionojnë bursat e nxënësve dhe studentëve;

c) Shpërblimet e marra për rastet e sëmundjeve apo fatkeqësive, në përputhje me dispozitat e legjislacionit dhe dispozitave nën ligjore në fuqi. Këtu përfshihen shpërblimet e dhëna nga punëdhënësi të punësuarve për raste sëmundjesh apo fatkeqësish, por, masa e shpërblimit që përjashtohet nga tatimi nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave vjetore nga punësimi të punonjësit përfitues të shpërblimit;

d) Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare apo në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike. Në çdo rast përjashtimi duhet të bazohet në dokumentacionin ligjor që vërteton natyrën e këtyre të ardhurave;

e) Të ardhurat e përfituara si dëmshpërblim i dëmeve nga kompanitë e sigurimit;

f) Të ardhurat në natyrë në formën e ushqimeve (antidote) për biznese që e parashikojnë një gjë të tillë në akte ligjore ose nënligjore në fuqi (si minierat, etj.).

g) Të ardhurat që përjashtohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Në çdo rast përjashtimi duhet të bëhet vetëm pasi të jetë depozituar dokumentacioni ligjor (dispozitat e marrëveshjes) që japin përjashtimin si dhe të jenë respektuar procedurat e vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për këtë qëllim.

h) Të ardhurat që përfitojnë punonjësit e Policisë së shtetit në zbatim të ligjit nr.8661, datë 18.09.2000 “Për sigurimin shoqëror suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

2.5 TARIFAT TATIMORE

2.5.1 Në zbatim të nenit 9, pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës do të tatohen sipas tarifave të pasqyrës nr.1 “Tabela e Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

2.5.2 Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, interesat nga huatë, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, qeratë apo të ardhura nga kontrata e tjera të ngjashme (huapërdorja, enfiteoza), tatohen 10 për qind në përputhje edhe me sqarimet e dhëna në dispozitat e tjera të këtij Udhëzimi (pikat 2.3 dhe 5).

2.6 MBLEDHJA E TATIMIT

2.6.1 Në zbatim të nenit 10, çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në gërmën ''a'' të nenit 8 të Ligjit është i detyruar të llogarisë dhe të mbajë në burim tatimin mbi të ardhurat personale (të ardhurat nga punësimi) në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të Ligjit. Tatimi i mbajtur nga punëdhënësi duhet të derdhet në organin tatimor përkatës jo me vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi do të bëhet duke përdorur "Formularin e Deklarimit dhe Pagesës të Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi", që i bashkangjitet këtij Udhëzimi. Kjo deklaratë paraqitet në Bankën ku kryhet pagesa, dhe, pas kryerjes së pagesës, dërgohet në organin tatimor. Punëdhënësit që janë të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël, duhet të llogarisin dhe të mbajnë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për çdo muaj, por formulari i deklarimit dhe pagesës dhe derdhja e tatimit për llogari të organit tatimor do të bëhet në baza tremujore, brenda dates 10 të muajit që pason mbylljen e çdo tremujori.

2.6.2 Punëdhënësit detyrohen të bëjnë ndalesat në borderotë e pagave (listpagesat), për efekt të tatimit mbi të ardhurat personale për pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me punësimin aktual (të ardhurat nga punësimi). Të ardhurat nga punësimi për çdo punonjës dhe llogaritja dhe mbajtja e tatimit pasqyrohen në formularët përkatës që i bashkangjiten këtij Udhëzimi dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave ne zbatim te ligjit Nr. 9136, Datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetesore", i ndryshuar . Këto të dhëna mujore do të hidhen në librin përmbledhës ku janë pasqyruar të gjithë të punësuarit dhe ndalesat përkatëse sipas muajve. Në fund të fletës të muajit përkatës të regjistrit, regjistrohet edhe numri dhe data e urdhër-xhirimit që pasqyron derdhjen në llogarinë e administratës tatimore të detyrimit përkatës.

2.6.3 Për pagesa të tjera që lidhen me të ardhurat e listuara në gërmat b deri g të Nenit 8, paguesi i të ardhurave mban në burim tatimin, sipas tarifave të përmendura në pikën 2.5.2. më lart, dhe e derdh atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

2.6.4 Për të ardhura të realizuara nga burime jashtë Shqipërisë dhe/ose të paguara nga persona të cilët nuk mund të bëjnë mbajtjen e tatimit në burim për llogari të organeve tatimore Shqiptare, përfituesi i të ardhurave është i detyruar të deklarojë dhe të paguajë në organin tatimor përkatës tatimin në masën 10 përqind të të ardhurave të realizuara jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

2.7 KALIMI I SË DREJTËS SË PRONËSISË MBI PASURITË E PALUAJTSHME

2.7.1 Me kalim të së drejtës së pronësisë do të kuptojmë një akt shitjeje apo dhurimi të pasurive të paluajtshme. Në rastin e dhurimit, për efekt të llogaritjes së tatimit, vlera e pasurisë së paluajtshme që dhurohet përcaktohet në bazë të vlerësimit të berë nga zyra e regjistrimit të pasurive nëpërmjet agjentëve vlerësues të autorizuar prej saj.

2.7.2 Kalimi i të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, tatohet sipas pasqyrës nr. 2 "Tatimi mbi Kalimin e të Drejtës së Pronësisë mbi Pasuritë e Paluajtshme" bashkëngjitur këtij Udhëzimi, me përjashtim të kalimit të së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore që tatohet me 0,5% të vlerës së transaksionit.

2.7.3 Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i të drejtës së pronësisë paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme. Derdhja bëhet para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme mbledhin tatimin lidhur me kalimin e të drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme dhe e derdhin atë brenda 10 ditëve nga kryerja e veprimeve në llogarinë e administratës tatimore. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, dërgojnë në degën përkatëse të tatimeve evidencën përkatëse e cila përmbledh emrin e personit tatimpagues, shumën e llogaritur të tatimit si dhe numrin dhe datën e dokumentit të derdhjes së këtij detyrimi në organin tatimor.

2.8 DETYRIMI I INDIVIDEVE PËR TË DEKLARUAR

Çdo individ që gjatë periudhës tatimore, përfiton të ardhura, të cilat i nënshtrohen tatimit mbi

të ardhurat personale, i deklaron çdo vit këto të ardhura sipas pasqyrës bashkëngjitur këtij udhëzimi. Nuk i nënshtrohen detyrimit për paraqitjen e deklaratës individët, të ardhurat e vetme të të cilëve janë ato sipas paragrafit të pikës „a", „b", „c" të nenit 8 dhe nenit 33 të këtij ligji. Kjo deklaratë dorëzohet në organin tatimor të juridiksionit brenda 30 ditëve nga përfundimi i periudhës tatimore (brenda 30 janarit të vitit pasardhës).

2.9 KUNDERVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE DENIMET

Në zbatim të neneve 14 dhe 15, mosparaqitja në kohë e formularëve të deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale dënohet me 10% të shumës përkatëse të detyrimit tatimor për të ardhurat nga punësimi, por jo më pak se 10 mijë lekë për çdo muaj ose pjesë të muajit të vonesës në paraqitjen e këtyre dokumentave.

3. TATIMI MBI FITIMIN

3.1 FUSHA E VEPRIMIT TË TATIMIT MBI FITIMIN

- Personat që i nështrohen tatimit mbi fitimit janë:

- Personat juridikë të krijuar sipas Ligjit ''Për shoqëritë tregtare'' dhe që janë të regjistruar për TVSH-në;

Personat juridike të themeluar sipas Kodit Civil të cilët ushtrojnë veprimtari fitimprurese në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Personat e tjerë juridikë të themeluar ose të njohur si të tillë me Ligje të veçanta;

- Ortakëritë sipas përcaktimit në pikën d të nenit 2 të Ligjit;

- Personat juridike, ortakëritë apo bashkimet e tjera të personave, të themeluara ose të organizuara në bazë të një Ligji të huaj dhe që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet një selie të përhershme;

- Çdo person tjetër, pavarësisht nga forma juridike e regjistrimit të tij, përfshirë personat fizikë që nuk janë subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, por janë të regjistruar si subjekte të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

3.2 DETYRIMI PËR TË PAGUAR

Në zbatim të nenit 17, tatimpaguesit rezidentë, të cilët i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi fitimin, do të tatohen në Shqipëri për fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shembull:

Një person juridik rezident shqiptar, zhvillon aktivitetin e tij në Tiranë (ku ka zyrat qendrore dhe/ose qendrën efektive të menaxhimit të biznesit të tij) dhe ka njëkohësisht aktivitet (degë, pika shitje – seli të përherëshme) në Durrës si dhe në Milano të Italisë.

Supozojmë se fitimet e realizuara nga ky subjekt për vitin 2006 kanë qenë:

- Në Tiranë	10.000.000 lek
- Në Durrës	7.000.000 lek
- Në Milano	8.000.000 lek
Totali	25.000.000 lek

Në këtë rast, tatimpaguesi rezident shqiptar në fjalë, paguan tatim mbi fitimin në masën 20% mbi fitimin total prej 25.000.000 lekë të realizuar nga të gjitha burimet brenda dhe jashtë vendit. Ky fitim duhet të pasqyrohet në bilancin përmbledhës të zyrave qendrore në Tiranë. Në këtë shembull, nuk eshte konsideruar mundësia e kreditimit te tatimin fitimit të paguar në Itali, problem i cili trajtohet në pikën 7 të këtij Udhëzimi.

Ndërsa tatimpaguesit jorezidentë, paguajnë tatim mbi fitimin vetëm për fitimet me burim në Republikën e Shqipërisë.

Shembull:

Një person juridik rezident italian (i krijuar sipas ligjit Italian), përveç aktivitetit në Itali, ushtron aktivitet edhe në Shqipëri ku vepron si person jorezident në zbatim të legjislacionit shqiptar nëpërmjet një selie të përhershme (që mund të jetë një shesh ndërtimi, një zyrë, zbatimi i një projekti, etj).

Fitimet e realizuara përkatësisht supozojmë se janë:

- Ne Itali	5.000.000 lek

- Ne Shqiperi 2.000.000 lek

Në këtë rast, tatimi mbi fitimin që ky tatimpagues paguan në Shqipëri është 2.000.000 x 20% = 400.000 lekë, pasi ai është tatimpagues jorezident dhe paguan tatim mbi fitimin vetëm për fitimet e realizuara në Shqipëri.

3.3 PËRJASHTIMET

Të përjashtuar nga tatimi mbi fitimin janë:

a) Organet e qeverisjes qendrore dhe vendore.

b) Banka e Shqipërisë.

c) Personat juridikë që ushtrojnë veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitime nga organizuesit apo anëtarët e tyre. Në rast se këto subjekte ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të karakterit ekonomik me qëllime fitimi, këto aktivitete janë të tatueshme në bazë të këtij Ligji. Për aktivitetin ekonomik me qëllim fitimi, personat e përmendur në këtë pikë janë të detyruar të deklarojnë në organet tatimore. Në këtë rast, si shpenzime të njohura do të jenë vetëm shpenzimet e kryera për aktivitetin ekonomik fitimprurës dhe si të ardhura do të konsiderohen të ardhurat që i atribuohen këtij aktiviteti ekonomik. Shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, nuk njihen si të zbritshme.

d) Organizatat e punës (sindikatat, konfederatat) dhomat e tregëtisë, industrisë apo bujqësisë si dhe organizmat e ngjashme me to që nuk kanë qëllime fitimi si: urdhëri i mjekut, dhomat e avokatisë, instituti i ekspertëve kontabël, etj; me kusht që pasuria apo fitimi i tyre të mos përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtari të tyre. Po kështu, në rast se subjektet e përmendura në këtë pikë, ushtrojnë edhe veprimtari të tjera të karakterit ekonomik fitimprurës, ky aktivitet është i tatueshëm në bazë të këtij Ligji.

e) Organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësitë e tyre në Republikën e Shqipërisë (si përfaqësitë apo organizmat e Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian, etj.), agjensitë e bashkëpunimit teknik dhe përfaqësitë e tyre, që janë të njohura si të tilla nga Shteti Shqiptar me dispozita ligjore dhe përjashtimi nga tatimi i të cilave është parashikuar në marrëveshje të veçanta.

f) Personat e parashikuar në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë.

g) Fondacionet ose institucionet financiare jo bankare të krijuara me Vendim të Këshillit të Ministrave që nuk kanë qëllim fitimi por kanë për qëllim mbështetjen e politikave zhvilluese të Qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive favorizuese për zhvillimin e sektorëve të caktuar si bujqësisë, bizneseve të vogla, etj.

h) Shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të liçensuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

Për përjashtimet e parashikuara në pikat “c’’ deri “h” me sipër, Degët e Tatimeve kërkojnë për çdo rast miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

3.4 FITIMI I TATUESHËM

Deklarimi dhe llogaritja e tatimit mbi fitimin bazohet në “Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin”, sipas modelit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një periudhe tatimore do të shërbejë si bazë bilanci kontabël dhe anekset e tij, të cilat duhet të jenë në përputhje me Ligjin nr. 7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”, me dispozitat e Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe dispozitat e këtij udhëzimi. Në parim, fitimi ose e ardhura neto e tatueshme, del si rezultat i diferencës midis të ardhurave totale (të ardhurat nga aktiviteti normal dhe të ardhura të jashtëzakonshme), përfshirë vlerën e përfitimeve dhe të avantazheve në natyrë, me shpenzimet e kryera me qëllim realizimin dhe ruajtjen e të ardhurave.

3.5 SHPENZIMET E NJOHURA

Shpenzime të njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Këto janë të gjitha shpenzimet (përfshirë shpenzimet e jashtëzakonshme) e biznesit, me përjashtim të atyre që janë kryer me qëllim formimin dhe rritjen e kapitalit. Shpenzimet e njohura janë kryesisht shpenzime të destinuara për të ruajtur ekzistencën e kapitalit si burim i të ardhurave dhe për të siguruar në kohën e duhur riformimin apo zëvendësimin e kapitalit (p.sh amortizimi). Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për

përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qënë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

a) të jenë kryer në interes të drejtëpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;

b) të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;

c) të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto;

d) në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor. Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e leshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike (p.sh. Ambasada të huaja, organizma ndërkombëtare, Zyra pune, Komisariate Policie, etj.) për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve, subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Degët e tatimeve mund të kërkojnë interpretimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me dokumenta të tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë udhëzim por që vërtëtojnë shpenzime biznesore të subjektit.

Materialet dhe mallrat publicitare si postera, spote publicitare ato filmike dhe fotografike, masa e produkteve të të cilave reklamohen në promovimet e promocionet e organizuara, që mbështetur në dokumentacionin justifikues, kryhen për qëllime të biznesit, bazuar në nenin 20 të Ligjit, njihen si shpenzime të njohura për efekt fiskal. Dokumentacioni që duhet të përdoret për rastet e promocioneve dhe promovimit janë:

- Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit ku të jenë të përcaktuar vendi, periudha e organizimit të promocionit, sasia e produkteve që do të shpërndahen, materialet publicitare që do të përdoren, etj.
- Projektideja lidhur me mënyrën e organizimit të promocionit dhe promovimit.
- Procesverbali për produktet që shpërndahen me personat që përfitojnë produktin falas
- Fletëshoqërimi nalli me ekstreme të plotësuara, ku tek marrësi i mallit do të firmosin promovuesit e shoqërisë. Faturat tatimore me TVSH do të jenë ditore për çdo promovues të cilës duhet t'i bashkangjiten në fund të ditës procesverbalet e mbajtura me personat përfitues.

Dokumentacioni që duhet të përdoret për dhënien e dhuratave simbolike :

-Vendimi i asamblesë së ortakëve ose administratorit për llojin dhe sasinë totale të mallrave që dhurohen dhe kujt do t'i dhurohen

3.6 Shpenzime të panjohura

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, nuk do të njihen si shpenzime të zbritshme, shpenzimet e mëposhtme:

a. Kosto e blerjes dhe e përmirësimit të tokës dhe truallit, konsiderohet shpenzim që nuk ka lidhje me rezultatin ushtrimor përkatës, por me investimin në aktivet e biznesit.

b. Kosto e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve, të cilat janë objekt i amortizimit. Për efekte fiskale, në kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të qëndrueshme hyjnë shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe se 15 përqind e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve për të katër kategoritë e tyre.

c. Çdo zmadhim i kapitalit të shoqërisë, ose i kontributit në ortakëri, mbi kapitalin ose kontributin fillestar të përcaktuar në kontratën dhe statutin e shoqërisë apo ortakërisë.

d. Vlera e shpërblimeve në natyrë, e cila nënkupton çdo shpërblim të paguar jo në para, por në natyrë dhe që merret si shpërblim, për punën e kryer nga të punësuarit apo persona të tjerë. Të kësaj natyre janë shpërblime të tilla si: kompensimet ushqimore, dhurimi i automjeteve, i paisjeve elektroshtëpiake, bileta për udhëtime turistike, dhënie në përdorim e banesave apo ambjenteve për qëllime personale apo qëllime të tjera që nuk kanë lidhje direkte me biznesin, etj. Vlera e shpërblimeve në natyrë është shpenzim i panjohur për shkak të faktit se ato nuk tatohen si të ardhura personale në zbatim të nenit 8 të Ligjit dhe të pikës 2.3 të këtij Udhëzimi. Në rastet kur shpërblimet e paracaktuara në natyrë jepen në para (psh kompensimi ushqimor për të punësuarit jepet në lekë, pasi subjekti nuk ka mencë për gatim) ato do të konsiderohen si të ardhura personale të individit dhe do të tatohen së bashku me pagën sipas tabelës nr.1 bashkangjitur Ligjit, ndërkohë që do të konsiderohen si shpenzime të zbritshme të biznesit. Kur shpërblimet në natyrë i jepen personave të tretë (jo të

punësuar) ato në asnjë rast nuk do të njihen si shpenzime të lejuara.

e. Kontributet vullnetare për pensione apo sigurime të tjera, (ndërkohë që kontributet e detyrueshme të punëdhënësit sipas ligjit janë shpenzime të zbritshme të biznesit).

f. Dividentët apo ndarjet e fitimit për aksionerët apo ortakët, pasi ato paguhen nga fitimi pasi të jetë paguar tatimi mbi fitimin.

g. Interesat e paguara nga tatimpaguesi gjatë vitit ushtrimor, të cilat tejkalojnë normën mesatare të interesit 12 mujor të kredisë për tregun bankar sipas publikimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Po kështu konsiderohet shpenzim i panjohur, shuma e interesave të huasë që kalon raportin 1 me 4, d.m.th. 1 njësi kapitale të veta (kapitali themeltar + diferenca nga rivlerësimet + primet + rezerva të ndryshme + fitime/humbje të mbartura + fitime/humbje të ushtrimit) kundrejt 4 njësi hua, sipas përcaktimit të bërë në paragrafin 2 të nenit 21 të Ligjit. Huate bankare afatshkurtra me një kohëzgjatje më të vogël se një vit kalendarik nuk konsiderohen për efekt të llogaritjes së raportit të huasë si më sipër. Nga ky kufizim (raporti 1:4) përjashtohen Bankat dhe Shoqëritë e Sigurimit.

h. Gjobat, kamatvonesat dhe kushtet e tjera penale që paguhen nga subjekti për shkelje të ndryshme ligjore apo administrative, janë shpenzime të panjohura për efekt fiskal. Në rastin e faljes së gjobave, kamatvonesave dhe kushteve të tjera penale me akte ligjore e nënligjore (akte administrative) të ardhurat e përfituara nga falja e tyre janë të ardhura të patatueshme ose shpenzime të njohura për efekt fiskal nëse fillimisht në momentin e vendosjes së tyre këto gjoba, kamatvonesa apo kushte të tjera penale janë pasqyruar si shpenzime të panjohura për efekt fiskal.

i. Krijimi ose rritja e rezervave dhe e fondeve të tjera speciale. Në bazë të ligjit, rezervat krijohen nga fitimi pas tatimit. Këtu përjashtohen rastet kur krijimi i rezervave parashikohet në ligje apo në akte të tjera nënligjore, si në ligjin Nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit” i ndryshuar, si dhe në ligjin dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë. Me rezerva dhe fonde të tjera duhen kuptuar edhe provigjonet për rreziqe (humbje) dhe shpenzime (detyrime) të krijuara nga fitimi pas tatimit sipas përcaktimit në nenin 38 të Ligjit ‘’Për kontabilitetin’’. Pra për qëllim të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, provigjonet që krijohen për mbulimin e humbjeve ose të shpenzimeve të pritshme, nuk përbëjnë shpenzime të njohura për efekt fiskal.

j. Tatimi mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe TVSH e zbritshme, si më poshtë:

Tatimi mbi të ardhurat personale mbahet 100 përqind nga paga e të punësuarve me detyrimin ligjor për t’u transferuar në llogarinë e organeve tatimore sipas përcaktimeve ligjore. Këtu bëhet fjalë për tatimin mbi të ardhurat personale të llogaritur dhe të mbajtur nga punëdhënësi mbi pagën bruto të punëmarrësve, pagë e cila është përfshirë njëherë në shpenzimet e biznesit. Në këtë mënyrë shmanget mundësia e dublimit të këtyre shpenzimeve në shpenzimet e njohura;

Tatimi mbi fitimin llogaritet mbasi është përcaktuar rezultati financiar (fitim ose humbje). Në këtë kuptim ai nuk është shpenzim por pjesë e rezultatit;

TVSH e zbritshme nuk kontabilizohet në llogarinë e shpenzimeve, ajo redukton TVSH e llogaritur në shitje, duke u kontabilizuar në llogarinë e TVSH-se. Përjashtimisht rastet kur TVSH-ja në blerje nuk kreditohet sipas Ligjit “Për Tvsh” dhe Udhëzimit në zbatim të tij, në këto raste kjo shumë e Tvsh-së do të kontabilizohet në llogarinë e shpenzimeve dhe do të njihet si shpenzim i zbritshëm për efekt fiskal.

Akciza e paguar në blerje ose në import në çdo rast është shpenzim i zbritshëm. Kështu p.sh. nëse një shoqëri transporti blen karburante, në çmimin e të cilave është përfshirë edhe akciza, e gjithë vlera e këtyre shpenzimeve është shpenzim i njohur. E kundërta ndodh me akcizën e llogaritur në shitje. Kjo akcizë nuk njihet si shpenzim i zbritshëm. Kështu p.sh. një tatimpagues prodhues birre, kur shet birre, llogarit edhe akcizën përkatëse të cilën e mbledh dhe e derdh për llogari të shtetit. Në këtë rast për pjesën e akcizës së llogaritur nuk preken llogaritë e të ardhurave dhe të shpenzimeve. pasi akciza në këtë rast është shtesë mbi çmimin e shitjes (kosto plus fitim) dhe nuk zbritet nga shpenzimet e biznesit;

Tatimi i mbajtur në burim si pjesë e pagesës për shërbime teknike apo shërbime të tjera, nuk rëndon veçmas llogaritë e shpenzimeve, pasi pagesa bruto për shërbimin (përfshirë tatimin në burim) njihet si shpenzim.

k. Shpenzimet e përfaqësimit dhe shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë vleren e 0,3 % të qarkullimit vjetor (siç është përkufizuar qarkullimi vjetor në Udhëzimin e Ministrisë së Financave

“Për TVSH”). Në shpenzimet e përfaqësimit përfshihen shpenzime me karakter të përgjithshëm që një shoqëri bën për prezantimin dinjitoz të saj në marrëdhëniet me partnerët apo institucione të tjera, p.sh. organizimi i takimeve, prezantimi i projekteve të reja, përurimi i linjave apo prodhimeve të reja, qerasjet dhe pritje-përcjelljet që lidhen me marrëdhëniet e biznesit

m. Shpenzimet e konsumit personal, ku përfshihen të gjitha shpenzimet e karakterit të konsumit personal, të cilat nuk kanë lidhje direkte me mbarëvajtjen dhe rezultatin e biznesit. Të tilla shpenzime konsiderohen për shembull kur tatimpaguesi një pjese të mallrave të prodhuara apo të tregëtuara prej tij i përdor për konsum personal apo familjar, kur një pjesë të karburantit e përdor për automjetin personal apo familjar, shpenzimet telefonike për vete apo persona të tjerë që nuk janë të punësuar në biznes apo funksionet e tyre nuk i justifikojnë këto shpenzime. Gjithashtu, konsiderohen si shpenzime të konsumit personal dhe të panjohura për efekt fiskal edhe shpenzimet për qeratë e banesave, të cilat shërbejnë për akomodimin dhe fjetjen e punonjësve vendas dhe të huaj, pavarësisht nga kushtet e vëna në kontratën e punësimit ose shërbimit.

n. Shpenzimet që kalojnë kufijtë e përcaktuar në ligje apo akte nënligjore, siç janë:

- shumat e amortizimit të aktiveve të biznesit, të cilat tejkalojnë normat e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji;

- shpenzimet që tejkalojnë kufirin e përcaktuar në ligjin “Për sponsorizimet”, jo më shumë se 4% të fitimit para tatimit për sponsorizimet në përgjithësi dhe jo më shumë se 10% për sponsorizimet për aktivitete kulturore, sportive,etj., sipas përcaktimit në Ligjin “Për Sponsorizimet”, por në asnjë rast totali i sponsorizimeve nuk duhet të kalojë 10% të fitimit para tatimit. Për një tatimpagues i cili rezulton me humbje në vitin korent, shpenzimet e kryera nga ai për sponsorizime gjatë këtij viti, janë shpenzime të panjohura, pra në këtë rast për efekt fiskal, për këtë tatimpagues bëhet korrigjimi i rezultatit;

- Shpenzimet e kryera për dieta të cilat kalojnë kufirin prej 3 mijë lekë për ditë të plota shërbimi brenda vendit dhe 1 mijë lekë për gjysëm ditë shërbimi brenda vendit si dhe shpenzimet e kryera për dieta jashtë vendit të cilat kalojnë kufirin prej 60 EURO për çdo ditë të plotë shërbimi dhe 30 EURO për çdo gjysëm dite shërbimi. Shpenzimet për shërbimet e biznesit brenda ose jashtë vendit duhet të justifikohen me dokumentat përkatëse të udhëtimit, si dokumentat e transportit, faturat e hotelit, pasaporta (vulat e hyrjes e të daljes nga vendi), etj., si dhe dokumentacioni teknik që vërteton nevojat e biznesit të shërbimit brenda ose jashtë vendit; etj.

nj. Shpenzimet për dhurata nuk njihen si shpenzim biznesi, përjashtuar dhuratat simbolike brenda kufirit të shpenzimeve të përfaqësimit të parashikuara në germën “k” të pikës 3.6.

o. Shpenzimet që rrjedhin si rezultat i korrigjimit të regjistrimeve të gabuara kontabile të kryera vitet e kaluara.

Në zbatim të ligjit “Për kontabilitetin”, rregjistrimet e gabuara kontabile të viteve të kaluara korrigjohen në vitin që ato konstatohen, por efekti fiskal i tyre do të llogaritet që nga periudha kur janë rregjistruar në mënyrë të gabuar. Në këto raste paguhet detyrimi dhe interesat, por nuk aplikohen gjoba.

p. Çdo shpenzim, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi.

Kjo do të thotë se asnjë shpenzim për blerje brenda vendit nuk është i njohur nëse ai nuk justifikohet me një nga dokumentat e përshkruara në pikën 3.5, gërma “d”).

Fatura që lëshohet nga tatimpaguesit e biznesit të vogël është dokument justifikues për shpenzimet vetëm në rast se ajo përmban të gjithë elementet që përcakton Ligji ‘’Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet’’ (numrin rendor, datën dhe vendin e lëshimit, numrin e Çertifikatës së Ushtrimit të Veprimtarisë, emrin dhe adresën e shitësit dhe blerësit, sasinë, çmimin dhe vleftën e plotë të shitjes, etj.). Kuponat tatimorë të lëshuar nga arkat rregjistruese dhe dëftesat tatimore nuk njihen si dokumente justifikues për shpenzimet.

q. Në bazë të shkronjës ll, të pikës 1, të Nenit 21, nuk do të njihet si shpenzim i lejuar vlera e faturave të pranuara për shërbime që janë kryer nga persona jo-rezidentë që nuk janë të rregjistruar në organet tatimore shqiptare, nëse brenda vitit kalendarik nuk është paguar tatimi në burim për ato shërbime. Kjo dispozitë ka synim shmangien e abuzimeve që janë vërejtur tek tatimpagues shqiptarë që kanë pranuar faturime për shërbime teknike dhe konsulenca nga jashtë (kryesisht nga persona të lidhur) i kanë kontabilizuar ato duke rritur shpenzimet (pra kanë ulur për atë vleftë fitimin e tatueshëm) dhe nuk kanë kryer likujdimin duke e spostuar atë nga një periudhë tatimore në tjetrën,

duke mos paguar tatimin në burim. Në një rast të tillë, fatura e pranuar do të konsiderohet shpenzim i panjohur për efekt fiskal në fund të periudhës tatimore, përderisa ajo të jetë likujduar ose të jetë paguar tatimi në burim në masën 10%.

r. Humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit dhe magazinimit do të njihen si shpenzim i lejuar deri në nivelin e përcaktuar në aktet ligjore apo nënligjore përkatëse. Në rastet kur akte të tilla mungojnë, Ministritë apo Institucionet Qëndrore përkatëse duhet të paraqesin në Këshillin e Ministrave projekt-vendimet për miratimin e kufijve maksimalë të normativave apo firove. Pra me ligj apo me Vendim të Këshillit të Ministrave duhet të jenë të përcaktuar kufijtë maksimalë të normativave apo firove dhe sigurisht, firot faktike duhet të jenë të dokumentuara me dokumentacionin përkatës teknik e financiar.

s. Në rastin e nxjerrjeve jashtë përdorimit ose shkatërrimit të materialeve apo mallrave të cilat për arsye të ndryshme, si dëmtime, kalim i afatit të skadencës, etj., janë të papërdorshme ose të pa tregtueshme apo tregtohen më çmime të ulura, përfshirë uljen sezonale, shpenzimet përkatëse ose të ardhurat e reduktuara do të njihen për efekt fiskal vetëm nëse vërtetohen me proces-verbalin përkatës të mbajtur nga një komision i posaçëm vlerësimi, dhe subjekti ka njoftuar organin tatimor përkatës. Ky njoftim duhet te shoqëhet me një kopio të proçes verbalit përkatës. Organi tatimor mund të dërgojë perfaqësuesin e vet që të jetë prezent në momentin e nxjerrjes jashtë përdorimit ose shkatërrimit të mallit, jo më vonë se 5 ditë nga data e njoftimit.

Për hipermarketet ky afat është 24 orë. Proces-verbali i vlerësimit duhet të përmbajë të dhëna të plota mbi sasitë, vlerat, kohën e furnizimit , arsyet e zhvlerësimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit, duke i garantuar organeve tatimore mundësinë e verifikimit dhe kontrollit.

Kur secili prej shpenzimeve të përmendura më sipër është regjistruar në kontabilitet dhe është zbritur nga të ardhurat gjatë llogaritjes së fitimit vjetor të tatimpaguesit, ato do të veçohen dhe t'i shtohen fitimit vjetor të tatueshëm.

3.7 AMORTIZIMI

3.7.1 Personat që llogarisin amortizimin

Në zbatim të nenit 22 të ligjit, Amortizimi i aktiveve të biznesit llogaritet nga:

- Pronari i aktiveve;
- Personi që mbart riskun, në rastin e aktiveve të dhëna me qera apo huapërdorje afat-gjata ose me qera financiare (leasing), duke u bazuar në të dhënat e kontratave përkatëse, dhe, duke mos lejuar dyfishim të shpenzimeve të amortizimit, tek pronari edhe tek përdoruesi i aktivit.

Në kushtet e zakonshme të qeradhënies, amortizimi do të llogaritet nga pronari i aktiveve dhe përdoruesit i njihet qeraja si shpenzim i lejuar, ndërsa pronari, sigurisht, do të raportojë të ardhurat nga qeraja në të ardhurat e tatueshme.

Aktive të tilla si: toka, trualli, veprat e artit, sendet antike, bizhuteritë, metalet dhe gurët e çmuar, nuk amortizohen.

3.7.2 Normat e amortizimit sipas grupeve

Amortizohen individualisht dhe në mënyrë lineare:

a. Kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, si dhe kostot e konstruksioneve, makinerive e pajisjeve me afat përdorimi më të madh se 20 vjet, të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me ndërtesat ose tokën. Të tilla janë sendet e ngjitura me plumb, gips ose tjetër që nuk mund të shkëputen pa u thyer ose pa u cënuar, ose pa prishur apo dëmtuar pjesën e tokës ose të ndërtesës me të cilën është trupëzuar si p.sh. ashensorët, konstruksionet metalike pjesë e ndërtesës, instalimet elektrike dhe hidraulike, etj. Po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportimit si: ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjat hekurudhore, linjat e tensionit të lartë, teleferikët, e të tjera aktive të ngjashme me to. Norma e amortizimit të këtyre aktiveve është 5 përqind.

b. Aktivet e patrupëzuara të biznesit si patentat, markat tregtare, shpenzimet e nisjes së aktivitetit, "emri i mirë" në rastet kur ky i fundit është blerë, etj. amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 15 përqind.

Baza e llogaritjes së amortizimit për dy kategoritë ''a'' dhe ''b'' të aktiveve të përmendura më sipër është vlera fillestare e aktivit (kosto historike) të cilës i shtohen edhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktivit. Për llogaritjen e amortizimit merret për bazë koha (muaji) e hyrjes apo e daljes së aktivit, sipas përcaktimit të bërë në Planin Kontabël.

Amortizohen mbi bazë grupimi:

c.Kompjuterat, sistemet e informacionit, programet kompjuterike dhe në përgjithësi produktet software e pajisjet e ruajtjes së të dhënave. Norma e amortizimit për këtë kategori aktivesh është 25 përqind.

d.Të gjitha aktivet e tjera të veprimtarisë të cilat nuk përfshihen në grupimet ‘’a’’, ‘’b’’ dhe ‘’c’’ të përmendura më sipër, si makineritë e pajisjet e prodhimit e të shërbimit, mjetet e transportit të të gjitha llojeve, etj., amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 20%.

Baza e llogaritjes së amortizimit për dy kategoritë ‘’c’’ dhe ‘’d’’ të aktiveve të përmendura më sipër është vlera kontabël e mbetur e grupit të aktiveve (vlera fillestare minus amortizimi), të cilës i shtohen edhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të grupit si dhe i zbriten të ardhurat nga shitja dhe kompensimet e marra.

Normat e lejuara për efekt fiskal në masën 5%, 15%, 20% dhe 25% janë të alpikueshme dhe për llogaritjen e amortizimit te aktiveve të dhëna me qera financiare (leasing), nga personi që mbart riskun, pamvarësisht nga kohëzgjatja e kontratës së qerasë financiare.

Për të gjitha aktivet që hyjnë gjatë periudhës ushtrimore, llogaritja e amortizimit fillon nga dita e parë e muajit që pason muajin e hyrjes, duke ndjekur të njëjtin rregull edhe për muajin e daljes së aktivit, pra amortizimi pushon së llogarituri ditën e parë të muajit që pason muajin e daljes.

Për të katër kategoritë e aktiveve të përmendura më sipër, për efekte fiskale, konsiderohen kosto të përmirësimit, të rinovimit dhe të rikonstruksionit, shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe së 15 përqind e vlerës kontabël të mbetur të aktiveve. Kur këto shpenzime janë më të vogla së 15 përqind e vlerës kontabël të mbetur të aktivit përkatës, ato konsiderohen shpenzime për mirëmbajtjen e aktivit dhe pasqyrohen totalisht si shpenzime biznesi për periudhën korente.

Persa i takon shpenzimeve të mirëmbajtjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit në një transaksion qiraje financiare, nëse qiramarrësi mbart riskun për humbjen apo shkatërrimin e aktivit, përballon këto shpenzime sigurisht të justifikuara me dokumentacionin e nevojshëm, në perputhje me përcaktimet e bëra në paragrafin e mësipërm.

Po kështu do të njihen si të zbritëshme në varësi të përcaktimit të pronësisë së aktivit të dhënë me qera financiare edhe shpenzimet për tarifat e tjera që paguhen, pranë organeve shtetërore siç janë taksa e regjistrimit të përvitshëm për automjetet, primet e sigurimit etj.

3.8 INVENTARI

Për vlerësimin e gjendjes së inventarit në fund të periudhës tatimore, tatimpaguesi mund të përdorë një nga metodat e vlerësimit të parashikuara në ligjin për Kontabilitetin, duke mos e ndryshuar këtë metodë nga njëra periudhë në tjetrën pa patur arsye të forta objektive për një ndryshim të tillë. Ndryshimi i metodës së vlerësimit mund të bëhet vetem pasi të jetë njoftuar me shkrim Dega përkatëse e Tatimeve jo më vonë se 30 ditë para fillimit të periudhës tatimore në të cilën do të aplikohet metoda e re e vlerësimit.

3.9 BORXHET E KËQIJA

Me borxh të keq kuptohet një kërkesë për t’u arkëtuar (detyrim debitor) e cila për shkak të gjendjes së keqe financiare të debitorit, vënies së tij në faliment ose për një shkak tjetër që nuk varet nga kreditori, kthehet në një detyrim që mund të mos arkëtohet tërësisht ose pjesërisht.

Një borxh i keq, që të njihet si i tillë gjatë vitit ushtrimor, duhet të përmbushë njëkohësisht tre kushtet e mëposhtme:

- Shuma e këtij borxhi të jetë përfshirë më përpara në të ardhurat e tatimpaguesit (me faturë ose dokumentacion tjetër qe është kontabilizuar si e ardhur në evidencën kontabile).
- Për arkëtimin e tij janë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme ligjore dhe janë zbatuar sanksionet e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe pasi nuk është bërë i mundur arkëtimi, ai dokumentohet me vendim të gjykatës apo organeve të tjera kompetente të njohura me ligj.
- Kur ky borxh është fshirë nga librat kontabël, gjë që do të thotë se është kaluar nga llogaritë përkatëse të klientit ku është kontabilizuar fillimisht, në llogaritë e rezultatit financiar të subjektit.

Nëse për çdo rast, një shumë e njohur më parë si borxh i keq arkëtohet gjatë vitit korent, kjo shumë përfshihet në të ardhurat e këtij viti.

3.10 PJESËMARRJET QË PËRJASHTOHEN NGA TATIMI MBI FITIMIN

Dividentët dhe ndarjet e fitimit të përfituara respektivisht nga shoqëri dhe ortakëri rezidente shqiptare (përfituesit), me qëllim që të shmanget tatimi i dyfishtë, përjashtohen nga tatimi mbi fitimin,

me kusht që këta dividentë të jenë paguar nga një shoqëri rezidente tatimore shqiptare apo fitimi të jetë ndarë nga një ortakëri rezidente tatimore shqiptare (pra këta dividentë apo ndarje fitimi shpërndahen pasi është paguar tatimi mbi fitimin në Shqipëri) dhe përfituesi i dividentëve apo i fitimit të shpërndarë të zotërojë jo më pak se 25% të aksioneve apo kapitalit të shoqërisë apo ortakërisë që bën shpërndarjen.

Dividentët ose shpërndarjet e fitimit të përfituara nga një shoqëri ose ortakësi (shkurt përfituesi) përjashtohen nga tatimi mbi fitimin, kur plotësohen të tre kushtet që vijojnë:

- Përfituesi është rezident tatimor shqiptar në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 3 të Ligjit.

- Paguesi (shoqëria ose ortakëria që bën shpërndarjen e dividentëve apo ndarjen e fitimit) është rezidente tatimore shqiptare në kuptimin e paragrafit 3 të nenit 3 të Ligjit (pra dividentët ose ndarjet e fitimit janë bërë pasi është paguar tatimi mbi fitimin).

- Përfituesi zotëron jo më pak se 25% të kapitalit aksioner ose të së drejtës së votës (në rastin e shoqërive aksionere), apo të kapitalit fillestar (në rastin e ortakërive), të paguesit.

E shprehur ndryshe, dividentët apo ndarjet e fitimit të përfituara nga një person juridik shqiptar, tatimpagues i tatimit mbi fitimin (përfituesi), përjashtohen nga tatimi mbi fitimin i përfituesit (nuk përfshihen në të ardhurat nga biznesi i tij) me kusht që personi që shpërndan dividentët ose fitimin (paguesi) të jetë gjithashtu tatimpagues i tatimit mbi fitimin në Shqipëri dhe përfituesi të zotërojë jo më pak se 25% të kapitalit të paguesit.

3.11 MBARTJA E HUMBJEVE

Humbja e rezultuar dhe e njohur nga organet tatimore, mund të mbartet në tre vitet e ardhshme rradhazi. Per shembull, nëse një subjekt ka rezultuar në vitin 2000 me 9 milionë lekë humbje, ai ka të drejtë ta mbartë këtë humbje në tre vite radhazi deri në vitin 2003. Kështu, nëse subjekti në fjalë rezulton me një fitim prej 4 milionë lekë në vitin 2001, për efekt fiskal, i lejohet të përdorë të gjithë fitimin e këtij viti për të mbuluar humbjen e vitit parardhes. Pra, nga 9 milionë humbja reduktohet në 5 milionë lekë. Nëse në vitin 2002 subjekti rezulton përsëri me një humbje, prej, p.sh., 3 milionë lekë, ai ka të drejtë ta mbartë atë në tre vitet e ardhshme, pra deri në vitin 2005. Nëse në vitin 2003 subjekti rezulton me fitim 2 milionë lekë, ai mund ta përdorë këtë fitim për të mbuluar humbjen e mbetur prej 5 milionë nga humbja e vitit 2000, e cila tashmë reduktohet në 5-2 = 3 milionë lekë. Nëse në vitin 2004 subjekti do të rezultojë p.sh. me 6 milionë lekë fitim, ai ka të drejtë të mbulojë me këtë fitim humbjen e rezultuar në vitin 2002 pra 3 milionë, dhe fitimi i mbetur prej 3 milionë tatohet normalisht. Në këtë mënyrë, e drejta e mbartjes së humbjes së mbetur nga viti 2000 ka përfunduar (për efekt fiskal nuk njihet mbulimi i saj me fitimin e vitit 2004). Kështu, çdo humbje mund të mbartet deri në tre vitet e ardhshme, duke u evidentuar veçmas humbja e çdo viti, me parimin sipas të cilit humbja më e hershme mbartet përpara humbjes më të vonë. Nëse një humbje nuk arrin të mbartet për tre vite pasardhëse radhazi (pasi subjekti mund të rezultojë përsëri me humbje), ajo nuk mund të shtrihet më tej dhe të prekë rezultatin e viteve të tjera, para aplikimit të tatimit mbi fitimin.

Paragrafi 2 i nenit 27 ndalon transferimin e humbjes së shoqërive, pasi mbartja e humbjes duhet të jetë e lidhur vetëm me tatimpaguesin që e pëson atë. Meqënëse zbatimi i këtij parimi kërkon që referimi të bëhet ndaj pronarit të shoqërisë, në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e tërthortë e kapitalit themeltar, ose të drejtave të votës të një personi ndryshon me më shumë se 25% në vlerë ose në te drejta votash, e drejta e mbartjes së humbjes në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit humbet.

3.12 DEKLARIMI TATIMOR DHE LLOGARITJA PERFUNDIMTARE E DETYRIMIT

Tatimpaguesi është i detyruar të paraqesë në organet tatimore Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin, së bashku me pasqyrat analitike, brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë edhe bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, pasqyrën e qarkullimit të likuiditeteve (cash-flow), një kopie të raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për shoqëritë që e kanë të detyruar ekspertizën sipas legjislacionit në fuqi, si dhe çdo të dhënë tjetër mbështetëse për argumentimin e të dhënave të deklaratës tatimore.

Në zbatim të nenit 29 të këtij Ligji dhe dispozitave të Ligjit nr.8560 datë 22.12.1999 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të dhënat e dokumentave të mësipërme quhen të pranuara kur miratohen nga organi tatimor përkatës ose kur kalojnë 60 ditë nga data e dorëzimit të tyre dhe organi tatimor nuk ka dhënë një përgjigje zyrtare me shkrim.

3.13 PARAPAGIMET (PARADHËNIET)

Tatimi mbi fitimin paguhet në formë paradhënie, brenda datës 15 të çdo muaji. Kështet mujore

të vitit ushtrimor llogariten siç përcaktohet në pikat 3.13.1 deri 3.13.4.

Organi tatimor, bazuar në të dhënat e deklaruara nga tatimpaguesi dhe të dhënat e bilancit kontabël dhe anekseve të tij të paraqitura nga tatimpaguesi, të korrigjuara në përputhje me rezultatet e kontrolleve të kryera pranë tatimpaguesit, përgatit Njoftim Vlerësimin Tatimor në lidhje me këstet e parapagimit të tatimit mbi fitimin. Njoftim Vlerësimi Tatimor për periudhën Janar-Prill i njoftohet tatimpaguesit brenda datës 15 dhjetor të vitit paraardhës, ndërsa Njoftim Vlerësimi Tatimor për periudhën Maj-Dhjetor i njoftohet brenda datës 15 prill. Njoftim Vlerësimi Tatimor i nxjerrë në përputhje me këtë paragraf është subjekt i apelimit tatimor, siç parashikohet nga Ligji "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

3.13.1 Llogaritja e kësteve të parapagimeve (të paradhënieve)

a. Për periudhën tatimore të vitit ushtrimor, kësti mujor i paradhënies përcaktohet duke u mbështetur në masën e fitimit të tatueshëm të dy viteve më parë, siç është përshkruar në shembullin e mëposhtëm:

Shembull nr. 1.

Tatimi mbi fitimin

- Viti 2000 1200000 lekë
- Viti 2001 1800000 lekë

Paradhëniet për vitin 2002.

Janar - Prill 2002: 1200000/12 muaj=100000 lekë/muaj
100000x4 muaj=400000 lekë në muaj

Maj - Dhjetor 2002: 1800000-400000/8 muaj =175000 lekë/muaj
175000 x 8 muaj = 1400000 lekë për 8 muaj

b. Në rastin kur tatimpaguesi ka më pak se dy vite që e ka filluar veprimtarinë, këstet e paradhënieve të tatim fitimit për periudhën ushtrimore llogariten sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull nr. 2.

Tatimi mbi fitimin

- Viti 2000 (fillon aktivitetin më 1 prill) 900.000
- Viti 2001 1.800.000

Paradhëniet për vitin 2002.

Janar-prill 2002: 900.000/9 muaj=100.000 lekë/muaj
100.000 lekex4 muaj=400.000 lekë.

Maj-dhjetor 2002 1.800.000-400.000/8muaj=175.000 lekë/muaj

c. Kur tatimpaguesi ka më pak se një vit që e ka filluar veprimtarinë, paradhëniet e tatim fitimit llogariten sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull nr. 3.

Tatimi mbi fitimin

- Viti 2000 Nuk ka aktivitet
- Viti 2001 Fillon aktivitet më 1 prill 1.350.000 lekë

Paradhëniet për vitin 2002

Janar-prill 2002 Paradhënia sipas vlerësimit të tatimpaguesit
Maj-dhjetor 2002 1.350.000 lekë/9 muaj =150.000 lekë/muaj
150.000 x 8 muaj=1.200.000 lekë

d. Kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë në vitin vijues, paradhëniet e tatimit mbi fitimin llogariten duke u bazuar në deklaratën parashikuese për shumën e vlerësuar të tatimit mbi fitimin, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur deri në fund të vitit. E njëjta mënyrë do të përdoret për llogaritjen e paradhënieve të tatimit mbi fitimin në rastet kur periudhat paraardhëse paraqiten me humbje.

Tatimpaguesit që e fillojnë veprimtarinë në vitin vijues tatimor dhe ushtrojnë aktivitet në sferën prodhuese (sipas përcaktimit të INSTAT-it për veprimtaritë prodhuese), në bazë të nenit 30 të Ligjit ("Parapagimet"), nuk do të paguajnë tatim mbi fitimin në formë paradhënie për 6 muajt e parë të veprimtarisë pas rregjistrimit në organin tatimor. Kështu, nëse një tatimpagues që zhvillon veprimtari në sferën prodhuese, rregjistrohet në organin tatimor më 1 janar të vitit vijues, ai nuk do të paguajë

tatim në formë paradhënie mbi fitimin për periudhën janar-qershor të vitit vijues, ndërsa për periudhën tjetër korrik-dhjetor, ai do të paguajë tatim mbi fitimin në formë paradhënie mbi bazën e deklaratës parashikuese për shumën e vlerësuar të detyrimit mujor, sipas paragrafit të parë të kësaj pike.

Në rast se veprimtaria e këtij tatimpaguesi (rregjistrimi në organin tatimor) kryhet në muajin shtator të vitit vijues, ai nuk do të paguajë tatim mbi fitimin në formë paradhënie për periudhën shtator-dhjetor të vitit vijues.

3.13.2 Korigjimi në ulje i kësteve të pagesave paradhënieve të tatimit mbi fitimin.

Kur tatimpaguesi vërteton para organeve tatimore, në mënyrë domethënëse dhe të argumentuar uljen e masës së përcaktuar të tatimit mbi fitimin, atëherë organet tatimore pas kontrollit dhe verifikimit në vend pranë tatimpaguesit, pranojnë zvogëlimin e kësteve të pagesave paradhënieve.

Shembull 1.

Kështet e llogaritura për muajt janar-prill: 400.000 lekë
Kështet e llogaritura për muajt maj-tetor: 1.200.000 lekë
Shuma: 1.600.000 lekë
Tatimi mbi fitimin i vlerësuar mbështetur në informacionet e dhëna nga tatimpaguesi):
1.500.000 lekë
Kështet e llogaritura paraprakisht për muajt nëntor-dhjetor
400.000 lekë
Kështet totale për vitin tatimor ushtrimor 2.000.000 lekë

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar është 23 përqind më i ulët se shuma e kësteve të llogaritura paraprakisht (2 000 000/1 500 000), gjë që do të thotë se administrata tatimore duhet të ulë në zero kështet mujore të periudhës nëntor-dhjetor të vitit tatimor ushtrimor sipas pikës 5 të nenit 30.

3.13.3 Korigjimi në rritje i kësteve të paradhënieve.

Administrata tatimore mund të rrisë kështet mujore të paradhënieve për dy muajt e fundit të vitit tatimor ushtrimor, në rastet e mëposhtme:

a. Kur tatimpaguesi konstaton se fitimi i vlerësuar prej tij është më i lartë se 10% te kësteve te parapaguara prej tij, ai duhet të paraqese një deklaratë vlerësimi të fitimit të vitit tatimor ushtrimor jo më vonë se data 31 tetor. Mbi këtë bazë administrate tatimore korrigjon kështet për muajt nëntor dhe dhjetor.

Shembull 1.

Kështet e llogaritura për muajt janar – prill: 400.000 lekë
Kështet e llogaritura për muajt maj – tetor: 1.200.000 lekë
Shuma: 1.600.000 lekë
Tatimi mbi fitimin i vlerësuar (mbështetur në informacionin e dhënë nga vetë tatimpaguesi):
2.500.000 lekë
Kështet e llogaritura paraprakisht për muajt nëntor–dhjetor:
400.000 lekë (2x200.000)
Kështet totale për të gjithë vitin tatimor ushtrimor
2.000.000 lekë (1.600.000+400.000)

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar është 25 përqind më i lartë se kështet e llogaritura paraprakisht, gjë që çon në një shtesë kësti për muajt nëntor-dhjetor prej 500.000 lekë në muaj (250.000+250.000 lekë)

Shembull 2.

Kështet e llogaritura për muajt janar-prill: 400.000 lekë
Kështet e llogaritura për muajt maj-tetor: 1 200.000 lekë
Shuma: 1 600.000 lekë
Tatimi mbi fitimin i vlerësuar (mbështetur në informacionet e dhëna nga tatimpaguesi):
2.100.000 lekë
Kështet e llogaritura paraprakisht për
muajt nëntor – dhjetor: 400.000 lekë
Kështet totale për vitin tatimor ushtrimor: 2.000.000 lekë

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar është 5 përqind më i lartë se shuma e kësteve të llogaritura paraprakisht (2.100.000/2.000.000), gjë që do të thotë së administrata tatimore nuk do të zbatojë pikën 6 të nenit 30.

b.Administrata tatimore korrigjon madhësinë e kështit mujor kur pas një kontrolli të kryer për

vitin tatimor paraardhës rezulton se tatimi mbi fitimin për vitin paraardhës ka qënë i pasaktë.

c. Administrata tatimore korrigjon madhësinë e këstit mujor, në çdo rast kur tatimpaguesi nuk vepron në përputhje me kërkesat e përmendura në pikën ‘’a’’ më sipër, duke u bazuar në të gjitha informacionet që ka në dispozicion, si të dhënat për xhiron, importet, eksportet, tenderat e fituar, informacione nga bankat, furnitorët, klientët, etj.

Në çdo rast, organi tatimor njofton tatimpaguesin për shtesën e kësteve, nëpërmjet Njoftim Vlerësimit Tatimor, dokument që përpilohet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

3.13.4 Afatet e pagesës dhe rillogaritja përfundimtare

Gjatë periudhës vijuese tatimore, tatimpaguesi paguan në llogarinë e organeve tatimore, jo më vonë se data 15 e çdo muaji, tatim fitimin mujor përkatës, për llogari të muajit në vijim, sipas metodës së përllogaritjeve të përshkruar më lart. Përjashtim nga ky rregull bëjnë tatimpaguesit, paradhënia e të cilëve nuk kalon shumën 10.000 lekë në muaj. Në këtë rast paradhëniet paguhen në mënyrë të përmbledhur për çdo tremujor, deri në datën 15 të muajit që pason tremujorin.

Llogaritja përfundimtare e tatimit mbi fitimin bazohet në të dhënat faktike të deklaratës tatimore dhe dokumentave të tjera mbështetëse, si bilanci kontabël dhe anekset e tij, të dhënat nga rezultatet e kontrollit tatimor, si dhe çdo dokument tjetër ligjor që ndihmon në përcaktimin e detyrimit tatimor. Organi tatimor mund të kërkojë të dhëna shtesë nga tatimpaguesi ose të bëjë verifikime në vend që ndihmojnë në saktësimin e detyrimit tatimor.

Nëse tatimi i deklaruar në bazë të deklaratës vjetore të të ardhurave është më i madh se paradhëniet e bëra gjatë vitit, tatimpaguesi është i detyruar të derdhë diferencën në momentin e paraqitjes së deklaratës. Nëse shumat e paradhënieve rezultojnë më të mëdha nga ato të deklaruara në deklaratën vjetore të të ardhurave, apo nga rezultatet e një kontrolli tatimor, organet tatimore janë të detyruara t’i njohin këto shuma për shlyerjen e detyrimeve tatimore të prapambetura ose për pagesën e detyrimeve tatimore të ardhshme, përfshirë pagesën e kësteve paradhënie për periudhat e ardhshme. Me kërkesën e tatimpaguesit këto shuma mund t’i rikthehen atij brenda 60 ditësh nga marrja e deklaratës tatimore.

4. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN

4.1 OBJEKTI I TATIMIT TË THJESHTUAR MBI FITIMIN

Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj tatimpaguesve, pavarësisht nga forma e organizimit, që nuk janë të regjistruar, ose të detyruar me ligj për t’u rregjistruar si tatimpagues për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

4.2 TARIFA E TATIMIT TË THJESHUAR MBI FITIMIN

Tarifa e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin është 1.5% e të ardhurave bruto (qarkullimit) të tatimpaguesit. Për efekt të llogaritjes së bazës tatimore mbi të cilën llogaritet ky tatim nuk njihet asnjë lloj shpenzimi i zbritshëm.

4.3 PËRJASHTIMET

Në bazë të pikës 2 të Nenit 32/1 do të përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin:

a. Ambulantët në fushën e tregtisë.

Këtu përfshihen tregtarët lëvizës, pra që nuk kanë një vend fiks biznesi, por i tregtojnë mallrat ose produktet e tyre artizanale në mjete të thjeshta lëvizëse si karroca, apo qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara ku shesin me pakicë produkte artizanale ose produkte të tjera si gazeta, revista, pije freskuese, akullore, misra, zbukurime artistike, etj. Pra në këtë grup përfshihen tregtarë të vegjël ambulantë që nuk kanë dyqan apo një vend fiks në tregjet e shitjes me shumicë ose me pakicë;

b. Personat që merren me transport individual.

Këtu përfshihen shoferat e taksive, të furgonëve, autobuzëve, kamionëve, kamionçinave apo të triçiklave që transportojnë pasagjerë apo mallra për nevoja të popullatës;

4.4 Regjistrimi

Regjistrimi i tatimpaguesve të biznesit të vogël bëhet në përputhje me proçedurat që vijojnë:

a. Tatimpaguesit e biznesit të vogël rregjistrohen vetëm një herë në momentin e fillimit të aktivitetit të tyre. Për t’u regjistruar në organin tatimor tatimpaguesi duhet të paraqesë të dhënat dhe dokumentat e mëposhtme:

- Formularin “Kërkesë për Rregjistrim” sipas formatit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi, të plotësuar me të gjithë të dhënat e kërkuara si dhe të nënshkruar nga tatimpaguesi.

- Dokumentin e identifikimit (çertifikatën personale me fotografi) të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

- Vendimin e gjykatës për rregjistrimin e personit fizik ose juridik.

- Statutin dhe aktin e themelimit në rastin e rregjistrimit personave juridikë.

- Aktin e pronësisë të vendndodhjeve të biznesit ose kontratat e qeramarrjes për vendndodhjet e biznesit.

- Të dhëna për qarkullimin (xhiron) e parashikuar për vitin vijues, sipas Formularit ”Deklarate Parashikuese e Qarkullimit për Biznesin e Vogël” E-TBV-014.

- Licencën teknike dhe profesionale për veprimtaritë ekonomike për të cilat kërkohet me ligj një gjë e tillë.

b. Në rast mosrregjistrimi, tatimpaguesit do të rregjistrohen nga vetë organi tatimor përkatës me të njëjtat efekte si të ishte bërë nga tatimpaguesi. Në bazë nenit 32/8 të Ligjit, në një rast të tillë aplikohet një gjobë prej 35.000 lekësh.

c. Tatimpaguesit do të rregjistrohen në degën e tatimeve ku gjendet vendi kryesor i biznesit. Vendi kryesor i biznesit është vendndodhja e biznesit e caktuar nga tatimpaguesi si vendi kryesor i veprimtarisë në kërkesën për rregjistrim. Nëse nuk ka vendndodhje fikse të veprimtarisë, vendi kryesor i veprimtarisë do të jetë adresa e vendbanimit ose ajo e deklaruar nga vetë tatimpaguesi.

d. Çdo tatimpagues, pas përfundimit të proçesit të rregjistrimit, pajiset nga dega e tatimeve me Çertifikatën e Rregjistrimit. Tatimpaguesit që janë rregjistruar me detyrim nuk do të pajisen me çertifikatë rregjistrimi deri sa të plotësojnë të gjithë kërkesat për rregjistrim të parashikuara në ligj. Megjithatë, për qëllime evidentimi dhe të pagimit të detyrimeve, këta tatimpagues konsiderohen si të rregjistruar.

e. Kur tatimpaguesi ka më shumë se një vendndodhje biznesi, ai duhet pajiset me Çertifikatë për çdonjërën nga këto vendndodhje. Në këtë rast, çertifikatat janë me të njëjtin NIPT, por me numër serial të ndryshëm të plotësuar me të dhënat e çdo vendndodhje të biznesit. Për qëllimet e nenit 32/2 të Ligjit, dhe të çdo dispozite tjetër të këtij Ligji, nuk pranohet fotokopja e çertifikatës së rregjistrimit. Çertifikata e Regjistrimit është e detyrueshme të vendoset në një hapesirë të dukshme të vendndodhjes së biznesit, me qëllim identifikimin e rregjistrimit të kësaj vendndodhje. Çertifikata e Regjistrimit është subjekt inspektimi nga organet tatimore.

f. Tatimpaguesi duhet të informojë degën e tatimeve për çdo ndryshim në të dhënat e paraqitura në momentin e rregjistrimit, përfshirë ndryshime në adresë, në llojin e aktivitetit, etj., duke përdorur Formularin e Kërkesës për Rregjistrim. Nëse tatimpaguesi ndryshon vendndodhjen e biznesit, duke e kaluar atë në një vendndodhje që është nën juridiksionin e një dege tjetër tatimesh, ai duhet të njoftojë organin tatimor ku është i rregjistruar si dhe organin tatimor ku është vendndodhja e re, brenda 2 javësh. Organi tatimor do të lëshojë një Formular për Pagesë të Zakonshme, ku jepet adresa e re, ndërsa pagesa mund të bëhet në filialin e bankës ose zyrës së postës ku ndodhet vendndodhja e biznesit. Nëse ndryshimi nuk njoftohet, pagesa e tatimeve duhet të bëhet në përputhje me të dhënat e Formularit për Pagesë të Zakonshme në bankë ose zyrën e postës në vendin e rregjistrimit.

4.5 DEKLARIMI

Tatimpaguesi duhet të deklarojë çdo vit para datës 31 Mars qarkullimin e tij të përgjithshëm për vitin e kaluar, nga të gjitha bizneset që përfshihen në objektin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin, sipas “Formularit të Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin” , bashkangjitur këtij Udhëzimi.

Tatimpaguesi duhet të deklarojë gjithashtu brenda datës 31 Mars edhe qarkullimin e parashikuar për vitin në vijim, sipas Formularit ”Dëklaratë Parashikuese e Qarkullimit për Biznesin e Vogël” E-TBV-014.

Nëse tatimpaguesi mbyll aktivitetin, ai duhet të paraqesë një deklaratë të qarkullimit të tij për vitin në vazhdim deri në datën e mbylljes, në Formularin e Njoftimit të Ndryshimeve në Rregjistrim, sipas modelit bashkangjitur këtij Udhëzimi.

Në rastet e ndërprerjes së përkohshme të aktivitetit, tatimpaguesi është i detyruar të deklarojë në Degën e Tatimeve kërkesën për ndërprerje të aktivitetit, në të cilën do të jepen detaje për arsyet dhe afatin e ndërprerjes së përkohëshme të aktivitetit. Me paraqitjen e kësaj kërkese duhet të dorëzohet dhe Çertifikata e rregjistrimit, NIPT-i i tatimpaguesit dhe deklarata mbi qarkullimin e realizuar dhe pagesën e detyrimit deri në afatin e ndërprerjes.

4.6 DOKUMENTACIONI QË PËRDORET DHE MBAJTJA E REGJISTRIMEVE

Për çdo vendndodhje të veprimtarisë, tatimpaguesi duhet të mbajë një seri rregjistrimesh më vete dhe dokumentacionin që lidhet me atë vendndodhje biznesi.

Për qëllimet e këtij tatimi, tatimpaguesi duhet të mbajë rregjistrimet dhe dokumentat që vijojnë:

- Dokumentet e blerjes, ku përfshihen fatura me TVSH, fatura të thjeshta, dëftesa tatimore, etj. për të vërtetuar blerjet e kryera.
- Dokumentat e shitjes, fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe përmbledhëset ditore të arkës regjistruese (për shitjet me arkë).
- Librin e blerjeve dhe
- Librin e shitjeve.

Të gjitha këto dokumenta do të jenë në përputhje me modelet që i bashkangjiten këtij Udhëzimi.

- Tatimpaguesit e biznesit të vogël janë të detyruar të lëshojnë dokumentat e mëposhtëm për çdo shitje malli apo shërbimi që realizojnë:
- Kupon tatimor në rastin kur tatimpaguesi është i pajisur me arkë rregjistruese. Ky kupon i jepet klientit për çdo shitje të kryer.
- Dëftesë tatimore, sipas modelit bashkangjitur këtij Udhëzimi, në rastin kur tatimpaguesi nuk është pajisur me arkë regjistruese, ose kur për arsye objektive, si mungesa e elektricitetit, etj., tatimpaguesi nuk mund të përdorë arkën rregjistruese. Dëftesat tatimore përgatiten në dy kopje me letër vetëkopjuese nga të cilat njëra i jepet klientit.
- Faturë të thjeshtë tatimore (sipas modelit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi) e cila lëshohet vetëm nga tatimpaguesit, të cilët shesin mallra apo shërbime për klientë të cilët nuk janë konsumatorë finalë të mallit apo shërbimit, por i kryejnë këto blerje për qëllim përpunimi apo rishitje, dhe janë subjekte të rregjistruar për tatimet. Tatimpaguesi duhet t'i japë klientit një faturë për çdo shitje mallrash apo shërbimesh. Fatura do të përbëhet nga dy kopje duke përdorur letër vetëkopjuese ose letër karbon, dhe tatimpaguesi do t'i japë një kopje klientit dhe një kopje do t'a mbajë vetë. Fatura duhet të jetë me numër serial, dhe numri i faturës duhet të shënohet në librin e shitjeve dhe blerjeve.

Në fund të çdo dite pune, tatimpaguesi duhet të rregjistrojë në librin e blerjeve totalin e blerjeve që ka bërë atë ditë, si edhe shpenzime të tjera që mund të ketë kryer, si pagesë qeraje, elektriciteti, paga, etj.

Në librin e shitjeve, në fund të çdo dite pune, tatimpaguesi duhet të rregjistrojë totalin e vlerës së shitjeve të realizuara prej tij, duke i grupuar respektivisht në shitje me faturë të thjeshtë tatimore, shitje me arkë rregjistruese (totali ditor i kasës) dhe shitje me dëftesa tatimore.

Jo më vonë se data 5 e çdo muaji, tatimpaguesi duhet të ketë llogaritur dhe mbyllur totalin e blerjeve dhe të shitjeve për muajin e kaluar. Tatimpaguesi nuk lejohet të grisë apo zëvendësojë faqet e librit të blerjeve apo të shitjeve, apo faqet e blloqeve të faturave të thjeshta tatimore apo dëftesave tatimore.

Të gjitha këto regjistrime dhe dokumenta duhet të ruhen nga tatimpaguesi, për një periudhë prej jo më pak se 5 vjet nga fundi i vitit kalendarik të cilit i përkasin.

Dega e tatimeve mundet që, në çdo kohë, të kontrollojë mbajtjen ose lëshimin nga ana e tatimpaguesit të dokumentave që vërtëtojnë shitjen (kupon kase, dëftesë tatimore, faturë e thjeshtë tatimore).

4.7 KONTROLLI TATIMOR DHE VERIFIKIMI

Gjatë vitit, organet tatimore kontrollojnë rregullshmërinë e rregjistrimeve të kërkuara nga ligji, për tatimpaguesit. Për këtë qëllim ato kontrollojnë: lëshimin e kuponit tatimor, të dëftesës tatimore apo faturës së thjeshtë, si dhe rregjistrimin e çdonjërit prej këtyre dokumentave në librin e shitjes. Ato kontrollojnë gjithashtu edhe evidentimin dhe rregjistrimin nga tatimpaguesit të blerjeve të realizuara për qëllimet e biznesit (rishitje, përpunim apo shpenzime te tjera), nëpërmjet dokumentacionit përkatës.

Dega e tatimeve, gjithashtu mund të ushtrojë kontroll të plotë në ambjentet e tatimpaguesit, duke e njoftuar paraprakisht atë. Në kontrollin e plotë organi tatimor kontrollon dhe verifikon mbajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe rregjistrimeve sipas përcaktimeve të bëra në këtë Udhëzim.

Krahas kontrollit të dokumentacionit, punonjësit e kontrollit të organeve tatimore bëjnë jo më pak 2-3 kontrolle (sondazhe për matjen e xhiros) në vit për çdo tatimpagues, me qëllim vlerësimin e

qarkullimit të realizuar nga tatimpaguesi nëpërmjet kronometrimit. Të dhënat e grumbulluara nga kronometrimet shërbejnë për vleresimin e detyrimeve tatimore si të vitit vijues, ashtu edhe të vitit pasardhës. Për saktësimin e të dhënave të tatimpaguesve, organet tatimore shfrytëzojnë edhe burime të tjera informacioni me të cilët tatimpaguesi ka operuar (si të dhënat e veprimeve me Thesarin, të dhëna nga shkëmbimi i informacionit, të dhëna nga zbërthimi i shitjeve të tatimpaguesve të mëdhenj importues apo prodhues etj). Mbi bazën e rregjistrimeve korrekte të mbajtura gjatë gjithë vitit dhe vlerësimeve nga kontrollet e organit tatimore, tatimpaguesit llogarisin dhe derdhin tatimin e thjeshtuar mbi fitimin, sipas afateve të përcaktuara në Ligj. Për mos deklarim të saktë të qarkullimit, në bazë të nenit 32/8, pika 1/b, të këtij Ligji, aplikohet një gjobë e barasvlefshme me 25% të shumës së detyrimit tatimor të fshehur.

4.8 PAGESA

4.8.1 Llogaritja e kësteve të pagesës paradhënie

Tatimpaguesi duhet të bëjë një parashikim të qarkullimit të tij për të gjithë vendndodhjet e biznesit, që duhet të bazohet në qarkullimin faktik të vitit të kaluar dhe në ndryshimet që parashikohen të ndodhin gjatë periudhës në vazhdim. Administrata tatimore llogarit kështet e tatimit në bazë të qarkullimit të parashikuar nga tatimpaguesi, përveç rasteve kur ekzistojnë të dhëna që tregojnë se parashikimi i bërë nga tatimpaguesi është i pasaktë, situatë në të cilën administrata tatimore mund të përdorë të dhënat që disponon dhe metoda indirekte për të rivlerësuar shifrën e qarkullimit të dhënë nga tatimpaguesi dhe të llogarisë kështet në bazë të të dhënave të saj.

Në rastet kur tatimpaguesi ka kryer veprimtari vetëm një pjesë të vitit (disa muaj) të mëparshëm, për të llogaritur qarkullimin për vitin vijues do përdoret formula e mëposhtme:

12/n x qarkullimin e deklaruar (ku n është numri i muajve të pjesshëm ose të plotë për të cilët ka patur qarkullim).

Administrata tatimore përdor gjithashtu të dhënat e ndryshme që disponon për të rivlerësuar shifrën e qarkullimit të dhënë nga tatimpaguesi dhe të llogarisë kështet në bazë të shifrave të rivlerësuara.

Lidhur me llogaritjen e kësteve të pagesës së detyrimeve, në vijim jepet një shembull ilustrues.

Shembull 1

Supozojmë se një tatimpagues, siç përcaktohet në nenin 32/4 të Ligjit, jo më vonë se data 31 Mars të vitit 2006 ka deklaruar qarkullimin për vitin 2005 dhe ka parashikuar për qarkullimin e vitit 2006 shumën 8.000.000 lekë.

Mbi bazën e këtij parashikimi Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2006 llogaritet :

8.000.000 x 1.5% = 120.000 lekë. Kjo shumë duhet të paguhet në 4 këste, respektivisht për 30.000 leke, jo më vonë se 20 prill, 20 korrik, 20 tetor dhe 20 dhjetor të vitit 2006.

Deri më datë 20 Prill të vitit 2006 krahas pagesës së kestit të parë për shumën 30.000 lekë duhet bërë dhe pagesa e mbetur nga rillogaritja e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin të vitit 2005.

4.8.2 Llogaritja dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi.

Personat juridikë dhe fizikë të rregjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël llogarisin dhe paguajnë tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për personat e punësuar, brenda datës 20 të muajit pasardhës të çdo tremujori të vitit kalendarik. Në rastin e personave juridikë, të punësuar konsiderohen edhe pronarët e personit juridik të cilët ushtrojnë funksione drejtuese apo çdo funksion tjetër tek ky person juridik.

Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi pasqyrohet në listpagesën "Për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetesore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi" sipas modelit që i bashkangjitet Udhëzimit të Ministrit të Financave "Për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetesore". Kjo listpagesë hartohet në baza mujore por dorëzohet, në degën përkatëse të tatimeve në baza tremujore brenda datës 20 të muajit pasardhës të çdo tremujori të vitit kalendarik.

Pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi duhet të kryhet së bashku me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetesore brenda datës 20 të muajit pasardhës të çdo tremujori të vitit kalendarik. Për këtë qëllim përdoret "Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", që i bashkangjitet këtij Udhëzimi.

4.8.3 Vlerësimi i detyrimeve tatimore shtesë

Kur vlerësohen detyrimet tatimore shtesë, organet tatimore mund të përdorin metoda alternative vlerësimi të parashikuara në Ligjin „Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"

dhe Udhëzimin në zbatim të tij.

Organet tatimore, për rastet kur konstatojnë se dokumentacioni i blerjeve dhe shitjeve nuk është mbajtur konform kërkesave ligjore, që do të thotë se: tatimpaguesi nuk pasqyron në mënyrë korrekte qarkullimin, nuk lëshon në mënyrë korrekte dokumentin e kërkuar për çdo shitje, nuk pasqyron në librat e blerjes të gjitha furnizimet që ka kryer, kanë të drejtë të përdorin metodat alternative të vlerësimit të detyrimit tatimor. Metodat alternative të vlerësimit janë përcaktuar në Ligjin "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe në Udhëzimin në zbatim të tij. Gjithashtu këto metoda do të përdoren edhe në rastet kur tatimpaguesit nuk deklarojnë të ardhurat e realizuara. Këto metoda do të përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, sondazhet dhe fotografimet e kryera lidhur me xhiron, sipërfaqet e prodhimit apo të shërbimit që disponon tatimpaguesi, pozicioni i vendit të biznesit (qëndër apo periferi) detyrimet e llogaritura nga tatimpagues të rregullt, por që kanë afërsisht të njëjtat kushte biznesi sikurse tatimpaguesi të cilit i bëhet vlerësimi, konsumi i energjisë elektrike, niveli i qerasë, numri i punonjësve, etj.

4.8.4 Mënyra e pagesës

Pagesa bëhet duke përdorur Urdhër Pagesën për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin, sipas modelit që i bashkangjitet këtij Udhëzimi. Përpara pagesës, në formular duhet të vendoset NIPT-i i tatimpaguesit. Tatimi paguhet në një bankë ose zyrë postare e cila vepron si agjente për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Pagesa bëhet në datën e përcaktuar nga ligji ose përpara saj, në një bankë ose zyrë postare që ndodhet në rrethin ku është rregjistruar tatimpaguesi. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nxjerr gjithashtu në formë kujtese një kalendar me datat e deklarimeve dhe të pagesave të detyrimeve tatimore.

Pagesa e pjesshme apo parapagesa për të cilën nuk identifikohet tatimpaguesi duke iu referuar NIPT-it, nëse pranohet nga banka apo zyra postare që vepron si agjent për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, nuk do të konsiderohet si pagesë kundrejt atij detyrimi të tatimpaguesit derisa të identifikohet pozitivisht nga organi tatimor se cili është tatimpaguesi që ka bërë pagesën. Nëse ky identifikim bëhet pas datës kur duhet të kryhej pagesa e tatimit, tatimpaguesi do të gjobitet sikur tatimi të ishte paguar në bankë apo zyrën postare në datën e identifikimit.

4.9 TRANSFERIMI I TË ARDHURAVE NË BUXHETET E BASHKIVE

Tatimi i mbledhur derdhet në buxhetin e shtetit për t'u transferuar eventualisht në buxhetet e çdo bashkie apo komune ku tatimpaguesi ka vendndodhjen e veprimtarisë, në përpjestim me qarkullimin e realizuar nga kjo vendndodhje, sipas procedurave ekzistuese.

Organi tatimor pajis degën e tatimeve të bashkisë ose komunës me një listë të çertifikatave të rregjistrimit të lëshuara për vendndodhjet e biznesit brenda juridiksionit të tyre. Kjo listë identifikon qartë emrin dhe NIPT-in e tatimpaguesit, adresën e vendndodhjes së biznesit dhe shumën e tatimit të paguar.

Punonjësit e zyrës se tatimeve të bashkisë ose komunës duhet të përdorin këtë informacion për të informuar Degën përkatëse të Tatimeve për çdo biznes të njohur i cili nuk është pajisur me çertificatë rregjistrimi.

Kur merr informacione nga bashkia apo komuna për biznese të cilat nuk janë të pajisura me Çertifikatë Rregjistrimi, dega e tatimeve merr masa për t'i regjistruar këto biznese brenda 30 ditësh pas marrjes së informacionit dhe informon bashkinë apo komunën për masat e marra brenda 45 ditësh pas marrjes së informacionit. Proçedurat e bashkëpunimi midis degëve të tatimeve dhe organeve të pushtetit vendor përcaktohen në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Vendor nr.5, datë 27.1.2003 "Mbi bashkëpunimin ndërmjet organeve tatimore qendrore dhe organeve të pushtetit vendor lidhur me administrimin e taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimin e thjeshtuar mbi fitimin".

5. TATIMI NE BURIM

5.1 MBAJTJA NE BURIM E TATIMIT MBI TE ARDHURAT

Në zbatim të nenit 33 të Ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, që bën pagesë të çdonjerës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

5.2 TATIMI NË BURIM NUK DO TË MBAHET KUR PAGESA I BËHET:

a. Personave juridikë të referuar në shkronjën "a" të pikës 1 të Nenit 16, që janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin dhe tatimit mbi vlerën e shtuar në organet tatimore shqiptare (pasi këta persona i përfshijnë këto të ardhura në të ardhurat e tyre të tatueshme);

b. Personave fizikë tregtarë të përfshirë në shkronjën "c" të pikës 1 të nenit 16, të cilët janë të rregjistruar si tatimpagues të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe të tatimit mbi fitimin dhe i përfshijnë këto të ardhura në të ardhurat e tatueshme.

c. Personave fizikë tregtarë, subjekte të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin kur pagesa është për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal te biznesit të tyre.

Këtu do të përfshihen dhe personat fizik tregtare që merren me grumbullimin e mbetjeve të metaleve, grumbullimit të bimëve mjekësore, grumbullimin e qumështit, ullirit, rrushit, shishe, etj.

Nuk mbahet tatim në burim për faturën që i paguhet një eksperti kontabël të rregjistruar si tatimpagues i Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin për shërbimet profesionale të kryera prej tij, pasi këto të ardhura janë të ardhura nga veprimtaria e tij normale biznesore dhe tatohen si të tilla, por do të mbahet tatimi në burim në rastet e pagesave që i bëhen ekspertëve kontabël për dividentë, interesa, të ardhura nga qeratë, etj., sipas përcaktimit në nenin 33.

d. Çdo personi juridik Shqiptar apo të huaj për pagesa lidhur me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

e. Çdo personi fizik ose juridik të huaj për shërbime që ata kryejnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të vërtëtuara me dokumentacionin përkatës financiar e teknik. Degët e tatimeve kërkojnë interpretimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për trajtimin tatimor të këtyre shërbimeve.

5.3 NIVELI I TATIMIT TE MBAJTUR NE BURIM

Tatimi në burim mbahet në masën 10% të pagesës bruto për të gjitha pagesat e listuara në nenin 33 me përjashtim të rasteve të dhëna në pikën 5.2 më lart. Për të ardhurat nga shitja e aksioneve apo kuotave të pjesëmarrjes, apo për tërheqjet (zvogëlimet) e kapitalit themeltar, ky tatim llogaritet për të ardhurat neto, në përputhje me sqarimet e bëra në këtë Udhëzim.

5.4 MBAJTJA E TATIMIT NE BURIM PER PAGESAT E KRYERA NGA JOREZIDENTET

Në zbatim të pikës 3 të nenit 33 të Ligjit, edhe personat jorezidentë mbajnë në burim tatimin për të gjitha pagesat (përcaktuar në pikën 1 të nenit 33 të Ligjit) të kryera nga ana e tyre, kur këto pagesa kryhen nëpërmjet një selie të përhershme që ata kanë në Republikën e Shqipërisë, apo përfaqesuesit të emëruar prej tyre.

5.5 EVIDENTIMI I TATIMIT TE MBAJTUR NE BURIM

Tatimi i mbajtur në burim evidentohet nga personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qëndrore dhe vendore, si dhe nga çdo subjekt tjetër i njohur si i tillë nga legjislacioni në fuqi, nëpërmjet rregjistrimeve në librat përkatës të evidentimit, të cilët përmbajnë të dhëna të plota identifikuese për subjektin përfitues (përfshirë fotokopje të çertifikatës së rregjistrimit në organin tatimor të përfituesit, sidomos kur nuk mbahet tatim në burim), shumën e pagesës, dhe tatimin e mbajtur në burim.

5.6 MBAJTJA E TATIMIT NE BURIM PER DIVIDENTET

Në zbatim të nenit 33/1 të ligjit, tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin, brenda datës 31 korrik të çdo viti duhet të depozitojnë, pranë Degës së Tatimeve, vendimin e organit kompetent vendim-marrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë të kapitalit dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividenti.

Në rast paraqitje me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë në masën 25.000 lekësh, për çdo muaj apo pjesë të muajit.

Tatimi mbi dividentin për llogari të organeve tatimore, duhet të derdhet nga shoqëria, brenda datës 30 korrik të vitit kur bëhet miratimi e rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividentit për përfituesit. Për mospagesën e ketij detyrimi brenda datës 30 korrik zbatohen interesat për pagesë të vonuar në zbatim te Ligjit Nr 8560, datë 22.12.1999 "Për proçedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

5.7 ZVOGELIMET E KAPITALIT

Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve, do të konsiderohet divident i tatueshëm dhe do të tatohet me 10%, por vetëm në masën që zvogëlimi i kapitalit rrjedh nga fitimet e kapitalizuara të shoqërisë dhe jo nga kontributet në para ose në natyrë të pronarëve. Sigurisht shtesat e kapitalit, kontributet në para ose në natyrë të ortakëve, dhe zvogëlimi i kapitalit duhet të jenë bërë në përputhje me rregullat dhe proçedurat e Ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

5.8 MBAJTJA E TATIMIT NE BURIM MBI TE ARDHURAT E ANTA-S

Në zbatim të paragrafit 5 t ë nenit 33 "Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat", Agjensia Ndërkombëtare e Transportit Ajror (ANTA) duhet të llogarisë dhe të derdhë në organet tatimore një tatim në masën10 % të arkëtimeve bruto nga Eurokontrolli, jo më vonë se 15 ditë nga çasti i arkëtimit. Brenda datës 20 të çdo muaji Dega e Tatimeve Tiranë dhe ANTA duhet të rakordojnë mbi shumat e faturuara dhe arkëtuara dhe tatimin e paguar, duke mbajtur dhe një akt-rakordimi.

6. TRANSFERIMI I ÇMIMIT

"Transferimi i çmimit", që në një formulim më të gjërë mund të shprehet "Transferimi i fitimit nëpërmjet ndryshimit të çmimeve", ka të bëjë kryesisht me persona të lidhur si: shoqëri, degë apo filiale që janë pjesë të një grupi kompanish, të një shoqërie shumëkombëshe apo ortakërie, apo që zotërohen nga i njëjti person apo grup personash, etj, të cilat janë të shpërndara dhe ushtrojnë biznesin në dy ose më shumë shtete, në të cilat trajtimi tatimor është i diferencuar.

Duke qenë se këta persona kanë lidhje të veçanta midis tyre (pra kontrollojnë njeri tjetrin apo kontrollohen nga të njejtët persona apo i përkasin të njëjtës kompani shumëkombëshe) ato mund të vendosin çmimet e shitjes për lëndët e para, gjysëmproduktet apo produktet që lëvizin nga njëri tek tjetri në mënyrë të tillë që pjesa më e madhe e fitimit të transferohet në atë vend ku tatim fitimi është më i ulët ose ku nuk ka tatim fare. E njëjta gjë mund të ndodhë edhe me shërbimet, si shërbime teknike, konsulenca, etj. që personat e lidhur i faturojnë njëri-tjetrit.

Çdo korrigjim i transferimit të çmimit në rastin e transaksioneve ndërkombëtare mund të bëhet vetëm nëpërmjet Komisionit të Transferimit të Çmimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në Ministrinë e Financave. Nëse një organ tatimor kërkon të zbatojë këtë dispozitë, ajo duhet t'ja kalojë çështjen komisionit të lartpërmendur. Ky Komision zbaton nenin 36 duke iu referuar rigorozisht Udhëzuesit të OECD-së të botuar në vitin 1995 për transferimin e çmimit.

Ky Komision mund të hyjë në marrëveshje detyruese me tatimpaguesin, mbështetur në pikën 2 të nenit 36, për të përcaktuar që më përpara transferimin e çmimit. Një marrëveshje e tillë do të nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

7. KREDITIMI I TATIMIT TË HUAJ

7.1 Kreditimi i tatimit te paguar jashte territorit te Republikes se Shqiperise

Neni 37 (paragrafi 1 dhe 2) ka të bëjë me kreditimin e tatimit që tatimpagues rezidentë në Republikën e Shqipërisë kanë paguar në vende të tjera (jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë) për fitime që ata kanë realizuar në ato vende. Por ky reduktim nuk do të kalojë nivelin e tatimit që do të aplikohej mbi ato të ardhura sikur ato të realizoheshin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të legjislacionit fiskal shqiptar.

Shembull:

Rasti 1. Një person juridik, rezident në Shqipëri, për vitin 2006, ka aktivitet në Shqipëri si edhe një degë në Itali, ku realizon fitim neto si më poshtë:

- nga aktiviteti në Shqipëri: 1.000.000 lekë;
- nga aktiviteti në Itali: 600.000 lekë.

Në bazë të dispozitave të këtij Ligji (neni 17) ky person, meqenëse është rezident Shqiptar, i nënshtrohet tatimit në Shqipëri mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pra detyrimi tatimor në Shqipëri do të jetë:

- fitimi në total: 1.600.000 lekë
- tatim fitimi=1.600.000 x 20% = 320.000 lekë

Por, për fitimin që ka realizuar në Itali tatimpaguesi është tatuar atje (si jo rezident) me tarifën e tatim fitimit në Itali që është 36%. Pra, tatimi i paguar në Itali:

600.000 x 36%=216.000 lekë

Tatimpaguesi sjell dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Pas

kësaj, Organi Tatimor Shqiptar bën reduktimin e tatimit si më poshtë:

- tatimi që duhej të paguhej sikur të ardhurat e realizuara në Itali të realizoheshin në Shqipëri: 600.000 x 20%=120.000 lekë. Pikërisht për këtë shumë do të bëhet reduktimi i tatimit, pra:

- 400.000 -120.000= 280.000 lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të paguajë në Shqipëri.

Rasti 2. Supozojmë se i njëjti Person Juridik Shqiptar ka një degë për ushtrimin e aktivitetit të tij në Hungari, ku tarifa e tatim fitimit është 18 %. Në këtë rast do të kishim:

- fitimi i realizuar në Shqipëri: 1.000.000 lekë
- fitimi i realizuar në Hungari: 600.000 lekë

Detyrimi tatimor në bazë të nenit 17 të ligjit:

1.600.000x20%=320.000 lekë

Por, për fitimin që ka realizuar në Hungari, tatimpaguesi është tatuar atje me tarifën 18%. Pra tatim fitimi i paguar në Hungari: 600.000 x 18 % = 108.000 lekë. Në këtë rast, meqenëse tatimi i paguar në Hungari (18%) nuk e kalon tatimin e pagueshëm për ato të ardhura në Shqipëri (20%), është pikërisht kjo shumë, pra 108.000 lekë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor në total. Në këtë rast, pasi nga tatimpaguesi të jetë marrë dokumentacioni i plotë që ka realizuar të ardhurat dhe ka paguar tatimin në Hungari në këtë shumë, kreditimi i tatimit do të bëhet si më poshtë:

320.000 -108.000=212.000 lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatimfitimit që ky subjekt do të paguajë në Shqipëri.

Siç shihet, kreditimi (reduktimi) i tatim fitimit të paguar jashtë për fitime të realizuara jashtë, në asnjë rast nuk duhet të kalojë, pra mund të jetë më i vogël ose i barabartë se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato fitime do të realizoheshin në Shqipëri.

I njejti parim vlen edhe për tatimin e individëve. Një individi rezident Shqiptar do t'i kreditohet tatimi mbi të ardhurat, i paguar jashtë Shqipërisë për të ardhura të realizuara jashtë (përkundrejt dokumentave vërtëtuese), por jo më shumë se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato të ardhura do të realizoheshin në Shqipëri.

Pra, gjithmonë, kreditohet (ose reduktohet) tatimi i paguar jashtë Shqipërisë për fitime ose të ardhura të realizuara jashtë Shqipërisë dhe nuk preket tatimi i të ardhurave të realizuara në Shqipëri.

7.2 KREDITIMI I HUMBJEVE

Paragrafi 3 i Nenit 37 lidhet me kreditimin (ose reduktimin) e humbjeve që një tatimpagues person juridik rezident shqiptar ka realizuar jashtë, përkundrejt fitimit që ai person ka realizuar në Shqipëri. Në këtë rast veprohet sikur neni 27 (Mbartja e Humbjeve) të zbatohej në çdo vend të huaj.

Shëmbull. Një person juridik rezident Shqiptar përveç aktivitetit në Shqipëri ka krijuar një degë në Itali (p.sh. aty mund të ambalazhojë produktet dhe të përfundojë kontrata shitjeje për tregun Italian) dhe dega në Itali vitin e parë rezulton me humbje dhe vitin e dytë me fitim. Të shohim si do të bëhet kreditimi (reduktimi) i humbjes në bazë të dispozitave të paragrafit të tretë të Nenit 37:

Për vitin 2001:

- fitimi në Shqipëri: 1.000.000 lekë
- humbja e degës në Itali: 200.000 lekë
- fitimi nga të gjitha burimet brenda dhe jashtë Shqipërisë (fitimi botëror ose global): 800.000 lekë
- tatim fitimi në Shqipëri:800.000x25%= 200.000 lekë
- tatim fitimi në Itali: 0 leke

Për vitin 2002:

- fitimi në Shqipëri: 1.000.000 lekë
- fitimi në Itali: 600.000 lekë
- fitimi nga të gjitha burimet Brenda dhe jashtë Shqipërisë (fitimi botëror): 1.600.000 lekë

tatim fitimi në Shqipëri si rezident (Neni 17) i llogaritur për fitimin global:1.600.000 x 25% =400.000 lekë

- tatim fitimi në Itali:600.000 x 36% = 216.000 lekë

Kreditimi (reduktimi) i tatimit të paguar në Itali do të bëhet në mënyrën dhe në masën që

vijon:

Nga fitimi i vitit 2002 i degës në Itali mbartet (zbritet) humbja e vitit të mëparshëm 600.000 - 200.000 = 400.000 lekë (sipas nenit 27). Për këtë shumë llogaritet tatimi sikur ky fitim të ishte realizuar në Shqipëri (sipas paragrafit 1 dhe 2 të Nenit 37), pra 400.000 x 25% = 100.000. Eshtë pikërisht kjo shumë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor global. Pra detyrimi tatimor përfundimtar per tatimin mbi fitimin që do të paguajë personi juridik në Shqipëri për vitin 2002, është: 400.000 - 100.000 = 300.000 lekë.

Paragrafi 4 i Nenit 37 jep faktin që (kreditimi) reduktimi i tatim fitimit i paguar në vende të tjera për të ardhura të realizuara apo humbje të pësuara në ato vende do të bëhet sipas metodave të përshkruara më lart për çdo vend në mënyrë të veçantë.

Në rastet e tatimit të paguar në vendet me të cilat janë përfunduar Marrëveshje (Konventa) për eleminimin e tatimeve të dyfishta, atëhere do të zbatohen dispozitat e këtyre Marrëveshjeve.

8. DISPOZITA KALIMTARE

Në zbatim të këtij neni, tatimpaguesit që përfitonin lehtësitë tatimore, sipas nenit 6 të ligjit nr. 7677, datë 03.03.1993 "Për tatimin mbi fitimin" do të vazhdojnë t'i gëzojnë ato në përputhje me dispozitat e atij ligji. Ndërsa subjektet e krijuar mbas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, nuk përfitojnë më lehtësi tatimore.

Gjithashtu, do të gëzojnë lehtësitë tatimore dhe përjashtimet, të gjithë tatimpaguesit e parashikuar në Ligjet: nr. 7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin"; nr 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit" dhe me Dekretin nr. 782, datë 22.2.1994 "Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve".

9. Shfuqizime

Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr. 5, datë 18.01.2005 shfuqizohet.

10. Bashkengjitur janë:

1. Tabela nr.1 "Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi";
2. Tabela nr.2 "Tatimi mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluejtëshme";
3. Formulari i Deklarimit dhe Pagesës të Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, E-TAP 010/a;
4. Formularit i deklarimit të të ardhurave personale nga burime të tjera (jo nga mardhënjet e punësimit aktual) E-TAP 013/a;
5. Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së Tatimit mbi Fitimin E-TAF 001/A;
6. Deklarata Analitike e Tatimit mbi të Ardhurat E-TAF 000/a;
7. Formulari "Kërkesë për Regjistrim" Form 1.1;
8. Formulari "Njoftim i Ndryshimeve në Regjistrim" Form 4.1;
9. Model Urdhër Pagese për Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin E-TBV-020/a;
10. Modeli i Librit të Blerjes për Tatimpaguesit e Biznesit të Vogël E-TBV-010;
11. Modeli i Librit të Shitjeve (Qarkullimit) për Tatimpaguesit e Biznesit të Vogël, E-TBV-011;
12. Modeli i Faturës së Thjeshtë Tatimore, E-TBV-055/a;
13. Modeli i Dëftesës Tatimore, E-TBV-013;
14. Formulari "Deklarata Parashikuese e Qarkullimit të Biznesit të Vogël" E-TBV-014.
15. Formulari i deklarimit dhe pageses se tatimit te thjeshtuar mbi fitimin. FDP-SPT 001.

11. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Tabela nr. 1

Tabela për tatimin mbi të ardhurat personale nga punësimi

E ardhura e tatueshme (në muaj)	T A P		
Mbi (lekë)	Deri në (lekë)	Lekë	Përqindje
0	14 000	0	+1% të shumës mbi 0 lekë

14 000	40 000	140	+5% të shumës mbi 14 000 lekë
40 000	90 000	1 440	+10% të shumës mbi 40 000 lekë
90 000	200 000	6 440	+15% të shumës mbi 90 000 lekë
200 000	Më tepër	22 940	+20% të shumës mbi 200 000 lekë

Tabela nr. 2

Tatimi i të ardhurave nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme

ÇMIMI I SHITJES	TATIMI I PAGUESHËM	
Mbi (lekë)	Në (lekë)	Përqindje
0	2 000 000	0,5% e çmimit të shitjes
2 000 000+	4 000 000	1% e çmimit të shitjes
4 000 000+	6 000 000	2% e çmimit të shitjes
6 000 000+	E më tepër	3% e çmimit të shitjes

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT
MBI TE ARDHURAT NGA PUNESIMI

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3)_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4)_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5)_____
Adresa: (6)_____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: (7)_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

(8) ☐ Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

(9) Te ardhurat e tatueshme (9)

(10) Tatimi per tu paguar (10)

(11) Numri gjithsej i personave per te cilet eshte mbajtur tatim (11)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke
☐ Xhirim
☐ Cek
☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Zyra e Tatimeve
Kopja -Personi i Tatueshem

Numri i Formularit E-TAP 010/a

Shenimet e Formularit E-TAP 010/a

Shenim 1:	*Periudha Tatimore.* Shenohet periudha tatimore ne formatin VVVVMM p.sh. 200509
Shenim 2:	*Numri Serial.* Kjo rubrike perdoret nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve.
Shenim 3–7:	*Kutiza 3 — 7 Gjeneralitete.* Shenoni te dhenat e subjektit siç paraqiten ne formular dhe tregoni nese te dhenat e paraqitura nuk jane te plota ose kane ndryshuar.
Shënim 8:	*Persona juridike, si dhe persona fizike me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) te regjistruar si tatimpagues ne TVSH, apo ne Biznesin e Vogel:* Nese per periudhen e deklarimit nuk egziston Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi per t'u paguar, spontoni kutizen nr.8. Nuk eshte e nevojshme te plotesoni ndonje kuti tjeter. Dorezojeni formularin, brenda dates se caktuar , ne banke ose poste (sipas percaktimit nga organet tatimore).
Shënim 9:	*Persona juridike, si dhe persona fizike me punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) te regjistruar si tatimpagues ne TVSH, apo ne Biznesin e Vogel :* Shënoni ne kutizen nr. 9 shumen e te gjithe pagave te tatueshme qe i keni dhene punemarresve (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter), që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a
Shënim 10:	Ne kutizen nr.10, shenoni shumen gjithsej te Tatimit mbi të Ardhurat nga Punesimi të mbajtur nga punëmarrësit e personit juridik dhe fizik (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a, dhe paguani shumën e duhur në bankë ose poste (sipas percaktimit nga organet tatimore), brenda dates se caktuar
Shenim 11	Ne kutizen nr.11, shenoni numurin gjithsej te punëmarrësve te personit juridik dhe fizik (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) per te cilet eshte mbajtur Tatim mbi te ardhurat nga punesimi, që e gjeni ne formularin "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a,
Shenim 12 **Personat Juridike e fizike te regjistruar ne TVSH ose dhe ne Biznesin e Vogel :**	*Person regjistruar ne TVSH (Biznes i Madh) apo ne Biznes te Vogel:* Plotesoni kutizat 9-10-11 me te dhena per gjithe punemarresit (perfshire dhe pronaret e personave juridike qe ushtrojne funksione drejtuese ne shoqeri si administratore apo çdo funksion tjeter) dhe me pas dergojeni kete formular ne banke ose ne poste (sipas percaktimit nga organet tatimore) me pagesen per t'u kryer. *a) Person i regjistruar ne TVSH (Biznes i Madh)* Formularin dorezojeni **brenda dates 20 te muajit ne vijim** te muajit te deklarimit, *b) Person I regjistruar ne Biznes te Vogel* Formularin dorezojeni **brenda dates 20 te muajit te pare pas perfundimit te çdo tremujori** te vitit kalendarik, **me te dhena mbi baze tremujori,** **Neqoftese kini statusin dhe punoni si I vetepunesuar i vetem pa punemarres apo si I vetepunesuar me punonjes te papaguar te familjes, nuk kini detyrim te paguani dhe deklaroni Tatim mbi te Ardhurat nga Punesimi.** **Sa herë** që ju edhe brenda të njëjtës periudhë tatimore (tremujori), **ndryshoni statusin**, nga "I vetëpunësuar i vetëm" dhe "I vetëpunësuar pa punëmarrës, me punonjës të papaguar të familjes" në statusin "I vetëpunësuar me punëmarrës" dhe "I vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes", **perpara ndryshimit te statusit jeni i detyruar te paraqiteni ne degen e tatimeve per te deklaruar ndryshimin** dhe per te plotesuar formularin e ndryshimeve ne regjistrim.
Shenim 13	Te dhenat e ketij formulari nxirren dhe **jane te barabarta me te dhenat e formularit** "Listepagesa e Sigurimeve Shoqerore, Shendetesore dhe Tatimit mbi te Ardhurat nga Punesimi" E-SIG 025/a, per periudhen tatimore korensponduese.
Shenim 14	**Per dorezimin me vonese te formularit ose per pagese te vonuar, zbatohen Interesa e Gjoba sipas ligjit.**

DEKLARATE E TATIMIT MBI TE ARDHURAT NGA BURIME TE TJERA

Perfituesi i te Ardhurave	Paguesi i të Ardhurave
Emri Mbiemri [1]_____ Adresa e Banimit [2] _____	Emri Mbiemri [3] _____ _____ Adresa [4] _____

Deklaroj nën përgjegjësinë time se të ardhurat që kam përfituar, mbi bazën e të cilave do të llogaritet dhe derdhet tatimi mbi të ardhurat personale në bazë të ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" janë:

Të ardhurat nga dhënia me qera		10 %	
Të ardhurat nga huatë		10 %	
Të ardhura nga pronësia intelektuale dhe të drejtat e autorit		10 %	
Të ardhurat me burim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë		10 %	
Të ardhuara të tjera		10 %	
SHUMA E TË ARDHURHURAVE QË DEKLAROHEN			

Shenim: Ne kete deklarate nuk perfshihen te ardhurat personale te realizuara, per te cilat tatimi eshte mbajtur ne burim sipas nenit 33 dhe paragrafit te pare te nenit 10 (te ardhura nga punesimi) te ligjit te cituar me siper.

DEKLARUESI

Data e Deklarimit: _____

_____
(emri, mbiemri, nenshkrimi)

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore	(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3)_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4)_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5)_____
Adresa: (6)_____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: (7)_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

Llogaritja e rezultatit

Te ardhurat dhe shpenzimet	Te ushtrimit	Tatimore
(8/9) Te ardhurat	(8)	(9)
(10/11) Shpenzimet	(10)	(11)
(12) Shpenzimet e pazbritshme		(12)
Rezultati		
(13/14) Humbja	(13)	(14)
(15/16) Fitimi	(15)	(16)
(17) Humbje e mbartur		(17)
(18) Fitimi i tatueshem neto (16-17)		(18)

Llogaritja e tatim fitimit

(19) Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte		(19)
(20) Tatim fitimi me perqindje te tjera		(20)
(21) Tatim fitimi (19+20)		(21)
(22) Tatim fitimi i shtyre	(22)	
(23) Parapagime	(23)	
(24) Tatim fitimi i mbipaguar	(24)	
(25) Tatimi fitimi i detyrueshem per tu paguar		(25)
(26) Denime / interesa per vonesa		(26)
(27) TOTALI PER TU PAGUAR		(27)

_____

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

PAGESA

Vetem per perdorim zyrtar

- ☐ **Leke**
- ☐ **Xhirim**
- ☐ **Cek**
- ☐ **Te tjera:**.....

SHUMA E PAGUAR: [ ]

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Zyra e Tatimeve
Kopja -Personi i Tatueshem

Udhezues per menyren e plotesimit te formularit

1. **Numri serial** gjenerohet nga Dega e Tatimeve dhe sherben per te azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata
2. **Periudha Tatimore** eshte vjetore
3. **Numri i Identifikimit te Personit te Tatueshem (NIPT)** eshte numri i dhene nga Dega e Tatimeve dhe qe identifikon personin e tatueshem ne te gjitha marredheniet me Degen e Tatimeve
4. **Emri Tregtar i Personit te Tatueshem** eshte emri me te cilin paraqitet veprimtaria dhe qe shenohet ne certifikaten e NIPT-it
5. **Emri,Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga nje person fizik dhe nuk ka emer tregtar
6. **Adresa** tregohet per vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise. Kjo adrese eshte treguar edhe ne certifikaten e NIPT-it
7. **Numri i Telefonit** (nqs ka) tregon numrin e telefonit ne vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise ekonomike
8. **Te ardhurat e ushtrimit** jane te ardhurat totale te periudhes ushtrimore
9. **Te ardhurat tatimore** jane te ardhurat qe i perkasin aktivitetit te tatueshem
10. **Shpenzimet e ushtrimit** jane shpenzimet totale te periudhes ushtrimore
11. **Shpenzimet tatimore** jane shpenzimet qe i perkasin aktivitetit te tatueshem
12. **Shpenzimet e pazbritshme** jane shpenzimet qe i perkasin aktivitetit te tatueshem dhe qe nuk njihen si te zbritshme per efekt te llogaritjes se fitimit te tatueshem
13. **Humbja e ushtrimit** eshte diferenca e shpenzimeve te ushtrimit (kutia 10) me te ardhurat e ushtrimit (kutia 8) ne rast se shpenzimet e ushtrimit jane me te medha se te ardhurat e ushtrimit
14. **Humbja tatimore** eshte diferenca e shpenzimeve tatimore (kutia 11) pasi te zbriten shpenzimet e pazbritshme (kutia12), me te ardhurat tatimore (kutia 9) ne rast se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme jane me te medha se te ardhurat e tatimore
15. **Fitimi i ushtrimit** eshte diferenca e te ardhurave te ushtrimit (kutia 8) me shpenzimet e ushtrimit (kutia 10) ne rast se te ardhurat e ushtrimit jane me te medha se shpenzimet e ushtrimit
16. **Fitimi tatimor** eshte diferenca te ardhurave tatimore (kutia 9), me shpenzimet tatimore (kutia 11) pasi jane zbritur nga keto te fundit shpenzimet e pazbritshme ne rast se te ardhurat tatimore jane me te medha se shpenzimet tatimore pa shpenzimet e pazbritshme.
17. **Humbje e mbartur** eshte humbja e mbartur nga periudhat paraardhese dhe qe njihet per efekte tatimore per tu mbuluar nga fitimet e periudhes qe deklarohet.
18. **Fitimi i Tatueshem Neto** eshte fitimi qe mbetet nga fitimi tatimor (kutia 16) pasi zbritet humbja e mbartur (kutia 17)
19. **Tatim fitimi me shkallen tatimore standarte** eshte eshte vlefta e tatim fitimit e llogaritur sipas vitit ushtrimor perkates, ne baze te ligjit Nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" (I ndryshuar)
20. **Tatim fitimi me perqindje te tjera** eshte shuma e tatimeve te llogaritura me perqindje te tjera (nese ka) ndaj fitimit te tatueshem neto sipas ligjeve te tjera te vecanta
21. **Tatim fitimi** eshte shuma e tatimit te llogaritur me shkallen tatimore standarte (kutia 19) me Tatim fitimin me perqindje te tjera (kutia 20)
22. **Tatim fitimi i shtyre** eshte shuma e llogaritur e tatim fitimit e cila per shkak te lehtesive tatimore (nese ka) nuk duhet te paguhet ne organet tatimore por vetem te rezervohet dhe te paguhet ne rast te thyerjes se kushtit per te cilin eshte perfituar lehtesia tatimore)
23. **Parapagime** eshte shuma e kesteve te parapagimit te tatim fitimit te paguara gjate periudhes tatimore
24. **Tatim fitimi i mbipaguar** eshte diferenca e parapagimeve (kutia 23) me tatim fitimin (kutia 21) pasi nga ky fundit te jete zbritur tatim fitimi i shtyre (kutia 22) , kur parapagimet jane me te medha se diferenca e tatim fitimit (kutia 21) me tatim fitimin e shtyre (kutia 22). (pra 23-(21-22) kur 23>(21-22))
25. **Tatim fitimi i detyrueshem per tu paguar** eshte diferenca e tatim fitimit (kutia 21) pasi te jete zbritur tatim fitimi i shtyre(kutia 22) me parapagimet (kutia 23) kur tatim fitimi (kutia 21) minus tatim fitimi i shtyre (kutia 22) eshte me e madhe se parapagimet (kutia 23). (pra (21-22)-23) kur 21-22>23)
26. **Denime/interesa per vonesa** jane denimet dhe interesat per vonesat ne deklarim ose pagese qe mund te llogariten paraprakisht dhe qe mund te paguhen me deklaraten
27. **Totali per tu paguar** eshte shuma e tatim fitimit te detyrueshem per tu paguar (kutia 25) me denimet dhe interesat e llogaritura me deklaraten (kutia 26)

DEKLARATA ANALITIKE PER TATIMIN MBI TE ARDHURAT

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

NIPT _____
Emri Tregtar _____
Adresa _____

Periudha tatimore
_____

EMERTIMI	Sipas Bilancit	Fiskale
Totali i të ardhurave	(1)	(2)
Totali i shpenzimeve	(3)	(4)
Total shpenzimet e pazbritshme sipas ligjit (neni 21):		(5)
[a] kosto e blerjes dhe e përmiresimit të tokës dhe të truallit		(6)
[b] kosto e blerjes dhe e permiresimit per active objekt amortizimi		(7)
[c] zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqerisë ose kontributit të secilit person në ortakëri		(8)
[ç] vlera e shperblimeve ne natyrë		(9)
[d] kontributet vullnetare të pensioneve		(10)
[dh] dividentet e deklaruar dhe ndarja e fitimit		(11)
[e] interesat e paguara mbi interesin maksimal të kredisë të caktuar nga Banka e Shqiperisë		(12)
[ë] gjobat, kamat-vonesat dhe kushtet e tjera penale		(13)
[f] krijimi ose rritja e rezervave e fondeve të tjera		(14)
[g] tatim mbi të ardhurat personale, akciza, tatimi mbi fitimin dhe tatimi mbi vleren e shtuar të zbritshme		(15)
[gj] shpenzimet e përfaqësimit, pritje percjellje		(16)
[h] shpenzimet e konsumit personal		(17)
[i] shpenzime të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj		(18)
[j] shpenzime për dhurata		(19)
[k] çdo lloj shpenzimi, masa e te cilit nuk vertetohet me dokumenta		(20)
[l] interesi i paguar kur huaja dhe parapagimet tejkalojne kater here kapitalin themelor		(21)
[ll] nëse baza e amortizimit është një shumë negative		(22)
[m] shpenzime për shërbime teknike, konsulence, manaxhim të palikujduara brënda periudhës tatimore		(23)
[n] Amortizim nga rivleresimi i aktiveve të qendrueshme		(24)
Rezultati i Vitit Ushtrimor:		
- Humbja	(25)	(26)
- Fitimi	(27)	(28)
Humbja për tu mbartur nga 1 vit me parë		(29)
Humbja për tu mbartur nga 2 vite me parë		(30)
Humbja për tu mbartur nga 3 vite me parë		(31)
Shuma e humbjes për tu mbartur në vitin ushtrimor	(32)	(33)
Shuma e humbjeve që nuk barten për efekt fiskal		(34)

Fitimi i tatueshem		(35)
Tatim fitimi i llogaritur		(36)
Zbritje nga fitimi (rezervat ligjore)	(37)	(38)
Fitimi neto per tu shperndare nga periudha ushtrimore		(39)
Fitimi neto per tu shperndare nga vitet e kaluar		(40)
Shtese kapitali nga fitimi		(41)
Dividente per tu shperndare		(42)
Tatimi mbi dividentin i llogaritur		(43)

Llogaritja e Amortizimit

Ne total llogaritja e amortizimit vjetor =(a+b+c+d)	(44)	(45)
a.Ndertesa e makineri afat gjate	(46)	(47)
b.Aktive te patrupezuara	(48)	(49)
c.Kompjuterat dhe sisteme informacioni	(50)	(51)
d.Te gjitha aktivet e tjera te aktivitetit	(52)	(53)
Tatimi i mbajtur ne burim ne zbatim te nenit 33		(54)

Data dhe Nënshkrimi i personit të tatueshëm -Deklaroj nga përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë

Udhezues per menyren e plotesimit te Deklarates Analitike

1. Totali i te ardhurave ne fushen (1)jane te ardhurat sipas bilancit te periudhen ushtrimore.
2. Totali i te ardhurave ne fushen (2) jane te ardhurat sipas fushes (1) me ndonje korektim nese ka per efekt fiskal.
3. Totali i shpenzimeve ne fushen (3) jane shpenzimet sipas bilancit ne periudhen ushtrimore.
4. Ne fushen (4) plotesimi i njejte me fushen (3)
5. Ne fushen (5) totali i shpenzimeve te pazbriteshme sipas ligjit fiskal, duhet plotesuar totali i shpenzimeve nga fusha (6) ne fushen(24).
6. Ne fushat nga nr (6) deri ne nr (24) do vendoset diferenca per efekt fiskal e shpenzimeve
7. Ne deklaraten analitike fushat qe nuk permbjane nr do te lihen te paplotesuara.
8. Ne fushen (25) humbja sipas bilancit do plotesohet diferenca kur totali ne fushen (1) eshte me i vogel se totali ne fushen (3).
9. Ne fushen (26) do vendoset diferenca midis totalit te fushes (2) me fushen(4) duke shtuar totalin ne fushen (5).
10. Ne fushen (27)fitimi sipas bilancit do te vendoset diferenca midis totalit ne fushen (1)totali i te ardhurave me totalin e shpenzimeve ne fushen (3)
11. Ne fushen (28) do vendoset diferenca midis totalit ne fushen (2) me totalin ne fushen (4) duke shtuar totalin e shpenzimeve te panjohura ne fushen (5)
12. Ne fushat me nr (29), (30) dhe (31) do te vendosen totalet e humbjeve te mbartura deri ne tre vite me pare.
13. Ne fushen (32) do vendoset totali i humbjes per tu mbartur ne vitin ushtrimor mbeshtetur ne rezultatin e ushtrimit sipas bilancit.
14. Ne fushen (33) do vendoset totali i humbjes per tu mbartur ne vitin ushtrimor mbeshtetur ne rezultatin fiskal te ushtrimit.
15. Ne fushen (34)do vendoset shuma e humbjeve qe nuk mbartet pasi ka kaluar afati 3 vjeçar i ligjit.
16. Ne fushen (35) fitimi i tatueshem do vendoset diferenca midis totalit ne fushen (28) Fitimi fiskal, me totalin e fushes (33), shuma e humbjes per tu mbartur ne vitin ushtrimor.
17. Ne fushen (36) tatim fitimi i llogaritur do vendoset totali qe rezulton nga shumezimi i fitimit te tatueshem, fusha (35) me perqindjen e caktuar te tatimit mbi fitimin.
18. Ne fushat (37) dhe (38) do vendosen totalet e rezervave ligjore te zbriteshme nga fitimi sipas bilancit apo nga fitimi fiskal.
19. Ne fushen (39) fitimi neto per tu shperndare nga periudha ushtrimore do vendoset diferenca midis fitimit te tatueshem fusha (35) me tatim fitimin e llogaritur(36) duke zbritur totalin e fushes (38) rezervat ligjore.
20. Ne fushen (40)fitimi neto per tu shperndare nga vitet e kaluara do vendoset fitimi i viteve te te kaluara i pa shperndare.
21. Ne fushen (41) shtese kapitali nga fitimi do vendoset totali i fitimit cili eshte caktuar per te kaluar ne shtese te kapitalit.
22. Ne fushen (42) dividente per tu shperndare do vendoset totali i dividenteve per tu shperndare qe rezulton nga diferenca e fushes (39)+(40)-(41)
23. Ne fushen (43) tatimi mbi dividentin do vendoset totali i dale nga shumezimi i totalit te fushes (42) me 10% e tatimit mbi dividentin.
24. Ne fushen (44) totali i amortizimit vjetor do te vendoset shuma e shpenzimeve te amortizimit vjetor sipas bilancit , per te kater grupet e aktiveve sipas normave te amortizimit jofiskale.
25. Ne fushen (45) totali i amortizimit fiskal do vendoset shuma e shpenzimeve te amortizimit vjetor sipas normave te ligjit fiskal per te kater grupet e aktiveve.
26. Ne fushen (54) Tatimi i mbajtur ne burim do vendoset totali i tatimit te mbajtur ne burim nga personi juridik(deklarues) per pagesat e bera te treteve qe jane objekt i tatimit te mbajtur ne burim sipas nenit 33 te ligjit.

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Ju lutem lexoni shenimet ne faqen 4 para se te plotesoni formularin.
Perdorni germa KAPITALE.

NIPT-i
Shih Shenimi 1

Emri tregtar i regjistruar

Detaje te ndryshimit

C'fare ndryshimesh po njoftoni?

Zgjidhni kutine e duhur dhe vazhdoni sipas udhezimit

Kujdes, duhet te plotesoni vetem ndryshimet.

Ndryshim ne detajet e regjistruarimit	☐	***Shko ne Seksionin 1 me poshte.***
Ndryshim i pergjegjesise per tatimet	☐	***Shko ne Seksionin 2, ne faqe 2.***
Ndryshim ne statusin juridik	☐	***Shko ne Seksionin 3, ne faqe 2***
Mbyllje e aktivitetit	☐	***Shko ne Seksionin 4, ne faqe 3***
Ndryshim i kategorizimit per sigurimet shoqerore	☐	***Shko ne Seksionin 5, ne faqe 3***

Seksioni 1

[2] Emri i ri tregtar
Shih shenimi 2

[3] Emri i drejtuesit te ri
Shih shenimi 3

[4] Adresa re drejtuesit
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

[5] Pronesia dhe forma ligjore

Shih shenimi 4

Shqiptare private	☐	Shqiptare shteterore	☐	E huaj	☐	E perbashket	☐
Person fizik	☐	Kolektive	☐	Komandite	☐	Trup diplomatik	☐
Sh.p.k	☐	Ortakeri	☐	Anonime	☐	Ent publik	☐
						OJF	☐

[6] Adresa kryesore
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

E mail

[7] Aktiviteti
Shih Shenimi 5

,ese biznesi juaj vepron nga me shume se nje adrese dhe detajet kane ndryshuar, jepni informacion me poshte. **Ju duhet te ktheni tifikaten e NIPT-it per adresen qe eshte mbyllur.Per adresen ekzistuese mund te shenoni vetem numrin e ri te telefonit ose Llojin ri te veprimtarise.** *Shih shenimi 6.*

Ndryshime ne Adrese ekzistuese
Shenim 6

Numri i certificates

Telefoni

Lloji i veprimtarise

Adrese e mbyllur
Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Certifikata bashkengjitur, *zgjidh kutine.* ☐ Numri i certifikates

Adrese e re

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Telefoni

Nese ka me shume se nje adrese, vazhdoni me Formularin 3

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese

Seksioni 2

Zgjidh kutine e duhur

[9] Per cilin tatim jeni pergjegjes **tani**?
Shih shenimi 7

- ☐ Vetem NIPT
- ☐ Tatim fitimi
- ☐ TVSH
- ☐ Aksiza
- ☐ Sigurimet Shoqerore
- ☐ Sigurimet Shendetesore
- ☐ Te Ardhurat nga Punesimi
- ☐ Tatim fitimi i thjeshtuar
- ☐ Lojrat e fatit
- ☐ Taksat nacionale
- ☐ Taksa vendore

Jepni tatimin dhe qarkullimin e parashikuar me poshte

Qarkullimi i parashikuar

Tatimi i parashikuar

Seksioni 3

[10] Nese jeni kthyer ne person Juridik
Shih shenimi 8

- **Plotesoni seksionin 4**
- **Plotesoni nje formular te ri regjistrimi**

,ksioni 4

.1] Data e mbylljes
Shih shenimi 9

Zgjidh kutine e duhur

Arsyeja e mbylljes — Shitur ☐ Mbyllur ☐ Transferuar ☐ Kalim ne pasiv ☐

Kur veprimtaria shitet ose transferohet, emri i pronarit te ri dhe adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Vertetim i transferimit

Une vertetoj qe kjo veprimtari me eshte transferuar mua . Une e pranoj transferimin dhe e kuptoj qe jam pergjegjes per te gjitha detyrimet e TVSH qe lidhen me kete biznes.

Nenshkruar ..... (Pronari i ri) Data.....

Seksioni 5

[12]
Kategoria per efekt sigurimesh
Shenim 10

- ☐ Punedhenes
- ☐ I vetepunesuar (I vetem)
- ☐ I vetepunesuar me punemarres
- ☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes
- ☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes

Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur eshte i plote dhe i sakte.

(Emri, nenshkrimi dhe data

Nese veproni si perfaqsues fiskal ,

Per perdorim zyrtar

[13]
Perjashtime dhe lehtesi tatimore

Kodi	Tatimi	Kodi i lehtesise	Pershkrimi i lehtesise	Data fillimit	Data mbarimit

Kodi Fiskal — Kodi Ekonomik

Verifikuar nga ..(Emri) (Nenshkrimi) Kodi Data

Njoftim i ndryshimeve ne regjistrim

Këtë formular duhet t'a përdorni për të njoftuar organin tatimor për ndonjë ndryshim që ndikon në regjistrimin tuaj. Duhet të njoftoni vetëm ndryshimet në të dhënat që keni raportuar në kërkesën për regjistrim. Për të bërë këto njoftime ekzistojnë disa kufinj kohorë. Nëse kryeni blerje ose shitje të tërë shoqërisë tregtare apo pjese të saj duhet të njoftoni menjëherë organin tatimor. Për ndryshi-met e tjera, njoftimi duhet bërë brenda 15 ditësh nga momenti i kryerjes së ndryshimit.

Plotesimi i formularit

Shenim 1 : Shkruani NIPT-i dhe dhe emrin e subjektit.

Shenimi 2 : jepni emrin e ri të subjektit.

Shenimi 3 : Nëse kemi një ndryshim në ortakun kryesor apo drejtorin, apo një tjetër person është tashmë i autorizuar të veprojë në emër të subjektit, shënoni të dhënat e personit të ri, duke përfshirë emrin dhe adresën e plotë postare të banesës private.

Shenimi 4 : Tregoni statusin e ri ose tipin e shoqërisë tregtare.

Shenimi 5 : Nëse veprimtaria ekonomike kryesore e subjektit ndryshon, shënoni këtu hollësitë.

Shenimi 6 : Për çdo degë të subjektit lëshohet një çertifikatë NIPT-i. e re. Numri i Identifikimit të Personi të Tatueshëm (NIPTi) me të cilin jeni i pajisur nuk ndryshon, por çertifikatat do të kenë të gjitha nga një numër unik. Nëse numri i telefonit të njërës nga degët e firmës tuaj ndryshon, ju duhet të shënoni numrin e ri duke shënuar **numrin e çertifikatës** të NIPT-it (jo vetëm NIPT-in).

Nëse një degë ekzistuese e shoqërisë tregtare mbyllet **ju duhet të ktheni çertifikatën e NIPT-it ne degen e tatimeve.** Anasjelltas, kur hapet një degë e re, organi tatimor do të lëshojë një çertifikatë NIPT-i në lidhje me atë degë.

Pasi të keni hapur degën e re, jepni të dhënat e veprimtarisë së biznesit që ushtrohet aty. Nëse nuk keni hapsirë të mjaftueshme për të gjithë informacionin, përdorni Shtojcen A.

Shenimi 7 : Spontoni kutinë përkatëse për të gjktha tatimet per te cilat cilin detyroheni të deklaroni dhe/ose paguani **tani,** dhe shënoni të dhënat lidhur me tatimin e parashikuar dhe qarkullimin. Nëse nuk kryeni veprimtari tregtare por që gjithësesi dëshironi të mbani një NIPT, duhet të kontaktoni degën tatimore për t'u këshilluar.

Nëse qarkullimi për vitin e fundit kalendarik e tejkalon vlerën prej 8 milion lekë, ju duhet të bëni kërkesë për t'u regjistruar për Tatimin mbi Fitimin dhe TVSH-në përpara datës 15 Janar të vitit pasardhës. Mos vononi, në të kundërt do të penalizoheni me gjobë. Nëse qarkullimi juaj për vitin e fundit kalendarik bie nën 8 milion lek, ju mund të bëni kërkesë që të paguani Tatim-Fitimin e Thjeshtuar dhe Tatimin Vendor mbi Biznesin e Vogël. Sidoqoftë, ju mund të vazhdoni të jeni i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin dhe TVSH-në nëse kjo ju sjell më shumë dobi.

Shenimi 8 : Nëse keni ndryshuar statusin tuaj juridik, një ndryshim i tillë përbën një mbyllje të një veprimtarie ekonomike dhe fillim të një veprimtarie tjetër, dhe për veprimtarinë e re duhet të plotësoni formularin Kërkesë për Regjistrim. Ktheni bashkë me formularin edhe çertifikatat.

Shenimi 9 : Nëse veprimtaria ekonomike është ndërpreë, shënoni datën e ndërprerjes dhe spontoni kutinë përkatëse për të dhënë arsyen e mbylljes së veprimtarisë.

Nëse e keni transferuar veprimtarinë ekonomike si ndryshim në pronësi, qoftë me anë të shitjes apo dhurimit, shënoni datën e ndërprerjes dhe jepni hollësitë e pasardhësit tuaj. Pasardhësi juaj duhet të firmos çertifikatën, duke pranuar përgjegjësinë për detyrimet e TVSH në lidhje me veprimtarinë e transferuar.

Shenimi 10 : nese kategorizimi juaj per efekt te sigurimeve shoqerore ka ndryshuar, zgjidhni vetem njeren nga kutite perkatese , per kategorine qe ju keni tashme.

Detyrimet ne te ardhmen

Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni degen e tatimeve ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni degen e tatimeve ose lexoni *www.tatime.gov.al.*

Lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Rruga 'Mustafa Lleshi', Nr 5, Tiranë

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Kerkese per Regjistrim

NIPT-i

(1) Emri Tregtar

(2) Administratori

(3) Adresa administratorit
Rruga dhe numri
Qyteti ose fshati
Rrethi
See Note 5

(4) Pronesia — Shqiptare private ☐ Shqiptare shteterore ☐ E huaj ☐ E perbashket ☐

(5) Forma ligjore — Person fizik ☐ Kolektive ☐ Komandite ☐ Trup diplomatik ☐

sh.p.k. ☐ Ortakeri ☐ Anonime ☐ Ent publik ☐ OJF ☐

(6) Adresa kryesore
Rruga dhe numri
Qyteti ose fshati
Rrethi

Telefoni — E mail

(7) Aktiviteti

(8) Kodi ekonomik — ***Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve*** — (9) Data e krijimit

(10) Jam i regjistruar per :

- ☐ Vetem NIPT
- ☐ Tatim fitimi
- ☐ TVSH
- ☐ Aksiza
- ☐ Sigurimet Shoqerore
- ☐ Sigurimet Shendetesore
- ☐ Te Ardhurat nga Punesimi
- ☐ Tatim fitimi i thjeshtuar
- ☐ Lojrat e fatit
- ☐ Taksat nacionale
- ☐ Taksa vendore ***(Ploteso Shto-jcen B)***

(11) Xhiro parashikuar — (12) Tatimi i parashikuar ***(Tatim fitimi ose tatim fitimi thjeshtuar)***

)
ategoria per efekt
gurimesh

- ☐ Punedhenes
- ☐ I vetepunesuar (I vetem)
- ☐ I vetepunesuar me punemarres
- ☐ I vetepunesuar me punemarres dhe punonjes te papaguar te familjes
- ☐ I vetepunesuar pa punemarres me punonjes te papaguar te familjes

(14) Adre-
sat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi

(15)
Shoqeria nga varet

Nipt-i | | | | | | | | | | | Rrethi | |

(16) Deklarim

Deklaroj qe informacioni i dhene ne kete formular dhe ne formularin e bashkengjitur
Shtojca A ☐ dhe/ose Shtojca B ☐ eshte i sakte

(17) Emri, nenshkrimi
dhe data

Per perdorim zyrtar

(18) Perjashtime dhe
lehtesi tatimore

Kodi	Tatimi	Kodi I lehtesise	Pershkrimi I lehtesise	Data fillimit	Data mbarimit

(19) Tatime te tjera per
te cilat biznesi
eshte pergjegjes

Kodi	Tatimi	Tipi I pergjegjesise (0—=tatimpagues,1=agjent tatimor,2=perfaqesues fiskal)

Verifikuar nga ..Emri Nenshkrimi Kodi Data

Ministria e Financave
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Adresa te tjera shtese (Shtojca A)

NIPT-i | | | | | | | | | | |

(14) Adresat e tjera

Rruga	Nr	Qyteti ose Fshati	Rrethi	Nr. certifikates

Ministria e Financave

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

(NVD)

Te perdoret vetem per taksen vendore per biznesin e vogel

Detaje te aktivitetit per cdo adrese (Shtojca B)

NIPT-i

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

(20) Adresa

Rruga dhe numri

Qyteti ose fshati

Rrethi

Lloji i veprimtarise se kryer ne kete adrese, dhe qarkullimi total per secilen veprimtari .

Çdo subjekti i kërkohet të regjistrohet në Degen e Tatimeve dhe të pajiset me Numrin e Identifikimit të Personit të Tatueshëm (NIPT). Kërkesa për regjistrim duhet të bëhet përpara se veprimtaria ekonomike të fillojë. Cilido person që është i detyruar të regjistrohet dhe nuk regjistrohet ka kryer një shkelje dhe për këtë do të paguajë denimin perkates.

Plotesimi i formularit
Fusha e pare e formularit eshte fusha e NIPT-it. Kjo fushe plotesohet nga organet tatimore.

(1) **Emri tregtar :** jepni emrin e plote Duhet të jepni emrin e plotë të shoqërisë tregtare siç tregohet në dokumentin e regjistrimit në Gjykatë - ky mund të jetë emri juaj ose i shoqërisë tregtare.
(2) **Administratori :** jepni emrin e pronarit të shoqërisë. Nëse jeni një person fizik, ky do të jetë emri juaj. Në të kundërt, jepni emrin e ortakut kryesor ose drejtorit, ose emrin e personit të autorizuar për të vepruar në emër të shoqërisë.
(3) **Adresa e administratorit** : jepni adresen e plote personale te administratorit emri i te cilit eshte paraqitur me lart.
(4) **Pronesia** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(5) **Forma ligjore** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(6) **Adresa kryesore** : jepni adresen ne te cilen ushtroni veprimtarine ekonomike. Nese keni me shume se nje vendodhje te veprimtarise ekonomike duhet te caktoni njeren prej tyre si adrese kryesore. Nese jeni ambulant, zejtar apo nje subjekt qe merret me transport, pra pa vend fizik te biznesit, jepni adresen tuaj private. Jepni numrin e telefonit, dhe adresen e postes elektronike nese keni, ne menyre qe te mund t'ju njoftojme per ndryshimet e mundshme qe mund te ndikojne mbi ju.
(7) **Aktiviteti** : kepni pershkrimin me fjale te aktivitetit tuaj ekonomik.
(8) **Kodi ekonomik** : kjo fushe plotesohet nga zyra e tatimeve mbi bazen e "Nomenklatures se veprimtarive ekonomike"
(9) **Data e krijimit** : jepni daten e regjistrimit ne Gjykate.
(10) **Jam i regjistruar per** : zgjidhni te gjitha kutite per tatimet qe jeni te detyruar te paguani. Ne rast se nuk paguani asnje tatim, por regjistroheni vetem per te marre nje numer identifikimi zgjdhni kutine—Vetem NIPT– . Ne rast veshtiresie kerkoni ndihmen e inspektoreve te regjistrimit ne zyren e tatimeve. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel duhet te plotesoni shtojcen B te formularit te Kerkeses per Regjistrim.
(11) **Xhiro parashikuar** : jepni xhiron qe parashikoni te realizoni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik.
(12) **Tatim parashikuar** : jepni tatim fitimin ose tatim fitimin e thjeshtuar qe parashikoni te realizoni ne vitin e pare te aktivitetit tuaj ekonomik. Kete fushe duhet ta plotesoni vetem nese kerkoni te regjistroheni per nje nga keta tatime.
(13) **Kategoria per efekt sigurimesh** : zgjidhni vetem njeren nga kutite per te treguar pozicionin e subjektit tuaj.
(14) **Adresat e tjera** : nese subjekti juaj operon ne me shume se nje adrese, duhet qe ne kete tabele te jepni te dhenat e seciles adrese, me perjashtim te adreses kryesore. Nese nuk keni vend te mjaftueshem ne formular duhet te plotesoni shtojcen A. Nese regjistroheni per taksen vendore per biznesin e vogel, duhet te plotesoni shtojcen B per secilen adrese,perfshi dhe adresen kryesore.Per secilen nga adresat ju do te pajiseni me certifikaten e regjistrimit.
(15) **Shoqeria nga varet** : nese shoqeria juaj varet nga nje shoqeri tjeter, jepni NIPT-in dhe rrethin ku eshte regjistruar kjo shoqeri.
(16) **Deklarim** : zgjidhni kutite perkatese nese keni plotesuar shtojcen A dhe/ose shtojcen B te ketij formulari.
(17) **Nenshkrimi dhe data** : Deklarimi duhet te behet nga pronari ose personi i autorizuar te veproje ne emer te subjektit.Ligji parashikon denime ne rastet e deklarimit te pasakte apo dezinformues.
(18) **Perjashtime dhe lehtesi tatimore** : kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(19) **Tatime te tjera per te cilat biznesi eshte** pergjegjes : Kjo fushe plotesohet nga inspektori i tatimeve.
(20) **Detaje te aktivitetit per cdo adrese** : kjo fushe ndodhet ne shtojcen B te formularit dhe plotesohet vetem nga subjektet qe regjistrohen per taksen vendore per biznesin e vogel. Jeprni cdo adrese ku zhvilloni veprimtarine tuaj, perfshi dhe adresen kryesore, dhe per secilen adrese jepni aktivitetin apo aktivitetet ekonomike qe zhvilloni ne te sipas klasifikimit te meposhtem :

- Shites me pakice -Shites me shumice -Prodhues -Sherbime - Profesione te lira -Ambulante dhe zejtare dhe qarkullimin per cdo aktivitet.

Ne rast se ushtroni veprimtari transporti paraqisni tipin e mjetit sipas tabeles

Transport pasagjeresh	**Transport mallrash**	**Transport detar**
Deri ne 5 vende,perfshi shoferin	Deri ne 2 ton	Transport detar brenda vendit
6 deri 9 vende,perfshi shoferin	2.1 deri 5 ton	Transport ne liqen brenda vendit
10 deri 25vende,perfshi shoferin	5.1 deri 10 ton	Varka per shetitje
26 deri 42 vende,perfshi shoferin	10.1 deri 16 ton	

Detyrimet ne te ardhmen
Per cdo ndryshim ne te dhenat e raportuara ne kete formular duhet te njoftoni degen e tatimeve ku jeni regjistruar, dhe te plotesoni formularin e Ndryshimeve ne Regjistrim, qe do ta gjeni ne zyren e tatimeve. Per cdo ndihme apo informacion shtese kontaktoni degen e tatimeve ose lexoni *www.tatime.gov.al.*

Ministria e Financave NVD

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

Urdhër pagesë

Data e pagesës | | | | NIPT | | | | | | | | | |

Emri

Adresa
Rruga dhe numri

Qyteti ose Komuna

Pagesë e listuar Tatim mbi Fitimin ☐ Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin ☐ Taksa Vendore mbi Biznesin e Vogël ☐

Pagesa të tjera Motivi..... Tipi i tatimit (nëse është rasti.....

Vlefta e detyrimit

Për përdorim nga Banka

Mënyra e pagesës
Të holla ☐ Çek ☐ Transferta ☐ Tjetër (specifiko) .....

Shuma (me fjalë) .....

Pranuar nga ..... (emri i arkëtarit të bankës)

Vula e bankës

Formulari E-TBV 020/a

Ministria e Financave NVD

Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve

Urdhër pagesë

Data e pagesës | | | | NIPT | | | | | | | | | |

Emri

Adresa
Rruga dhe numri

Qyteti ose Komuna

Pagesë e listuar *Tatim mbi Fitimin* ☐ *Tatimi i Thjeshtuar mbi Fitimin* ☐ Taksa Vendore mbi Biznesin e Vogël ☐

Pagesa të tjera *Motivi*..... *Tipi i tatimit (nëse është rasti*.....

Amount due

Nëse vonohet pagesa e vlefës së detyrimit do të mbahen shtesa

Për përdorim nga Banka

Mënyra e pagesës
Të holla ☐ Çek ☐ Transferta ☐ Tjetër (specifiko) .....

Shuma (me fjalë) .....

Pranuar nga ..... (emri i arkëtarit të bankës)

Vula e bankës

Formulari E-TBV 020/a

Seria: 00

LIBRI I BLERJES

E-TBV- 010

Nr 000000

Viti _____ Muaji _____

Date	Blerja Mallrave [illegible]	Shpenzime te tjera	Shenime
1	2	3	4

Seria 00 **Nr 000000**

LIBRI I SHITJEVE (Qarkullimit)

E-TBV-011

Viti _____ Muaji _____

Numri Rendor	Data e muajit	SHITJET			Totali Ditor
		Me Fature te Thjeshte Tatimore	Me Kupon Kase	Me Deftese Tatimore	
1	2	3	4	5	6

Seria : 00

FATURE E THJESHTE TATIMORE

Nr. _____ Datë _____

Shitësi ..... (emri i subjektit)

Nr 000000

NIPT | | | | | | | | | | |

Adresa.....

Blerësi ..... (emri i subjektit)

NIPT | | | | | | | | | | |

Adresa.....

Transportuar me mjetin .....
Tipi ..... Targë .....
Prona e shitësit/blerësit .....

Transportuar nga ....
Tipi ..... Targë .....
Emri/Mbiemri .....
NIPT .....

Nr. Rend.	Lloji i mallit apo i shërbimit	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefta
	TOTALI				

Emri dhe nënshkrimi i shitësit

(.....)

Vula

a) faqe 1: Origjinali - Blerësi
b) faqe 2: Shitesi

Emri dhe nënshkrimi blerësit

(.....)

Formulari E-TBV 055/a

Shenim: Kjo faturë lëshohet nga çdo subjekt përfshirë personat juridikë, fizikë tregtare dhe çdo ent shteteror ose privat, të cilët nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së.

Seria : 00 **Nr 000000**

DEFTESE TATIMORE

E-TBV-013

Nr _____ Date _____

Shitesi : _____
NIPT: _____
Adresa: _____

Nr Rendor	Lloji i mallit ose sherbimi	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlefta
TOTALI					

Emri dhe firma e shitesit

(_____)

Shenim: Kjo deftese zevendeson kuponin e kases dhe leshohet nga subjektet per shitjet me pakice te mallrave ose sherbimeve, ne rastet kur:
- subjekti ne baze te dispozitave ne fuqi nuk eshte i detyruar te paiset me kase regjistsruese
- subjekti, per arsye objektive (mungese energjie elektrike, prishje e kases regjistruese) nuk mund te leshoje kupon tatimor nepermjet kases regjistruese.

FORMULAR I DEKLARIMIT TE QARKULLIMIT TE BISNESIT TE VOGEL

E-TBV-014

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) (Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore

(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): (3)_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: (4)_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: (5)_____
Adresa: (6)_____
Qyteti/Komuna/Rrethi:
Numri Telefonit: (7)_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

(8) ☐ Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

[A] Qarkullimi faktik i vitit te kaluar (9)

[B] Qarkullimi i planifikuar i vitit ne vazhdim (10)

[C] Tatimi per tu paguar per vitin ne vazhdim (11)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

_____

Shenim: Ne kutine 11, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per t'u paguar per vitin ne vazhdim, te vendoset shuma vjetore e ketij tatimi qe rezulton *nga shumezimi I qarkullimit te planifikuar sipas* kutise 10 me tarifen e tatimit te thjeshtuar mbi fitimin prej 3%.

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE PAGESES SE TATIMIT TE THJESHTUAR MBI FITIMIN

Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) (Vetem per perdorim zyrtar)

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E FINANCAVE

(2) Periudha tatimore	(1) Numri Serial: _____

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT):	**(3)**_____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:	**(4)**_____
Emri Mbiemri i Personit Fizik:	**(5)**_____
Adresa:	**(6)**_____
Qyteti/Komuna/Rrethi:	_____
Numri Telefonit:	**(7)**_____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

(8) ☐ Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

(9) Importe		(9)
(10) Blerje brenda vendit		(10)
(11) Eksporte		(11)
(12) Shitje brenda vendit		(12)
(13) Totali i shitjeve		(13)
(14) Tatim fitimi i thjeshtuar		(14)
(15) Parapagime	(15)	
(16) Tatimi i mbipaguar	(16)	
(17) Tatimi i mbetur per tu paguar		(17)
(18) Denime / interesa per vonesa		(18)
(19) TOTALI PER TU PAGUAR		(19)

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

Vetem per perdorim zyrtar

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Cek

☐ Te tjera:.....

PAGESA

SHUMA E PAGUAR: ☐

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nepunesit te bankes

Origjinali - Zyra e Tatimeve
Kopja -Personi i Tatueshem

Udhezues per menyren e plotesimit te formularit

1. **Numri serial** gjenerohet nga Dega e Tatimeve dhe sherben per te azhornuar regjistrimet kur paraqitet deklarata

2. **Periudha Tatimore** eshte vjetore, ose pjese e vitit ne rast mbyllje te aktivitetit.

3. **Numri i Identifikimit te Personit te Tatueshem (NIPT)** eshte numri i dhene nga Dega e Tatimeve dhe qe identifikon personin e tatueshem ne te gjitha marredheniet me Degen e Tatimeve

4. **Emri Tregtar i Personit te Tatueshem** eshte emri me te cilin paraqitet veprimtaria dhe qe shenohet ne certifikaten e NIPT-it

5. **Emri,Mbiemri i Personit Fizik** vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga nje person fizik dhe nuk ka emer tregtar

6. **Adresa** tregohet per vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise. Kjo adrese eshte treguar edhe ne certifikaten e NIPT-it

7. **Numri i Telefonit** (nqs ka) tregon numrin e telefonit ne vendin kryesor te ushtrimit te veprimtarise ekonomike

8. **Pa veprimtari** zgjidhet vetem nese nuk eshte kryer aktivitet gjate periudhes per te cilen behet deklarimi.Vendosni nje kryq ne kutine 8, firmoseni deklaraten dhe paraqiteni ne banke.

9. **Importe** jane importet gjithsej gjate periudhes per te cilen behet deklarimi.

10. **Blerje brenda vendit** jane blerjet brenda vendit gjithsej gjate periudhes per te cilen behet deklarimi.

11. **Eksporte** jane eksportet gjithsej gjate periudhes per te cilen behet deklarimi.

12. **Shitje brenda vendit** eshte shitjet brenda vendit gjithsej gjate periudhes per te cilen behet deklarimi.

13. **Totali i shitjeve** eshte shuima e eksporteve me blerjet brenda vendit (13 = 11 + 12).

14. **Tatim fitimi i thjeshtuar** eshte shuma e tatimit te llogaritur sipas vitit ushtrimor perkates, ne baze te ligjit Nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" (I ndryshuar)

15. **Parapagime** eshte shuma e kesteve te parapagimit te tatim fitimit te thjeshtuar te paguara per periudhen tatimore per te cilen behet deklarimi.

16. **Tatim fitimi i mbipaguar** eshte diferenca e parapagimeve (kutia 15) me tatim fitimin e thjeshtuar (kutia 14) , kur parapagimet jane me te medha se tatim fitimi i thjeshtuar . (pra 15-14 kur 15 > 14)

17. **Tatimi i mbetur per tu paguar** eshte diferenca e tatim fitimit te thjeshtuar (kutia 14) me parapagimet (kutia 15) kur tatim fitimi i thjeshtuar eshte me i madh se parapagimet . (pra 14-15 kur 14>15)

18. **Denime/interesa per vonesa** jane denimet dhe interesat per vonesat ne deklarim ose pagese qe mund te llogariten paraprakisht dhe qe mund te paguhen me deklaraten

19. **Totali per tu paguar** eshte shuma e tatim fitimit te detyrueshem per tu paguar (kutia 17) me denimet dhe interesat e llogaritura me deklaraten (kutia 18). (19=17+18)

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".
Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

1. **REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
2. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
3. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN PUBLIK……. 1500
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005) ……. 600
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vellimi i II-të)..... 1500
4. TAKSAT DHE TATIMET…(suplement 2006)……..... 1500

1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT…… 1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT…… 2000

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…… 500
2. KODI DOGANOR……..... 1000
3. KODI DETAR …… 1000

Doli nga shtypi më 21.2.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 300 lekë